

ZIBER LATA

# PËRSIATJE KURANORE

SURJA EL-FATIHA DHE 10 SURET E FUNDIT



SHKUP, 2018

<i>TITULLI:</i>	PËRSIATJE KURANORE
<i>AUTOR:</i>	ZIBER LATA
<i>REDAKTOR PROFESIONAL:</i>	METIN IZETI
<i>REDAKTOR GJUHËSOR:</i>	NAZIF ZEJNULLAHU
<i>BOTUESI:</i>	ZIBER LATA
<i>KOPERTINA:</i>	HALIL BERISHA

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент  
Охридски", Скопје

28-23-277

LATA, Ziber

Përsiatje kuranore: surja el-fatiha dhe 10 suret e fundit /  
Ziber Lata. - Diber: Z. Lata, 2018. - 243 стр.; 21 см

Фусноти кон текстот. - Регистар. - Библиографија: стр.  
239-241

ISBN 978-608-245-263-0

а) Куран - Толкувања  
COBISS.MK-ID 105624842

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
NE PËR KURANIN DHE KURANI PËR NE .....	9
HYRJE.....	13
Nivelet e shpjegimit të Kuranit .....	16
ISTIADHJA – الأِسْتِغَاذَةُ .....	21
Ligjërimi në kohën e tashme .....	25
Relacioni i istiadhes me leximin e Kuranit.....	28
Istiadhja është simbol i suksesit dhe i modestisë .....	30
Nevoja për të Domosdoshmin .....	34
Zemra është kopshti Zotit.....	37
Shejtani ishte adhurues i Zotit .....	39
Istiadhja është e varur për emrin Allah .....	40
E mira, antitezë e së keqes.....	45
Thirrja për modesti .....	46
Shejtani, burim i frikës dhe i stresit .....	48
Subjektivizmi në istiadhe dhe formësimi i karakterit të pavarur .....	49
BESMELJA – الْبِسْمَلَةُ.....	51
Musa (a. s.) dhe besmeleja.....	53
Porta e mëshirës absolute .....	55
Besmeleja është nishan i Zotit (xh. sh.) .....	56
SURJA EL-FATIHA – سُورَةُ الْفَاتِحَةِ .....	59
Dallime leksikore mes disa leksemave.....	60
Me hamd fillon gjithçka.....	62
Reflektime kuptimore të fjalisë emërore ﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾ .....	64
Hamdi është eternal.....	64
Nyja shquese (ال) dhe fillimi me hamd.....	66
Mbështjellja e Kuranit me dy lutje .....	69
Arsyeshmëria e fjalës botë – njëjës dhe shumës (الْعَالَمِينَ).....	71

Variacioni fonetik i fjalës ملك.....	73
Largpamësia dhe puna.....	74
Bashkësia para individit.....	77
Prova e ibadetit.....	78
Njëherë ibadet, pastaj kërkesë për ndihmë.....	80
Parakushti i udhëzimit .....	82
Lutja e përkryer.....	84
Folja اِهْدِنَا – ihdina (udhëzona!) .....	85
Rrugë e qartë.....	86
Es-siratu (الصِّرَاط) dhe El-mustekim (المُسْتَقِيم).....	87
Reflektimet kuptimore të foljes أُنْعَمْتَ.....	89
Kush janë “ata që tërhoqën hidhërimin” dhe “të humburit” ....	92
Tri boshtet e sures El-Fatiha.....	94
<b>SURJA EL-FIL – سُورَةُ الْفِيلِ</b> .....	95
Forma pyetëse-habitore dhe shikimi vizionar.....	96
Bërja (فَعَلْ) dhe Zoti (رَبِّ) .....	97
Damkimi i pronarëve dhe jo i elefantëve .....	99
Dallimi mes مَكْر dhe كَيْد.....	101
Lufta qiellore dhe hapësinore .....	102
Zogjtë dhe elefantët .....	103
Pashquarsia e fjalës shpezë (طَيْرًا).....	104
Folja تَرْمِيهِمْ (i gjuajnë ata) .....	105
Gjethi i përtypur (كَعْصِفٍ مَّاكُولٍ).....	106
<b>SURJA KUREJSH – سُورَةُ قُرَيْشٍ</b> .....	107
Adaptimi me dhuntinë.....	108
Bashkimi sjell fitore.....	109
Fillimi dhe fundi i sures .....	110
Përse Kurejshët? .....	111
Aleancë ekonomike dhe tregtare.....	113
Përse dimri para verës? .....	115
Kërkesa për adhurim .....	116
Përse uria është dhënë para frikës?.....	117

Simboli i sigurisë.....	118
<i>I ushqeu dhe jo i ngopi</i> .....	119
Parafjala مِنْ (nga/prej) dhe pashquarsia pas tyre.....	121
<b>SURJA EL-MAUN – سُورَةُ الْمَاعُونِ</b> .....	123
Nga hyjnorja te njerëzorja.....	124
Lidhshmëria e fillimit dhe e fundit të sures.....	125
Skaji i së keqes.....	126
Fjalja pyetëse dhe folja أَى.....	127
Përgënjeshtim i vazhdueshëm.....	129
Ushqimi është specifikë.....	130
Trajtime rreth fjalës الِذِينَ.....	130
Përse shpërfillja e jetimit?.....	132
Lidhja e besimit me proceset shoqërore.....	134
Dallimi mes طَعَامٍ dhe إِطْعَامٍ.....	135
F-ja te fillimi i ajetit فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ.....	136
Renditja e ajeteve.....	138
Tri veprime me një kuptim.....	141
Namazi në fokus.....	142
Çrregullim i fitres/natyrshmërisë së shëndoshë.....	143
<b>SURJA EL-KEUTHER – سُورَةُ الْكُؤْتَرِ</b> .....	145
Dallimi mes أُعْطِيَ dhe آتَى.....	147
Keutheri e përforcon suren Duha.....	149
Kuptimet e fjalës كُؤْتَرٌ.....	149
Roli i lidhëzës فَ mes dy ajeteve të para.....	150
Përse أَقِمِ الصَّلَاةَ dhe صَلِّ.....	151
Kuptimi i foljes نَحَرَ.....	153
Katër përballë katërve.....	154
Dallimet e fjalës شَتَانٍ nga sinonimet tjera të përafërta.....	154
Lidhja e këtij ajeti me dy të parët.....	157
Reflektime kuptimore nga ajeti i fundit.....	157
Nga Keutheri deri tek Ebteri.....	158

<b>SURJA EL-KAFIRUN</b> – سُورَةُ الْكَافِرُونَ.....	161
Renditja në mus'haf dhe në zbritje.....	162
Format e mohimit të adhurimit të kotë.....	162
Intoleranca me të keqen dhe kultura e dialogut.....	164
Fuqia shprehëse e urdhërores قُلْ <i>thua!</i> .....	166
Përse shumësi i rregullt?.....	168
Krenaria është në fe.....	170
Të gjithë kanë një pikë referimi.....	171
<b>SURJA EN-NASR</b> – سُورَةُ النَّصْرِ.....	175
Përdorimi i foljes جَاءَ dhe urdhërorja.....	177
Udha e suksesit.....	178
Përdorimi i foljes رَأَيْتَ.....	180
Fjala التَّاسِمَ “njerëzit” dhe folja يَدْخُلُونَ “hyjnë”.....	181
Tri begati përballë tre urdhrave.....	182
<b>SURJA EL-MESSED</b> – سُورَةُ الْمَسَدِ.....	185
Disa dilema rreth sures Mesed.....	186
Mesedi është simbol i filjimit.....	188
Jo <i>xhaxha</i> , por <i>Ebu Leheb</i> .....	189
Dallimi i foljes تَبَّ nga حَسِرَ dhe دَمَّرَ.....	190
Llagapi Ebu Leheb.....	193
Pasuria dhe fitimi.....	194
Familja e dështuar.....	195
Përdorimi i fjalës امْرَأَتُهُ.....	196
Kapitullimi i Ebu Lehebit.....	197
“Në qafë” عَلَى جِيدِهَا dhe jo “mbi qafë” عَلَى جِيدِهَا.....	198
<b>SURJA EL-IHLAS</b> – سُورَةُ الْإِحْلَاصِ.....	201
Mesedi fillon pa قُلْ, kurse Ihlasi me قُلْ.....	202
Allahu në suren Ihlas.....	203
Tri cilësi pohuese përballë tri mohueseve.....	206
Pse kjo sure quhet Ihlas?.....	207
Lindja, veti njerëzore; jo hyjnore.....	208
<b>SURJA EL-FELEK</b> – سُورَةُ الْفَلَقِ.....	210

Përse fillon me قُلْ <i>thua!</i> .....	211
Përse folja أَعُوذُ është në kohën e tashme? .....	212
Përdorimi i fjalës فَكُّ Felekun .....	213
Togu شَرِّ غَاسِقِي simbolizon esencën e së keqes.....	215
Lufta me keqbërësin vetëm kur bën keq .....	216
<b>SURJA EN-NAS – سُورَةُ النَّاسِ</b> .....	218
Atributet e Zotit dhe fjala <i>njerëz</i> .....	220
Përdorimi i urdhërores قُلْ <i>thua!</i> .....	221
Etimologjia e fjalës نَاسٌ .....	223
Kuptimi i fjalës الْخَنَاسِ.....	225
Kraharorët dhe jo zemrat .....	226
Toleranca dhe barazia në suren Nas .....	228
E përgjithshmja e sures Felek dhe e veçanta e sures Nas.....	229
Asnjë emër i përveçëm .....	230
Synimi i sures Nas.....	231
Vendosmëria dhe aktualiteti i besimtarit .....	232
Përmbyllja e Kuranit.....	233
<b>INDEKSI I EMRAVE</b> .....	236
<b>LITERATURA E SHFRYTËZUAR</b> .....	240



## NE PËR KURANIN DHE KURANI PËR NE

Kurani (Kur'an) është libri i shenjtë i myslimanëve, të cilët konsiderojnë se ai i paraprin krijimit të botës dhe gjuhës së vet arabe. Nëna e Librit (*Ummu'l-Kitab*), që përmendet në Kuran në formë të mistershme, është Kurani i pakrijuar, arketipi i tij platonik i shkruar në Qiell jo si vepër e Zotit, por si atribut apo emanacion i Tij. Prandaj gjuha kuranore është forma fillestare, e cila nuk mund të imitohet. As prozë, as poezi, por “diktat i përkryer” dhe “mrekulli gjuhësore” (*i'xhaz*). Është ky libër nga i cili rrjedhin të gjitha vlerat myslimane dhe më i riu ndër librat epokalë; simbol, të cilin duhet ta deshifrojë çdo pranues. Kjo edhe është urtësia pas shprehjes së mirënjohur: (se) Kurani nuk mund të përkthet, por duhet përkthyer; ngase çdo përkthim i Kuranit është një reduktim i pashmangshëm i domethënies së tij, me dënimin për të qenë i privuar që më parë nga një pjesë e mirë e vlerave estetike të strukturave të tij të mrekullueshme sintaksore-intonuese, ngaqë ai “gjithmonë e ka mbajtur virgjërinë e vet”.

Njohja më e gjerë me origjinalin e Kuranit dhe dëgjimi i leximit të tij, i recitimit ceremonial, i mahnit edhe njerëzit për të cilët Kurani nuk paraqet Fjalën e Zotit. Të gjithë përkthyesit e Kuranit e kanë përjetuar vështirësinë që e mban në vete Teksti i Shenjtë, sepse nuk është çështja që Fjala, thjesht, të përkthet, por diçka që i tejkalon këto dimensione: kemi përkthimin e Kuranit që i bëhet veshit, syrit dhe zemrës së njeriut. Kjo është e ngjashme, për shembull, si me për-

pkjekjen për ta “përkthyer” bukurinë e natyrës. Përpos kësaj, Kurani ka stil, tingull dhe ngjyrim të veçantë të fjalëve dhe mu për këtë arsye edhe përkthyesit përjetojnë dridhje të madhe, frikë të madhe, jo ngaqë nuk e kuptojnë, por pikërisht për shkak se me çdo lexim të Tekstit të Shenjtë kuptojnë diçka të re, diçka të ndryshme nga ajo që përkthehet. Kjo është edhe arsyeja për nevojën e komentimit apo interpretimit të Kuranit, pra edhe ndër ne shqiptarët, ku e shohim zhvillimin e lëndës së tefsirit mes tradicionales dhe “modernes”, edhe pse jo me intensitetin e popujve të tjerë.

Vetë Kurani tregon se është i përbërë nga ajete muhkem (të cilat janë me kuptim të sheshtë) dhe muteshabih (të cilave mezi u merret vesh kuptimi), d.m.th. të qarta dhe alegorike. Pikërisht për këtë, edhe vetë arabët e kohës së shpalljes së Kuranit, edhe pse Kurani është shpallur në arabisht, për shkak të nevojës që sa më mirë t’i kuptojnë disa ajete të shpallura, shpesh i janë drejtuar Pejgamberit (a. s.) që t’ua shpjegojë domethëniet e tyre, që e bën Muhamedin (a.s.) mufesir të parë. Pra, kjo do të thotë se njohja vetëm e arabishtes së Kuranit nuk është e mjaftueshme për ta kuptuar edhe domethënien e Kuranit. Gjithashtu, lidhur me këtë paraqitet edhe problematika e dialekteve të shumta të arabishtes, të cilat edhe sot e kësaj dite janë të pranishme në hapësirën arabe. Atëherë mund të na bëhet edhe më e qartë nevoja e komentimit të Kuranit për ata të cilëve u mungon edhe njohuria më e vogël për arabishten.

Pavarësisht nga ajo se religjiozitetin apo sjelljen religjioze e kuptojmë si shpallje të Zotit dhe si përgjigje të njeriut ndaj saj, ose si para-traditë njerëzore, ose madje edhe si “prodhim shoqëror”, ajo është gjithmonë e pranishme në përvojën njerëzore si realitet me prejardhje mbinjerëzore, si diçka mbiracionale, me arsyen brenda për brenda, por pa e

përfshirë të plotë formën diskursive të të menduarit dhe, sipas kësaj, as edhe objektivizimin në tërësi.

Feja dhe religjioziteti nuk janë fenomene të cilat në vete dhe plotësisht mund të kuptohen me njohjet mendore njerëzore, por ato janë mister, fshehtësi, ku është i përfshirë ai që beson. Në përvojën jetësore të njeriut fusha e religjiozes nuk është si disa fusha të tjera të veprimit; ajo është një fushë tërësisht e privilegjuar – fusha e përjetimit të së Shenjtës. Religjioziteti ka të bëjë me atë që është fushë misterioze dhe e fshehtë e raportit të njeriut me Zotin e vet, respektivisht me ato dimensionet më të thella dhe më intime të ekzistencës njerëzore.

Njeriu në jetën e tij është hulumtues shumë i madh dhe shpirti i tij aspak nuk kënaqet vetëm me atë që të shohë diçka për “si” – për ligshmëritë e veprimit. Ai dëshiron të futet edhe më thellë dhe të arrijë deri te përgjigjet më të gjera, më të plota dhe më kuptimore. Kjo sidomos vlen për çështjet e religjionit dhe të religjiozitetit, apo të sjelljes religjioze, të lidhjes së njerëzve me religjionin dhe me institucionin fetar.

Thjesht, nuk mund të përpunohen të gjitha dukuritë religjioze dhe të gjitha nuancat e religjiozitetit në kuadër të historisë, që është karakteristike e vetë tefsirit. Po ashtu, është e pamundur të jepet përgjigja e plotë për atë se ç’mendon njeriu për gjithë këtë, sepse ndryshe mendon fetari nga shkencëtari, fenomenologu nga historiani etj. Aq shumë shprehje të llojllojshme të religjiozitetit, të raportit me botën, aq shumë formulime dhe sisteme religjioze, sekte të cilat nuk kanë krijuar sisteme të veta religjioze - një laramani aq e madhe idesh, mendimesh, ritesh, besimesh, qëndrimesh, përjetimesh dhe përvojash, të tilla që rrallë mund të gjend-

en në sferat tjera të veprimtarisë njerëzore.

Vepra “Përsiatje kuranore” e studiuesit tonë të ri Ziber Lata është një përpjekje modeste - por, ama, shumë fisnike - për të depërtuar në thellësitë etimologjike të sureve të shkurtra të Kuranit të Shenjtë. Njohja solide e gjuhës arabe i ka ndihmuar autorit të depërtojë në analizën e fjalëve kuranore dhe në rendin logjik të tyre në kuadër të kontekstit të Kuranit. Kujtoj se vepra është një nismë e mirë, së pari, për autorin, ndërsa më pas edhe për nënqiellin shqiptar në analizat gjuhësore dhe semantike të fjalësit kuranor.

Metin Izeti

21 dhjetor 2017, Tetovë

## HYRJE

Falënderimi i takon të Gjithëdijshmit, që na begatoi me dritën e arsyes; përshëndetjet e përzemërta i takojnë Muhamedit (a. s.), pejgamberit të Allahut, pishtarit të dijes; dhe rahmeti i Zotit qoftë mbi gjurmuesit e shkëndijës!

Përgjegjësia për të gjurmuar rreth kuptimeve kuranore është po aq e madhe, sa kujdesi për të mos i prekur ato. Përpjekja për ta mbrojtur çiltërsinë dhe origjinalitetin e fjalësit kuranor, me kalimin e kohës ka rezultuar me kujdesin e veçantë për t'u qëndruar besnik kuptimeve të tekstit të fjalës hyjnore dhe mosdepërtimit të lirë në analizën e konteksteve kuranore. Gjithashtu, ngecja e zhvillimit të mendimit islam, shpërfillja e përvojave intelektuale të qytetërimeve të tjera, mbyllja e derës së ixhtihadit (në sferën e jurisprudencës), izolimi brenda vetes, censurimi i veprimtarisë intelektuale nga pushtetarët etj., bënë që procesi i të menduarit të mos hapërojë me shpejtësinë e pranishme në botën perëndimore në kohën e re. Nuk ka dyshim që kjo ngecje ka qenë e iniciuar edhe nga droja religjioze e mendimtarëve myslimanë për të mos e humbur identitetin e idesë origjinale islame, në dallim nga koncepti i mendimit perëndimor, i cili nuk e ka pasur aq edhe dert platformën metafizike-shpirtërore të veprimit shoqëror. Të gjithë këta faktorë kanë lënë gjurmë edhe në shpjegimin e Kuranit dhe në zhvillimin e koncepteve të mirëfillta të kësaj fushe.

P.sh. Fahrudin er-Razi, dijetar dhe komentues i dalluar i Kuranit i shek. VI hixhri, veprimtaria shkencore e të cilit

është shumë e gjallë edhe sot e kësaj dite, përveç mësimëve islame ishte tepër i përgatitur edhe në shkencat e kohës, si: kelam, filozofi, logjikë, linguistikë, astronomi etj., bile i gërshetonte ato në formë të përkryer, prandaj dhe formoi koncepte të reja të studimit dhe komentimit të Kuranit, në bazë të cilave funksionojnë edhe komentet më të mira bashkëkohore, pa të cilat ka qenë i pamundur zhvillimi i koncepteve të reja të studimit dhe komentimit të këtij Libri.

Të mos flasim për ata të cilëve edhe Raziu iu duket i tepërt, sepse kanë mbetur në formën e përcjelljes (rivajetit), të pranimit të paprekur, pa koment të Kuranit dhe të cilët asesi nuk i pranojnë komentimet më të avancuara (racionale). Avancimi i metodave të shpjegimit të Kuranit nuk i mohon metodat tradicionale, sepse përmes tyre fitohen kuptimet parësore dhe të përgjithshme të ajeteve kuranore, megjithatë kjo nuk do të thotë se duhet ngecur aty. Pra, mbyllja e dyerve të mendimit transparent dhe kolorit nuk ka ndikuar vetëm në ngecjen e disiplinave shkencore, thënë kushtimisht të përbotshme, por edhe në ato të fjalës hyjnore.

Qysh atëherë e deri në qindvjeçarin e fundit nuk kemi pasur ndonjë teori të mirëfilltë të studimit të Kuranit, përveç disa emrave si Mulla Sadra Shirazi, Davud el-Kajseriu dhe ndonjë tjetër. Të gjitha sqarimet apo komentimet – tefsiri tradicional, racional, mistik etj. - në një mënyrë i janë referuar qasjes juridike dhe apologjetike, madje edhe në çështjet e hermeneutikës kuranore. Shumë pak studiues të drejtimeve profane i janë qasur shpjegimit të Kuranit, ndoshta sepse rishtazi janë frikësuar që të mos bëjnë gjynah, sepse Kurani është ‘pronë vetëm e teologëve’.

Kjo tregon se koha e hedhjes së mendimeve individuale rreth kuptimeve kuranore ka mbaruar, jo pse ato mund të

mos jenë të sakta, por sepse ato nuk zhvillohen dhe shpesh mbesin të mangëta. Si rezultat, nuk mund të arrihet në një teori të mirëfilltë të studimit të tij për kohën dhe hapësirën bashkëkohore. Kjo kërkon grupe dhe institute serioze, të cilat duhet të merren me këtë punë, të cilat një pjesë të mendimeve do ta zhvillojnë mirëfilli deri në formimin e metodeve dhe teorive të ndryshme të shpjegimit të Kuranit, ndërsa një pjesë tjetër do ta arkivojnë, qofshin edhe të gabuara, në mënyrë që studiuesit e ardhshëm të mos përsëriten dhe të mos i gjurmojnë kuptimet kuranore në sfera të gabuara.

Një lëshim tjetër në interpretimin e Kuranit është interpretimi tendencioz për të vërtetuar një tezë të caktuar, së cilës i përket vetë komentuesi. Në këtë mënyrë, shumë fraksione kanë ndërtuar metoda të veçanta, të cilat kanë funksionuar sipas parimeve themelore të atij sektit, apo drejtimi.

Në shek. XIX dhe XX, kur të gjitha disiplinat shkencore morën hovin e zhvillimit, edhe studimi i Kuranit paksa ndryshoi. Shumë studiues myslimanë dhe të huaj filluan të bëjnë studime të veçanta rreth shpjegimit të Kuranit nga këndi i shkencave të ndryshme: psikologji, linguistikë, sociologji, logjikë, semantikë, matematikë, astronomi etj., edhe pse në të kaluarën kanë qenë në formë parciale. Problemi i këtyre hulumtimeve është se ato u bënë nga individë të caktuar, e kishin karakterin e hipotezave të pavërtetuara dhe të cilat ende nuk janë zhvilluar seriozisht nga institutet përkatëse.

Sidoqoftë, Kurani, në një mënyrë apo në një tjetër, gjatë gjithë historisë është shpjeguar dhe është komentuar në forma të ndryshme.

## Nivelet e shpjegimit të Kuranit

Pa marrë parasysh teoritë, metodat dhe llojet e interpretimit të Kuranit, në tekstin në vijim do të paraqesim disa nivele të interpretimit të tekstit kuranor:<sup>1</sup>

### 1. Komentim – تَفْسِيرٌ

Kur flitet për shpjegimin e Kuranit, termi i parë me të cilin ballafaqohet hulumtuesi është *tefsiri*. Meqenëse termi *tefsir* shpeshherë është përdorur edhe për nivelet e tjera të sqarimit të ajeteve kuranore, përsëri ajo që kuptohet nga tërësia e librave të tefsirit është niveli i parë i procesit të thellimit në semantikën e Kuranit.

Fjala *tefsir* (تَفْسِيرٌ) në aspektin gjuhësor (leksikor) do të thotë sqarim apo zbulim i të mbuluarës.<sup>2</sup> Në aspektin terminologjik, në nivelin e kësaj trajtese, tefsiri përfshin sqarimin dhe shpalimin e kuptimeve të qarta kuranore, pa u thelluar në kuptimet më komplekse apo të ndërlikuara.

Sa për ilustrim do ta marrim vetëm ajetin 32 të sures en-Nur:

﴿وَأَنكِحُوا الْأَيَّتَىٰ مِنكُمُ وَالصَّالِحِينَ مِن عِبَادِكُمْ وَإِمَائِكُمْ إِن يَكُونُوا فُقَرَاءَ يُغْنِهِمُ اللَّهُ مِن فَضْلِهِ ۗ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ﴾

***“Martoni të pamartuarit ndër ju dhe sklleverit e skllavet e ndershme. Në janë të varfër, i begaton Allahu me mirësinë e Vet. Allahu është tejet Bujar, Dijeplotë.”***

Ky ajet kuranor, përkatësisht pjesa *“Në janë të varfër, i*

<sup>1</sup> Disa (katër) nga nivelet e shpjegimit të ajeteve kuranore janë perifrastuar nga ligjërata e studiuesit Mahmud Shems.

<sup>2</sup> Fejruz Abadi, *El-Kamus el-muhit*, Beirut-Liban, Muessesetu er-Risaleh, 2005/1426, f. 456.

*begaton Allahu me mirësinë e Vet'*, nga këndi i tefsirit tregohet premtimi i Allahut për të pamartuarit, se martesë do t'i begatojë. Nuk bëhet përpjekje për sqarime më të thelluara, por ndalet vetëm në kuptimin themelor dhe të përgjithshëm të ajetit.

## 2. Meditim – تَأْمُّنٌ

Ky nivel i kuptimit dhe i shpjegimit të Kuranit nënkupton që një ajet të vështrohet disa herë, me përpjekjen që të kuptohet synimi kryesor. Në këtë fazë lexuesi apo studiuesi e lexon ajetin me vëmendje disa herë, derisa të arrijë të shtrijë disa pyetje dhe dilema për diskutim - çdoherë sipas normave dhe kritereve të pranuar.

P.sh. në ajetin e cituar më lart "*Në janë të varfër, i begaton Allahu me mirësinë e Vet'*", tani studiuesi kalon në një fazë tjetër. E lexon disa herë dhe fillon të hapë dilema dhe të parashtrijë pyetje: pse ndonjë çifti Allahu nuk i jep pasuri? Pse nuk përmendet "nëse do Allahu", kur dihet se begatia dhe pasurimi ndodh vetëm nëse Ai do? etj.

## 3. Shkoqitje – تَفَكُّرٌ

Pas meditim, shtrimit të pyetjeve dhe dilemave, paraqitet nevoja e shkoqitjes dhe zbërthimit të problematikave të cituara më lart. Në këtë fazë studiuesi del jashtë ajetit, bën krahasime me ajetet e ngjashme etj., por pa sjellë një përfundim të mirëfilltë për të gjitha këto. Në një mënyrë, dilemat e shtruar në fazën e meditim, këtu vetëm i zgjeron dhe i krahason me të tjerat. Ose këtu mund t'u përgjigjet dilemave të parashtruara nga medituesi, por jo se i ka dhënë përgjigje çdo dileme rreth atij ajeti.

P.sh. në ajetin paraparak “Në janë të varfër, i begaton Allahu me mirësinë e Vet”, ku paraparakisht u shtrua pyetja: përse Allahu nuk e thekson “nëse do Ai”? Tani i jepet përgjigje: Dëshira e Zotit për ta begatuar dikë, e dikë tjetër jo, kuptohet nga ajeti 28 i sures et-Teube, në të cilin thuhet: **وَإِنْ خِفْتُمْ** ﴿عَيْلَةً فَسَوْفَ يُغْنِيكُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ إِنْ شَاءَ﴾ “Në i frikësoheni varfërisë, do t’ju pasurojë Allahu me Mirësinë e Tij nëse do.” Pra, në një mënyrë i jepet përgjigje dilemës se përse Krijuesi nuk e ka theksuar dëshirën e Tij në ajetin 32 të sures en-Nur, sepse për begatimin është mjaftuar vetëm në një rast.

Por, jo çdo gjë përfundon këtu, sepse tani parashtrohen disa pyetje më të ndërlikuara: përse Zoti begatimin që lidhet me martesën nuk e ka shoqëruar me frazën “nëse do”, kurse begatimin që lidhet me varfërinë, e cila erdhi si rezultat i moslejimit të politeistëve në vendet e shenjta, e ka shoqëruar me frazën “nëse do”? Analizat dhe përgjigjet e dilemave më komplekse, të fituara në këtë fazë, jepen në nivelin e fundit.

#### 4. Përsiatje – تَدَبُّرٌ

Niveli i fundit i shpjegimit apo interpretimit të ajeteve kuranore brenda aftësive njerëzore quhet *tedebbur* – përsiatje. Në këtë nivel u jepet përgjigje të gjitha dilemave të shtrura në fazën e *teemmul-it* dhe të *tefekkur-it*. Me një fjalë, ky është stacioni i fundit në semantikën e fjalësit kuranor, i arritur nga mundësitë dhe aftësitë njerëzore.

P.sh. në suren en-Nur “Në janë të varfër, i begaton Allahu me mirësinë e Vet” nuk është theksuar dëshira e Zotit, në mënyrë që zemrat e besimtarëve të rrinë të qeta, sepse kur bëhet fjalë për formim të familjes, Allahu nuk thotë “nëse

do Ai", por u jep siguri dhe u premtan se do t'i begatojë me pasuri dhe të mira. Kështu, zemrat e besimtarëve qetësohen. Në suren Teube, ndërkaq, Allahu ka thënë: *"Besimtarë! Idhujtarët janë të papastër dhe të mos i afrohen Faltores së Shenjtë pas këtij viti. Në i frikësoheni varfërisë, do t'ju pasurojë Allahu me Mirësinë e Tij nëse do. Allahu është Dijeplotë, i Urtë."* (Et-Teube, 28) Këtu flitet për besim dhe për mosbesim, për çiltërsinë e besimtarit dhe për ndyrësinë e politeistit, d.m.th. nëse ju i ndaloni jobesimtarët që të hyjnë në vendet e shenjta dhe si rezultat i asaj keni rënie ekonomike, dijeni se Allahu do t'ju begatojë nëse do, por edhe nëse nuk ju begaton, përsëri ata nuk duhet lejuar që të hyjnë. Pra, fraza "nëse do" tregon se për ju nuk duhet të jetë prioritet pasurimi juaj, por parimi dhe besimi që keni në zemrat tuaja. Gjithashtu, përmendja e frazës "nëse do Ai" nënkupton se jo domosdo besimtarët duhet pasuruar nëse nuk i lënë politeistët të hyjnë në vendet e shenjta, por duhet përpjekje dhe punë.

## 5. Përkujtim – تَذَكُّرٌ

Nivelet e mëparshme kryesisht kanë të bëjnë me proceset psikike-procedurale-shkencore. Ato mbulojnë fazat që duhet t'i kalojë çdo studiues për të arritur deri te nxjerrja e një konkluzioni shkencor të mirëfilltë. Kjo e fundit, ndërkaq, i tejkalon proceset procedurale-psikike-shkencore, përkatësisht kjo kalon në një nivel më të avancuar. Këtu përpjekja është që përmes asaj që u arrit deri në fazën e *tedebburit* të krijohet një lidhje e fuqishme mes robit dhe Krijuesit. Nëse u hedhim një vështrim ajeteve kuranore që e përdorin fjalën tedhekkur apo derivatet e saj, atëherë do të shohim se

ajo kryesisht është e lidhur drejtpërdrejt me *lafdhulxhelalin* (Allahun): ﴿فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ﴾ “Më kujtoni Mua, t’ju kujtoj edhe Unë juve!”; ﴿أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ﴾ “Vërtet, a nuk qetësohen zemrat me përkujtimin e Allahut?!”

Po ashtu, nëse i referohemi kuptimit leksikor të vetë fjalës, atëherë shohim se përmes saj kuptohet *përkujtimi*, kurse përkujtimi në vetvete ngërthen një proces të gjatë, thjesht e kalon atë që quhet rrugë shkencore. Përkujtimi, konkluzionet e fituara në fazat e para rikthehen për t’i vënë në funksion të Qenies Absolute. Madje, vetë njëri nga emrat e Kuranit është *Dhikr*, sepse e rikujton robin që vazhdimisht të mbajë lidhjen me Zotin.

Analizuar nga aspekti i metodologjisë shkencore të kohës së re, përkujtimi si një nga nivelet e komentimit kuranor, ose ta them ndryshe të gjetjes së kontekstit të diskursit hyjnor, është paksa i pakuptueshëm. Por, ama, pasi bëhet fjalë për analizë të fjalës tejlëndore dhe me efekt të madh tradicional, është e pashmangshme që gjatë hermeneutikës të depërtohet edhe në shpirtësinë e personave dhe në lidhjen e tyre me Krijuesin dhe kjo ka mundësi të bëhet vetëm përmes përqendrimit shpirtëror në tekstin e analizuar.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Dijetarët e shfrytëzuar në këtë punim janë: Fahrudin er-Razi, Ez-Zemahsheriu, Muhammed Mutevelli esh-Sha’ravi, Uvejd el-Atavij, Fatil bin Salih es-Samurai, Mahmud Shems, Muhamed Safi el-Musteganemi, Mevdudiu, El-Megamisi, Alusi, Muhamed Ikbali etj.

## الِإِسْتِغَاذَةُ – ISTIADHJA

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

*“Mbrohëm me Allahun kundër shejtanit të mallkuar”*

Një nga stilet shprehëse me vlerë të fuqishme semantike në fjalësin kuranor është edhe renditja e fjalëve, fjalive, periudhave, ajeteve dhe sureve. Prandaj, pa u futur në thelbin e istiadhes, fillimisht do të lëvrojmë për të nxjerrë urtësitë dhe ngjyrimet kuptimore të renditjes së besmeles pas istiadhes.

Pasi të kërkohet mbrojtja kundër shejtanit të mallkuar, menjëherë kërkohet angazhimi në rrugën e Zotit. Kjo e tregon metodën se si duhet të funksionojë çdo punë në këtë botë: njëherë të largohet e keqja dhe pastaj, menjëherë, të drejtohem në punë të mira. Jo rastësisht këto dy fraza kanë ardhur njëra pas tjetrës. Fatkeqësisht, realiteti i sotëm e tregon të kundërtën, sepse është ndarë istiadhja nga besmeleja: dikush i largon të gjitha barrierat në një punë të caktuar, por nuk angazhohet me metodat dhe mënyrën e duhur për ta finalizuar atë, e dikush tjetër përpiqet që ta arrijë qëllimin e caktuar pa i larguar sfidat paraprake. Nëse njëra është tezë e tjetra antitezë, atëherë bashkimi i të dyjave përbën sintezën e kërkuar për çdo besimtar.

Istiadhja, në një mënyrë, është distancim nga mendimi që si pasojë do ta kishte parimin e të keqes. Pra, komentimi, krahas përqendrimit në deduktimin e thukët dhe të qartë të

parimeve, duhet ta ketë parasysh edhe vendzënien shoqërore të tyre. Edhe pse kjo duket si relativizim i mendimit, por ama, nga aspekti i disiplinave fetare edhe vetë mendimi, qoftë ky edhe i shndërruar në teori, është relativ. Domethënë, është i veshur me teshat e kohës dhe të vendit, ndërsa buron nga përmasa pa kohë dhe pa hapësirë.

Pas frazës “mbrohem me Allahun nga shejtani i mallkuar” duhet të pasojë një punë e cila duhet të bëhet në emër të Allahut, pra, nuk mjafton që vetëm të largohemi nga rrugeta e shejtanit, ose të qëndrojmë tërë ditën duke kërkuar ndihmë kundër shejtanit, por patjetër të angazhohemi në punë konkrete për ta mposhtur atë të mallkuar, sepse përndryshe ai kurrë nuk do të jetë i mposhtur.

Diskursi filozofik-mendor i Kuranit është në shërbim të realitetit të zbuluar nga Allahu dhe, si pasojë e kësaj, gjithnjë duhet ta ketë parasysh vërtetimin e kësaj pike. Filozofia kuranore ka për qëllim zbulimin e të vërtetës në kuadër të tekstit të zbritur prej Zotit dhe këtë kontekst duhet ta ruajë gjithnjë.

Këto dy fraza tregojnë fund e krye rrugën e suksesit: mënjanimin e të gjitha pengesave të mundshme dhe angazhimin për ta arritur një synim të caktuar përmes mënyrës më të mirë.

Gjithashtu, istiadhja dhe besmeleja myslimanin e mësojnë se duhet të ketë një projekt shumë të qartë dhe të detajuar për ta arritur atë që prej tij e kërkon Zoti. Qysh në fillim ua bën me dije të gjithëve se ‘unë nuk jam në rrugën e shejtanit, por jam në rrugë të Zotit’; me një fjalë, e paraqet plotësisht qëllimin (platformën) e vet dhe nuk qëndron i fshehur nën petkun e identitetit dyfytirësh dhe të paqartë, përkundrazi, e qartëson në formë të prerë, bile duke i treguar dy

skajet më të largëta - armik, shejtanin dhe synim, Zotin. Pastaj - që mendoj se është më e rëndësishmja - ai nuk është mendimtar i lirë/freethinker, ashtu siç e kuptojmë ne sot, pra t'i zhvlerësojë të gjitha traditat dhe të kujdeset vetëm për konstatime të mbështetura në avancimin e logjikës. Logjika vetëm në bashkëkohësi e ka marrë statusin e shkencës vendimmarrëse; tradicionalisht ajo ka qenë veçse mjet për të arritur deri tek e vërteta.

Para se të analizohet arsyeja e përdorimit të fjalë *shejtan* (الشَّيْطَانُ) në vend të *Iblis* (إِبْلِيسَ), do t'u bëjmë një analizë etimologjike dhe leksikore të dyja fjalëve.

Fjala *Iblis* (إِبْلِيسَ) është emër i prejardhur nga rrënja *بلس* e cila do të thotë dëshpërim apo humbje shprese.<sup>4</sup> Shejtani në fillim quhej *Azazil*, pastaj e refuzoi urdhrin e Zotit për t'i rënë në sexhde Ademit (a. s.) në shenjë respekti dhe u dëbua nga mëshira e Tij. Kur refuzoi, u quajt *Iblis*, sepse e humbi shpresën nga mëshira e Zotit. Kjo ishte periudha kur djalli ende ishte vetëm e keqja e vetvetes dhe nuk ishte angazhuar për t'u bërë cytje dhe për t'i devijuar njerëzit nga rruga e drejtë. Kur ai filloi t'i shmangë njerëzit nga rruga e vërtetë, atëherë e mori emrin *shejtan*.

Për prejardhjen e fjalës *shejtan* (شَيْطَان) leksikologët arabë kanë dy mendime: një pjesë thonë se rrënja e saj është *she-tane* شطن d.m.th. *litar i gjatë dhe i fortë për të lidhur kafshën ose kovën e bunarit*. Gjithashtu, kjo rrënjë do të thotë edhe *largim*; mendimi i dytë është se rrënja e saj është *shیط* e cila do të thotë *shkatërrim*. Me një fjalë, po t'i marrim të dy mendimet bashkë, vijmë në përfundim se fjala *shejtan* do të thotë: *i*

<sup>4</sup> Ibn Mendhur, *Lisan el-arab*, dar el-mearif, f. 343.

*lidhuri, i cili përpiqet të lidhë; i larguari, i cili përpiqet të largojë; dhe i shkatërruari, i cili përpiqet të shkatërrojë.*

Këto cilësi të shejtanit i shpalos vetë shqiptimi apo nyjëtimi i fjalës shejtan. Tingulli [sh] i fjalës shejtan është bashkëtingëllore e shurdhët fërkimore dhe zvarritëse, njësoj si vesvesja që është e pahetueshme dhe graduale. Pastaj vjen diftongu EJ (shejtan), i cili po ashtu gjatë shqiptimit ka një lloj zgjatjeje. Me një fjalë, arma më e fuqishme e shejtanit, vesvesja, fillon dhe vepron gradualisht njësoj si shqiptimi gradual i Sh-së dhe i diftongut EJ, kurse përfundon me shkronjën e fortë T, njësoj si pasoja e vesveses, e cila është shumë e rëndë dhe e vështirë.<sup>5</sup>

Po ta vështrojmë përdorimin e këtyre dy termave në Kuran, lehtë do ta dallojmë Iblisin prej shejtanit. Ja, për shembull, në ajetet e sures Taha:

﴿وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلٰٓئِكَةِ اسْجُدُوْا لِاٰدَمَ فَسَجَدُوْۤا اِلَّاۤ اِبْلِيسَ اَبٰى ﴿۱۱۶﴾ فَقُلْنَا يٰۤاٰدَمُ اِنَّ هٰذَا عَدُوُّكَ ﴿۱۱۷﴾ وَارْزُقْكَ فَلَا يُخْرِجُكَ مِّنَ الْجَنَّةِ فَمَتَشَقَّى ﴿۱۱۸﴾ اِنَّ لَكَ اَلَّا تَجُوْعَ فِيْهَا وَلَا تَعْرٰى ﴿۱۱۹﴾ وَاَنَّكَ لَا تَظْمَؤُا فِيْهَا وَلَا تَضْحٰى ﴿۱۲۰﴾ فَوَسَّوَسَۤ اِلَيْهِ الشَّيْطٰنُ قَالَ يٰۤاٰدَمُ هَلْ اٰدُلُكَ عَلٰى شَجَرَةٍ الْخٰلِدِ ﴿۱۲۱﴾ وَمُلْكٍ لَا يَبۜتَلٰى﴾

*Kur u thamë engjëjve: “Përruljuni Ademit”, - u përulën përveç Iblisit. Refuzoi. (116) Thamë: “O Adem! Ky është armik për ty e për tët shoqe, pra, të mos ju nxjerrë nga kopshti e të mjerohesh. (117) Nuk je i uritur aty, as i zhvoshur. (118) Nuk je i etur aty, as ke vapë.”(119) I pëshpëriti shejtani dhe i tha: “O Adem! Eja të të çoj te pema e përjetësisë dhe e sundimit pa rënie.” (120)*

Këto ajete na pasqyrojnë se shejtani në fillim, kur u bë kryelartë dhe i padëgjueshëm ndaj Zotit, d.m.th. e keqja ve-

<sup>5</sup> Muhamed Davud, *Revaiu el-bejan*, huazuar nga:  
<http://islamiyyat.3abber.com/post/228993>.

tvetes, u quajt *Iblis*, kurse kur filloi me misionin për të lajthitur njerëzit u quajt *shejtan*. Fjalën *shejtan* Kurani e përdor edhe për njerëzit.

Tani, pasi i sqaruar dallimet mes këtyre dy fjalëve, lehtë mund ta kuptojmë arsyen se pse në besmele kërkojmë mbrojtje kundër shejtanit dhe jo kundër Iblisit:

- a) myslimani mbrohet vetëm nga ai që e sulmon dhe jo nga të tjerët;
- b) besimtari duhet të mbrohet edhe nga njerëzit, edhe nga xhindet; ndërkaq, termi *Iblis* nënkupton vetëm botën e xhindeve;
- c) myslimani e lufton vesin dhe jo subjektin;
- ç) ne duhet të mbrohemi nga dikush që përpiqet të na lidhë me të keqen dhe jo nga dikush që thjesht na ka bërë një të keqe rastësie, njësoj siç duhet luftuar atë që ka bërë pakt me të keqen dhe jo atë që gabon vetëm një herë.

### Ligjërimi në kohën e tashme

Duke e ditur se shejtani është personifikim dhe simbol i së keqes, i cili shfrytëzon çdo mjet më modern dhe më të sofistikuar për ta zbukuruar të keqen, Allahu i Madhërishëm na ka mësuar që të mbrohemi me folje të kohës së tashme. Pra, nëse ai na mashtron me metoda dhe mjete të reja, edhe ne kërkojmë mbrojtje me folje të kohës së tashme, e cila përfshin edhe të ardhmen.

Dikush mund të pyesë: a nuk duhet të mbrohemi edhe nga përvoja e kaluar e shejtanit? Përgjigjja: gjithsesi se po, por kërkimi i mbrojtjes me folje të kohës së tashme tregon se shejtani për t'i devijuar njerëzit nga rruga e keqe përqen-

drohet në mjetet më moderne të kohës. P.sh. për ta mashtruar një njeri që mos ta falë namazin e sabahut, në të kaluarën ka pasur metoda krejt të tjera, kurse sot përmes mjeteve teknologjike e mban deri në orët e vona të natës dhe shumë kollaj mund të mos zgjohet për ta falur sabahun. Apo p.sh. në të kaluarën shumë lehtë mund të ishte korruptuar një njeri me një kafshë, kurse sot duhet një veturë shumë moderne për ta korruptuar dikë. Prandaj, ne kërkojmë që të na mbrojë nga të gjitha kurthet e tij, me theks të veçantë nga kurthet e kohës.

Tani do të bëjmë disa dallime leksikore mes leksemave sinonimike لَعِينٌ dhe رَجِيمٌ dhe fuqisë shprehëse që ka përzgjedhja e kësaj së dytës.

Sado që këto dy mbiemra janë të njëjtë, dallimi mes këtyre i jep një fuqi të veçantë shprehëse kësaj fraze. Të dy mbiemrat mund të përkthehen *i mallkuar*, mirëpo لَعِينٌ përdoret vetëm për mallkim gojor apo shpirtëror, kurse mbiemri رَجِيمٌ ka edhe kuptimin *i dëbuar*, *i gjuajtur*, *i larguar* etj., d.m.th. ky i fundit përdoret edhe për mallkimin me pasoja fizike. Djetarët islamë, kur flasin për kuptimin e fjalës رَجِيمٌ thonë se shejtani vazhdimisht gjuhët me yje, gjuhët nga haxhilerët kur i hedhin gurë shejtanit etj. Këto janë të vërteta të cilat nuk i mohan askush, por mendoj se urtësia e përdorimit të mbiemrit رَجِيمٌ është shumë më e madhe.<sup>6</sup> Përdorimi i mbiemrit رَجِيمٌ në vend të لَعِينٌ tregon se lufta kundër shejtanit dhe së keqes nuk zhvillohet vetëm me mallkime gojore, por ajo duhet luftuar me vepra konkrete dhe fizike, të cilat do ta gjuajnë dhe do ta mposhtin shejtanin. Pra, istiadhja na mës-

---

<sup>6</sup> Shih: Ebu el-Hasen Hixham el-Mahxhubi dhe Vedi er-Radi, *Tefsiru el-istiadheti*, Rijad: 2015.

on që ne të jemi konkretë në punët tona dhe në luftimin e së keqes, dhe jo të mbështetemi vetëm në fjalë apo në ‘nijetin e mirë’.

Gjithashtu, tregon se e keqja, sado qoftë shpirtërore, kërkon punë konkrete fizike për t’u mënjanuar.

Përveç dallimit mes sinonimeve لَعِينٌ dhe رَجِيمٌ, në shprehje vjen edhe një dallim mes vetë fjalës رَجِيمٌ dhe مَرْجُومٌ, pra mes dy fjalëve me rrënjë të njëjtë, por me dallime kuptimore në nuanca shumë të imëta.

Esenca e fjalës رَجِيمٌ është مَرْجُومٌ. Të dyja fjalët e kanë kuptimin e njëjtë, mirëpo Allahu e ka zgjedhur fjalën رَجِيمٌ i dëbuar.

Nëse i referohemi rregullës “çdo shtesë në strukturën të fjalës e zgjeron edhe kuptimin e saj”, atëherë edhe çdo heqje nga struktura e fjalës e ngushton edhe kuptimin e saj. Fjala رَجِيمٌ në strukturën e vet nuk e ka shkronjën M (م), dhe në vend të vavit (و) e ka shkronjën J (ي), e cila është shumë më e lehtë se vavi. Të gjitha këto tregojnë se lufta kundër shejtanit nuk është shumë e komplikuar, por është shumë e lehtë për besimtarin e mirëfilltë.<sup>7</sup>

Gjithashtu, fjala رَجِيمٌ është më nënçmuese për shejtanin, sepse në gjuhën arabe bashkëtingëllorja J, e cila përpara ka zanoren I të gjatë, në gjuhën arabe të jep të kuptosh nënçmim, sepse edhe shqiptimi është më i mekët, por edhe shkrimi i vokalit I është nën shkronjë.

---

<sup>7</sup> Ibid.

## Relacioni i istiadhes me leximin e Kuranit

Istiadhja përdoret në shumë raste, pothuaj në çdo pore të jetës së njeriut, mirëpo parashtrohet pyetja: përse Kurani istiadhen e ka lidhur me leximin e Kuranit Fisnik, ku thotë: ﴿فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾ “Kur lexon Kuran, kërkohet mbrojtjen e Allahut nga djalli i mallkuar” (En-Nahl, 98)?

Pasi shejtani është simbol i së keqes dhe i paragjykimeve, momenti më i volitshëm kur njeriut nuk i duhet paragjykimi i gabuar është kur ai e lexon librin e Zotit, sepse vetëm ai që lexon pa paragjykime, mëson dhe udhëzohet. Gjithashtu, Zoti i Madhërishëm në ajetin paraprak e ka lidhur istiadhen me leximin - jo me punë të tjera; sepse leximi është pika nismëtare kur njeriu duhet të jetë i zhveshur prej paragjykimeve dhe mendimeve të këqija për ta formuar karakterin e tij të shëndoshë.

Me pak fjalë, ai që lexon pa paragjykime dhe pa ndikime djallëzore, do të ketë mundësi ta mposhtë shejtanin dhe të gjitha sfidat tjera që do t'i dalin para vetes.

Gjithashtu, është e rëndësishme të thuhet edhe fakti se Kurani është libër i jetës dhe gjallëria e myslimanit është e kornizuar në tekstin e Kuranit. Si rrjedhojë, në çastin kur kërkohet fillimi i leximit të Kuranit me istiadhen, njëkohësisht nënkuptohet edhe bartja e këtij rregulli në të gjitha segmentet e jetës së personit, pasi e njëjta është e paraqitur në fizionominë kuranore.

Ky relacion i ngushtë i istiadhes me leximin e Kuranit bëhet edhe më i fuqishëm kur vetë folja është në vetën e parë اَعُوذُ “Mbrohem”.

Istiadhja në vetvete ngërthen një luftë mes vetë njeriut dhe shejtanit. Allahu i Madhërishëm e ka zgjedhur formën

më të mirë përmes së cilës të mbrohet njeriu kundër shejtanit. Veta e parë në njëjës nuk i lë njeriut hapësirë të tregohet i pakujdesshëm dhe të mbështetet në krah të të tjerëve. P.sh. nëse do të përdorej trajta e shumësit *mbrohem*, në vend të *mbrohem*, atëherë njeriu në luftën kundër shejtanit do të mbështetej në mundin e të tjerëve. Përdorimi i njëjësit tregon se çdo njeri vetë, personalisht, duhet të angazhohet në luftën kundër së keqes.

Kjo nuk nënkupton se për ta mposhtur shejtanin dhe të keqen nuk duhet të bashkëpunohet; përkundrazi, bashkëpunimi është vepra më e lavdëruar te Zoti, por përsëri angazhimi parësor dhe bartja e përgjegjësive për dështimet e mundshme i takon individit.

Gjithashtu, veta e parë nënkupton se ti personalisht je ai i cili duhet të marrësh iniciativë për ndryshim. Në këtë rast, nuk duhet të harrohet edhe fakti se shejtani më së tepërmi e sulmon nefsën/unin njerëzor, i cili është i veçantë për çdo person dhe Allahu në një mënyrë na tregon se duhet të mbrohem nga shejtani në zbërthimin e informatave që i marrim nga jashtë, por që në realitet verifikohen në unin e njeriut.

Përveç iniciativës vetjake për luftë me shejtanin, Allahu përmes njëjës shquese na e përcakton edhe objektivin; thjesht, të keqen që ka njeriu para vetes.

Fjala *shejtan* në istiadhe është e shquar, me njëjës shquese ٱ. Për njëjës shquese ٱ gjuhëtarët kanë disa mendime. Një pjesë thonë se ajo është *një shquese që përfshin llojin*, me të cilën përfshihet gjithë lloji i shejtanëve. Një pjesë tjetër thonë se nyja shquese në istiadhe e përfshin shejtanin me të cilin njeriu ballafaqohet drejtpërdrejt, pra njeriu kërkon të

mbrohet nga shejtani (e keqja), që e ka para sysh, e keqe e cila për ty është e qartë dhe se duhet të luftohet. Nyja shquese, gjithashtu, e tregon identitetin e shejtanit, i cili është i paraqitur me vetitë e tij në tekstin hyjnor, me qëllim që njeriu të mos hamendet për pasqyrimet e tij.

### **Istiadhja është simbol i suksesit dhe i modestisë**

Kurani lexohet për shumë arsye. Kuptohet, arsyeja kryesore është arritja e kënaqësisë së Zotit. Një ndër motivet e leximit të Kuranit është që njeriu të pajiset me sa më shumë informacione dhe udhëzime, ashtu që udhëtimin e tij drejt Botës Tjetër ta realizojë pa asnjë pengesë.

Krijesa e cila vazhdimisht përpiqet që njeriun ta shmanjë nga kjo rrugë është shejtani, prandaj ne duhet të kërkojmë mbrojtje kundër tij dhe çdo punë tonën ta realizojmë në formën më të mirë. Aty ku përzihet shejtani, njeriu nuk mund ta bëjë siç duhet punën e vet. Pra, nëse kërkohet mënyra më e mirë për ta realizuar një sukses, atëherë duhet ndjekur metodologjia kuranore: në fillim të largohet e keqja e parikuperueshme, siç kërkojmë ta heqim qafe shejtanin para çdo pune; të mos lejohet ndërhyrja e asnjë faktori turbullues gjatë një procesi të caktuar, siç nuk e lejoi Zoti shejtanin të depërtojë kur robi i Tij lexon Kuran.

Kërkimi i mbështetjes hyjnore kundër shejtanit të mallkuar është nevojë e domosdoshme për çdo besimtar. Njeriu kur kërkon mbrojtje kundër shejtanit, apriori duhet të kuptojë se këmbëngulja në të keqe është shkatërruese. Shejtani nuk u dëbua prej mëshirës së Zotit për gabimin që bëri, por për shkak të këmbënguljes në mëkat. Prandaj, besimtari i vërtetë sa herë që ta nisë një punë, duhet të jetë i vetëdijshëm se mospranimi i mendimit të tjetrit është punë shejtani

dhe pretekst për të dështuar. Istiadhja që lexohet duhet kuptuar edhe kështu: "O Zot, në këtë punë që kam nisur, kërkoj mbrojtje kundër kësaj krijese të padëgjueshme. Nëse ai u bë kryelartë kur ju e urdhëruat, unë do të jem i dëgjueshëm dhe sa herë që të gaboj, të lutem më fal dhe më mundëso të përmirësohem!"

Po ashtu, në rrjedhën e kësaj modestie që reflekton istiadhja, falë Allahut të Madhërishëm, në istiadhe dhe në besmele është e pranishme parafjala *ب* (me), e cila përveç modestisë nënkupton edhe nënshtrimin dhe lidhjen me Zotin.

B-ja në istiadhe ('mbrohem *me* Allahun kundër shejtanit të mallkuar') tregon se lufta kundër së keqes (shejtanit) duhet të realizohet me një projekt konkret dhe mirë të studiuar, sipas projektit siç e ka kërkuar Zoti në Kuran. Në të njëjtën kohë, edhe realizimi i punëve të mira (*me* emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit) të bëhet me një projekt të përpiktë dhe të sofistikuar. Kjo tregon se rruga e suksesit kërkon angazhim të dyfishtë dhe të barabartë - si në ballafaqimin me sfidat, ashtu edhe në finalizimin e synimit përfundimtar.

Në të dy rastet tregohet lidhja e robit me Krijuesin. Kur robi lidhet me Zotin, dështimi është i pamundur. Parashtrohet pyetja: përse ne e themi istiadhen dhe besmelen, e në anën tjetër në shumë punë kemi dështuar? E para, sukcesi nuk vjen në formën që e kërkojmë ne, por Allahu e jep sipas mënyrës, kohës dhe vendit më të nevojshëm për ne. E dyta, lidhja me të Përkryerin tregon se projektet tona duhet të jenë relativisht të përkryera, bile me plane parësore, dytësore etj. Realiteti i sotëm është krejt ndryshe - mbrohemi dhe kërkojmë mbrojtje tek Allahu i Përsosur, e në anën tjetër

përpilojmë projekte shumë të cekëta, afatshkurtra dhe pa alternativa të tjera të mundshme. Është e vërtetë se ne kërkojmë ndihmë nga Zoti për pafuqinë tonë, por fuqinë dhe aftësinë që na ka falur i Madhi Zot në raport me krijesat tjera duhet ta shfrytëzojmë në maksimum, sepse ndoshta Allahu (xh. sh.) e ka fshehur suksesin tonë pikërisht në atë pjesë të potencialit që na ka dhuruar dhe të cilin ne nuk e kemi shfrytëzuar!

B-ja në këto dy fraza është nënshtrim ndaj Krijuesit, por dhe sundim dhe krenari ndaj krijesave.

Përse në istiadhe nuk përcaktohet puna për të cilën kërkojmë mbrojtje?

Shejtani është krijesë që përpiqet ta mashtrojë njeriun në të gjitha mënyrat. Nëse robi kërkon mbrojtje vetëm për një punë të caktuar, atëherë shejtani do të gjejë një mënyrë apo metodë tjetër për të depërtuar. Kjo formë e papërcaktuar ia mbyll të gjitha dyert shejtanit dhe nuk e lë të depërtojë në asnjë mënyrë. Kjo frazë na mëson se kur luftohet një e keqe, duhet bërë të gjitha përgatitjet për luftimin e saj. Në qoftë se ne e heqim vetëm një pjesë të së keqes, atëherë ka rrezik që pjesa tjetër të shtohet dhe përsëri të na mbulojë.

Mënyra se si e mbron Allahu njeriun nga shejtani për ne është e paqartë, bile ndonjëherë mund të jetë edhe e dhimbshme dhe e padashur për njeriun. P.sh. për ta mbrojtur një njeri nga mosbesimi (vepër shejtanore), Allahu ia merr shpirtin me besim, por parashtrohet pyetja: sa njerëz ka që e urrejnë vdekjen, qoftë edhe kur është në pyetje besimi?! Prandaj, besimtarit nuk i intereson mënyra se si i ndërhyt atij shejtani dhe cila është mënyra se si e mbron Zoti atë; ai - njeriu, pra, thjesht e kërkon suksesin, qoftë edhe me 'dëmin' personal. Kjo tregon se besimtari e shikon idealin; pava-

rësisht çmimit që duhet të paguajë për atë ideal.

Kur përmendet istiadhja, atëherë apriori parashtrohet një pyetje: përse ajo shqiptohet dhe nuk shkruhet në mus'haf?

Përderisa bëhet fjalë për lexim Kurani, për ibadet, për punë të hairit etj., fillimisht duhet të evitohen dhe të thuhën të këqijat. Ato nuk duhet vetëm të dihen dhe të fshihen, por të thuhën, siç shqiptohet istiadhja në fillim.

Sa i përket shkrimit, Allahu nuk ka dashur që librin e Vet ta fillojë me armikun e Tij dhe me fjalë pesimiste, por me mëshirë dhe falënderim.

Përse istiadhja fillon me hemzen e vetës së parë?

1. Hemzeja tregon prezencën apo praninë. Istiadhja fillon me hemze, në mënyrë që zemra e njeriut (bashkë me fizikun) të jetë e pranishme në luftën kundër shejtanit. Jo të kërkohet mbrojtje vetëm formalisht, por me gjithë qenien.
2. Gjithashtu, hemzeja nënkupton vetminë, kurse nuni (نُونٌ) bashkësinë dhe madhësinë. Vetmia e ndihmon njeriun të jetë modest dhe i përulur, dhe pastaj ta shmangë cilësinë më të keqe të shejtanit, kryelartësinë.<sup>8</sup>

Nga materiali i shtruar deri tani mund të nxirren këto tri parime të istiadhes:

- 1) njohja e shejtanit,
- 2) konstatimi se njeriu është krijesë që ka nevojë për ndihmën e Zotit; dhe
- 3) puna apo angazhimi sipas Kuranit dhe sunnetit për

---

<sup>8</sup> Shih: Ebu el-Hasen Hixham el-Mahxhubi dhe Vedi er-Radi, *Tefsiru el-istiadheti*, Rijad: 2015.

ta shmangur shejtanin dhe për t'u afruar te Zoti. *Njohje, konstatim dhe shërim (evitim).*

### Nevoja për të Domosdoshmin

Në frazën **أَعُوذُ بِاللَّهِ** – *kërkoj mbrojtje tek Allahu*, kemi një ngritje: nga krijesa - te Krijuesi dhe nga e mundshmjia - tek i Domosdoshmi.

Kjo është rruga e parë që duhet ndjekur, sepse nevoja jonë për Zotin e mundëson njohjen më të mirë të Tij. Kjo fjali është simbol i nevojës sonë për Allahun. Pra, fjala e rob-it (**أَعُوذُ** - *kërkoj mbrojtje*) prek pohimin e tij të prerë, se ai është i varfër dhe nevojtar për Allahun. Kurse fjala (**بِاللَّهِ** – *tek Allahu*) është simbol i të Pasurit Suprem, i Atij që i sjell mirësitë dhe që i largon ligësitë, dhe se askush nuk mund të cilësohet me këto cilësi. Vetëm Ai mund t'i zgjidhë hallet e njerëzve dhe t'u japë atyre të mira.<sup>9</sup>

Istiadhja është një mekanizëm i fuqishëm për ta njohur Zotin.

Fraza (**أَعُوذُ بِاللَّهِ** – *kërkoj mbrojtje tek Allahu*) e pasqyron dobësinë e rob-it dhe fuqinë e Zotit. Kjo na vetëdijeson, se mënyra më e mirë për t'u afruar tek Allahu është pamundësia dhe nënshtrimi. Kështu që, Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Kush e njeh veten, ka njohur Zotin”, d.m.th.: kush e kupton dobësinë dhe mangësinë e vet, e njeh Allahun, sepse i përkryer është vetëm Ai. Kush e njeh veten të dobët, e njeh Zotin të Përkryer; kush e njeh veten me të meta, e njeh Allahun të Përsosur etj.

Adhuresit mund t'i nënshtrohen adhurimit të mirëfilltë vetëm pasi të distancohen nga rruga shejtanore. Kjo bëh-

---

<sup>9</sup> Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb*, Vëllimi I, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 101.

et me istiadhen, por duhet ditur se edhe istiadhja është një lloj ibadeti. Pra, nëse themi se para çdo ibadeti duhet thënë istiadhja, atëherë duhet të thuhet edhe para kësaj një istiadheve, gjë që është e pamundur për ta realizuar. Megjithatë, prej nesh kërkohet që vërtet ta kuptojmë këtë paaftësi dhe mangësi tonën, sepse vetëm atëherë e kemi plotësuar zinxhirin e pafund të istiadheve, me një të shqiptuar të saj.

Në të vërtetë, secili ibadet është i pamjaftueshëm për të shpëtuar, nëse njeriu nuk e kupton dobësinë e vet, nëse nuk shpreson në mëshirën e Zotit dhe nëse mbështetet në mundin e vet.

Po ashtu, fokusi i shejtanit është që robi të lexojë sa më pak Kuran.

Thelbi i istiadhes është mbështetja tek Ai që i largon të këqijat. Puna më fisnike së cilës i vihet shejtani, që i bën më shumë cytje atij, është leximi i Kuranit: sepse, atij që lexon Kuran me nijetin për të adhuruar të Gjithëmëshirshmin, me meditimin tek premtimi i Tij (xheneti), tek kërcënimi (xhehenemi), tek thellimi në ajetet dhe fjalët e Tij, i shtohet edhe më shumë ndjenja e adhurimit dhe e largimit prej gjërave të ndaluara. Për këtë arsye, leximi i Kuranit llogaritet ibadeti më i madh, por, edhe përpjekja e shejtanit në këtë sferë është më e madhe. Duke pasur parasysh këtë, edhe nevoja e njeriut për t'u mbrojtur nga shejtani është më e madhe. Prandaj, leximi i Kuranit duhet filluar me istiadhe.<sup>10</sup>

Shejtani është armiku i njeriut. I Gjithëmëshirshmi thotë: **“Me të vërtetë, shejtani është armiku juaj. Prandaj, ko-**

---

<sup>10</sup> Fahrudin Er-Razi, *vep. e cit.*, f. 103.

**nsiderojeni atë armik.”** Allahu (xh. sh.), ndërkaq, është Mbikëqyrësi, Krijuesi dhe Realizuesi i të gjitha dëshirave. Njeriu kur nis një ibadet, frikësohet prej armikut, prandaj përpiqet që ta fitojë kënaqësinë e Zotit, që Ai t’ia largojë vështirësinë e shejtanit. E, kur robi ta arrijë shmangien e kësaj pengese, ta përjetojë kënaqësinë dhe krenarinë, atëherë e harron armikun dhe i përkushtohet tërësisht të Dashurit (Allahut xh. sh.). Prandaj, puna e parë është ikja nga shejtani, punë e cila bëhet përmes istiadhes, kurse e dyta, vendosja nën strehimin e Sunduesit të Gjithëfuqishëm, gjë e cila bëhet me besmelen.

Pra, istiadhja është një katarzë (pastrim) paraprake për çdokënd që e shqipton.

Allahu Fuqiplotë ka thënë: **“Atë (Kuranin) nuk e prek-in, veçse të pastërtit.”** Kur zemra dhe gjuha flasin diçka tjetër jashtë përmendjes së Zotit, atëherë bëhet një lloj ndotje e cila kërkon pastrim. Kur themi (أَعُوذُ بِاللَّهِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu*), atëherë jemi pastruar dhe jemi përgatitur për ta përmendur Allahun (për ibadet), prandaj pas istiadhes themi: (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ – *me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit*).

Nëse u hedhim një vështrim disa ibadeteve, shohim se ato kërkojnë një lloj pastrimi fizik; bile, në disa prej tyre, siç është namazi, pastërtia kushtëzohet në disa segmente. Pra, Islami nuk është fe formaliste, që të kërkojë vetëm pastrimin e trupit, por ajo paralelisht kërkon edhe pastrimin e shpirtit para çdo ibadeti në vazhdim.

Kjo frazë (istiadhja) e përgatit myslimanin që të ballafaqohet me armiqtë e unit të tij.

Disa njerëz të urtë kanë thënë: “Ti ke dy armiqtë: një të

dukshëm dhe një të padukshëm, kurse prej teje kërkohet që t'i luftosh ata. Zoti (xh. sh.) për armikun e dukshëm ka thënë: **“Luftoni ata që nuk besojnë tek Allahu”**, e për të padukshmin: **“Me të vërtetë, shejtani është armiku juaj. Prandaj konsiderojeni atë armik.”** Kur ta luftosh armikun e dukshëm, ndihma e Zotit është me ty: **“Zoti juaj ju ndihmoi me pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.”** Po edhe kur ta luftoni armikun e padukshëm, Zoti është me ju: **“Në të vërtetë, ti (shejtani) nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi.”** Luftimi i armikut të padukshëm është më i rëndësishëm, sepse armiku i dukshëm të privon prej kënaqësive të kësaj bote, kurse i padukshmi të largon prej fesë dhe prej bindjes tënde. Nëse na mund armiku i dukshëm, jemi robër; nëse mbi ne ngadhënjën armiku i padukshëm, jemi të ngujuar. Gjithashtu, atë që e vret armiku i dukshëm bie shehid (dëshmor); atë që e vret armiku i padukshëm (shejtani), ai është i dëbuar prej mëshirës së Zotit. Prandaj, kujdesi kundrejt rrezikut të armikut të padukshëm duhet të jetë më i madh. Kjo mund të bëhet atëherë kur njeriu me zemër dhe me gjuhë thotë: **“أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – kërkoi mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar”**.

### Zemra është kopshti Zotit

Vërtet, zemra e besimtarit është vendi më fisnik. Ajo ka më shumë vlerë se shtëpitë e fortifikuara, se fushat e bukurra dhe se kopshtet e gjelbëruara. Ajo është sikur pasqyra e pastër, madje edhe më shumë se kaq; sepse, nëse pasqyra mbulohet me diçka, në të nuk shikohet asgjë, ndërsa zemrën e besimtarit nuk e mbulojnë as shtatë kate qiej, as Froni dhe as Arshi. Këtë të vërtetë e tregon Allahu (xh. sh.) kesh-

tu: **“Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë.”** (Fatir, 10) Pra, zemra krahas gjithë këtyre mbulesave, mbërrin të kuptojë madhështinë hyjnore të Zotit dhe cilësitë e përhershme të Tij.

Zemra është vendi më fisnik. Ky realitet tregohet në tri mënyra. E para: Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Varri është një kopsht prej kopshteve të xhenetit”. Pra, ai mund të jetë i tillë vetëm për një rob zemërmirë. Kur e dimë se zemra është djepi i njohjes së Zotit, atëherë vërtet ajo meriton të jetë vendi më fisnik. E dyta: Sikur Allahu (xh. sh.) dëshiron të na thotë: “O robi im, zemra jote është kopshti im, kurse xheneti është kopshti yt. Nëse ti je bujar me (kopshtin Tim) zemrën tënde, e ngulit në të njohjen dhe dashurinë ndaj Meje, atëherë si mund të jem Unë koprrac ndaj (kopshtit tënd) xhenetit. E treta: i Lartmadhërishtmi na tregon mënyrën e zbritjes së robit në kopshtin e xhenetit. **“Në kuvendin e së vërtetës (në Xhenet), tek një Sundues i Plotfuqishëm.”** (El-Kamer, 55) Zoti nuk ka thënë vetëm “Sundues”, por “Sundues i Plotfuqishëm”. Pra, Allahu (xh. sh.) atë ditë do të jetë Sunduesi Suprem, kurse robërit do të jenë sundues relativë nën fuqinë e Zotit.

Nëse e kemi kuptuar këtë pjesë hyrëse, atëherë i kuptojmë këto fjalë, sikur Zoti na thotë: O robi im, xhenetin Tim e bëra për ty, e ti xhenetin tënd (zemrën) ma dhurove Mua, por nuk u tregove shumë i drejtë, sepse kur u afrove për të hyrë në xhenet, Unë e largova shejtanin prej aty para se të hysh, duke i thënë: **“Dil prej andej i përbuzur dhe i përjashtuar!”** (El-Araf, 18) E ti, shtatëdhjetë vjet pasi hyra në kopshtin (zemrën) tënde, ende nuk je në gjendje ta dëbosh armikun Tim (shejtanin). Atëherë robi përgjigjet: O Zot, Ti vërtet e largove shejtanin nga xheneti, por unë s’po mund

ta largoj atë nga vetja, sepse jam i dobët. Allahu (xh. sh.) thotë: Kur i dobëti hyn nën mbrojtjen e Allahut, bëhet i fortë, prandaj hyr nën mbrojtjen time dhe nxirre armikun nga zemra jote duke thënë: “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar*”.<sup>11</sup>

Dikush mund të pyesë: nëse zemra është kopshti i Allahut, atëherë pse Ai nuk e nxjerr vetë shejtanin? Dijetarët përgjigjen kështu: njohjen e Zotit në zemër e fut vetë njeriu. Ai që dëshiron të futë diçka tjetër pos tij, njëherë duhet ta pastrojë atë nga e para. Ashtu që, për të filluar adhurimin e Allahut, fillimisht duhet pastruar zemra nga të gjitha mbeturinat dhe tundimet e shejtanit. Ky pastrim fillon me parullën “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar*”.

### Shejtani ishte adhurues i Zotit

Zoti sikur na thotë: ti nuk u tregove i drejtë, o robi im! A e di përse e kam dëbuar shejtanin nga mëshira ime? Ai më adhuronte Mua si melaqet, madje në pamjen e jashtme dukej se vërtet më adhuronte, mirëpo lidhja jonë u shkatërrua atëherë kur unë e urdhërova t'i binte në sexhde babait tuaj, Ademit (a. s.), e ai këtë nuk e bëri. Kështu, ai u bë kryelartë dhe nuk pranoi të më shërbente Mua, ndërsa me Ademin (a. s.) nuk kishte asgjë. Ai me vite të tëra të konsideron armik dhe të kundërshton në çdo të mirë, kurse ti ende e do dhe u nënshtrohesh të gjitha dëshirave të tij. Prandaj, lëre këtë rrugë të shëmtuar, tregoje armiqësinë tënde ndaj tij dhe thuaj: “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu*

<sup>11</sup> Fahrud-din Er-Razi, *vep. e cit.*, f. 105.

*prej shejtanit të mallkuar”.*

Veti e shpirtligjve është revanshi pas dështimit. Njësoj si Iblisi, i cili pasi u dëbua nga mëshira e Zotit (xh. sh.), u zotua se do të bëjë përpjekje maksimale për të devijuar të tjerët.

Nëse e vështron tregimin e babait tënd, të Ademit (a.s.), atëherë do të shohësh se shejtani u betua të jetë këshilltar i tij dhe e nxori atë nga xheneti. Për ty, ndërkaq, ai është betuar se do të devijojë nga rruga e drejtë. Allahu (xh. sh.) thotë: **“Ai (Iblisi) tha: ‘Betohem në madhërinë Tënde se unë do t’i mashtroj (devijoj) ata të gjithë, përveç robërve Tu të sinqertë!’”** (Sad, 82-83) Shejtani i premtoi Ademit (a. s.) se dëshiron ta këshillojë atë, por e nxori nga xhenetit; kurse për ty që u betua se do të të devijojë, paramendo se çfarë mund të të bëjë. Prandaj thuaj: *“أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – kërkoj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar”.*

Po ashtu, kjo ngjarje na mëson se premtimi nga keqberësi asnjëherë nuk duhet besuar, sepse pavarësisht nëse premtimi është pozitiv apo negativ, pasojat i ka të kobshme.

### **Istiadhja është e varur për emrin Allah**

Allahu (xh. sh.) ka urdhëruar të thuhet *“أَعُوذُ بِاللَّهِ – kërkoj mbrojtje tek Allahu”*. Pra, e ka përdorur emrin *“الله – Allah”*, sepse me këtë emër e keqja dhe mëkati kapen në mënyrë të përpiktë, në të gjitha dimensionet e së keqes. Për t’u hetuar mëkati duhet fuqi, dituri, urtësi etj. Nëse nuk do ta përmendnim emrin gjithëpërfshirës *“Allah”*, atëherë do të duhej të thoshim: *“أَعُوذُ بِالْقَادِرِ الْعَلِيمِ الْحَكِيمِ... – Kërkoj mbrojtje tek i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdijshti, i Urti, etj.”*, sepse për t’iu larguar dhe për ta evituar mëkatin duhen të gjitha këto cilësi. P.sh. nëse

një vjedhës e di se pronari i një gjëje është vetëm i fuqishëm, por jo edhe i dijshtëm apo i gjindshëm, atëherë ai vendos të vjedhë. Pra, poseduesi i vetëm njërës prej këtyre vetive nuk e mbron pasurinë.

Kur robi thotë: (أَعُوذُ بِاللَّهِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu*), nuk i ka lënë shteg shejtanit për të shpresuar, sepse emri “Allah” i përmban të gjitha cilësitë e përsosura të Zotit dhe i bën ballë çdo mëkati apo lëshimi. Pra, me përdorimin e istiadhes përforcohet çdo pikë e dobët që ke, në mënyrë që mos të hyjë shejtani prej saj.

Meqë në istiadhe mbështetja bëhet vetëm tek Allahu, atëherë edhe sfida bëhet me të keqen dhe jo me keqbërësin, sepse Allahu kërkon të luftohen veset e këqija dhe jo individët.

Kur robi thotë “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar*”, tregon se ai nuk pajtohet të qëndrojë pranë shejtanit. Pakënaqësia e njeriut me shejtanin nuk është pse ai është mëkatar, sepse mëkati i tij nuk e dëmton myslimanin, por për shkak të aleancës që ai ka lidhur me mëkatin dhe për shkak të propagandës që ai bën në favor të punëve të këqija. Kështu që, nëse njeriu nuk e do shejtanin për mëkatin që ai bën për vete, atëherë me më shumë përparësi është që mos ta dojë vetë mëkatin.

Fatkeqësisht, sot një numër i madh i myslimanëve përpiqen që t’i eliminojnë mëkatarët, pa i kushtuar vëmendje vetë aktit të mëkatit. Nëse luftohen mëkatarët dhe mbetet gjallë fryma mëkatore, atëherë ajo do të prodhojë mëkatarë të tjerë; e, nëse luftohet fryma mëkatore, atëherë mëkatarët do shkatërrohen vetë, sepse ata nuk mund të mbijetojnë në ambiente paqësore.

Një prej anomalive kryesore të mendësisë bashkëkohore, ndërkaq, është arsyetimi i mëkatit dhe kjo e bën edhe më të vështirë veprimin kundër shejtanit dhe të keqes.

Istiadhja është e fokusuar në luftimin e së keqes si fenomen dhe jo të keqbërësve si individë, prandaj Zoti (xh. sh.) na flet në formë të detajuar për vetë të keqen.

Fjala “الشَّيْطَانُ – shejtan” është emër, ndërsa “الرَّجِيمُ – i mallkuar” është mbiemër, por e përmendi edhe cilësinë e tij nënçmuese, edhe pse ai nuk mund ta dëmtonte aspak Zotin. Zoti (xh. sh.) sikur na pyet: edhe pse shejtani me mijëra vite veproi në mesin tonë, a na dëmtoi neve diçka? Me siguri që jo. Madje, përveç kësaj ne e mallkuam dhe e dëbuam prej mëshirës sonë. Kurse ty, për një moment të hedh në zjarrin e përhershëm... Atëherë, pse nuk përpiqesh ta largosh dhe ta mallkosh duke thënë: “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar*”.

Ky përshkrim i shejtanit, me emër e mbiemër, tregon se Zoti ia shpalosi fytyrën e vërtetë atij, në mënyrë që njerëzit të mos bien pre e kurtheve të tij. Pra, Zoti ta shpalosi të vërtetën për të, para se ai të veprojë, kurse ti duke qenë nën presion të hapur të tij, ende hamendesh a ta luftosh.

Përshkrimi i detajuar i shejtanit dhe vizatimi i vijave të rrugës së besimtarit është argumenti më i qartë se Meritori i gjithçkasë është vetëm Allahu, pra vetëm Atij duhet mbështetur.

Dikush mund të pyesë: pse nuk themi “أَعُوذُ بِاللَّهِ – *kërkoj mbrojtje prej melaqeve?*” Ngase, edhe një melaqe do të mjaftonte për t’u mbrojtur prej shejtanit. Për çfarë arsye Zoti e përmend emrin e këtij (shejtanit) përballë emrit të vet të madhërisëm? Përgjigjja do të ishte kështu: Zoti dëshiron

t'i thotë: "O robi Im, ai të shikon ty, e ti nuk e shikon atë. Allahu (xh. sh.) thotë: **"Ai dhe shpura e tij ju shohin, prej nga ju nuk i shihni ata."** (El-Araf, 27) Ai ju bën kurthe juve, sepse ai ju shikon, e ju nuk e shikoni atë. Prandaj, mbajuni për Atë që e shikon shejtanin, e shejtani nuk e shikon Atë. Thoni "أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar*". Me një fjalë, të gjitha kurthet e shejtanit mund t'i dijë vetëm Zoti, ndërsa melaqet e dinë vetëm atë që Allahu ua mëson.

Rrugua drejt dëlirësisë hyjnore nuk arrihet duke u mbështetur në krijesa, sado të mira të jenë ato, por duke iu përulur Krijuesit. Pra, qysh në istiadhe robi vendoset para një zgjedhje shumë të rëndësishme: të vazhdojë të jetojë brenda kritereve të cilat i ka vënë Zoti për të gjitha krijesat, apo të drejtohet kah Krijuesi dhe të bëhet krijesa më e dalluar?!

Allahu (xh. sh.) fjalës "الشَّيْطَانُ – shejtan" ia shtoi shkronjën elif dhe lam (të cilat janë për shquarsi), në mënyrë që t'na njoftojë me gjithë familjen shejtanore. Shejtanët janë të shumtë, që shihen dhe që nuk shihen. Ndoshta ata që shihen janë më të rrezikshëm.

Në një mexhlis është thënë: "Kur njeriu dëshiron të japë sadaka, vijnë shtatëdhjetë shejtanë, të cilët e kapin për dore, për këmbe dhe për zemre, vetëm për ta ndaluar prej sadakasë." Kur dëgjoji një njeri për këtë, tha: "Unë do t'i luftoj të shtatëdhjetit." Doli nga xhamia, shkoi në shtëpi, e mbushi torbën me grurë dhe doli dhe nisi të shpërndante sadaka. Papritmas, kërceu gruaja e tij dhe filloi të grindet me të, derisa ia mori grurin. Kështu, burri u kthye në xhami i dëshpëruar dhe i dështuar. Njëri prej të pranishmëve e pyeti: "Çf-

arë bërë?” Tha: “I munda të shtatëdhjetë shejtanët, por erdhi nëna e tyre dhe më mundi mua.”<sup>12</sup>

Ky tregim nuk është paraqitur për ta nënçmuar gruan, sepse në vend të saj mund të jetë edhe djali, prindi, shoku etj., por thjesht për të dhënë një shembull se si shejtani i shfrytëzon barrierat, të cilat mund të jenë edhe shumë të vështira për t’u kaluar, qofshin ato kur vihen edhe prej njerëzve më të afërt dhe më të dashur.

Me elifin dhe lamin në fjalën “الشَّيْطَانُ – shejtan” mund të nënkuptohen edhe të gjitha mëkatet që bëhen me pëlqimin e shejtanit. Vetë pëlqimi është si me e bë mëkatin. Ndryshe ndodh me kundërshtimin e asaj ideje. Duhet kuptuar se edhe në shariat ekziston një gjë e tillë. P.sh. tek imam Ebu Hanifja leximi i imamit vlen edhe për xhematin, kështu që vetëm heshtja dhe dëgjimi i xhematit e plotëson leximin.

Largësia me shejtanin dhe afërsia me Zotin janë ligj hyjnor.

Fjala “الشَّيْطَانُ – shejtan” rrjedh prej fjalës “شَطَنَ – i larguar”. Mëkatari është i larguar, kurse adhuruesi është i afruar. Allahu (xh. sh.) thotë: **“Kurrresi mos iu nënshtro atij (shejtanit), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!”** (El-Alek, 19) Allahu është afër teje: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam afër.”** (El-Bekare, 186) Fjala “الرَّجِيمُ – rraxhim” nënkupton shënjestrën në të cilën gjuhet vazhdimisht. Edhe shejtani u atribuua me mbiemrin “الرَّجِيمُ – rraxhim”, sepse pareshtur goditet me mallkime dhe deshpërime. E ti, o rob i mirë, je i lidhur me lumturinë: **“e Ai (Allahu) i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përku-shtimit”.** (El-Fet’h, 26) Këto që thamë na tregojnë se Allahu

<sup>12</sup> Fahrudin Er-Razi, *vep. e cit.*, f. 101.

(xh. sh.) shejtanin e largoi nga mëshira e vet duke e qëlluar me mallkime, kurse besimtarin e afroi pranë (mëshirës) dhe e lidhi fort me mirësinë.

Gjithashtu, duhet kuptuar se Zoti nuk i ndryshon ligjet e veta: as shejtanin nuk e afron dhe as ty nuk të dëbon. Kështu që, ty të mbetet ta mbash afërsinë me Allahun dhe largësinë me shejtanin, duke thënë “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërk-oj mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar*”.

Nga e gjithë ajo që u tha deri tani, kuptohet se fushat sfiduese të besimtarit janë katër, përkatësisht katër janë edhe boshtet ku njeriu duhet të arrijë suksesin.

Pengesat në rrugën e Allahut janë katër: shejtani, nefsi (egoja), dynjaja dhe krijesat. Shejtanin e sfidon istiadhja, nefsin-përpyekja/muxhahede, dynjanë-zuhdi (jeta askete) dhe krijesat-largimi apo veçimi prej tyre/halvet.<sup>13</sup>

### **E mira, antitezë e së keqes**

Puna e parë që duhet bërë është largimi i të keqes. Pjesa e parë e shehadetit është: “Nuk ka Zot tjetër”, pra, niset me mohim, sepse kur të largohen zotat e rrejshëm, mbetet Zoti i Vërtetë, Allahu. Prandaj, edhe Kurani niset me istiadhen, duke kërkuar mbrojtje kundër babait të së keqes. E kur të mënjanohet shejtani, atëherë përpara na mbetet vetëm Kurani, fjala më madhështore.

Shpeshherë gabohet kur dikush përpiqet ta ndërtojë të mirën mbi rrënojat e së keqes. Istiadhja dhe shehadeti na

---

<sup>13</sup> Ebul Kasim Muhamed bin Ahmed bin Xhuzij El-Kelbij, “*Et-Tes’hil li ulumi et-tenzil*” I (Bejrut, Dalul Kutubil Ilmijeh, 1995), f. 41.

mësojnë se fillimisht duhet pastruar terreni mirë nga mbetjet e së keqes, pastaj të ndërtohet kështjella e mirësisë. Nëse themeli nuk është i ndërtuar mirë, atëherë në tronditjen më të vogël të kështjellës themeli do ta thotë fjalën e vet.

Një problem tjetër i mirësive është se si ato të vazhdojnë të kenë jetë të gjatë në mesin tonë, sepse mbrojtja e një të mire është më e vështirë sesa fitimi i saj.

Dikush mund të parashtojë pyetjen: pse thuhet “أَعُوذُ بِاللَّهِ – kërkoi mbrojtje tek Allahu”, e jo “بِاللَّهِ أَعُوذُ – tek Allahu kërkoi mbrojtje”. Shejtani e beson Allahun me bindje, por u bë jobesimtar, sepse nuk iu nënshtrua urdhrit dhe i përshkroi shok Atij, duke e bërë veten idhull. Pra, kjo është dhe puna më e madhe e tij, që njerëzve besimin në Zot t’ua turbullojë dhe t’i çojë që të bëjnë shirk. Allahu (xh. sh.) e dinte se fusha më aktive e tij do të jetë në shirk sesa në mohim, sepse njerëzit do ta idolizonin unin e vet, prandaj e ka përmendur mbrojtjen para emrit të Vet (Allah). Gjithashtu, edhe në jetën e përditshme e kemi kuptuar se mbrojtja e një gjëje është më e vështirë se fitimi i saj. Pra, shejtani e di se për t’i bindur njerëzit në mosekzistimin e Allahut e ka shumë të vështirë, prandaj iu qas njolllosjes së besimit. Por, Allahu (xh. sh.) këtë të vërtetë e di para se ai ta mendojë, prandaj na porositi qysh në fillim me mbrojtje.

### Thirrja për modesti

Problemi i parë që Allahu (xh. sh.) ka propozuar të sfidohet është lufta me shejtanin, sepse një ndër cilësitë më kryesore, madje shkaku që u dëbua prej mëshirës së Zotit, është kryelartësia. Sikur Zoti (xh. sh.) dëshiron të na thotë: Hiqeni kryelartësinë, sepse çdo gjë që bëni duke qenë kryelartë

asgjësohet.

Shumë dijetarë kryelartësinë e kanë vënë në rendin e parë të mëkateve, bile disa edhe para mosbesimit dhe shirkut; jo nga pesha e mëkatit, por nga aftësia për të ndryshuar. Shumë jobesimtarëve dhe politeistëve po t'u sqarohet realiteti, e pranojnë. Kryelarti, ndërkaq, as që pranon t'i sqarohet diçka. Njësoj si Iblisi - ai nuk e mohoi ekzistencën e Zotit, por me kryelartësi e mohoi urdhrin e Tij.

Shpeshherë modestia keqkuptohet, madje në shumë raste ngatërrohet edhe me naivitetin. Modestia e kërkuar në Kuran dhe e mishëruar në jetën profetike të Muhamedit (a. s.) është veti e cila prodhon efekte pozitive të shumanshme. Nëse modestia nuk i mundëson besimtarit të arrijë çiltërsinë shpirtërore, atëherë nuk është e duhura.

Kurani është libri që i siguron njeriut jetën e xhenetit. Shejtani, ndërkaq, mundohet ta largojë njeriun prej tij ashtu siç e nxori Ademin (a. s.). Prandaj, para se robi të fillojë ta përgatit veten për xhenet, duke e lexuar dhe zbatuar Kurandin, fillimisht duhet ta largojë atë (shejtanin), që është pengesa kryesore.

Gjithsesi se duhet të kihet kujdes edhe në ndarjen e vijës shumë të hollë ndërmjet modestisë dhe lajkës, si dhe ndërmjet kryelartësisë/qibrit dhe seriozitetit/vakar. Pra, besimtari duhet të jetë modest dhe serioz dhe në asnjë mënyrë lajkatar dhe qibërli.

Nëse Kurani është xhenet, në xhenet hyjnë vetëm të pastrit.

## Shejtani, burim i frikës dhe i stresit

Në ditët e sotme problemet fizike dhe psikike te njeriu kryesisht shkaktohen si rezultat i frikës, i stresit dhe i pasigurisë. Të gjitha këto veprime ndodhin nga nxitja e shejtanit. Ai që krijoi çdo gjë, ndërkaq, e di shumë mirë këtë realitet, prandaj i urdhëroi njerëzit që prej në fillim ta luftojnë atë që i shkakton këto problem, duke thënë “أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ – *kërkoj mbrojtje tek Allahu kundër shejtanit të mallkuar*”, e pastaj mund të vazhdojë leximin e Kuranit, por edhe ta jetojë jetën në siguri dhe paqe. Pra, atë që sot bota e ka problem kryesor, Zoti e ka zgjidhur ende pa i nisur fjalët e veta në Kuran.<sup>14</sup>

Po ashtu, kjo na porosit që njerëzve t’u sigurohet siguria dhe mirëqenia para se t’u ofrohet Islami.

Përveç realitetit që shejtani është burim i frikës dhe i stresit, Allahu (xh. sh.) brenda istiadhes na ka mësuar se si të krijohet koncepti i qartë i punës së mëtutjeshme, sepse mospasja e një projekti të konceptuar mirë e sjell stresin dhe frikën nga shejtani.

Allahu (xh. sh.) në istiadhe na ka treguar se si duhet nisur punët. Në çdo nismë duhet pasur koncept të qartë për punën që duhet bërë, prandaj Allahu (xh. sh.) qysh në istiadhe na mëson që gjatë gjithë jetës, në mesin e tyre edhe gjatë leximit të Kuranit, synim t’i kemi këto dy parime: largimin nga punët shejtanore dhe drejtimin apo fitimin e kënaqësisë së Zotit. Nuk i takon besimtarit që të veprojë pa pasur një koncept të qartë për atë që do ta arrijë.

---

<sup>14</sup> Ebul Kasim Muhamed bin Ahmed bin Xhuzij El-Kelbij, *vep. e cit., f. 42.*

## Subjektivizmi në istiadhe dhe formësimi i karakterit të pavarur

Në istiadhe Zoti (xh. sh.) na ka urdhëruar që të kërkojmë mbrojtje në vetën e parë njëjës *أَعُوذُ* “*Unë kërkoj mbrojtje*”, sepse këtu bëhet fjalë për devijim apo për udhëzim - do ta ndjekim shejtanin, apo Allahun; do ta marrim rrugën e mbarrë, apo të gabuar. Pra, këtu merret përgjegjësia, për të cilën robi vetë personalisht do të përgjigjet: “çdo shpirt do të jetë peng i asaj që ka punuar”. Prandaj, edhe marrjen e përgjegjësisë e ka theksuar në vetën e parë njëjës, sepse edhe dhënia llogari për përgjegjësinë (besimin) e marrë do të bëhet një nga një.

Përgjithësimi të cilin sot shumë individë përpiqen ta bëjnë në adresë të Islamit është i gabuar, sepse duke u përpjekur ta tregojnë si fe kolektive, harrojnë se nga një aspekt fetaria është çështje shumë subjektive. Pra, raporti i robit me Zotin është subjektiv, përderisa nuk është e përzier e drëjta e robit.

Istiadhja në të njëjtën kohë është edhe besim tek e fshehta. Pikërisht kjo e reflekton edhe subjektivizmin e myslimanit.

Ai që e thotë me bindje dhe sinqeritet istiadhen, përveç tjerash, e ka plotësuar edhe besimin tek e fshehta, sepse kërkon mbrojtje tek Allahu, i Cili është i Padukshëm; sepse është kundër shejtanit, i cili po ashtu është i padukshëm për ne.

Pra, njeriu ende pa filluar leximin e Kuranit parimisht bën pranimin e një ndër shtyllave më të nevojshme të besimit islam.

Në fjalën “أَعُوذُ بِاللَّهِ – mbrohem me Allahun”, parafjala “ب” “me” tregon lidhje të fortë me Allahun. Vetë krijimi i lidhjes së fortë të njeriut me Zotin, e bën atë të pavarur para njerëzve. Pra, istiadhja e nxit robin që të bëhet vetja dhe vetë ta formojë karakterin e vet personal, pa qenë i varur prej askujt.

Ai që e shqipton istiadhen duhet të reflektojë nënshtrim dhe varësi vetëm ndaj Zotit (xh. sh.), kurse çiltërsi dhe pavarësi ndaj krijesave.

Njeriu, edhe pse është qenie shoqërore, ai përsëri ka të veçantën e tij, të cilën duhet ta lidhë vetëm me Krijuesin.

Gjithashtu, istiadhja është nxitje për të besuar caktimin e Allahut, sepse me shqiptimin e sinqertë të këtyre fjalëve, fatin ia mbështet vetëm Atij.

Prej njeriut kërkohet që në nisjen e çdo pune të ketë bazament dhe mbështetje të fortë. P.sh. nëse një ndërtesë njëzetkatëshe ngrihet mbi themelet që mbajnë vetëm dy kate, me siguri ndërtesa do të rrëzohet. Kur njeriu e shqipton sinqerisht istiadhen, ai e ka vënë bazamentin dhe mbështetjen më të fuqishme që ekziston, kështu që e ka rrugën e hapur që të vazhdojë, sa të dojë, me ndërtimin. Pra, besimtarit nuk i takon që të nisë punë të mëdha me kapacitet të vogël, sepse atëherë bëhet edhe një mëkat tjetër që nuk i takon atij - lënia e punës përgjysmë.

Kurani, kthimin e të keqes me të mirë e bëri armë kundër shejtanit njeri, kurse istiadhen armë për shejtanin xhind.<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Muhamed Mahmud Hixhazi, “*Et-Tefsirul Vadih*” I (Darul Xhil), f. 3.

## BESMELJA – الْبِسْمَلَةُ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit”*

Besmeleja “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit” është një sintagmë dhe jo një fjali e vetme kuptimplote. Dijetarët islamë mendojnë se qoftë para, ose pas besmeles, paramendohet të jetë një folje *punoj, lexoj, shkruaj, udhëtoj* etj., varësisht për çfarë përdoret. Imam Bejdaviu mendon se më mirë është që pjesa e paramenduar të vihet pas besmeles.<sup>16</sup>

Ata që mendojnë se paramendohet në fillim, togfjalëshin “me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit” e quajnë kallëzues, kurse pjesën e paramenduar në fillim kryefjalë. Megjithatë, parashtrohet pyetja: përse Zoti nuk ka zgjedhur një frazë universale, e cila i përfshin të gjitha dhe të mos paramendohet asgjë? Përgjigjja: Allahu i Madhërishëm dëshiron që Kuranin ta fillojë me nijet dhe jo me fjalë të cilat dikush mund t’i shqiptojë spontanisht. Pra, besmeleja është një fjali, kryefjala e së cilës është në zemër, kurse kallëzuesi në letër. Fjalja kuptimplote fitohet vetëm kur të dy gjymtyrët kryesore të fjalisë, kryefjala dhe kallëzuesi, janë të pranishme. Nëse njëra mungon, fjalja mbetet e mangët. Nëse ze-

---

<sup>16</sup> El-Bejdaviu, *Envaru et-tenzil ve envaru et-te’vili, vëllimi I, Daru Ihjai et-Turathi el-arabijji*, Bejrut, f. 25.

mra nuk e ka përcaktuar dhe përforcuar nijetin, atëherë pjesa që lexohet (besmeleja) do të dalë vetëm si fjali, por pa shpirt. D.m.th. kur njeriu dëshiron një besmele të fortë, duhet të ketë një nijet të sinqertë.

Një pjesë tjetër e dijetarëve mendojnë se pjesa e pararenduar është në fund, jo në fillim, sepse për besimtarin nuk është e rëndësishme puna, por lidhja me Allahun. Për t'u treguar përparësia e lidhjes me Zotin, s'ka nxjerrë asnjë fjalë para frazës që tregon lidhjen e robit me Zotin.<sup>17</sup>

Kjo formë e besmeles të jep të kuptosh se për besimtarin nuk ka rëndësi se çfarë pune bën, por e rëndësishme është që në çdo punë të mos e humb lidhjen me Krijuesin.

Gjithashtu, mosshqiptimi i punës që bëjmë mund të jetë si rezultat i asaj se njeriu për ta fituar lidhjen me Zotin mund të kryejë çdo punë të nevojshme.

Po ashtu, kur e nisim një punë, nëse ne e përcaktojmë, në një mënyrë e kemi humbur lidhjen me Zotin nëse brenda asaj pune lindin punë të tjera të vogla. Pra, besmeleja nuk lidhet me procesin e punës, sepse ajo i lihet në dorë Zotit (xh. sh.), por me objektivin dhe synimin e njeriut.

Kjo lidhshmëri e robit me Allahun, përveç lutjes ndaj Zotit që të na ndihmojë në çdo punë, na i mëson edhe parimet kryesore të një suksesi:

- a) Nijeti i sinqertë, i cili nuk shqiptohet, por fuqishëm përjetohet dhe reflekton në vepra të shëndosha. Pra, besmeleja na mëson se një punë mund të jetë e suksesshme vetëm kur nijeti është i sinqertë, kurse aty ku nijeti arsyetohet me fjalë (siç ndodh sot) dhe jo me punë, është tregues i josinqeritetit. Gjëja më e urryer për nijetin e

---

<sup>17</sup> El-Bejdaviu, *vep. e cit.*, f. 102.

sinqertë është fjala, kurse treguesi më i qartë i nijetit të rrejshëm janë fjalët.

- b) Lidhja me Zotin. Kjo lidhje i siguron të gjitha kushtet e nevojshme për ta arritur një punë të caktuar. Besimtari që ka formuar lidhjen me Zotin e ka ofruar projektin më të përsosur për realizimin e qëllimit të vet. Kështu që, besimtari duhet t'i matë mirë punët kur dëshiron të realizojë një projekt të caktuar.

### **Musa (a. s.) dhe besmeleja**

Një ditë Musa (a. s.) u sëmur dhe dhimbjet e barkut sa vinin e i shtoheshin më shumë. Për këtë iu ankua Allahut (xh. sh.) e Ai e udhëzoi se për t'u shëruar duhej të merrte një bimë, pas së cilës do të shërohej. Musa (a. s.) e mori dhe u shërua. Pastaj, edhe një ditë tjetër iu kthye e njëjta dhimbje. Kështu, shkoi dhe mori bimën e njëjtë për ta pirë. Por, më kot, sepse dhimbja iu shtua edhe më shumë. Me këtë rast Musa (a. s.) iu drejtua Allahut (xh. sh.): "O Allah, kur e hëngra herën e parë, gjeta derman; por, herën e dytë më ndikoi për keq. Ç'është kjo punë?!" Allahu iu përgjigj se 'herën e parë shkove me urdhrin Tim, kurse herën e dytë shko-ve vetë'. A nuk e di se dynjaja është gjithë helm, ndërsa kundërhelmi është edhe gjëja më e keqe.<sup>18</sup>

Kjo ngjarje e Musait (a. s.) jep një frymëzim të fuqishëm për krijimin e lidhjes mes robit dhe Krijuesit. Ajo që Musain nuk e shëroi herën e dytë është veprimi kokë më vete, kurse ajo që e shpëtoi herën e parë është nënshtrimi ndaj urdhrin të Zotit (xh. sh.), pavarësisht se në të dy herët ilaçin e piu

---

<sup>18</sup> Fahrurddin Er-Razi, *vep. e cit.*, f. 124.

me bismilah. Pra, përveç artikulimit të besmeles, patjetër duhet të bëhet edhe artikulimi metafizik i saj.

Kjo ngjarje po ashtu flet për fleksibilitetin e përdorimit të mësimave fetare në situata të caktuara; jo çdoherë duhet përdorur metoda të njëjta, sepse ajo tregon mungesën e aftësisë së njohjes së prioriteteve dhe mungesën e urtësisë islame. Po e paraqes simbolikisht: aty ku duhet thënë “eudhu bil-lahi...”, mos thuaj “bismil-lahi”; ose e kundërta.

Kjo ngjarje është shumë e pranishme edhe sot, sepse shpeshherë hasim në myslimanë të cilëve nuk u bën derman as Kurani, as besmeleja dhe asgjë nga feja. Në mesin e arsyeve të kësaj problematike është pikërisht ‘lëshimi’ që bëri Musa (a. s.), pra të bëjnë tjetërsimin dhe ta përdorin Kuranin për punët (interesat) e veta të ngushta, dhe jo të shfrytëzohet aty ku realisht duhet. Nëse raporti i individit me Kuranin nuk ndërtohet në bazë të vetë normave kuranore, por sipas tekeve personale, atëherë efekti i fesë do të jetë i kufizuar.

Besmeleja, ashtu siç ishte shërim për Musën, po ashtu është lehtësim dhe shpëtim edhe për mbarë njerëzimin.

Fraza “بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ – me emrin e Allahut, Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit”, të jep të kuptosh se para saj ekziston shprehja أَيْدٍ – filloj; pra: “Filloj me emrin e Allahut, Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit”. Meqë kjo shprehje përdoret në fillim të çdo pune, atëherë kuptohet se çdo fillim ka nevojë për ndihmë dhe lehtësim, prandaj Allahu (xh. sh.) përveç ndihmës që i jep njeriut me besmelen, ia thjeshtëson edhe shqiptimin e saj. Kjo është mëshira e Allahut, e cila përveç ndihmës, i thjeshtëson punët në çdo fillim, andaj ne duhet të marrim mësim prej kësaj: çdoherë të përpiqemi për lehtësim dhe thjeshtësi.

Thuhet se Faraoni para se të vetëshpallet zot, ndërtoi një kështjellë dhe urdhëroi që në derën e jashtme të saj të shkruhet “ بِسْمِ اللَّهِ – me emrin e Allahut”. Kur u vetëshpall zot, tek ai u dërgua Musa (a. s.), por Faraoni assesi të përmirësohet, andaj Musa (a. s.) lutej: “O Zot, lutem për të, por nuk shoh asnjë të mirë tek ai!” Allahu i përgjigjet: “O Musa, ndoshta t’i dëshiron ta shkatërrosh duke shikuar në mosbesimin e tij, kurse Unë shoh atë që ai ka shkruar në derën e tij.”

Pavarësisht nëse është apo nuk është e vërtetë kjo ngjarje, thelbi i kësaj qëndron në vetë faktin se, nëse ai që i ka dhënë shumë pak rëndësi emrit të Allahut, siç ishte rasti i Faraonit, Allahu e shpëton prej së keqes, atëherë si do të jetë me atë që lind dhe vdes duke mbajtur në zemër emrin e Tij?! Pra, në një mënyrë apo në një tjetër, besimtari duhet të jetë i lidhur me Allahun (xh. sh.), apo siç ka thënë Pejgambëri (a. s.) *“كُلُّ كَلَامٍ أَوْ أَمْرٍ ذِي بَالٍ لَا يَفْتَحُ بِذِكْرِ اللَّهِ فَهُوَ أَتَمُّ”* “Çdo fjalë apo punë e nisur pa përmendjen e Allahut është e dështuar”.<sup>19</sup>

### Porta e mëshirës absolute

Në besmele përmenden dy emra të Allahut: Er-Rahman dhe Er-Rahim, të cilat besimtarit të vërtetë i japin një fuqi të pafund, sepse ata e dinë se Ai që e ka emërtuar Vetën me Er-Rahman dhe Er-Rahim është Allahu, andaj si mos të mëshirojë.

Transmetohet se një lypsar ka trokitur në portën madhështore të një zengjini për të kërkuar diçka, por i është dhënë shumë pak. Të nesërmen, mori sëpatën dhe shkoi që t’ia

---

<sup>19</sup> Imam Ahmedi, *El-Musnedu*, vëll. XIV, Muessesetu Risaleh, 2001, f. 329.

copëtojë derën. Kur e pyetën se përse vepron kështu, ai u përgjigj: “Ose derën t’ia përshtat dhënies, ose dhënien derës.” Pra, një dere të madhe nuk i takon të japë një gjë të vogël.<sup>20</sup>

Po ashtu, në besmele gjithsej përmenden tre emra të Zotit: Allah, Er-Rahman dhe Er-Rahim. Emri Allah i përfshin të gjitha cilësitë e Zotit, pra edhe mëshirën edhe dënimin, por me vetë faktin që pas emrit Allah pasojnë Er-Rahman dhe Er-Rahim, tregon se mëshira e Allahut është më e madhe se ndëshkimi.

### Besmeleja është nishan i Zotit (xh. sh.)

Kur punëtorët apo shërbëtorët e një mbreti dëshirojnë të blejnë ndonjë kafshë për vete, i vënë nishanin e mbretit, në mënyrë që grabitqarëve mos t’u shkojë syri tek ato, sepse e dinë se fuqia e mbretit është e pamposhtur. Sikur Allahu i Madhërishëm dëshiron të na thotë: në ibadetin dhe nënshtrimin që ti e bën ndaj Meje, ekziston një armik grabitqar, i cili çdoherë përpiket të të largojë prej rrugës së drejtë, prandaj vëre nishanin tim; thuaj: *Bismilah*, që mos t’i shkojë syri te ti dhe të të pengojë.

Pikërisht përmes këtij nishani shpëtoi i dërguari i Zotit (xh. sh.), Nuhi (a. s.).

Nuhi (a. s.) kur hipi në anije tha: “بِسْمِ اللَّهِ مَجْرَاهَا وَمُرْسَاهَا - *me emrin e Allahut, ajo (anija) lundron dhe ndalet*”. Gjersa Nuhi (a. s.) gjeti shpëtimin me gjysmën e besmeles, si mund të jetë i privuar prej shpëtimit ai që e përdor të plotë atë gjatë gjithë jetës?!

Gjithashtu, i dërguari i Zotit, Sulejmani (a. s.), fitoi sun-

<sup>20</sup> Fahuddin Er-Raziu, *vep. e cit. vëllimi I*, f. 174.

dimin e kësaj dhe të botës tjetër me fjalën “ إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ – “ajo (letra dërguar mbretëreshës Belkis) është prej Sulejmanit dhe është: me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”. Pra, pasurinë e kësaj dhe të Botës Tjetër mund ta shpresojë vetëm rob i thotë këto fjalë, që thotë besmelen.

Në të njëjtën kohë, përveç mirësive të kësaj bote, besmeleja (nishani i Zotit) e shpëton njeriun edhe në Botën Tjetër.

Besmeleja ka 19 shkronja, por edhe xhehenemi ka 19 melaqe mbikëqyrëse (që dënojnë); pra, me çdo shkronjë të shqiptuar nga besmeleja mbrohemi nga njëra prej tyre.

Kur njeriut i kujtohet të thotë *bismil-lah* në fillimin e një pune, i kujtohen edhe mëkatet e bëra. Në atë moment shejtani i thotë atij: “Ti je aq i keq, saqë nuk ka shpëtim për ty; andaj, mos u lodh me këtë punë.” Por, urtësia e Zot të Madhërishëm e mbizotëron këtë tundim të shejtanit dhe i thotë: “Mos u merakos! Unë jam Er-Rrahman dhe Er-Rahim; jam i Mëshirshëm për jobesimtarët e jo më për Ty, që së paku më njeh Mua, andaj vazhdo me punën që ke nisur!”

Pra, që në fillim Allahu i Madhërishëm u jep kurajë besimtarëve dhe e mund logjikën e pesimizmit.

Besmelja është vënë në fillim të çdo sureje, prandaj thuhet në nismë të çdo leximi. Ajo është si çelësi magjik që e hap arkën e mbushur me thesar.

Kur jemi te leximi i Kuranit, vlen të thuhet edhe ajo se nisma e leximit duhet shikuar në dy dimensione: në dimensionin fikhor (artikulimi fizik) dhe në dimensionin spiritual, ashtu siç ndjen besimtari. Të dy dimensionet janë të domosdoshme për kompaktësinë e aktivitetit të besimtarit. Nëse

myslimani nuk e thotë besmelen në fillim të leximit, atëherë ka lënë mënjanë një preferencë fetare dhe nuk ka marrë forcën e nevojshme shpirtërore, të cilën Allahu ua jep njerëzve që në besmele.

Vetia e mëshirës, e theksuar në besmele, është veti ngadhënyjese mbi të gjitha vetitë e Allahut.

## SURJA EL-FATIHA – سُورَةُ الْفَاتِحَةِ

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

﴿بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ٢﴾ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ٣﴾  
 مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ٤﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ٥﴾ أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ٦﴾  
 صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ٧﴾

“(1). Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit. (2). Falënderimi i takon Allahut, (3). Mëshiruesit, Mëshirëplotit, (4) Sunduesit të Ditës së Gjykimit! (5). Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë. (6). Udhëzoni në Rrugën e Dretë, (7) në rrugën e atyre që ke bekuar, jo të atyre mbi të cilët ra hidhërimi dhe as të atyre që kanë humbur.”

Zbritja e Kuranit zgjati 23 vjet. Gjatë zbritjes, Kurani nuk e ka pasur këtë renditje që ka sot, për shkak se zbritja kryesisht ka shkuar sipas nevojës. Pasi i zbriste një ajet, apo një sure e caktuar Muhamedit (a. s.), në të njëjtën kohë urdhërohej që ky ajet apo kjo sure të vihej në vendin e caktuar nga Zoti (xh. sh.). Kështu që, çdo njësi kuranore e ka rëndësinë dhe funksionin e vet; madje edhe shkronjat kanë një lloj funksioni semantik dhe stilistik. Pra, edhe renditja e sureve dhe ajeteve kuranore është nga Zoti/Teukifi dhe, si rrjedhojë, rendi logjik i ajeteve dhe sureve është përplot me mesazhe këshilluese dhe sqaruese.

Shkronja e parë me të cilën fillon Kurani fisnik është (1),

hemzetu el-vasli (hemzeja lidhëse). Kjo germë vendoset në fillim të fjalëve dhe gjatë leximit e lidh fjalën përkatëse me fjalën paraprake. Por, nëse me këtë shkronjë nis Kurani, atëherë çfarë funksioni mund të ketë kjo hemze lidhëse, kur përpara nuk ka fjalë tjetër?

Kjo shkronjë qëndron në mes dhe bën lidhje mes fjalës së zbatuar të Zotit (krijimtarisë) dhe fjalës së Tij të shkruar (Kuranit). Gjithashtu, kjo hemze lidhëse bën një lidhje mes njetit shpirtëror të lexuesit dhe vetë tekstit kuranor, d.m.th. atë njet që njeriu ka në zemër, atë do të ta gjejë në leximin e Kuranit.

### Dallime leksikore mes disa leksemave

Një nga emrat e sures El-Fatiha është edhe *أُمُّ الْكِتَابِ* “Nëna e Librit” apo *أُمُّ الْقُرْآنِ* “Nëna e Kuranit”. Kjo sure quhet kështu sepse në pika të shkurtra i përfshin të gjitha boshtet kuptimore të Kuranit: besimin, jurisprudencën, moralin, historinë etj., prandaj leximi i çfarëdo ajeti pas kësaj sureje në namaz nuk e humb rrjedhën kuptimore me Fatihanë, ngase ajo flet për gjithçka.

Ku dallon *el-hamdu* (الْحَمْدُ) nga *el-med’hu* (الْمَدْحُ)?

Këto dy fjalë, sado që duken sinonimike, dallojnë nga njëra-tjetra. Përveç dallimeve tjera, një dallim esencial mes këtyre dy termave është se *hamdi* përdoret vetëm për qenie intelektuale, kurse *med’hi* përdoret për gjithçka - për qenie mendore dhe për qenie jointelektuale.<sup>21</sup>

Meqë *hamdi* është fjala e parë në Kuran, kjo tregon se kjo fe dhe ky besim qysh në nismë lidhen ngushtë me gjall-

<sup>21</sup> Fadil bin Salih Es-Samurai, *El-lemesatu el-bejanijjetu fi nususi et-tenzili*, “Dar Ammar”, Bejrut, 2003, f. 11.

ërinë dhe intelektin. Besimi islam nuk lidhet me gjëra të ngurta dhe të palogjikshme.

Po ashtu, qysh në fjalën e parë të Kuranit Allahu (xh. sh.) reflekton dashuri dhe krijon lidhje dashurie me robërit e Vet – ngaqë një dallim tjetër mes këtyre dy termave është se hamdi ngërthen dashuri dhe respekt ndaj atij që e lavdëron, kurse med’hi nuk e kushtëzon dashurinë ndaj atij që e lavdëron.

Med’hi mund të vijë para se të bëhet një e mirë dhe pas saj, kurse hamdi bëhet vetëm pas një të mire. Pra, kur hamdi i bëhet Zotit për një punë të cilën ne nuk e duam (p.sh. vdekja), nënkupton se ky përcaktim ka një lloj mirësie të cilën ne nuk e kuptojmë, d.m.th. bëhet përsëri pas një mirësie.

Lavdërimi i quajtur med’h ndonjëherë është i ndaluar, siç ka thënë Muhamedi (a. s.): “*Hidhni dhe mbi fytyrat e lavdëruesve!*”, ndërsa hamdi është falënderim i cili mund të bëhet vazhdimisht.

Hamdi është prodhim i vetëdijes dhe jo i hamendjes. Robi kur e falënderon Zotin kërkohet që të ketë njohuri, në mënyrë që falënderimi të realizohet në bazë të diturisë, kurse med’hi mund të bëhet pa pasur nevojë për shumë informacionesh dhe diturish.

Pra, hamdi (حمد) dhe med’hi (مدح) kanë tri shkronja të njëjta në rrënjën e tyre, ndërsa ajo që i dallon është vetëm ndryshimi i vendit të shkronjave, njësoj siç i dallojnë në kuptim vetëm disa nuanca të imëta kuptimore.<sup>22</sup>

Pas dallimit të këtyre dy leksemave sinonimike, tani do të shohim po ashtu dallimin mes *hamdit* (حَمْد) dhe *shukrit*

---

<sup>22</sup> Fadil bin Salih Es-Samurai, *vep. e cit.*, f. 12.

(شُكْر).

Një sinonim tjetër i përfaqësues i fjalës *hamdun* është fjala *shukrun*. Siç është thënë më parë, sinonime të plota në gjuhën kuranore nuk ka, prandaj mes hamdit dhe shukrit ka dallime në nuanca kuptimore.

Fillimisht duhet kuptuar se hamdi nuk nënkupton vetëm falënderimin, por edhe lavdërimin (med'h), ndërsa shukri nuk e përfshin lavdërimin (med'hin).

Shukri kryesisht përdoret për të mirat që i bëhen vetëm falënderuesit, kurse hamdi bëhet për të mirat personale dhe për të mirat që bëhen ndaj të tjerëve.

Zoti (xh. sh.) e ka porositur njeriun që në fjalën e parë, që të jetë altruist dhe të mos mendojë vetëm për vete, por t'i vlerësojë edhe të mirat që bëhen ndaj të tjerëve, prandaj e ka përdorur hamdin, pra, robi të jetë falënderues edhe për të mirat që i janë dhënë atij, por edhe për të mirat që u janë dhënë të tjerëve.

### Me hamd fillon gjithçka

Hamdi është falënderim që i drejtohet vetëm Allahut dhe askujt tjetër, kurse shukri është falënderim që mund t'i drejtohet Krijuesit, por edhe krijesave.

Gjithashtu, një dallim tjetër i rëndësishëm mes këtyre dy fjalëve kuranore është se shukri përdoret vetëm në mirësi, ndërsa hamdi i bëhet Zotit edhe për të mirat edhe për fatkeqësitë që mund t'i bien mbi kokë njeriut.<sup>23</sup> Nëse dikush do të pyesë: përse duhet falënderuar edhe në fatkeqësi? Përgjigjja është se njeriu është qenie e dobët, e paaftë ta kuptojë gajbin (të fshehtën) dhe ta deshifrojë përcaktimin e

<sup>23</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *vep. e cit.*, vëllimi I, f. 180-200.

Zotit, sado që i Gjithëmëshirshmi asgjë nuk ka caktuar në dëm të krijesave. Çdo gjë është caktuar në favor dhe në të mirë të njeriut, por ai është i pamundshëm ta kuptojë atë, prandaj Allahu (xh. sh.) e ka urdhëruar atë që ta falënderojë në çfarëdo lloj situatë, ngase, ndoshta pjesa e dukshme e saj është fatkeqësi, por brendinë e ka të mbushur me mirësi të padeshifrueshme për njeriun. Sa për ta sinjalizuar këtë problematikë, Allahu (xh. sh.) e ka paraqitur rastin e Musait (a. s.) me Hidrin në Kuran, ashtu që besimtari të bindet për paaftësinë e tij për ta kuptuar çdo gjë në botë.

Një nuancë dalluese mes fjalës hamdun dhe shukrun është se hamdi është falënderim vetëm deklarativ, kurse shukri është falënderim aplikativ.

Njerëzit nuk janë të barabartë në formulimin e fjalive. Dikush është më i aftë në formimin e fjalive më të bukura dhe më kuptimplote, kurse disa të tjerë janë më të dobët. Pra, Allahu (xh. sh.) me hamdin i barazoi të gjithë njerëzit, sepse e përzgjodhi vetë fjalën më të përkryer, përmes së cilës falënderohet. Ajo e cila do t'i dallojë njerëzit është falënderimi aplikativ (shukri). Kështu që, njerëzit më nuk do të dallohen përmes fjalëve të bukura, sepse fjalët më të bukura i ka thënë Zoti (xh. sh.), ndërsa njerëzit do të dallohen vetëm me punët dhe të bëmat e tyre.

Shukri, gjithashtu, është në relacion të drejtë me mirësitë dhe begatitë e kësaj bote lëndore, siç thuhet në ajetin *Lein shekertum leezidennekum*.

Menjëherë pas krijimit, fjalën e parë që e shqiptoi Ademi (a. s.) ishte الْحَمْدُ لِلَّهِ "Falënderimi i takon Allahut!" Gjithashtu, thirrja (lutja) e fundit që do të thuhet nga banorët e Xhennetit është pikërisht kjo ﴿وَأَخِرُ دَعْوَاهُمْ أَنْ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾ "dhe

*thirrja (lutja) e fundit e tyre është 'Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve'".*

Nisma dhe përfundimi i kësaj bote ka shkuar mbi hamdin, prandaj përpiqu që punët tua fund e krye të jenë të shoqëruara me hamdin. Pra, njeriu është një kozmos i vogël, rrethanat e të cilit duhet të jenë në përputhje të plotë me kozmosin e madh.

Prandaj, emri kryesor i kësaj sureje është **الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ** (Hapëse), sepse me të hapet Kurani, me të fillohet namazi dhe me të niset çdo lutje drejtuar Zotit (xh. sh.).

### **Reflektime kuptimore të fjalisë emërore **الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ****

Ajeti i parë (pas besmeles) i *Fatihësë* **الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ** "Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve", në sintaksën e gjuhës arabe llogaritet fjali emërore, sepse fillon me emër: **الْحَمْدُ** është kryefjala, kurse **لِلَّهِ** është kallëzuesi.

Në sintaksën e gjuhës arabe, për nga përbërja janë të njohura dy tipa fjalish: fjalia emërore, që fillon me emër, dhe fjalia foljore, që fillon me folje, por pastaj secila ka gjymtyrët e veta të veçanta. Dallimi semantik mes këtyre dy llojeve të fjalive qëndron në atë se fjalia emërore është e zhveshur prej kategorisë së kohës, sepse kohë kanë vetëm foljet, pra, gjenden në fjalitë foljore.

Nëse do të ishte thënë **أَحْمَدُ اللهُ** "falënderoj Allahun" apo **نَحْمَدُ اللهُ** "falënderojmë Allahun" etj., atëherë pjesë e fjalisë do të ishte *koha* dhe *vepruesi (falënderuesi)*, ndërsa fjalia e dhënë është e zhveshur nga koha dhe vepruesi.

### **Hamdi është eternal**

Kjo fjali emërore na mëson se Allahu (xh. sh.) është i lavdëruar edhe nëse askush nuk e lavdëron. Po ashtu, ai është i lavdëruar çdoherë, jo vetëm në kohën e kaluar apo në kohën e ardhmen, por lavdërimi i Tij është eternal. Pra, të lavdëruarit e Zotit nuk është i varur nga subjekti që do ta lavdërojë dhe as nga koha që ai të lavdërohet, sepse meqë Kurani ishte edhe para krijimit fizik të njeriut dhe krijesave tjera, pra në përmasën e qenësisë së pastër të Zotit, atëherë do të thotë që Zoti e lavdëron veten e Tij dhe na këshillon që ta ndjekim këtë rrugë.

Në të njëjtën kohë, njeriu duhet të vetëdijesohet se lavdërimi i Zotit është krejt i pavarur, d.m.th. nuk i shtohet krenaria Zotit nëse ne e lavdërojmë, sepse Ai vetvetiu është i lavdëruar, ndërsa ne duhet të shqyrtojmë qëndrimin tonë, nëse duam apo nuk duam të jemi pjesë e këtij nderi të madh që na ka mundësuar Zoti për ta falënderuar Atë.

Një dallim tjetër mes fjalisë emërore ekzistuese ﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ﴾ dhe fjalisë foljore hipotetike ﴿أَحْمَدُ اللَّهَ﴾, apo ﴿نَحْمَدُ اللَّهَ﴾, është se fjalia emërore e mbron besimtarin nga dyfytërsia dhe e siguron që të mos thotë diçka që nuk e ndjen. Si?

Fraza ﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ﴾ përdoret në shumë raste në jetën e besimtarit. Ajo nuk është thjesht një ajet kuranor me të cilin fillon Kurani, por zë vend dhe përsëritet në çdo pore të jetës së besimtarit. Pra, nëse besimtari e përdor fjalinë foljore “e falënderoj Allahun”, ose “e falënderojmë Allahun”, d.m.th. tregon një fakt, se ‘unë ose ne e falënderojmë Allahun’, mirëpo pasi kjo përsëritet shumë shpesh, atëherë shumë herë kjo frazë del spontanisht nga goja e besimtarit dhe pa e ndjerë. Kur ai thotë se ‘unë ose ne e falënderojmë Allahun’, mirëpo atë nuk e ndjen, sepse e ka thënë spontanisht, atëhe-

rë ka thënë diçka që nuk e ndjen dhe kështu brendia e tij bie ndesh me fjalët e shqiptuara.<sup>24</sup> Ndërsa, nëse ai e përdor fjalinë emërore “falënderimi i takon Allahut”, atëherë brendia e tij nuk bie në kundërshtim me fjalët e shqiptuara, sepse fjalia emërore nuk ka veprues (unë, ne, ai etj.), por thjesht tregon se Zoti është i falënderuar, gjë e cila nuk përbën problem, sepse edhe nëse e thotë pa vetëdije, përsëri nuk ka gënjer, ngase Zoti çdoherë është i falënderuar.

Disa fjalën الْحَمْدُ e lexojnë në rasën kallëzore الْحَمْدُ. Fillimi i fjalës me një emër në rasën kallëzore tregon se përpara ka një folje të paramenduar, kështu që fjalia shndërrohet në fjali foljore. Disa kur e lexojnë الْحَمْدُ thonë se përpara paramendohet folja e mënyrës urdhërore اِحْمَدُوا “falënderojeni!”, mirëpo shumica e linguistëve të hershëm dhe të vonshëm e përjashtojnë këtë mundësi, sepse urdhërorja “Falënderojeni Allahun!”, nuk nënkupton se Zoti është i falënderuar. Për ta pasur më të qartë, do ta marrim një shembull tjetër, p.sh. “lavdëroje Zejdin!”; Zejdi mund të jetë i lavdëruar dhe i palavdëruar; pra, esenca është që ti ta lavdërosh, kurse te fjalia emërore “Zejdi është i lavdëruar”, nuk ka rëndësi nëse ti e lavdëron apo jo, ai është i lavdëruar. Prandaj, mundësia e leximit në rasën kallëzore është përjashtuar nga të gjithë dhjetë lexuesit (kuratë) e Kuranit.<sup>25</sup>

### Nyja shquese (ال) dhe fillimi me hamd

<sup>24</sup> Fadil bin Salih Es-Samurai, *El-lemesatu el-bejanijjetu fi nususi et-tenzili*, “Dar Ammar”, Bejrut, 2003, f.13.

<sup>25</sup> Ebu Hajjan Ethiru ed-din el-Endelusij, *El-Bahru el-Muhitu*, vëllimi I, Dar el-Fikr, Bejrut, f. 118-119.

Nyja shquese në gjuhën arabe çdoherë është e përparme dhe ka edhe efekte semantike (kuptimore).

Për nyjën shquese te fjala الْحَمْدُ linguistët arabë kanë thënë se ajo është لَامُ الْإِسْتِغْرَاقِ (L-ja gjithëpërfshirëse), e cila përfshin çdo lloj falënderimi që mund t'i bëhet Zotit (xh. sh.).<sup>26</sup>

Kjo nyjë shquese tregon se sado që njeriu të jetë i aftë për ta falënderuar Allahun, ai përsëri nuk do të ketë mundësi që t'i përfshijë të gjitha falënderimet për të gjitha begatitë që i ka falur Zoti (xh. sh.).

Mëshira e Zotit (xh. sh.) bëri që robërit e Tij ta falënderojnë njësoj dhe me pak të fitojnë shumë.

Nëse vështrohet me vëmendje kuptimi i ajetit të parë të sures Fatiha, i cili fillon me hamd, do të vihet në përfundim se ky ajet kuranor flet për një proces shpirtëror; flet për një përgatitje paraprake shpirtërore, e cila fitohet me rezonim, me meditim, me lodhje të arsyes, me fokusim të zemrës dhe me stërvitje të shpirtit, për ta kuptuar realitetin në gjithë krijimtarinë e Zotit (xh. sh.). Pas këtij meditimi, njeriut i hapen shumë dilema para vetes, ato që historikisht i ka diskutuar filozofia dhe të cilave nuk u ka dhënë përgjigje: Kush jam unë? Nga kam ardhur? Prej ku gjithë këto mirësi? Ku do të përfundoj unë? etj. Pikërisht për këtë arsye, Allahu (xh. sh.) e fillon me këto fjalë: "Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!", dhe këtu fitohet zgjidhja për të gjitha dilemat që njeriu ka para vetes, sepse kur e falënderon Allahun, e ka njohur Atë si Krijues, si Furnizues etj., dhe në fund, përmes ajetit الْحَمْدُ لِلَّهِ është pajtuar se Kurani është rruga që do ta ndjekë në zgjidhjen e mistereve dhe problemeve që i

<sup>26</sup> Esh-Sheukani, *Fet'hu el-Kadir*, vëllimi I, El-Marifetu, 2007, f. 13.

dalin në jetë.

Pra, hamdi është dakordim për të vazhduar më tutje. Përderisa njeriu i drejtohet Kuranit për ta gjetur modelin më të përkryer të jetës së vet, atëherë fillimisht duhet të dakordohet dhe t'i pranojë mirësitë që Zoti ia ka bërë deri në atë moment me **الْحَمْدُ لِلَّهِ**, sepse ai që nuk është mirënjohës për atë që ka pasur, nuk mund të përfitojë nga ajo që vjen më pas.

Nëse e shohim fjalinë **الْحَمْدُ لِلَّهِ** "Falënderimi i takon Allahut", ajo mund të ishte edhe **بِاللَّهِ الْحَمْدُ** "Allahut i takon lavdërimi", siç është në disa sure të tjera. Fjalja e dytë, ajo që fillon me emrin Allah **اللَّهُ الْحَمْدُ** tregon: falënderimi i takon vetëm Allahut dhe askujt tjetër, ndërsa qëllimi i ajetit të parë të sures Fatiha nuk është se falënderimi i takon vetëm Allahut, por edhe të gjithë të tjerëve që meritojnë falënderim. Pra, hamdi madhështor i takon vetëm Allahut, por hamdi (relativ) gjithashtu u takon të gjithë atyre që meritojnë lavdërim, apo siç ka thënë Muhamedi (a. s.) në një hadith të tij **مَنْ لَمْ يَحْمَدِ اللَّهَ لَمْ يَحْمَدِ النَّاسَ لَمْ يَحْمَدِ اللَّهَ** "Kush nuk i falënderon njerëzit, nuk e ka falënderuar as Allahun".

Pas këtij sqarimi lexuesi i vëmendshëm do të pyeste: përse në disa ajete të tjera në Kuran fjala Allah (apo përemri i Tij) vjen para fjalës hamd, si p.sh. **فَلِلَّهِ الْحَمْدُ** "Allahut i takon falënderimi" apo **لَهُ الْحَمْدُ** "Atij i takon falënderimi" etj.?

Përgjigjja: në të gjitha rastet kur Allahu e ka specifikuar falënderimin për Të, pra e ka sjellë emrin e Vet para falënderimit, në ajetet përpara është folur për diçka që është kompetencë apo mund ta bëjë vetëm Ai, p.sh. në suren Xhathijeh, në ajetin 36, thuhet **فَلِلَّهِ الْحَمْدُ** "E Allahut i takon falënderi-

mi”, sepse në ajetet paraprake flitet për skena të Botës Tjetër, e për punët e Botës Tjetër nuk ka kompetencë askush përveç Zotit (xh. sh.), prandaj falënderimi këtu është specifikuar vetëm për Allahun (xh. sh.). Të ngjashme janë pothuaj të gjitha ajetet tjera.<sup>27</sup>

Kur flitet për Allahun (xh. sh.), duhet pasur kujdes maksimal, sepse flitet për Qenien Supreme dhe të Pagabueshme. Nëse në vend të fjalës Allah do të ishte një emër tjetër i Zotit (xh. sh.), atëherë Zoti (xh. sh.) do të ishte më i lavdëruar për cilësinë që mban vetë Emri i Tij, mirëpo Allahu (xh. sh.) është i Lavdëruar për të gjitha cilësitë e Tij që i dimë dhe që nuk i dimë, prandaj e ka përdorur emrin e Tij universal Allah, në mënyrë që falënderimi ndaj Tij të jetë gjithëpërfshirës.

Një arsye tjetër e dhënies së fjalës Allah, pastaj emrat e tjerë të Zotit, është që njoftimi i parë i besimtarëve me Zotin (xh. sh.) të bëhet përmes emrit të Tij universal (Allah). Pra, kur njeriu fillon të lexojë Kuran nga fillimi, në tri fjalitë e para njihet me Qenien Absolute përmes emrit të Tij universal: fillon me **أَعُوذُ بِاللَّهِ**, pastaj me **بِسْمِ اللَّهِ** dhe vazhdon me **الْحَمْدُ لِلَّهِ**.<sup>28</sup>

## Mbështjellja e Kuranit me dy lutje

<sup>27</sup> Fadil bin Salih Es-Samurai, *El-Iemesatu el-bejanijjetu fi nususi et-tenzili*, “Dar Ammar”, Bejrut, 2003, f.20.

<sup>28</sup> Shihabuddin el-Alusi, *Ruhu el-Meani – tefsiru el-Alusi*, vëllimi I, Dar el-Kutub el-Ilmijeh, f. 76-77.

Krahas kuptimeve të tjera të fshehura në El-Fatiha, kjo sure ka funksion të fuqishëm edhe si lutje, bile njëri ndër emrat e kësaj sureje është El-Kafijeh (E mjaftueshmja), sepse ajo mjafton për çfarëdo lutje, kurse lutjet tjera nuk e zëvendësojnë këtë, pra lirisht mund të themi se është lutje universale, siç është edhe për nga kuptimi sure universale.

Në të njëjtën kohë, edhe surja e fundit e Kuranit, surja En-Nas, është lutje. Kështu që Kurani është libër që fillon me lutje dhe që përfundon me lutje.

Mbështjellja e këtyre dyfishtë e Kuranit tregon se njeriu është qenie e dobët dhe se ka nevojë për ndihmë. Këto dy sure janë simbol i modestisë së besimtarit, sepse çdoherë njeriu ka nevojë për ndihmë, kështu që kryelartësia rezulton si karakteristikë antikuranore.

Lutja e parë, Fatihaja, është lutje për ta gjetur rrugën e drejtë, ndërsa Feleku dhe Nasi janë lutje për ta vazhduar këtë rrugë dhe për t'i sfiduar të gjitha pengesat që mund të dalin në këtë rrugë.

*Pas emrit Allah është dhënë Rabbun*

Allah është emri universal i Zotit (xh. sh.), kështu që të gjithë emrat tjerë janë sinonime të fjalës Allah, por çdoherë duke favorizuar një cilësi të caktuar të Zotit në sytë e njerëzve. Është njësoj si të thuash Allah, Er-Rahman, Er-Rahim, El-Melik etj. Por, Allahu (xh. sh.) për ta favorizuar një cilësi të vet në sytë tanë, ai Vetën e ka emërtuar me emra të ndryshëm.

Në ajetin e parë të sures Fatihaja (pas besmeles), menjëherë pas emrit Allah është dhënë Rabbun. Vallë, a thua përse?

Përkthimi më ngushëllues i fjalës Rabbun (رب) - i vetmi i mundshëm për t'u shprehur me një fjalë - është fjala Zot.

Zot në gjuhën shqipe është një fjalë e cila nënkupton Qenie Absolute, por çdoherë duke pasur nuanca kuptimore të forcës, mbisundimit etj., kurse në gjuhën arabe kuptimi thelbësor (pra, Qenie Absolute) është i njëjtë, mirëpo nuanca kuptimore që jep fjala Rabbun është ndryshe nga nuanca kuptimore që jep fjala Zot, sepse fjala Rabbun më shumë anon kah mëshira, edukimi, mbajtja e rendit etj.

Fjala Rabbu (رَبُّ) rrjedh nga rrënja رَبَّ، e cila d.t.th. edukim. Kështu që kjo fjalë Zotin na e tregon si Edukuesin Absolut, si Krijues, si Mbajtës të rendit dhe si Kontrollues të mbarrëvajtjes së gjithë krijimtarisë.

Nëse dikush do të habitej me përsosurinë e krijimtarisë së Zotit (xh. sh.), në të gjitha sferat, qofshin shpirtërore apo materiale - si janë krijuar; si janë vënë në lëvizje; dhe mijëra 'si' të tjera - duhet kuptuar që përgjigje e gjithë këtyre është se Zoti (xh. sh.) është Rabbun, Ai që i ka krijuar, që i ka vënë në lëvizje, që ia ka dhënë çdo krijese cilësinë që të funksionojë brenda një sistemi të caktuar etj.

Një arsye tjetër e përdorimit të fjalës Rabbun është se Allahu (xh. sh.) vazhdimisht udhëzimin e ka lidhur me emrin e Tij, Rabbun, sepse në udhëzim sa është i rëndësishëm kthimi në rrugë të drejtë, po aq është i rëndësishëm edukimi dhe vazhdueshmëria në atë rrugë.

### Arsyeshmëria e fjalës botë – njëjës dhe shumës (الْعَالَمِينَ)

Fjala عَالَمٌ "botë" trajtën e shumësit në gjuhën arabe e bën në dy forma: عَالَمُونَ dhe عَوَالِمَ.

Në ligjërimin kuranor, siç është thënë më parë, sinonimi të plotë nuk ka, por ka sinonimi kontekstuale. Edhe në

rastin konkret, kur për një fjalë ka disa trajta shumësi, atëherë asnjëra prej tyre nuk mund të jetë sinonim i plotë i njëra-tjetrës. Trajta عَوَالِم është shumësi i parregullt, që thjesht tregon sasi, pra më shumë se dy botë, pa u ndalur në cilësinë e tyre. Kurse trajta عَالَمِينَ (عَالَمِينَ) është shumësi i rregullt (apo i ngjan shumësit të rregullt) të gjinisë mashkullore. Ky shumësi mund të vijë vetëm te emrat që kanë veti intelektuale, ose që janë të arsyeshëm.

Parashtrohet pyetja: nëse trajta عَالَمِينَ është për qenie logjike, ku mbesin qeniet jologjike?

Linguistët arabë thonë se fjala عَالَمِينَ përfshin gjithçka përveç Zotit (xh. sh.) - qofshin ato logjike apo jologjike, njerëz, kafshë, bimë apo gjëra të ngurta, veçse Allahu e ka shprehur në formë të shumësit të rregullt të gjinisë mashkullore për të treguar se Atë mirëfilli e njohin ata që i përkasin botës logjike. Pra, e ka dhënë në këtë trajtë për t'i veçuar ata që janë brenda botës intelektuale.

Nëse vështrohet lidhja gjinore mes fjalës Rabbun dhe Alemin, tregon se Allahu është Zot i të gjithëve, por lidhjen e ka bërë me botët logjike.<sup>29</sup>

Veçmas asaj që u tha më parë, fjala alem (عَالَمٌ) reflekton dy mësimet të rëndësishme në intelektin e besimtarit:

E para: vetë rrënja e fjalës është identike me rrënjën e fjalës ilmun (عِلْمٌ) d.m.th. dituri. Kështu që, dituria është rru-ga më e mirë për ta kuptuar botën, e cila pastaj çon në njohjen e Zotit.

E dyta: fjala alemun (عَالَمٌ) botë, ka ardhur në një paradi-

<sup>29</sup> Fadil bin Salih Es-Samurai, *El-lemesatu el-bejanijjetu fi nususi et-tenzili*, "Dar Ammar", Bejrut, 2003, f. 24-29.

gmë përmes së cilës zakonisht shprehen emrat e mjeteve. Kështu që, bota është mjeti më i përsosur me të cilin mund ta njohim Zotin (xh. sh.).

Pra, e gjithë bota fund e krye është mjet dhe jo qëllim.

### Variacioni fonetik i fjalës ملك

Fjala ملك ka dy lexime (kiraete) të njohura: leximi مَلِك (Maliki-Pronari Absolut) dhe leximi مَلِك (Meliki-Mbreti Absolut). Nëse analizohen kuptimet e këtyre dy fjalëve me rrënjë dhe formë të njëjtë, atëherë shohim se ato e plotësojnë Madhërinë e Zotit (xh. sh.).<sup>30</sup>

Të jesh mbret, nuk do të thotë ta kesh çdo gjë në pronësinë tënde. Pronar apo posedues të jesh, nuk do të thotë që të jesh edhe mbret. Kështu që Allahu Fuqiptotë deshi që përmes një fjale të vetme t'i shpreh të dy kuptimet: Ai është Pronar dhe Mbret Absolut në të njëjtën kohë. Çdo gjë në krijimtari është e Tij, por në të njëjtën kohë Ai është edhe Mbreti apo Sunduesi Absolut i tyre.

Pasi ajeti flet për Ditën e Gjykimit, atëherë leximi i së njëjtës fjalë me dy variacione të mundshme tregon se Allahu nuk është vetëm Pronari Absolut, por ai është edhe Mbreti Absolut i asaj dite. Kjo në njërin anë është shpresëdhënëse për besimtarin, por në anën tjetër është e trishtueshme për jobesimtarin.

Bota Tjetër ka shumë emra në gjuhën arabe. Çdo emër, përveç kuptimit të përgjithshëm për Botën Tjetër, favorizon

<sup>30</sup> Ahmed bin Ahmed El-Garnatijju, *Melaku et-te'vili el-kati'i bi dhevi el-ilhadi ve et-ta'tili*, Vëllimi I, Dar el-kutubi el-ilmijeti, Bejrut, f. 24-25.

një kuptim të caktuar që lidhet ngushtë me atë ditë, p.sh. يَوْمُ الْقِيَامَةِ është emri më i përgjithshëm, por pasi fjala قِيَامَةٌ d.t.th. ngritje, atëherë ky emër favorizon momentin kur do të ringjallemi dhe do të ngrihemi para Allahut (xh. sh.), apo quhet e tillë sepse tregon se atë ditë do të ngrihen në shqyrtim shumë punë të mëdha që i ka folur Kurani. Fjala الْيَوْمُ الْأَجْرُ d.m.th. Dita e Fundit, favorizon kuptimin se kjo ditë është e fundit për mbarë njerëzimin dhe e njëjta më nuk ka fund, pra, nëse dikush pret një ditë më ndryshe se ajo që ka punuar vetë në dynja, ajo më nuk ekziston, sepse kjo ishte dita e fundit ku veprat e njerëzve u ndanë përgjithmonë.

Ka edhe dhjetëra emra të tjerë, por tani do ta marrim në shqyrtim emrin يَوْمُ الدِّينِ. Fjala دَيْنٌ në etimologjinë e gjuhës arabe do të thotë shpërblim apo dënim për atë që është bërë më parë. Pra, krahas kuptimit të përgjithshëm për Botën Tjetër, kjo fjalë përshkruan momentin kur secili do ta merr atë që ka punuar në dynja. Të qenët e Zotit Sundues dhe Pronar i botës tjetër, veçanërisht i momentit kur njerëzve do t'u ndahen shpërblimet apo dënimet për punët e bëra më parë, duhet ta vetëdijesojë njeriuin e mençur që në këtë botë (në këtë dynja) t'u nënshtrohet parimeve të Këtij që ka në dorë shpërblimin apo dënimin e punëve të tij.

Në gjuhën arabe دَيْنٌ quhet feja dhe bota tjetër, pra, rruga në të cilën duhet ecur në këtë botë quhet din, njësoj si momenti kur do të jepet përgjegjësi për veprimtarinë e kësaj rruge. Me dinin e dynjasë fitohet dini i ahiretit; pa dinin e dynjasë humbet edhe dini i ahiretit.

## Largpamësia dhe puna

﴿مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ \* إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾  
 “Sunduesit të Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë” - janë dy ajete të cilat kanë një lidhshmëri të përkryer njëri me tjetrin. I pari tregon pikën e fundit ku duhet të mbërrijë çdo njeri, kurse i dyti tregon mënyrën e arritjes. I pari tregon largpamësinë e besimtarit, sepse ai nuk duhet të jetë shkurtpamës, kurse i dyti pasqyron rrugën e mbërritjes atje.

Pra, këto dy ajete u mësojnë lexuesve të Kuranit që çdoherë kur të përcaktojnë qëllime, në të njëjtën kohë t’i përcaktojnë edhe mjetet e mbërritjes tek to.

Fatkeqësisht, sot te shumë myslimanë fillimisht mungon largpamësia dhe projektet afatgjate, por edhe tek ata që kanë një lloj vizioni largpamës, mungon harta dhe mënyra e arritjes së atyre objektivave.

Nëse largpamësia e botës islame do të shtrihej deri në Botën Tjetër dhe nëse rruga e arritjes së saj do ishte adhurimi i Zotit dhe kërkimi i vazhdueshëm i ndihmës, atëherë realiteti do të ishte ndryshe.

Një frymëzim kuptimor për suren el-Fatiha e hasim në hadithin kudsij të njohur për suren Fatiha.

Kur flitet për vlerat e sures el-Fatiha, shpesh përmendet një hadith kudsij, i cili po ashtu thekson edhe një emër të kësaj sureje, emrin الصلاة – *salatun*.

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: "قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: فَسَمِعْتُ الصَّلَاةَ بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي نَصْفَيْنِ وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ فَإِذَا قَالَ الْعَبْدُ: ﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾ قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: حَمِدَنِي عَبْدِي وَإِذَا قَالَ: ﴿الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ﴾ قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: أَنْتَى عَلَيَّ عَبْدِي وَإِذَا قَالَ: ﴿مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ﴾ قَالَ: مَجَّدَنِي عَبْدِي وَقَالَ مَرَّةً: فَوَضَّ إِلَيَّ عَبْدِي فَإِذَا قَالَ: ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ قَالَ: هَذَا بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ فَإِذَا قَالَ:

﴿أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ﴾  
 قَالَ: هَذَا لِعَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ.

Transmeton Ebu Hurejra (r. a.): E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut të ketë thënë: *Allahu ka thënë: “E kam ndarë namazin ndërmjet Meje dhe robit Tim në dy gjysma, dhe ai (robi) do ta fitojë atë për të cilën është lutur.”* Kur robi thotë: “El hamdu lil-lahi rabbil alemin”; Allahu thotë: “Robi Im më falënderoi.” Kur robi thotë: “Er-rahmanir-rahim”; Allahu thotë: “Robi Im më lavdëroi.” Kur robi thotë: “Maliki jeumiddin”; Allahu thotë: “Robi Im më madhëroi (robi Im i është bindur Madhërisë Sime).” Kur robi thotë: “Ijjake na’budu we ijyake nesta’in”; Ai thotë: “Kjo është ndërmjet Meje dhe robit Tim dhe ai do ta fitojë atë, për të cilën është lutur.” Kur robi thotë: “Ihdinas-siratal mustekim, siratal lehdine en amte alejhim, gajril magdubi alejhim we led-dalin”; Ai thotë: “Kjo është për robin Tim, dhe ai do ta ketë atë që e ka kërkuar.”

Në këtë hadith kudsij tregohet se kjo sure është ndarë në dy pjesë të barabarta: pjesa e parë i takon Zotit, kurse e dyta i takon robit. Tri ajetet e para janë për Zotin, tri ajetet e fundit<sup>31</sup> janë për robin, kurse ajeti i mesëm, gjysma e parë, është për Zotin: “Vetëm Ty të adhurojmë” dhe gjysma tjetër për robin “Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”.

Parashtrohet një pyetje: a thua përse kjo ndarje?

Surja *Fatiha*, përveç porosive të tjera, e tregon mënyrën dhe formën e jetës së besimtarit. Tregon baraspeshën që njeriu duhet të mbajë gjatë gjithë jetës së vet mes të drejtës së Zotit dhe të drejtës së robit. Kjo sure është shembulli i parë

<sup>31</sup> Sipas ndarjes së atyre që nuk e llogarisin besmelen pjesë të sures *Fatiha*. Shafiitët dhe malikitët mendojnë se besmeleja është pjesë e sures *Fatiha*.

dhe më i përsosur i të qenët të Islamit *fe mesatare*.

Gjithashtu, kjo ndarje proporcionale paraqet mesazhin kryesor të Kuranit dhe rrugën e vërtetë e cila do të sqarohet në suret e mëtuqjeshme. Në një mënyrë, qysh në fillim të Kuranit lexuesit i tregon se ky libër e njih vetëm rrugën e mesatares dhe vetëm përmes kësaj do ta arrini objektivin kryesor të kësaj feje.

Kjo e shpjegon më së miri faktin përse ajeti *“Ijjake na’budu we ijjake nesta’in”* është ajeti në të cilin është gërshetuar dituria e gjithë librave të shpallur.

### **Bashkësia para individit**

Sado që ibadeti në Islam, shikuar nga këndi i lidhjes mes robit dhe Zotit, është veprim individual, Allahu (xh. sh.) zgjodhi trajtën e shumësit (bashkësisë) për ta treguar atë në sures Fatiha. Adhurimi dhe kërkesa e shumicës janë çelësi i suksesit.

Me adhurim fitohet Bota Tjetër, kurse me kërkimin e ndihmës fitohet kjo botë. Allahu (xh. sh.) të dyja, edhe adhurimit, edhe kërkimin e ndihmës i ka dhënë në shumës: *“Ty të adhurojmë dhe Ty të kërkojmë ndihmë”*, në mënyrë që besimtari të mos jetë egoist në fitimin e këtyre dy mirësive, por të dëshirojë që edhe të tjerët të jenë pjesëmarrës. Apo thënë më mirë, Bota Tjetër dhe përfitimet e kësaj bote më mirë fitohen në një bashkësi të koordinuar mirë, dhe jo si individë, bile Allahu (xh. sh.) edhe hyrjen në xhenet e ka kushtëzuar me hyrjen në grupin e robërve të mirë ﴿فَادْخُلِي فِي عِبَادِي / وَاذْخُلِي﴾ ﴿جَنَّتِي﴾ *“Hyr në grupin e robërve të Mi! Hyr në xhenetin Tim.”* (El-Fexhr, 29-30)

Dhënia e shumësit është një tregues i fuqishëm i modestisë së besimtarit, në mënyrë që t'i shmanget përdorimit të vetës së parë në njëjës (unë), sepse kjo e fundit është veti shejtanore.

Gjithashtu, trajta e shumësit “të adhurojmë”, “të kërkojmë ndihmë” dhe “na udhëzo”, qysh në fillim të Kuranit e mësojnë besimtarin që çdoherë t'i njohë edhe vlerat e të tjerëve, d.m.th. kurrë nuk duhet të mendojë se vetëm ai e adhuron Zotin, se vetëm ai i kërkon ndihmë Zotit etj.

Krejt në fund, ky ajet kuranor e përmban fuqishëm parimin e njohur islam: “E drejta kolektive çdoherë ka përparësi para të drejtës individuale”.<sup>32</sup>

Po ashtu, ajeti *إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ* “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë”, flet për adhurim dhe lutje për ndihmë, mirëpo Allahu (xh. sh.) para se t'ia mësojë njeriut adhurimin dhe lutjen, e ka përgatitur shpirtërisht që adhurimi dhe lutja e tij të jenë të pranuar. Kjo përgatitje është bërë në ajetet paraprake të sures El-Fatiha, ku ia mëson tri parimet kryesore të adhurimit të denjë dhe të lutjes së sinqertë:

- Me *الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ* ia ka mësuar dashurinë;
- Me *الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ* ia ka mësuar mëshirën, dhe
- Me *مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ* ia ka mësuar frikën.

Pra, këto janë tri vetitë me të cilat robi duhet pajisur për të pasur adhurim të denjë dhe me të cilat mund të fitojë ndihmën e Zotit (xh. sh.). Gërshetimi i dashurisë, i mëshirës dhe i frikës bëhet shtytës për njeriun për punë të mira.

### Prova e ibadetit

<sup>32</sup> Esh-Sheukani, *Fet'hu el-Kadir*, vëllimi I, El-Marifetu, 2007, f. 12.

Sigurisht, çdokush dëshiron që ibadeti apo lutja e tij të jetë e pranuar te Zoti (xh. sh.), sepse synimi final i ibadetit dhe lutjes është fitimi i lidhjes me Zotin dhe përfitimi i robit në të dyja botët.

Nëse u hedhim një vështrim ajeteve të sures El-Fatiha, do të gjejmë se përveç nxitjes për ibadet dhe lutje, janë dhënë edhe rrugët për të provuar këtë ibadet dhe këtë lutje.

Jo rastësisht Allahu (xh. sh.), pas ajeteve që kërkojnë ibadet apo lutje, menjëherë flet për rrugën e drejtë, d.m.th. nëse dëshiron të kesh ibadet dhe lutje të pranuar, atëherë shiko se sa je në rrugë të drejtë pas ibadetit dhe pas lutjes. Nëse ibadeti dhe lutja nuk e udhëzojnë njeriun në rrugë të drejtë, atëherë vihet në dyshim edhe ibadeti edhe lutja. Shkurt thënë, qenia në rrugën e drejtë është provë e ibadetit të pranuar.

Tri apo katër ajetet e para janë dhënë në vetën e tretë, ku flitet për Qenien e Zotit (xh. sh.). Po ashtu, brenda këtyre ajeteve nuk është dhënë asnjë folje, për ta shmangur kriterin kohë, vend dhe veprim.

Nëse do të ndiqej ligjërimi i njëjtë, ajeti i katërt do të ishte **اللَّهُ نَعْبُدُ وَاللَّهُ نَسْتَعِينُ** "Allahun e adhurojmë dhe Allahut i kërkojmë ndihmë", mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Përse?

Pas përshkrimit të Vetes në tri ajetet e para në vetën e tretë, Allahu (xh. sh.) në ajetin e katërt ka bërë ndryshim të vetës, pra e ka dhënë në vetën e dytë. Ky ndryshim nuk është i rastësishëm, por për të treguar se gjatë adhurimit dhe lutjes për ndihmë Allahu (xh. sh.) çdoherë është afër, sepse veta e dytë shpreh afërsi dhe bashkëbisedim.

Përveç faktit se Allahu (xh. sh.) qëndron pranë atyre që luten, gjithashtu, Ai duhet të jetë i vetmi synim i besimtarëve.

Rregulli i përgjithshëm i renditjes së gjymtyrëve të fjalisë foljore në gjuhën arabe është kështu: folja, kryefjala dhe pastaj kundrina. Në ajetin e katërt të sures Fatiha kundrina i ka paraprirë foljes ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë”. Pra, kundrinori Ty, në të dy rastet ka ardhur para foljes.<sup>33</sup> Kur kundrinori vjen para foljes, nënkupton specifikim apo veçim. Në rastin konkret, fillimi i dy fjalive me kundrinorin Ty (إِيَّاكَ) tregon se meritë për t’u adhuruar ka vetëm Allahu, dhe ndihma duhet kërkuar vetëm prej Tij.

Ky ajet përfaqëson pikën kyç, ku ekuilibrohet e drejta e Zotit dhe e drejta e robit; të dyja, në të dy pjesët e këtij ajeti, të dhëna me dy folje: “Vetëm Ty të adhurojmë”, që është e drejtë e Zotit, dhe “Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”, që është e drejtë e robit. Folja përfaqëson veprim konkret, dhe atë të shprehur në kohën e tashme, d.m.th. arritja dhe mbajtja e baraspeshës mes Zotit dhe robit vijnë vetëm me punë konkrete.

### Njëherë ibadet, pastaj kërkesë për ndihmë

Dituritë kuranore na mësojnë se qëllimi kryesor i ardhjes së njeriut në këtë botë është ibadeti - adhurimi i Zotit (xh. sh.): “Nuk i kam krijuar xhindet dhe njerëzit për tjetër, veçse të Më adhurojnë”. Ibadeti që kërkohet në këtë ajet është në kuptimin e gjerë të fjalës ibadet, prandaj do të ishte absurde që synimi i kësaj bote të jetë ibadeti, e puna e parë në Kuran

<sup>33</sup> Ibn Kajjim, *Et-Tefsiru el-kajjimu li imami Ibni el-Kajjimi*, Bejrut, f. 35.

të jetë diçka tjetër, veç ibadetit. Zoti zgjodhi ta nisë veprimtarinë e besimtarit në Kuran me vepër (gjuhësisht, me folje), që është synim i ekzistencës njerëzore në dynja. Pastaj, çdo vepër tjetër është plotësim i kësaj kauze të çmuar. Të gjitha urdhëresat dhe të gjitha ndalesat tjera brenda Kuranit nëse nuk bëhen me nijet ibadeti (adhurimi) ndaj Krijuesit janë të kota. Pra, motoja ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ﴾ “*Vetëm Ty të adhurojmë*” është pika së cilës duhet t’i referohet çdo veprim apo mosveprim i përfituar nga Kurani.

Ibadeti është renditur para kërkesës për ndihmë, sepse në Islam njëherë përcaktohen synimet, pastaj zgjidhen mjetet e nevojshme dhe legjitime për përmbushjen e atyre objektivave.

Teoria e Makiavelit “qëllimi e arsyeton mjetin”<sup>34</sup> ka bërë që në shumë vise të botës të dominojë anarkia dhe dhuna, vetëm që dikush t’i realizojë synimet e veta pa u kushtuar vëmendje mjeteve që rëndojnë mbi kurrizin e të tjerëve. Ajeti ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë*” e ka përshkruar qëllimin dhe mjetin e besimtarit, por me një dallim rrënjësor nga doktrina makiaveliste. Makiavelizmi nuk zgjedh mjetin për t’i arritur qëllimet e veta, kurse Islami e ka të domosdoshme zgjedhjen e mjeteve të duhura dhe legjitime për t’i realizuar ato: sepse, Ai të është dhënë edhe para qëllimit (ibadetit), por edhe para mjetit (kërkesës për ndihmë). Pra, për ta realizuar ibadetin, që është synim i jetës së besimtarit, patjetër duhet të shfrytëzohet mjeti që del nga i njëjti qëllim, sepse përndryshe nuk vlen. Pikërisht për këtë arsye para fjalës kura-

<sup>34</sup> Adam Minter, *The Harvard Review of Philosophy*, Vëllimi I, 1992, f. 25-32.

nore ﴿نَسْتَعِينُ﴾ “kërkojmë ndihmë” është përemri ﴿إِيَّاكَ﴾ “Ty”, siç është dhe para adhurimit, në mënyrë që besimtari ta kuptojë se qëllimi dhe kërkesa për ndihmë të puqen në një pikë të përbashkët hyjnore. Pra, të ekzistojë një paralelizëm mes qëllimit dhe mjetit.

### Parakushti i udhëzimit

Kur i analizojmë tri foljet e para në Kuran, atëherë shohim se e para është: “Ty të adhurojmë”, e dyta: “Ty të kërkojmë ndihmë” dhe e treta: “Na udhëzo!”.

Sikurse që duket, udhëzimi është renditur i tretë, me parakusht adhurimin dhe kërkimin e ndihmës. Të adhurosh dhe të kërkosh ndihmë, do të thotë të njohësh dobësinë, paaftësinë dhe nevojën për Qenien Absolute. Prandaj, nëse njeriu ndihet i pavarur, pa iu dashur asnjë lloj ndihme, e ka të vështirë të udhëzohet.

Kërkimi i ndihmës po ashtu është një tregues i fuqishëm i modestisë dhe i përlësisë së robit, prandaj këtij i jepet udhëzimi. Ndryshe është me kryelartin dhe me egoistin, të cilët nuk ndiejnë nevojë për ndihmë, prandaj atyre edhe nuk u jepet udhëzimi.

Udhëzimi, krahas kushteve paraprake, ka edhe disa kondita gjatë dhe pas udhëzimit.

Kërkesa e parë dhe e drejtpërdrejtë në Kuran, të cilën besimtari e bën, është pikërisht kërkesa për udhëzim dhe drejtim në rrugën e drejtë.

Kjo kërkesë nuk është thjesht një lutje për të qenë në rrugë të drejtë, por është edhe lutje për të ecur përpara dhe për t’u avancuar, sepse sigurimi i rrugës së drejtë është mundësia më e shkëlqyer që njeriu të ecë përpara më shpejt.

Pra, është absurde që myslimani përpara vetes ta ketë rrugën e drejtë, ndërsa në udhëtim dhe avancim të jetë pas të tjerëve. Prapambetja e myslimanëve sot nuk ka si sqarohet ndryshe veçse si përtaci para kësaj rruge të sofistikuar, apo si ngatërrim i rrugës, duke menduar se është në rrugë të drejtë.

Parashtrohet një pyetje: udhëzimi është diçka e ngurtë, apo një proces i vazhdueshëm në jetën e besimtarit?

Nëse pohohet fakti se udhëzimi ndodh vetëm një herë në jetën e besimtarit, apo vetëm pasi ai të ketë devijuar besimin, atëherë përse lutemi çdo ditë nga dyzet herë (në çdo namaz) për udhëzimin të cilin veçse e posedojmë?

Parimisht, kalimi nga mosbesimi në besim bëhet një herë, mirëpo njeriu nuk ka nevojë vetëm për udhëzimin që të futet në rrugë të drejtë, por ai duhet që vazhdimisht të pajiset me udhëzime që ta vazhdojë këtë rrugë. Është absurde që njeriu në shekullin XXI të ndjekë shenjat formale të rrugëve të dhëna para katërmbëdhjetë shekujve (kuptohet, çdoherë duke ruajtur thelbin hyjnor). Lutja të cilën besimtari e bën me dhjetëra herë në ditë gjatë namazit ﴿أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ﴾ “Udhëzoni në rrugën e drejtë” tregon se besimtari pareshtur kërkon që rruga e tij t’i plotësojë të gjitha standardet e nevojshme të kohës, të vendit dhe të rrethanave.

Po ashtu, ky ajet na frymëzon që ne të jemi dinamikë dhe vazhdimisht t’i kërkojmë referencat dhe shenjat më të mira për rrugën që kemi zgjedhur, duke e luftuar fuqishëm pasivitetin dhe ngurtësinë.

Ky ajet gjithashtu e shpreh edhe vazhdimësinë e qëndrimit në falënderim dhe adhurim të Allahut, që realisht është rruga e drejtë.

Ky ajet kuranor e mëson besimtarit që të bëhet autokritik dhe kurrë të mos i hyjë vetja në qejf, sepse çdo ditë porositet për t'u lutur për udhëzim.

### Lutja e përkryer

Në mesin e shumë margaritarëve kuptimorë të sures Fatiha, në formë të përkryer është plasuar edhe mënyra më e mirë e lutjes.

Lutja në gjuhën arabe bëhet në disa forma, kryesisht me folje të kohës së shkuar, të kohës së tashme dhe të mënyrës urdhërore. Forma që zë më shumë vend në lutjet kuranore dhe profetike është forma me folje të urdhërores, siç është dhënë në suren Fatiha: ﴿أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ﴾ “Udhëzoni në rrugën e drejtë!”

Trajta urdhërore kryesisht kumton një urdhër, apo një kërkesë. Por, parashtrohet një pyetje: si mund të urdhërohet Zoti?

Nëse e shohim gjuhësisht, atëherë përgjigja është shumë e thjeshtë: mënyra urdhërore nënkupton edhe lutjen; jo çdoherë urdhrin. Megjithatë, ka një problem tjetër: përse lutja të jetë pikërisht në këtë formë, kur ka edhe forma të tjera? Cila është specifika e lutjes me folje në mënyrën urdhërore nga lutja me folje në kohën e kaluar apo në kohën e tashme?

Një ndër kushtet e lutjes së pranuar është bindja se lutja do të pranohet. Gjëja më e urryer gjatë lutjes është mëdyshja se a do të pranohet ose jo. Prandaj, Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Kur të bëjë dua ndonjëri prej jush, le të jetë i vendosur në lutjen e tij e mos të thotë ‘O Allahu im, nëse dëshiron, më jep mua!’, sepse nuk ka kush që i bën imponim Atij.” Edhe dijetarët

islamë, kur kanë diskutuar për lutjet e pranuara, kanë thënë se vendosmëria është kusht kyç.

Kështu që, shprehja e lutjes në mënyrën urdhërore nuk nënkupton urdhrin ndaj Zotit, por e përshkruan bindjen e besimtarit për t'iu pranuar lutja; pra, ai nuk e vë në dyshim pranimin, kështu që atij i mjafton të urdhërojë. P.sh. njeriu urdhër të prerë mund t'i japë vetëm atij tek i cili është i bindur se nuk e kthen prapë, sepse përndryshe do të zgjidhte fjalë më të matura dhe më të ëmbla. Megjithatë, kjo jo çdoherë nënkupton se i urdhëruari e ka frikë apo është më i dobët se urdhëruesi, por mund të jetë rezultat i një besueshmërie të paparë mes njëri-tjetrit. Pra, edhe drejtimi i lutjes në mënyrën urdhërore, nënkupton se besimtari ka një bindje të fuqishme në pranimin e lutjes, prandaj vetëm kërkon, dhe i jepet.<sup>35</sup>

Kështu Fatihaja na mëson se çfarë lidhje të formojë robi me Zotin, edukatën e kerkimit nga Ai dhe mënyrën më të mirë për t'i realizuar dëshirat.

### Folja إِهْدِنَا – ihdina (udhëzona!)

Kundrinori i foljes هَدَى “ka udhëzuar” mund të vijë i drejtë ﴿إِهْدِنَا الصِّرَاطَ﴾ “Udhëzona rrugën” dhe i zhdrejtë me parafjalë: ﴿إِهْدِنَا إِلَى صِرَاطٍ﴾ “udhëzona në rrugën”. Kjo e fundit është më e përhapur dhe më e përdorshme, mirëpo ajo (me parafjalë) flet për ata që nuk janë në rrugë të drejtë, d.m.th. i merr dhe i fut brenda saj, kurse e para (pa parafjalë) i mbulon dy kuptime: edhe atë që nuk është, e fut në rrugë të drejtë-

<sup>35</sup> Ibn Kethir, *Tefsiru El-Kur'ani el-Adhimi*, vëllimi I, Daru Et-Tajjibeh, 1999, f. 28.

të; por edhe atë që është, e përforcon dhe e çon më andej. Pra, Allahu (xh. sh.) nuk e ka sjellë me parafjalë, në mënyrë që t'i përfshijë të dy kuptimet.

Kjo lutje është simbol i xhematit dhe i grupit, antitezë e vetmisë dhe egoizmit.

Mësimet kuranore dhe tradita profetike e Muhamedit (a. s.), të inspiruar dhe të dirigjuara nga Madhëria e Zotit (xh. sh.), na kanë mësuar që lutjet t'i bëjmë në trajtën e shumësit.

Që në lutjen e parë të Kuranit Allahu (xh. sh.) i ka shpallur Muhamedit (a. s.) që atë ta bëjë në shumës, në mënyrë që njeriu ta shmang egoizmin dhe nëse njerit i pranohet lutja, atëherë mëshira e Zotit t'i mbulojë të gjithë lutësit. Pra, lutja në shumës është një shans më tepër që lutjet tona të pranohen.

### Rrugë e qartë

Komentuesit e Kuranit kanë dhënë opinione të ndryshme rreth shprehjes ﴿الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ﴾ "Rrugën e drejtë". Kanë thënë se janë Kurani, Pejgamberi (Sunneti), Islami etj.

Pavarësisht mendimit për rrugën e drejtë, një gjë është e ditur se Allahu (xh. sh.) këtë rrugë e ka dhënë të shquar, me një shquese të përparme el- (ال). Kjo shquarsi tregon se rruga nëpër të cilën duhet të ecë besimtari duhet të jetë e shquar dhe e njohur.

Ky ajet kuranor na mëson që asnjëherë mos t'i bëjmë trase rrugës që s'e njohim. Më parë se çdo gjë, ajo duhet të jetë e studiuar mirë dhe e qartë.

Po ashtu, shquarsia tregon se kjo rrugë është e shquar dhe e njohur mirë, sepse nëpër të kanë ecur pejgamberët

dhe njerëzit e mirë që nga njeriu i parë e deri në ditën e fundit të kësaj bote, prandaj: ‘mos u hamend para saj, sepse çdo gjë është e njohur mirë, e sigurt dhe e provuar me fund të suksesshëm’.

### Es-siratu (الصِّرَاطُ) dhe El-mustekim (المُسْتَقِيمُ)

Leksiku i gjuhës arabe ka disa sinonime për fjalën rrugë. Më të njohurat janë: *es-sebilu* (السَّبِيلُ), *et-tariku* (الطَّرِيقُ) dhe *es-siratu* (الصِّرَاطُ).

*Es-sebilu* (السَّبِيلُ) kryesisht nënkupton rrugën e paecur.

*Et-tariku* (الطَّرِيقُ) kryesisht nënkupton rrugën e ecur.

Fjala *es-siratu* الصِّرَاطُ, ndërkaq, ka disa specifika të veta:

- Rrugë e sinjalizuar mirë dhe dihet gjithë ecuria në të; nga fillimi deri në fund. Kjo fjalë përdoret edhe për rrugën e drejtë, por ndonjëherë edhe për rrugën e xhehenemit. P.sh. në ajetin 23 të sures *Es-Saffatu* thuhet: ﴿...فَاهْدُوهُمْ إِلَى صِرَاطِ الْحَكِيمِ﴾ “...prandaj, udhëzoni ata në rrugën e Xhehimit (zjarrit)”. Pra, Allahu (xh. sh.) shenjat e duhura i ka vënë në të dy rrugët, kështu që zgjedhja të mbetet ty.
- Allahu në këtë ajet e ka përzgjedhur fjalën *sirat*, në mënyrë që të kuptohet rruga e kësaj bote dhe *sirati* i botës tjetër, që të çon në Xhenet;
- Pasi *sirat* është rrugë e sinjalizuar, atëherë i bie që të jetë edhe rrugë e lehtë;
- Rrugë më e gjerë. Pra, nuk është thjesht një rrugë e ngushtë, por rrugë e gjerë, ku besimtari mund të ecë komod. Prandaj, kjo fjalë në Kuran nuk është dhënë

askund me trajtën e shumësit, sepse ajo është e vetme.

Thënë shkurt, fjala Es-siratu (الصِّرَاطُ) është rrugë e lehtë, e sinjalizuar dhe e gjerë, e cila fillon në dynja dhe përfundon në ahiret: në Xhehenem ose në Xhenet.

Në pamundësi për ta përmbledhur poliseminë (shumëkuptimësinë) e cilësorit El-Mustekim (المُسْتَقِيم) në një fjalë të vetme në gjuhën shqipe, kryesisht e kanë përkthyer si *e drejtë*.

Tema e fjalës e mbiemrit El-Mustekim (المُسْتَقِيم) është e ndarë në dy morfema: morfema ndajshitesore مُسْتَدَّ dhe morfema rrënjore قِيم. E para (اسْتَدَّ / مُسْتَدَّ) i shtohet fjalës për të kërkuar diçka, kurse rrënjja قِيم / قوم ka kuptimin e *qëndrueshmërisë, të ngritjes dhe të vlerës*. Pra, edhe vetë fakti se është shprehur me emër, kjo fjalë do të thotë: rrugë e cila vazhdimisht kërkon qëndrueshmëri, ngritje dhe vlera. Pra, nuk mjafton që çdoherë rruga të jetë veç e drejtë. Vërtet drejtëza është pika më e afërt për t'i bashkuar dy pikë, por rruga e drejtë duhet të jetë e rregulluar mirë dhe e pastruar nga të gjitha pengesat e mundshme, kurse fjala *mustekim* përfshin rrugën më të sigurt, më të qëndrueshme, më të ndritur, më me vlerë dhe më të drejtë për të arritur qëllimin final të ekzistencës në këtë botë.

Gjithashtu, fjala Mustekim tregon se rruga e besimtarit nuk është statike, por ajo ndryshon varësisht rrethanave, kohës, njerëzve etj., prandaj Allahu (xh. sh.) e ka parashtruar përmes morfemës مُسْتَدَّ d.m.th. vazhdimisht kërkon qëndrueshmëri, ngritje dhe vlera. Po të ishte rruga e ngurosur dhe e njëjtë për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohët, atëherë ka mjaftuar të thoshte: الصِّرَاطُ الْمُسْتَقِيمُ "Rrugën e drejtë".

Një mësim tjetër i rëndësishëm nga ky ajet kuranor, përkatësisht nga vetë fjala sirat صِرَاط fitohet edhe nga vetë përsëritja e kësaj të fundit.

Drejtimet e mundshme që i merr njeriu në jetë, të paraqitura në këtë sure, janë tre: njëri pozitiv dhe dy negativë, mirëpo Allahu Fuqiptotë, për hir të rrugës së drejtë, fjalën صِرَاط “rrugë” e përdor dy herë, edhe atë vetëm për rrugën pozitive dhe jo për ato negative.

Proporcion të drejtë në kontekst të vazhdimësisë së qëndrimit në rrugën e drejtë ka edhe në kuptimin e fjalëve *udhëzona* dhe *mustakim*. Ashtu siç *udhëzona* në kontekst të Fatihasë ka elemente të vazhdimësisë zbatuese, ashtu edhe *mustakim* në brendi e ngërthen qëndresën e vazhdueshme në rrugën drejt Zotit.

Kjo jep të kuptohet se specifikimi i udhës pozitive si rrugë, bile përsëritja dy herë brenda saj, tregon se vetëm ky drejtim meriton të quhet rrugë, kurse dy drejtimet tjera negative janë veç - paudhësi.

### Reflektimet kuptimore të foljes اَنْعَمْتَ

Brenda këtij përdorimi janë fshehur shumë urtësi dhe mësim, të cilat mund t'i shohë vetëm mendja e mprehtë dhe e çiltër:

- Rruga në të cilën kërkon të udhëzohet robi është një ni-met dhe mirësi e madhe;
- Përse nuk është thënë “në rrugën e atyre që besuan”, “në rrugën e atyre që u nënshtruan” ose “në rrugën e myslimanëve” etj.? Përmes kësaj folje tregohet se jeta e të udhëzuarit çdoherë është e begatuar, sido qofshin

rrethanat. Edhe pse besimtarët mund të vuajnë, Allahu edhe vuajtjet e tyre i përkthen në begati;

- Folja është dhënë në kohën e kaluar “në rrugën e atyre që i begatove”. Pra, ai që e pranon një vlerë të së kaluarës, do të mund ta fitojë edhe të ardhmen. Këtu besimtari e pranon se Zoti i ka begatuar shumë të tjerë para tij, prandaj tani kërkon që në mesin e tyre të jetë edhe vetë ai, ky, konkreti;
- Përse është dhënë “që i begatove ti” dhe jo: “që u begatuan”? Besimtari është i vetëdijshëm se dhuruesi i begatime është vetë Allahu. Për besimtarin nuk është e rëndësishme vetëm begatia, por edhe burimi i asaj begatie. Mirësia së cilës nuk i dihet burimi nuk është e mirëseardhur për besimtarin. Prandaj, pranë foljes “të begatosh” أَتَعَمَّ qëndron edhe përemri vetor َ Ti, d.m.th. Allahu.
- Udhëzimi që kërkohet në ajetin paraprak këtu tregohet se është nimet (begati) i Zotit, i dhënë prej Tij, dhe nuk është meritë e jote. Shpeshherë ky ajet dhe të ngjashmit me të keqkuptohen, sepse këtu nuk flitet për determinizëm hyjnor, por për dëgjueshmëri të robit ndaj Krijuesit. D.m.th. besimtari i vërtetë punon pareshtur për ta fituar udhëzimin e Zotit, kurse i ligu qëndron duarkryq për ta pritur udhëzimin e Tij;
- Allahu (xh. sh.) kur flet për rrugën e drejtë, tani e konkretizon se kjo rrugë është edhe e begatshme. Pasi Zoti na e shpalos rrugën e drejtë, menjëherë parashtrohet pyetja: por, çfarë ofron kjo rrugë e drejtë? Përgjigjja është vetë ajeti: “në rrugën e atyre të cilët i begatove...”
- Kjo frazë gjithashtu ngjall kureshtjen e besimtarit për ta mësuar të kaluarën dhe përvojën e besimtarëve të tjerë,

d.m.th. kush kanë qenë të begatuarit? Si e kanë arritur këtë begati? etj.

- Folja **أُنعمت** (ke begatuar) përfshin tri dimensione të përsosurisë: a) udhëzimin e përsosur; b) privilegjin e përsosur në këtë dhe në botën tjetër; dhe c) shpërblimin e përsosur;
- Përdorimi i kësaj folje nënkupton se udhëzimi kërkohet në një rrugë që është provuar, në një rrugë të dëshmuar për nga suksesi i saj. Ky nuk është, thjesht, një premtim për rrugë të suksesit. Udhëzimi e ka edhe këtë domethënie: po deshët, kthehuni dhe shiheni suksesin real të kësaj rruge të gjeneratat e kaluara - të pejgamberët, të të sinqertët, të dëshmorët dhe të mirët. Formulimi i këtillë i jep sigurinë e plotë besimtarit, e bën atë të përkushuar, që mos të luhetet në këtë rrugë të dëshmuar nga të gjitha anët;
- Rahmeti i të Gjithëmëshirshmit brenda fjalës **أُنعمت**. Allahu (xh. sh.) pasi e tregon udhëzimin, sqaron se *istikameti* - qëndrueshmëria (mustekim) është mënyra e vetme për ta arritur atë që quhet nimet (begati). Allahu ka mundur që veç një herë t'i përmendte ata ndaj të cilëve është hidhëruar, ata që janë humbur si rezultat i daljes nga rruga e drejtë, por ai zgjodhi ata që i ka begatuar, duke u dhënë njerëzve alternativë të parë të mirën dhe jo të keqen.

Gjithashtu, siç thamë më parë, me foljet **أُنعمت** ka begatuar, e ka dhënë Vetën **أنت** Ti, d.m.th. ti o rob, nëse do të qëndrosh afër Zotit, atëherë zgjidhe atë me të cilin Ai e

ka bashkuar emrin e vet.<sup>36</sup>

### **Kush janë “ata që tërhoqën hidhërimin” dhe “të humburit”**

Kur i shfleton librat e tefsirit, gjen se “ata të cilët tërhoqën udhëzimin” janë hebrejtë, kurse “të humburit” janë të krishterët, ose ndonjëherë edhe e kundërta. Kjo gjithsesi është vërtetë, por parashtrohet pyetja: përse një sure fisnike dhe kaq e lexueshme sa kjo, të ketë vetëm këtë kuptim? Përgjigjja: Ajo që u tha më parë gjithsesi është e vërtetë, por me frazën “ata të cilët tërhoqën hidhërimin” nënkuptohen edhe ata të cilët kanë dituri dhe nuk punojnë sipas saj, kurse me frazën “të humburit” përfshin vepruesit pa dituri.

Ata që tërhoqën hidhërimin dhe të humburit përfaqësojnë dy doktrina kryesore në arenën botërore.

Fjalët الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ dhe الضَّالِّينَ janë dy fjalë të shquara me një shquese të përparme ل. Shquarsia te këto dy fjalë nuk nënkupton shquarsinë e personave konkretë, por tregon qartësinë e doktrinave të tyre: të Krishterimit dhe të Hebraizmit. Kjo d.m.th. se këto dy doktrina janë të sqaruara imtësisht në Kuran dhe janë të njohura mirë për besimtarët myslimanë.

#### *Vetë shumësi nënkupton doktrinë*

Nëse u hedhim një vështrim gjuhësor dy ajeteve të fundit të sures Fatiha, atëherë do të shohim se aty paraqiten tri rrugët e mundshme të njeriut në këtë botë: rruga e drejtë,

---

<sup>36</sup> Shih: Fadil bin Salih Es-Samurai, *El-lemesatu el-bejanijjetu fi nususi et-tenzili*, “Dar Ammar”, Bejrut, 2003, f.60-66.

rruga e njerëzve që tërhoqën hidhërimin dhe rruga e njerëzve të humbur.

Nëse i analizojmë mirëfilli, shohim se ato të gjitha janë dhënë në trajtën e shumësit dhe jo në njëjës. Rrugën që e ndjek një individ, qoftë e mirë apo e padrejtë, ajo llogaritet thjesht një drejtim individual dhe funksioni i saj nuk është provuar si një normë e përgjithshme. Por, kur një drejtim është trasuar nga një grup njerëzish, atëherë kjo llogaritet doktrinë. Prandaj, Allahu (xh. sh.) të tri rrugët i paraqet në shumës, për të na treguar se bëhet fjalë për tri doktrina zotëruese në skenën botërore. Po ashtu, njëherësh, na bën me dije se edhe ne çdoherë duhet të investojmë në botëkuptime dhe rrugë të standardizuara mirë, sepse përndryshe individualitetet tona janë krejt të parëndësishme në konkurrencën e fuqishme të ideologjive.

Në të njëjtën kohë, fraza الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ “ata që tërhoqën hidhërimin” nuk tregon se kush është hidhëruar, por vetëm tregon se ndaj këtyre njerëzve ka hidhërim, pra, nuk thuhet: “me të cilët Ti u hidhërove”, siç ka thënë te ﴿أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ﴾ “që i begatove Ti”. Fillimisht, tregon se Allahu (xh. sh.) nuk cilësohet si Hidhëruar. Po ashtu, tregon se njerëzit e kësaj kategorie nuk tërheqin vetëm hidhërimin e Zotit (xh. sh.), por edhe hidhërimin e krijesave.

Tërheqja e vërejtjes është renditur para devijimit, sepse kur shohim se si e ka bërë Zoti (xh. sh.) renditjen e kategorive të njerëzve, apriori të shkon ndër mend pyetja: përse kjo renditje?

Përgjigjja është shumë e thjeshtë: Allahu (xh. sh.) i ka renditur ata që tërheqin hidhërim para të humburve, sepse

ky është mëkati i parë që u bë në dynja. Kur Zoti e krijoi njeriun, urdhëroi që për respekt të gjitha krijesat t'i bien në sexhde Ademit (a. s.). Të gjithë i ranë, veç Iblisi jo; prandaj u dëbua nga mëshira e Zotit (xh. sh.).

Pastaj vijnë njerëzit e humbur, të cilët nuk kanë pasur qasje në dituritë e kohës.

Po ashtu, të parët i theksoi ata që i ka begatuar, sepse fillimisht është begatuar Ademi (a. s.); pastaj doli Iblisi zi-liqar.

### Tri boshtet e sures El-Fatiha

Tematika e sures El-Fatiha ka tri boshte kuptimore kryesore:

I pari: njohja e Zotit (xh. sh.) përmes tri ajeteve të para ﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ / الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ / مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ﴾ *“Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, Sunduesit të Ditës së Llogarisë.”*

I dyti: adhurimi i Zotit (xh. sh.) dhe kërkimi ndihmë prej Tij. ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ *“Ty të adhurojmë dhe Ty të kërkojmë ndihmë.”* Pas njohjes së Zotit, tani kërkohet të adhurohet vetëm Ai; pastaj i kërkohet Atij.

I treti: sqarimi i faktit se ibadet nuk është thjesht kryerja e disa ritualeve të thjeshta, por është ajo që Zoti thotë në ajetet vijuese ﴿هُدًىٰنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ / صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ﴾ ﴿وَالَّذِينَ﴾ *“Udhëzoni në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre që i begatove, dhe jo në rrugën e atyre që tërhoqën hidhërimin dhe që janë të humbur”*. Pra, ibadet nuk janë vetëm ritualet, por e gjithë rruga e drejtë që është trasuar nga ata që janë begatuar, duke e shmangur hidhërimin dhe rrugën e devijuar.

## SURJA EL-FIL – سُورَةُ الْفِيلِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ ﴿١﴾ أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ ﴿٢﴾  
وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ ﴿٣﴾ تَرْمِيهِم بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ ﴿٤﴾ فَجَعَلَهُم كَعَصْفٍ  
مَّأْكُولٍ ﴿٥﴾﴾

“(1) Nuk ke parë njerëzve të elefantit yt Zot ç'u punoi? (2) A nuk bëri që plani i tyre më kot të shkojë? (3) Mbi ta tufë-tufë zogj dërgoi, (4) duke i gjuajtur me gurë balte të pjekur (5) dhe i bëri si kashtë e shkelur.”

Shumë komentues të Kuranit kanë thënë se fjalësi kuranor konsiderohet si një njësi e pandarë, që nga surja Fatiha deri te surja Nas.

Thelbi i sures Humezeh është humbja në Botën Tjetër, kurse thelbi i sures Fil është humbja në këtë botë. Në këto dy sure Allahu (xh. sh.) i pasqyron të gjitha llojet e humbjeve: humbjen ekonomike, humbjen e pushtetit, disfatën luftarake, humbjen e prestigjit etj.

Parashtrohet pyetja: përse pikërisht këto dy sure e përshkruajnë humbjen?

Para këtyre dy sureve vjen një sure tjetër e shkurtër, surja Asr, ku thuhet: “Vërtet njeriu është në humbje”. Pasi i tregon katër cilësitë e njerëzve që janë të privuar nga kjo humbje, në dy suret tjera: Humezeh dhe Fil, Allahu (xh. sh.)

i tregon më gjerësisht kush janë të humburit.

Allahu (xh. sh.) fillimisht ka folur për humbjen në ahiret, por për ta konkretizuar dhe për t'ua treguar më realisht njerëzve që nuk besojnë, u sjell shembullin e humbjes në dynja.

### Forma pyetëse-habitore dhe shikimi vizionar

Surja Fil fillon me pjesëzën pyetëse ا (A?), me pjesëzën mohuese لَمْ (nuk) dhe me foljen كَرَّ (ke parë). Është e vetmja sure që fillon në Kuran me këto tri elemente.

Në stilistikë kjo llogaritet si formë e veçantë e fjalisë pyetëse-habitore, e cila shprehet përmes mohimit, p.sh. nëse themi: "A e ke parë Fisnikun si noton?!", kjo fjali është habitore, kurse nëse themi: "A nuk e ke parë Fisnikun si noton?!" është fjali që shpreh një habi më të madhe se e para.

Sa i përket foljes كَرَّ "sheh", parashtrohet pyetja: përse Allahu e përdor këtë folje, kur dihet se ne nuk e kemi mbërritur atë ngjarje, por vetëm kemi dëgjuar për të? Përse nuk është thënë "A nuk e di (ti)...?!".

Allahu (xh. sh.) e ka zgjedhur këtë folje për të na treguar se kjo që shpallet dhe që përshkruhet nga Zoti (xh. sh.) është sikur me e pa me sytë e ballit. Po ashtu, ky shikim (رَأَى) nuk është si shikimet tjera (نَظَرَ etj.), por ky shikim krijon një mendim apo ide të caktuar, pra është shkallë më e avancuar e shikimit. Ky lloj shikimi njeriut duhet t'i japë një ide të caktuar, për të mos e përsëritur mëkatin e ngjarjes së elefantit.

Gjithashtu, ky mëkat përsëritet edhe ditët e sotme, pra ndaj Allahu (xh. sh.) thotë: "A nuk e ke parë?!", sepse i njëj-

ti përsëritet vazhdimisht para syve të njerëzimit.<sup>37</sup>

Pas formës pyetëse – habitore, Allahu (xh. sh.) na flet për mënyrën e realizimit të kësaj disfate.

Në një fjali të rëndomtë, në vend të كَيْفَ (si) mund të përdorej edhe مَا (çka), mirëpo مَا (çka) e vendos theksin mbi pasojat materiale të gjithë ngjarjes, pra e prek fundin e ngjarjes, kurse كَيْفَ (si) e përfshin gjithë ngjarjen, bile edhe të gjitha elementet tjera që lidhen me këtë ngjarje.<sup>38</sup> Prandaj, Allahu (xh. sh.) zgjodhi që me pak fjalë t'i përshkruajë faktorët, zhvillimin e betejës, pasojat, mësimet, porositië etj.

Nëse i shohim zhvillimet nëpër botë, atëherë del se myslimanët në përgjithësi më shumë i shohin pasojat dhe përfundimet e ngjarjeve, kurse pak kanë qasje te faktorët, para-përgatitjet, zhvillimi i planeve afatgjatë etj. Kjo sure na mëson që ne gjërat t'i mendojmë me Si dhe jo me Çfarë, sepse kjo e fundit t'i hap sytë vetëm kur një zhvillim i caktuar është në fund.

### **Bërja (فَعَلَ) dhe Zoti (رَبِّ)**

Për “të bësh” në gjuhën arabe janë disa folje, por më të përdorurat janë: خَلَقَ “bërje nga asgjë d.m.th. krijim”, جَعَلَ “bërje duke e ndryshuar nga një gjendje në tjetrën” dhe فَعَلَ “bërje e përgjithshme”, e cila mund të jetë nga fillimi (krijim), por mund të jetë edhe tjetërsim i funksionit të gjësë së

<sup>37</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 97.

<sup>38</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Fili*,

<https://www.youtube.com/watch?v=fVXyCUXIVTY>.

krijuar.<sup>39</sup>

Dallimi paraprak e qartëson përdorimin e foljes *فَعَلَ* në suren Fil. Kjo folje u përdor, sepse Allahu (xh. sh.) për ta mposhtur ushtrinë e Ebrehasë diçka krijoi nga fillimi - siç thuhet për zogjtë, dhe diçka tjetër e shndërroi në gjendje tjetër - siç ishte rasti me elefantët, të cilët janë krijuar për të ecur përpara, por Allahu (xh. sh.) i bëri që ata të stagnojnë.

Sidoqoftë, kjo na tregon një realitet historik, por cili është mësimi ynë nga folja *فَعَلَ* “ka bërë”?

Pasi këtu flitet për një betejë të caktuar, atëherë edhe ne duhet të kuptojmë se për të ngadhënjyer në beteja duhet që fillimisht të zbulojmë diçka që nuk e ka armiku, por edhe atë që e ka, ta shndërrojmë në favorin tonë.

Për kuptimin leksikor të këtij emri të Zotit kemi folur në ajetin e parë të sures Fatiha, por këtu do ta sqarojmë funksionin e këtij emri në këtë sure fisnike.

Pasi një nuancë kuptimore të emrit Rabbun është edhe edukimi dhe na tregon se e gjithë ajo që Zoti bëri në ngjarjen e elefantit ishte për ta edukuar njerëzimin dhe jo për ta ndëshkuar.

Përse fjala *يَتَذَكَّرُ* është e lidhur me përemrin pronor të vetës së dytë njëjës *yt* (كَ)?

Pasi kjo sure ka zbritur në periudhën mekase dhe flet për një ngjarje që ka ndodhur në vitin kur ka lindur Muhamedi (a. s.), kohë kur besoheshin shumë zota, Allahu (xh. sh.) përmes lidhjes gjenitive *يَتَذَكَّرُ* “Zoti yt” tregon se ajo që ndodhi në ngjarjen e elefantit nuk u bë nga zotët e tyre, por nga Zoti yt.

<sup>39</sup> Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 98.

## Damkimi i pronarëve dhe jo i elefantëve

Fatkeqësisht, nëse lexon disa komente të kësaj sureje, shpeshherë gjen debate të gjata rreth numrit të elefantëve që morën pjesë në Luftën e Elefantit. Jo që kjo është e gabuar, por të përflitet vetëm numri i tyre, pa u kushtuar vëmendje mësimëve dhe porosive që përcjell kjo sure, mendoj se nuk është gjë e preferuar. Në këtë ajet vëmendje e veçantë u kushtohet pronarëve të tyre, sepse elefantët nuk erdhën vetë dhe as që bënë strategjinë e luftës. Pra, gjithë biseda është fokusuar te të zotët e elefantëve.

Ky ajet kuranor na shpalos një realitet tjetër nga strategjia luftarake. Allahu thotë ﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ﴾ “A nuk e pe si bëri Zoti me pronarët e elefantit” dhe jo “me vetë elefantët”. Kjo na tregon se edhe ne gjatë betejave të ndryshme, në rend të parë duhet kushtuar vëmendje gjeneralëve, komandantëve dhe strategëve të luftërave, dhe jo vetëm armëve që dirigjohen, sepse arma sado e sofistikuara të jetë, nuk bën punë pa një mendje të ndritur. Fatkeqësisht, një gabim i myslimanëve të sotëm është se përpjekja kryesore bëhet si të bëjnë ‘elefant’ (armatim) sa më të madh, dhe jo si të përgatisin komandantë, gjeneralë dhe strategë lufte sa më të shkathët.

Sintagma e fundit e këtij ajeti është أَصْحَابِ الْفِيلِ “të zotët e elefantit”, d.m.th. kemi lidhje gjenitive. Nëse u hidhet një vështrim elementeve nga se është e përbërë lidhja gjenitive në përgjithësi, do të shohim se ajo përbëhet nga dy emra: i pari është pronë e të dytit, pra emri i dytë çdoherë është më i privilegjuar. Kur themi أَصْحَابِ النَّبِيِّ “Shokët e Pejgamberit”, emri i parë është lidhur me të dytin, për t’u privilegjuar,

prandaj kur themi أَصْحَابُ الْفِيلِ “Shokët (pronarët) e elefantit” të parët janë lidhur me elefantin që është kafshë, si rrjedhojë të jesh shok ose ndjekës i elefantit për njeriun është nënçmim. Njësoj siç ndodh në jetën e përditshme - nëse duam ta lavdërojmë një njeri, themi “Shok i filanit (i një njeriu të mirë)”, e nëse dëshirojmë ta nënçmojmë, atëherë themi “Shok i filanit (i një njeriu të keq)”.<sup>40</sup>

Ajeti i dytë ﴿الْمُ يَجْعَلُ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ﴾ “A nuk e bëri kurthin e tyre të dështojë?!” paraqet një formë tjetër pyetëse-habitore, e dyta me radhë. Në rastet kur kemi përsëritje të të njëjtit stil të të shprehurit, atëherë edhe i dyti është njësoj i rëndësishëm si i pari. Pra, aq sa është me peshë ngjarja e elefantit, po aq peshë ka edhe ngadhënjimi i kurtheve.

Kjo përsëritje e formës pyetëse-habitore mund të japë edhe një mësim tjetër, se rëndësia e detektimit të kurtheve është pika kyç në një betejë.

Kur folëm për ajetin e parë të sures Fil, bëmë dallimin mes foljeve خَلَقَ, فَعَلَ dhe جَعَلَ, të cilat kishin kuptimin e bërjes, por me dallime të ndryshme kuptimore. Folja جَعَلَ ishte shndërrim i një gjëje në diçka tjetër. Pra, ajo ekziston, vetëm se i ndryshohet cilësia dhe funksioni.

Allahu (xh. sh.) e përdor në ajetin e dytë, sepse kurthi i armiqve veçse ekzistonte, por ajo që bëri Ai ishte tjetërsimi dhe dështimi i këtij kurthi.

---

<sup>40</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Fili*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=fVXYCUXIVTY>.

## Dallimi mes مَكْر dhe كَيْد

Të dyja këto fjalë e kanë kuptimin e kurthit. Mekri (مَكْر) është një plan i menduar mirë dhe i ditur, për ta arritur një çështje të caktuar, kurse (كَيْد) është përpjekja për ta arritur një punë të caktuar përmes një plani të një pune tjetër, pra të punosh diçka për ta arritur diçka tjetër.

Planin që e kishte Ebrehaja ishte hakmarrje ndaj arabit që urinoi pranë qabesë së tyre në Jemen, kurse qëllimi final ishte që ta mposhtë Qabenë në Mekë, në mënyrë që haxhilerët dhe turizmi të zhvendosen atje.

Zoti (xh. sh.) i dha efekt të kundër kësaj ekspedite (kej-di), sepse në vend që ta zvogëlojë numrin e haxhilerëve, ai u shtua edhe më shumë.

Nëse analizohet fjala تَضَلِيل, ajo nuk është thjesht një humbje e thjeshtë, pra nuk përkthehet si mbiemër *i humbur*, por ajo në gjuhën arabe është paskajore d.m.th. ajo është vetë humbja. Nëse analizohet mirëfilli, atëherë do të kuptohet se paskajorja, foljet dhe të gjithë fjalët e prejardhura nga kjo paradigmë (فَعَّلَ/يُفَعِّلُ/تَفَعَّلَ) shprehin një veprim të kryer për një kohë më të gjatë. Pra, dështimi i kurthit të tyre nuk ndodhi vetëm në momentin kur Allahu (xh. sh.) i dërgoi mbi ta shpezët, por ajo ndodh edhe sot e kësaj dite, sepse askush nuk mund t'i bëjë konkurrencë Qabesë së Bekuar.<sup>41</sup>

Kjo gjithashtu u jep një mësim të rëndësishëm myslimanëve. Kurthet e armiqtve drejtuar atyre nuk duhet të luftohen me projekte të përkohshme, që vetëm të evitojnë një pro-

<sup>41</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 100.

blem momenti, por ato të jenë projekte afatgjatë që do t'u sigurojnë paqe myslimanëve për shumë kohë, siç e mposhti Allahu (xh. sh.) kurthin e Ebrehasë përgjithmonë.

Nëse analizohen ajetet e sures Fil, atëherë sipas kronologjisë së ngjarjes ky ajet duhet të jetë i fundit, mirëpo është i dyti. Njëherë dërgohen shpezët, lëshojnë gurët, i bëjnë si kashtë e prishur dhe në fund kurthi konsiderohet i dështuar.

Vendosja e këtij ajeti në rendin e dytë jep një porosi shumë të rëndësishme: nëse në një betejë të caktuar nuk është zbuluar strategjia e armikut (kurthi), atëherë ndërhyrja fizike është e kotë; e nëse ajo është e deshifruar atëherë ndërhyrja fizike është shumë e lehtë.

Leximi i kurtheve të armiqve është më i rëndësishëm se ndërhyrja ushtarake. Realiteti ynë sot është shumë ndryshe, sepse ne hyjmë në luftë pa pasur një strategji të studiuar mirë.

### **Lufta qiellore dhe hapësinore**

Mënyra se si Zoti (xh. sh.) e mposhti këtë ushtri madhështore të asaj kohe, të pajisur deri në dhëmbë dhe me armatim më të sofistikuar (me elefantë), të jep të kuptosh se fuqia mbisunduese e botës është lufta nga qielli, prandaj Allahu (xh. sh.) thotë: ﴿وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ﴾ "Mbi ta dërgoi zogj tufë-tufë". Folja *أَرْسَلَ* "dërgoi" zakonisht pas merr parafjalën *إِلَى*, kurse kur bëhet fjalë për luftë dhe dënim, atëherë e merr parafjalën *عَلَى*.<sup>42</sup>

<sup>42</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Fili*,

<https://www.youtube.com/watch?v=fVXyCUXIVTY>.

Po ashtu, tani folja **أُزِئِلَ** është dhënë në trajtën e kohës së kaluar, sepse tani bëhet vetëm përshkrimi i një ngjarje të ndodhur në një kohë të caktuar në të kaluarën.

Lufta u realizua në stilin e njëjtë, njësoj siç dëshironin ata të mposhtin Mekën.

Ebreheja shkoi nga Jemeni në Mekë për të sulmuar, ndërsa Allahu (xh. sh.) i dërgoi zogjtë nga një vend tjetër për kundërsulm. Pra, lufta u bë në Mekë, por jo me mjete të vendit. Të dyja palët ishin të ardhura.

Ata dëshironin që t'u sillnin mekasve dhe Qabesë një telash mbi kokë, ndërsa Allahu (xh. sh.) atyre mbi kokë u solli zogjtë e babil.

Ata zgjodhën elefantin si kafshën më të madhe; Allahu (xh. sh.) po ashtu u dërgoi shtazë (zogi) si kundërpërgjigje.

Ata synonin që përmes elefantëve të shkatërrojnë dhe të shkelin çdo gjë; Allahu (xh. sh.) i bëri vetë ata si kashtë e shkelur.

Krijuesi i gjithësisë, sigurisht, kishte mundësi t'i shkatërronte vetëm duke thënë "bëhu!" dhe ajo do të ishte bërë, por përmes saj na dha një shkollë të paharrueshme të gjithëve - që çdoherë t'i përgatisim kushtet sipas nevojës dhe asnjëherë të mos presim se dikush do të bëjë mrekullinë dhe ne do të shpëtojmë. Pra, edhe Zoti, i Cili kishte mundësi ta bënte me një të thënë, nuk e bëri, por e ndoqi rrjedhën e luftës dhe iu përgjigj në të njëjtën mënyrë.

### **Zogjtë dhe elefantët**

Forcë luftarake e të dyja palëve ishin shtazët. Humbësit kishin shtazën më të madhe, ndërsa fituesit shtazën më të

vogël. Ç'na mëson, vallë, kjo?

Fillimisht, kjo është nënçmim për forcën më të madhe, sepse u mposhtën me armën më të vogël.

Po ashtu, na mëson se asnjëherë nuk duhet neglizhuar tjetri, sado i dobët të jetë. Besimtarët, përveç përgatitjes, patjetër duhet të mbështeten te Zoti (xh. sh.). Në të kundërtën, do t'u ndodhë si pronarëve të elefantit dhe si besimtarëve në Luftën e Hunejnit.

Që në fillim, ajeti i parë tregon se cak i këtij sulmi do të jenë pronarët e elefantit, jo elefantët. Pastaj, në të gjitha ajetet tjera e kemi përemrin vetor (apo pronor) هُمْ (ata/ atyre), p.sh. ﴿كَيْدَهُمْ﴾ "kurthin e tyre", ﴿أَرْسَلَ عَلَيْهِمْ﴾ "dërgoi mbi ta", ﴿تَزِمِيهِمْ﴾ "i gjuajnë ata" dhe ﴿فَجَعَلْنَاهُمْ﴾ "i bëri ata".

Të gjithë këta përemra, të cilët në gjuhën arabe përdoren vetëm për frymorë me intelekt, hedhin dritë mbi saktësinë maksimale të këtij sulmi të urdhëruar nga Zoti (xh. sh.). Në këtë betejë cak i sulmit ishin pronarët e elefantit, prandaj gjithë beteja u zhvillua në kurriz të tyre. Edhe pse elefantët ishin shtazët (armatimi) i tyre, Allahu (xh. sh.) urdhëroi që të mos merren shpirtra të pafajshëm (qofshin ato edhe kafshë), por të preket drejtpërdrejt thelbi i problemit, pronarët e elefantit.

### Pashquarsia e fjalës shpezë (طَيْرًا)

Në ajetin e tretë të sures Fil fjala shpezë (طَيْرًا) është dhënë e pashquar. Kjo pashquarsi tregon se shpezët që sulmonin pronarët e elefantit ishin të panjohura dhe nuk dihet se nga vinin.

Po ashtu, kjo pashquarsi tregon se nëse armiku ta njej armën, ta sundon atë. Prandaj, çdoherë sulmi ndaj armikut

duhet bërë me armë që është e panjohur për të, ose mënyra e sundimit të asaj arme po ashtu të jetë e panjohur.

Shpezët Allahu (xh. sh.) i cilëson me cilësinë e babil. Fjala e babil (أَبَابِيلَ) e sqaron mënyrën e ardhjes së shpezëve; se ato nuk kanë ardhur të gjitha menjëherë, por tufë-tufë, varësisht nga misioni dhe caku që u kishte përcaktuar Allahu (xh. sh.).

Kjo fjalë nuk flet vetëm për ndarjen e shpezëve në tufë, por kjo nënkupton edhe ndarjen e betejës në disa faza të zhvillimit të saj. Pikërisht siç zhvillohen luftërat më të sofistikuarat sot - njëherë dërgohen një tufë avionësh për të kryer një fazë të sulmit, pastaj të tjerët për një fazë tjetër etj.

Kështu, pra, Ebrehaja kishte dërguar gjithë arsenalin, prandaj dështoi, ndërsa Allahu i dërgoi shpezët tufë-tufë për të na mësuar se një luftë e suksesshme mund të fitohet vetëm nëse ndahet në disa faza të zhvillimit të saj dhe nëse mirëmenaxhohet arsenalin që është në dispozicion.

### Folja تَرْمِيمُ (i gjuajnë ata)

Në ajetin paraprak u përshkrua dërgimi i shpezëve, por me folje të kohës së kaluar (أَرْسَلْنَا) “dërgoi”, ndërsa në ajetin pasues, ku flitet për gjuajtjen e këtyre shpezëve, folja është dhënë në kohën e tashme تَرْمِيمُ “i gjuajnë ata”... Përse?

Sigurisht, të vërtetën absolute e di vetë Allahu, por gjuajtja nga qielli nëpër luftëra nuk është një veprim që u bë vetëm nga shpezët në Luftën e Elefantit, por ajo ka vazhduar edhe sot e kësaj dite. Pra, dhënia e foljes تَرْمِي “gjuajnë” në kohën e tashme, ku dihet se koha e tashme e mbulon edhe të ardhmen, është një mrekulli në vete, sepse në kohën e

zbritjes së kësaj sureje dhënia e foljes në kohën e tashme ishte pak e habitshme, por në kohën tonë e kuptojmë se ajo ka qenë një mrekulli dhe një paralajmërim se gjuajtja nga qielli do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

### Gjethi i përtypur (كَعَصْفٍ مَّاكُولٍ)

Siç theksuam në fillim të sures Fil, këto tri sure (Asr, Humezeh dhe Fil) flasin për problemin e humbjes.

Surja Asr fillimisht tregon se gjithë njerëzimi është në humbje, përveç njerëzve që besojnë, që bëjnë punë të dobishme, që e porosisin njëri-tjetrin që t'i përmbahen të vërtetës dhe porosisin njëri-tjetrin që të jenë të durueshëm.<sup>43</sup> Njerëzit që nuk u përmbahen këtyre katër boshteve, do të fillojnë të tallen dhe të përqeshin njerëzit tjerë dhe do të bëhen materialistë, të cilët vetëm tubojnë dhe numërojnë pasurinë, të cilëve Zoti u premtonte dënim të ashpër në Botën Tjetër.<sup>44</sup> Por, për ata që nuk e besojnë Botën Tjetër, ose që nuk janë të bindur rreth saj, ka sjellë edhe shembull të kësaj bote. Ata njerëz do t'i gjejë si pronarët e elefantit, të cilët ishin të pasur dhe të hipur mbi kafshët (armët) më të sofistikuara të kohës, por në fund përfunduan si kashta e përtypur dhe e shkelur.

<sup>43</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 102.

<sup>44</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Fili*, <https://www.youtube.com/watch?v=fVXyCUXIVTY>.

## SURJA KUREJSH – سُورَةُ قُرَيْشٍ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿لَا يَلْفُفُ قُرَيْشٌ ۝١ إِذْ لَفَّهِمْ رِحْلَةَ الِشْتَاءِ وَالصَّيْفِ ۝٢ فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ ۝٣ الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ ۝٤﴾

“(1) Për të drejtën që Kurejshët gëzojnë, (2) të drejtën e tyre dimrit e verës kur udhëtojnë, (3) Zotin e kësaj Shtëpie le të adhurojnë! (4) Që i ushqen në uri dhe në frikë i siguron.”

Boshti i sures Fil është ngjarja e elefantit, kurse boshti i sures Kurejsh është ushqyerja dhe sigurimi. Nëse i analizojmë këto dy boshte, atëherë kuptojmë se ato kanë një lidhje mjaft të fuqishme me njëri-tjetrin. Nëse Allahu nuk do t'i shkaktonte disfatë Ebrehasë, atëherë Kurejshëve do t'u merreshin këto mirësi që janë përshkruar në suren Kurejsh, sepse do t'ua merrte Qabenë, e cila ishte burim risku për ata dhe do t'i robëronte, pra nuk do të ishin të siguruar nga frika, prandaj Allahu (xh. sh.) u kërkon që të mos i neglizhojnë dhe të mos e minimizojnë vlerën e këtyre, por ta adhurojnë Allahun, sepse në të kundërtën, uria dhe frika do të ishin evidente në mesin e tyre.

Allahu (xh. sh.) suren Fil e përfundon me fjalën ﴿فَجَعَلَهُمْ﴾ “e i bëri ata si gjethi i gërryer”; pastaj suren Kurejsh e filloi ﴿لَا يَلْفُ قُرَيْشٌ﴾ “Për pajtimin (marrëveshjen apo

bashkimin) e Kurejshëve.”<sup>45</sup> Pra, nëse parashtrohet pyetja: përse Zoti e bëri si gjethi i gërryer ushtrinë e Ebrehasë, atëherë përgjigja vjen menjëherë në suren Kurejsh: për hir të bashkimit të Kurejshëve.<sup>46</sup>

### Adaptimi me dhuntinë

Kjo sure mekase flet për një dobësi shumë të rrezikshme që e godet njerëzimin në përgjithësi, por me theks të veçantë njerëzit e luhatshëm dhe të pavëmendshëm. Ky virtyt i ligë është adaptimi apo të mësuarit që dikush të jetojë me një begati pa ia ditur vlerën asaj, sepse një ndër kuptimet e fjalës **إِيْلَافٌ** është ky, pra adaptimi me begatinë pa e njohur rëndësinë e saj. Prandaj, ndodh që njeriu mësohet të jetojë me një dhunti të Zotit (xh. sh.) pa e ndjerë mirësinë dhe madhësitinë e asaj dhuntie, pastaj si rezultat nuk ia jep edhe hakun asaj, pra nuk e falënderon Allahun (xh. sh.) siç duhet për të.

Allahu (xh. sh.) ua mundësoi Kurejshëve këto dy udhëtime tregtare - i ushqe u dhe u dha siguri, por ata përsëri nuk e adhuruan Zotin (xh. sh.), sepse adaptimi i injorantit me një të mirë bën që ai të mos e ndjejë rëndësinë e asaj mirësie dhe, si rezultat, ai më nuk do të jetë as falënderues ndaj saj.

Për ta dalluar më mirë se kush janë mosmirënjohësit, shiko nëse këta njerëz i kanë cilësitë e njerëzve të përshkruar në suren vijuese, Maun.

---

<sup>45</sup> Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 103.

<sup>46</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti Kurejsh*, <https://www.youtube.com/watch?v=6SyzJAYmBNQ>.

Imam Fahrudin Raziu thotë: begatitë janë dy llojesh – njëra është largim i dëmit dhe të keqes, gjë e cila ndodhi në suren paraprake (Fil), dhe e dyta është sjellja e mirësive, e cila është përshkruar në këtë sure. Pra, pasi Zoti (xh. sh.) ua largoi të keqen dhe u solli këto mirësi, atëherë u kërkoi që *ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie.*

### **Bashkimi sjell fitore**

Kurani është libër që ka zbritur për të qenë evident me mësimet e tij deri në ditën e fundit të kësaj bote. Ai nuk është libër që sjell ngjarje historike të thata, pa porosi ose, thjesht, vetëm ta pasurojë kulturën e besimtarit. Përkundrazi, Kurani brenda ngjarjeve të ndryshme historike ka ndërthurrur porosi dhe mësimet të pakufishme.

Ne e dimë se mekasit ishin popull që kishin ngatërresa naive mes vete, rrallëherë, për të mos thënë asnjëherë, i gjeje të bashkuar. Por, ngjarja e elefantit ishte ajo që i bëri të bashkohen si një trup i vetëm me të gjitha fiset tjera mekase. Allahu (xh. sh.), pasi e ka bërë ligj që bashkimi sjell fitore, mekasve ua solli fitoren, edhe pse ata nuk kishin mundësi ta përballojnë armikun.

Kjo u jep një mësim shumë të fuqishëm myslimanëve të sotëm dhe e bën këtë sure shumë aktuale. Pa marrë parasysh përgatitjen e armikut, mjafton që myslimanët të jenë të bashkuar dhe Zoti do t'i mposhtë të gjithë armiqtë dhe kundërshtarët.

Parashtrohet një pyetje: përse Zoti i ka veçuar Kurejshët dhe jo të gjitha fiset mekase?

Pikërisht për një arsye të fuqishme: sepse Kurejshët ishin fisi që udhëhiqnin me Mekën, pra, sikur Allahu (xh. sh.)

dëshiron të na thotë se populli asnjëherë nuk mund të bëhet bashkë, por mjafton bashkimi i udhëheqësve dhe çdo gjë është e kryer. Pra, bashkoni udhëheqësit dhe - korrni fitore.

Kurejshët njëkohësisht ishin fisi me autoritet më të madh në mesin e arabëve dhe ata vështirë se do ta pranonin udhëheqjen e një individi që do të vinte nga një fis tjetër. Pra zgjedhja e një individi nga fisi Kurejsh është edhe pragmatizëm shoqëror i kontaktit hyjnor me hapësirën.

### Fillimi dhe fundi i sures

Nëse analizohet fillimi i sures Kurejsh, konkretisht ajeti i parë لَيْلَافِ قُرَيْشٍ “për bashkimin e Kurejshëve”, ku një kuptim i fjalës لَيْلَافِ është bashkim apo grumbullim,<sup>47</sup> dhe fundi i saj اَلَّذِي اَطْعَمْتُمْ مِنْ جُوعٍ وَاَمَّاتُمْ مِنْ خَوْفٍ në frikë”, atëherë shihet një lidhshmëri e fortë mes tyre, sikur Zoti (xh. sh.) i ka kushtëzuar dy begatitë e fundit – largimin e urisë dhe përfitimin e sigurisë, me bashkim paraparak. Pra, nëse një popull do të arrijë që të krijojë një lloj bashkimi, atëherë uria dhe frika nuk gjejnë vend në atë mes. Por, ka një problem në kuptimin e kësaj që u tha deri tani, sepse me bashkim nuk nënkuptohen vetëm forcat ushtarake, por nënkuptohet një lloj bashkimi shumëdimensional: ideologjik, mental, moral etj. Nëse një popull nuk është i bashkuar në idealet e veta, shpirtërisht dhe praktikisht, atëherë nuk ka si priten rezultatet e atij bashkimi inekzistent.

Një fuqi tjetër shprehëse ka vetë fillimi i kësaj sureje, me parafjalën. Parafjala لَا (për) ka shumë kuptime, disa tho-

---

<sup>47</sup> Shihabuddin el-Alusi, *Ruhu el-Meani – tefsiru el-Alusi*, vëllimi XXX, Dar el-Kutub el-Ilmijeh, f. 238.

në se është *L shkakore*, që lidhet me suren paraprake. Pra, bashkimi i Kurejshëve ishte shkak për shkatërrimin e asaj që ndodhi në suren Fil, prandaj disa i quajnë si një sure dhe i lidhin kështu: “I bëri si gjethi i shkelur, për shkak të bashkimit të Kurejshëve”. Disa thonë se L-ja është shkakore, por lidhet me vetë ajetet tjera të sures, d.m.th.: “Adhurojeni Zotin e kësaj shtëpie për shkak të bashkimit të Kurejshitëve dhe mundësisë që Zoti u dha të udhëtojë dimrit e verës.”

Një kuptim tjetër i parafjalës J është se ajo është L habitore. d.m.th.: “Është i çuditshëm (o Muhamed) bashkimi i Kurejshëve”.

Nëse L-ja është habitore, atëherë parashtrohet pyetja, përse duhet habitur?

Sigurisht, bashkimi i fiseve arabe me njëri-tjetrin ishte një çështje shumë e rrallë, madje pothuaj e pamundur, prandaj bashkimi i tyre kundër Ebrehasë është për t’u habitur.

Përse duhet habitur me një fakt historik? Kuptimi i këtij togfjalëshi habitur nuk përfshin vetëm dimensionin historik, por edhe atë aktual, sepse Allahu (xh. sh.) përmes kësaj habie na tregon se problemi i bashkimit të fiseve arabe nuk është vetëm problem i së kaluarës, por ai do të mbetet problem afatgjatë për arabët dhe për gjithë myslimanët.

### **Përse Kurejshët?**

Çdo mendje e ndritur vetvetiu do ta parashtronte këtë pyetje: përse Zoti (xh. sh.) i veçoi Kurejshët me dy begatitë e theksuara më parë - largimin e urisë dhe sigurimin nga frika?

Përgjigjja më e thjeshtë do të ishte se ata janë fisi i Muhamedit (a. s.), gjë e cila nuk mohohet, por në të njëjtën kohë

nuk mund të pranohet si arsyeja e vetme, sepse atëherë çdokënd do ta brente fakti se përse një fis, i cili ishte jobesimtar kohën kur zbriti kjo sure, t'i përfitojë të gjitha këto privilegje? Sigurisht, nepotizmi nuk ka pasur vend në drejtësinë hyjnore, drejtësi të cilën po instalonte dalëngadalë Muhamedi në Tokë, prandaj as arsyeja e fitimit të këtij privilegji nuk mund të jetë gjenealogjike.

Mësimi më i vyer që myslimanëve duhet t'u shkojë ndër mend kur e lexojnë emrin e fisit Kurejsh në këtë sure është që Zoti (xh. sh.) u ndihmoi dhe i begatoi Kurejshët kur ata u bashkuan. Zoti i ndihmon një fisi të konsoliduar mirë, edhe nëse ata janë jomyslimanë. Pra, pasi kjo sure flet për çështje jetësore të kësaj bote, atëherë punët nuk maten me kandarin e besimit, por me aftësinë për t'u bashkuar në shumë sfera të jetës.

Nëse ne jemi në të drejtë, atëherë duhet të përpiqemi që vlerat tona të bëhen vlera të përgjithshme dhe të bashkoemi në nivel shoqëror në ato vlera, pastaj do të vijë edhe ndihma dhe fitorja nga Zoti. Në të kundërtën, duhet të rishikohet koncepti i asaj që ne quajmë vlerë apo metodat e plasimit të atyre vlerave në nivel më larg se vetvetja.

Të mos harrojmë faktin se kjo sure zbriti në kohën kur pjesa dërrmuese e Kurejshëve e luftonin Muhamedin (a. s.); megjithatë, Zoti (xh. sh.) nuk ua humbi atë që ata e kishin përparësi, bile e përmend vlerën e bashkimit të tyre në betejën e elefantit.

Arabët, si popull, dallonin me atë se, përkundër thatësisë në ato vise, e siguronin bukën e gojës dhe jetonin në begati. Atëherë kur harxhohej një burim furnizimi, Allahu (xh. sh.) u hapte një mundësi tjetër, sepse kështu u lut profeti i Zotit, Ibrahim (a. s.), dhe lutja iu pranua.

Kur u mbyllën të gjitha dyert dhe u shterën burimet e furnizimit, atëherë Allahu (xh. sh.) u hapi mundësinë e tregtisë. Por, tregtia për arabët përbënte një punë jashtëzakonisht të vështirë, sepse duhej të kalonin me mijëra kilometra nëpër shkretëtirën e nxehtë dhe të rrezikshme. Megjithatë, Allahu Fuqiplotë edhe këtë ua lehtësoi dhe i adaptoi me këtë punë. Prandaj, një kuptim i fjalës إيلاف është *adaptim* dhe *mësim me diçka*. Pra: 'për atë që Zoti jua bëri të përshtatshme udhëtimin në verë dhe në dimër, ju adhurojeni Atë'.

Pra, Zoti (xh. sh.) në këtë sure ka bërë një lidhje të shkëlqyer të të drejtës së Zotit me të drejtën e njeriut, ngase Allahu (xh. sh.) çdoherë i jep përparësi të drejtës së njeriut, pra, atëherë kur Ai (Allahu xh. sh.) u dha mundësi jetese mekasve, atëherë u kërkoi edhe përgjegjësinë e adhurimit.

### **Aleancë ekonomike dhe tregtare**

Historia e popullit arab tregon se ata ishin fise beduine, në luftëra të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Shumë fise u shfarosën si pasojë e luftërave naive ndërfisnore. Pra, karakteristikë e fiseve arabe ishte përçarja dhe sundimi ndaj njëri-tjetrit.

Duke i marrë parasysh këto rrethana armiqësore dhe thatësinë e egër shkretinore, parashtrohet pyetja se si mbetën gjallë këta njerëz?

Krahas gjithë armiqësive dhe kacafytjeve, arabët kishin një moment që bashkoheshin dhe qëndronin pranë njëri-tjetrit - ai moment ishte udhëtimi për në Sham dhe për në Jemen, udhëtim ky tregtar që u siguronte kafshatën e gojës. Udhëtimi me muaj nëpër shkretëtirë përbënte një rrezik të madh për çdokënd që dëshironte të merrte atë rrugë, pran-

daj nevojitej bashkëpunim më i gjerë për ta përballuar këtë ‘përbindësh’.

Prandaj, Allahu (xh. sh.) dy herë e përsërit fjalën إِيَّاف “bashkim”. Herën e parë e thotë me konotacion të përgjithshëm për Kurejshët, kurse herën e dytë e specifikon për udhëtimin tregtar të tyre në dimër dhe në verë.

Gjithashtu, Allahu i Madhërishëm në këtë sure e ka theksuar këtë problematikë (bashkimin e fiseve arabe) për dy arsye: a) bashkëpunimi ndërfisnor tek arabët ishte diçka shumë e rrallë dhe b) bashkëpunimi mes myslimanëve do të jetë shumë i rëndësishëm për ardhmërinë e vetë myslimanëve. Zoti (xh. sh.) përmes kësaj sureje u vë një theks të veçantë aleancave ekonomike-tregtare, problem i cili është shumë i pranishëm në botën islame. Ashtu siç e mposhti Ebrehanë Zoti (xh. sh.) vetëm pse Kurjeshët i bashkuan forcat e tyre, njësoj edhe myslimanët do t’i mposhtin të gjithë Ebrehatë e sotëm nëse bashkohen, e veçanërisht nëse ata kanë bashkëpunime ekonomike-tregtare.<sup>48</sup>

Nëse i hedhim një sy problemit prej të cilit sot rënkon bota islame, do të konstatojmë se aleanca tregtare dhe ekonomike e myslimanëve me njëri-tjetrin do të ishte goditja më e fuqishme që mund t’u bëhet të tjerëve.

Kjo sure bëhet çdoherë dhe më aktuale kur dëgjon se si vendet e populluara me myslimanë janë të ndara në dhjetëra shtete, madje duke i vendosur embargo të rrepta njëri-tjetrit. Kjo është arsyeja përse sot surja Kurejsh duhet të reflektojë më fuqishëm në mesin tonë, sepse pikërisht moskuptimi i mesazhit të kësaj sureje bën që sot ‘Ebrehaja’ të hedh valle lirshëm në tokat e myslimanëve.

---

<sup>48</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti Kurejsh*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=6SyzJAYmBNQ>.

## Përse dimri para verës?

Tregtia u bë një burim i fuqishëm i furnizimit të arabëve, prandaj ata udhëtonin dimër e verë për të luftuar, prej më parë, urinë e skajshme që kaplonte viset arabe. Udhëtimi i dimrit bëhej në Jemen, kurse udhëtimi i verës bëhej në viset e Shamit (Sirisë). Parashtrohet pyetja: përse Allahu (xh. sh.) e ka vënë përpara udhëtimin e dimrit, kur dihet se udhëtimet më të shpeshta dhe më të njohura ishin në Sham?

Krahas shumë mirësive të tjera, udhëtimi i dimrit ishte më i nevojshëm për mekasit, sepse dimri është më i vështirë për njerëzit që ta sigurojnë ushqimin. Çdo i varfër në botë dimrin e ka një sfidë më vete, sepse vera është një lloj lehtësime për të. Po ashtu, vera është një stinë gjatë së cilës njeriu edhe mund të punojë, të mbjellë e të korrë diçka, kurse në dimër këto s'mund t'i bëjë. Pra, udhëtimi i dimrit ishte më domethënës për të mbijetuar.<sup>49</sup>

Vënia e dimrit në këtë ajet kuranor para verës jep një porosi tjetër, se çdoherë punët dhe krizat ekonomike duhet zgjidhur në bazë të efektit dhe përparësisë që kanë. Aty ku kriza është më e vështirë, duhet dhënë përparësi më shumë. Pra, çdoherë duhet që fillimisht të shqyrtohen 'dimrat' dhe pastaj 'verat'.

Një urtësi tjetër, përse Zoti e përmendi udhëtimin tregtar në përgjithësi, dhe udhëtimin e dimrit me përparësi pas ngjarjes së elefantit, është se vendin prej nga ishte Ebrehaja, që për ta ishte burim kërcënimi dhe frike, Allahu (xh. sh.) e bëri burim furnizimi dhe sigurie për mekasit.

---

<sup>49</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *vep. e citl.*, f. 107.

## Kërkesa për adhurim

Ajeti i tretë i sures Kurejsh fillon me pjesëzën ف، e cila bën lidhje të fortë mes asaj përpara dhe asaj pas. Në fillim Zoti (xh. sh.) u mundësoi që ata të bashkohen kundër armikut, e mposhti Ebrehanë me gjithë ushtrinë e tij madhështore, u mundësoi që të udhëtojnë në dimër e në verë për të fituar riskun etj. dhe pastaj, në fund, Allahu (xh. sh.) u kërkoi që menjëherë dhe domosdoshmërisht ta adhurojnë Zotin e Kësaj Shtëpie.

Surja Kurjesh zbret afërsisht gjysmë shekulli pas ngjarjes së elefantit. Nëse i hidhet një vështrim historisë së ngjarjes së elefantit, atëherë shohim se Abdulmuttalibi, gjyshi i Muhamedit (a. s.) që përfaqësonte mekasit, shkoi tek Ebrehaja dhe ia kërkoi devetë që i kishte rrëmbyer, ndërsa ai e pyeti: përse i kërkoni devetë dhe nuk e mbron Qabenë? Abdulmuttalibi i tha: “Pronar i deveve jam unë, kurse Qabeja ka një Zot që e mbron.”<sup>50</sup>

Kjo sinjalizon se ata besonin se Qabeja ka një Zot të vetin, prandaj Allahu (xh. sh.) në suren Kurjesh nuk u kërkoi të besojnë një zot që ata nuk e njihnin, por u kërkoi pikërisht Atë Zot që ata e kishin pranuar qysh me kohë.

Nëse do të ishte “le ta adhurojnë Allahun”, atëherë ata do ta refuzonin menjëherë, sepse emri Allah mbulonte konceptin fetar të Muhamedit (a. s.), kurse fjala “Zotin e kësaj shtëpie” ishte një fjalë më afër tyre, prandaj Allahu (xh. sh.) ua ofroi besimin përmes rrugës më të afërt që ata njihnin.

Po ashtu, togfjalëshi “Zotin e kësaj shtëpie” jep edhe një

---

<sup>50</sup> Ibn Kethiri, *El-Bidajetu ve en-nihajetu*, Vëllimi III, Daru Hixhr li Et-Tabaatu ve en-Neshri ve et-Teuzi'i ve el-I'lami, 1997, f. 145.

mësim tjetër të rëndësishëm, pasi surja flet për krizë ekonomike dhe sigurie, duke dhënë alternativa të ndryshme, si tregtia në dimër e në verë, Allahu (xh. sh.) u drejtohet me ajetin “le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie”, sepse ata e dinë se Zoti i kësaj shtëpie sjell zgjidhje të sigurt. Ashtu siç e mposhti ushtrinë e elefantit, ashtu e mposht edhe urinë dhe frikën tuaj, apo siç u nderuan me fitore nga Zoti i kësaj shtëpie, le ta adhurojnë pikërisht Zotin e kësaj shtëpie.<sup>51</sup>

Gjithashtu, pasi ky urdhër është në vetën e tretë, pra u drejtohet Kurejshëve të cilët në atë kohë ishin jobesimtarë, Allahu zgjodhi që të përmend një emër të Tij, emër që në vetvete ka mëshirë dhe butësi - pikërisht fjalën Rabbun.

### **Përse uria është dhënë para frikës?**

Një nga problemet me të cilët sot përballet bota në përgjithësi, dhe veçanërisht myslimanët, është pamundësia për t'i spikatur prioritetet.

Renditja e sureve, ajeteve dhe vetë fjalëve kuranore është dhe duhet të jetë një faktor shumë i rëndësishëm për mësimin e prioriteteve nga vetë myslimanët.

Një gjë e tillë është shumë aktuale te surja Kurejsh, sepse Allahu (xh. sh.) i ka dhënë prioritet urisë para frikës, ngase vetë konteksti i sures flet për probleme tregtie. Nëse dikush do të shtrojë dilemën se përse nuk është dhënë në fillim frika - sepse, përveç që ajetet paraprake flasin për çështje tregtare, vetë surja paraprake flet për çështje frike (problemi i ngjarjes së elefantit) - dhënia përparësi urisë ndaj

---

<sup>51</sup> Fadil bin Salih es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 102-103.

frikës tregon edhe një fakt tjetër të prapaskenës së luftës së Ebrehasë: qëllimi i luftimit të mekasve nuk ishte për t'i sunduar, por për t'ua rrëmbyer Qabenë dhe për t'i tërhequr haxhilerët në Jemen, kështu që, edhe pse lufta shkaktoi një lloj frike, Allahu (xh. sh.) e theksoi njëherë urinë, sepse qëllimi final i tyre ishte që t'ua rrëmbejnë burimin më të leverdishëm që kishin mekasit, përfitimin nga haxhilerët.

Nëse i referohemi ajetit 155 të sures Bekare: **“Ne ju propojmë me frikë, uri dhe mungesë pasurie, frymësh e prodhimesh. Dhe përgëzoji durimtarët!”**, shohim se i ka dhënë përparësi frikës para urisë, sepse ajetet paraprake flasin për probleme luftarake. Pastaj, në ajetin 112 të sures Nahl: **“Allahu sjell shembull një vendbanim në paqe e siguri; i vinte risku me bollëk nga çdo anë dhe mohoi të mirat e Allahut. Allahu e bëri, me ç’punoi, të vishte petkun e urisë e të frikës”**, përsëri fillimisht përmendet uria pastaj frika, sepse problemi në fjalë është kryesisht problem ekonomik.<sup>52</sup>

Këto variacione formulimesh fuqishëm nxisin mësimin e prioriteteve, prandaj edhe myslimanët nuk duhet që mësimet fetare t'i plasojnë në formë të ngurosur, që për të gjitha situatat të kenë një retorikë, një qëndrim, një fjalor apo një strategji, sepse ato duhet të ndryshojnë sipas nevojës së kohës, së vendit dhe të rrethanave, kuptohet, duke mos i prekur indet thelbësore të koncepteve hyjnore.

### Simboli i sigurisë

Kjo sure e shkurtër, krahas mësimeve të tjera, flet për funksionimin e shëndoshë të një shoqërie. Allahu (xh. sh.) i

---

<sup>52</sup> Shihabuddin el-Alusi, *Ruhu el-Meani – tefsiru el-Alusi*, vëllimi XXX, Dar el-Kutub el-Ilmijeh, f. 241.

ka bashkuar dhe i ka shpëtuar Kurejshët, gjë të cilën e thamë më parë, mirëpo përsëri vazhdon dhe flet për vazhdueshmërinë e këtij sukseesi që e arritën nga Ebrehaja.

Nëse surja analizohet mirë, atëherë dalin në pah dy shtyllat kryesore të funksionimit të mirëfilltë të çdo shoqërie apo shteti: siguria ekonomike dhe ajo politike. Nëse një shoqëri nuk gëzon siguri ekonomike dhe politike, atëherë degradimi i asaj shoqërie do të jetë shumë i afërt.

Dy ajetet e fundit janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin: **“Zotin e kësaj Shtëpie le të adhurojnë! (4) Që i ushqen në uri dhe në frikë i siguron”**. Adhurimi, pra, është i lidhur me sigurinë ekonomike dhe politike, prandaj nëse nuk kemi mirëqenie ekonomike dhe siguri veprimi, atëherë edhe adhurimi i Zotit të Kësaj Shtëpie do të jetë i cunguar.

Gjithashtu, fakti që pas këtij ajeti, **“Që i ushqen në uri dhe në frikë i siguron”** vjen surja Maun, tregon se pasiguria ekonomike dhe materiale do të sjellë shumë njerëz me cilësitë e sures Maun.<sup>53</sup>

### *I ushqeu dhe jo i ngopi*

Përpikëria kuranore reflekton në çdo njësie gjuhësore. Zoti (xh. sh.) ka përzgjedhur fjalët kuranore me maturinë absolute, prandaj në suren Kurejsh thuhet: “i Cili i ushqeu në uri”, dhe jo “i Cili i ngopi në uri”. Allahu (xh. sh.) njerëzit i ndihmon në formë më të përkryer. Ngopja dhe mbushja e barkut është një vepër e urryer sipas parimeve islame, prandaj edhe Zoti nuk ndihmon për ta dëmtuar robin. Gjitha-

---

<sup>53</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti Kurejsh*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=6SyZJAYmBNQ>.

shtu, kur kemi parasysh kërkesën paraprake për adhurim të Zotit, ngopja dhe mbushja e barkut do ta vështirësonte atë. Ibadeti më i denjë i robit është kur ai e ka flakur urinë, por pa e mbushur barkun.<sup>54</sup>

Kjo sure vizaton një strategji të mirë sundimi.

Surja Kurejsh, si çdo sure tjetër kuranore, është polise-mantike dhe shumëdimensionale.

Pasi shmangia e frikës dhe e urisë përbënte një faktor kyç në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë, po ashtu, këto dyja llogariten edhe mjeti kryesor për të sunduar një mjedis.

Sundimi kërkon një plan të studiuar mirë paraprakisht, i cili pastaj realizohet në këto dy dimensione të rëndësishme: mbjelljen e varfërisë në atë mjedis dhe ngjalljen e frikës.

Pra, në ajetin e dytë të sures Fil Allahu (xh. sh.) thotë: **“A nuk bëri që plani i tyre të dështojë?”**, kurse menjëherë në suren tjetër sqaron se si u realizua dështimi i kurthit të tyre, pra shmangu varfërinë dhe krijoi siguri në mesin e tyre.

Një gjë të tillë e sqarojnë edhe faktet historike të shoqërive të ndryshme. Çdoherë sundimet janë bërë përmes këtyre dy veprimeve: kanë ngjallur frikë dhe e kanë dobësuar ekonominë e një vendi. Pikërisht një gjë e tillë sot u ndodh edhe myslimanëve, sepse kundërshtarët kanë një plan të studiuar mirë, të cilin e realizojnë përmes propagandave të ndryshme mediatike, duke ngjallur frikë dhe duke kontrolluar ekonominë e shteteve të banuara me myslimanë.

---

<sup>54</sup> Fadil bin Salih es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 105.

## Parafjala مِنْ (nga/prej) dhe pashquarsia pas tyre

Përdorimi dhe përsëritja e parafjalës مِنْ (nga/prej) në ajetin e fundit kuranor të sures Kurejsh, i jep një nuancë kuptimore më të thukët sures: ﴿الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَءَامَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ﴾.

Para se ta sqarojmë këtë, do t'i përmend dy shembuj tjerë, pas së cilës do të kuptohet edhe përdorimi i kësaj parafjale në këtë ajet.

Allahu (xh. sh.) në ajetin 151 të sures El-En'am thotë kështu: ﴿وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِنْ إِمْلَاقٍ﴾ **“dhe mos i mbysni fëmijët tuaj nga varfëria”**; pastaj në ajetin 31 të sures El-Isra Zoti Fuqiplotë thotë: ﴿وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ حَسَبَةَ إِمْلَاقٍ﴾ **“dhe mos i mbysni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë”**. Ajeti i dytë tregon se varfëria nuk është e pranishme, por thjesht ekziston frika për varfëri në të ardhmen, kurse në ajetin e sures El-En'am, ku është përdorur parafjala مِنْ “nga/prej”, të jep të kuptosh se varfëria është e pranishme në atë mes.

Ky sqarim na tregon se edhe në ajetin e fundit të sures Kurejsh flitet për uri dhe frikë evidente dhe jo për diçka që është në pritje apo për diçka hipotetike.

Përveç parafjalës مِنْ, një fuqi shprehëse ka edhe pashquarsia e fjalëve që vijnë pas saj.

Për tipin e pashquarsisë së këtyre dy fjalëve gjuhëtarët kanë dhënë mendime të ndryshme, ndërsa këtu do të përmendet mendimi më i përfolur.

Pashquarsia e këtyre dy fjalëve tregon llojin e urisë dhe të frikës. Nëse i referohemi historiografisë arabe, do të shohim se arabët atë kohë i kishte kapluar një uri e skajshme, saqë njerëzit kishin filluar të hanin cofëtina dhe kocka të dj-

egura. Pra, ishte një uri e paparë. Po ashtu, frika që ata e përjetuan nga ushtria e Ebrehasë ishte ndryshe nga frika që kishin përjetuar më parë, sepse ata çdoherë ishin ballafaquar me hordhi të ndryshme arabësh, por kurrë me një ushtri aq serioze dhe aq të madhe, saqë u erdhën brenda në Mekë, ku dukej se çdo gjë do të bëhej hi. Pra, pashquarsia e këtyre dy emrave tregon se kjo uri dhe kjo frikë ishin të panjohura për ju më parë.<sup>55</sup>

Fjala *uri* mund të merret si simbolikë e injorancës, kurse fjala *frikë* si simbolikë e devijimit. Pra, në urinë e injorancës - i ushqeu me ushqimin e vahjit, e në trishtimin e devijimit - i siguroi me udhëzim.

---

<sup>55</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 110.

## SURJA EL-MAUN - سُورَةُ الْمَاعُونِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالذِّينِ ﴿١﴾ فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ ﴿٢﴾ وَلَا يُحِضُّ عَلَىٰ طَعَامِ الْمِسْكِينِ ﴿٣﴾ فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ ﴿٤﴾ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ ﴿٥﴾ الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ ﴿٦﴾ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ ﴿٧﴾﴾

“(1) E shëh kë mohon Ditën e mbrame? (2) Është ai që përçxë jetimin (3) dhe nuk nxit për të ushqyer të varfrin. (4) Mjerë ata që falen, (5) që janë të pavëmendshëm kur falen, (6) ata që shtiren (7) dhe pengojnë të mirën!”

Në këto dy sure Allahu (xh. sh.) e thekson të ushqyerit. Në suren Kurejsh Allahu (xh. sh.) thotë: *“الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ”* “Ai i Cili i ushqeu ata në uri”, d.m.th. Allahu i Madhërishtëm është Ai i Cili e nxjerr njeriun nga uria apo nga zia e bukës. Kurse në suren Maun thotë: *“وَلَا يُحِضُّ عَلَىٰ طَعَامِ الْمِسْكِينِ”* “dhe (njeriu) nuk nxit për të ushqyer të varfrin.”, d.m.th. këtu vëmendja është fokusuar në nxitjen e njeriut për të ushqyer të tjerët. Këto dy ajete kanë një lidhshmëri të shkëlqyer. Në lidhshmërinë mes këtyre dy ajeteve kuptohet një fakt dhe një porosi. Fakti është se njeriu është qenie shumë harrestare, ngase Allahu (xh. sh.) në suren paraprake (Kurejsh) i tregon se ‘Unë jam Ushqyesi’, e ky njeri i ngratë, jo shumë larg, menjëherë në suren vijuese (Maun), tregon se i dhimbset nxitja në të ushqyer dhe jo më të ushqejë. Porosia, ndërkaq, është kjo: o

njeri, nëse ti nuk ke mundësi të ushqesh dikë, apo të dhimbset pasuria, atëherë të paktën nxiti të tjerët që të ushqehet i varfri dhe mos harro faktin se Vetë Zoti pak më parë (në suren Kurejsh) ta shmangu urinë.

Në të vërtetë, këtu shpaloset edhe rruga e shmangies së urisë, pra, vetë nxitja për të ushqyer të varfrit është rruga e parë për ta evituar varfërinë.

### Nga hyjnorja te njerëzorja

Nëse i hedhim një vështrim ajetit të fundit të sures Kurejsh, do të shohim se janë potencuar dy dhunti të Zotit (xh. sh.): largimi i njerëzve nga varfëria e skajshme dhe ofrimi i sigurisë kundrejt frikës. Pastaj, të njëjtat veprime janë theksuar në suren Maun, por tani kërkohet prej njeriut që të mos e shpërfill jetimin, por t'i ofrojë siguri atij dhe të nxisë që të ushqehet i varfri. Pra, mes këtyre dy dhuntive të Zotit dhe dy obligimeve të njerëzve që kanë mes njëri-tjetrit, Allahu (xh. sh.) e ka vënë këtë ajet: *أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْإِيمَانِ* "E sheh atë që e mohon Dinin!". D.m.th. kalimi, reflektimi dhe mishërimi i dhuntisë hyjnore në botën humane (njerëzore) bëhet vetëm nëse kalohet kah Dini, kurse ai që ka shijuar dhuntitë hyjnore dhe e përgënjeshton Dinin, nuk lejon që ato dhunti të reflektojnë në jetën e përditshme të njeriut. Pra, esenca e Dinit është të marrë nga bota hyjnore dhe të reflektojë në botën njerëzore. Nëse besimtari nuk arrin që frymëzimin hyjnor ta përkthejë në jetën e përditshme dhe kjo të rezultojë me efekt social, atëherë duhet ta rishikojë lidhjen e quajtur Din.

### Lidhshmëria e fillimit dhe e fundit të sures

Allahu (xh. sh.) në ajetin e parë thotë: **أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالدِّينِ** “*E sheh atë që e mohon Dinin!*”, pavarësisht nëse me Din kuptohet feja islame apo Bota Tjetër; e sigurt është që bëhet fjalë për diçka madhështore, sepse të dyja janë thelb i misionit hyjnor në Tokë. Kurse fundi i kësaj sureje me këtë ajet shkon kështu: **وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ** “*dhe pengojnë të mirën (më të vogël)*”. Maun d.m.th. një e mirë shtëpiake që ka vlerë aq të vogël, saqë çdokush mund ta dhurojë pa problem. Pra, surja fillon me një habi hyjnore për atë që përgënjeshtrojnë Dinin dhe përfundon me diçka materiale, që është pothuaj e pavlerë. Kjo na mëson se për të qenë mysliman dhe besimtar i këtij dini, apo për të fituar Botën Tjetër, nuk mjafton të merresh vetëm me punë të mëdha, por duhet kushtuar rëndësi edhe punëve të vogla, sepse ato ndonjëherë mund të kenë efekt shumë më tepër se punët e mëdha. Atëherë kur Muhamedi (a. s.) ia ktheu shpinën të verbrit, për t’u takuar me njerëzit më me peshë, atëherë edhe Allahu (xh. sh.) e qortoi dhe e mësoi se në fe duhet kushtuar rëndësi edhe gjërave të vogla edhe të mëdha.<sup>56</sup>

Përveç lidhshmërisë së fillimit me fundin e kësaj sureje, disa mësimë dalin edhe nga vetë emrat e saj.

Kjo sure ka shumë emra, si: **أَرَأَيْتَ، الْيَتِيمِ، سُورَةُ الدِّينِ، الْمَاعُونَ** etj. Të gjithë emrat shpalosin nga një kuptim të sures. Megjithatë, ne do të ndalemi tek emri **الْمَاعُونَ**. Kjo fjalë rrjedh nga rrënja **عَوَّنَ** e cila do të thotë *të ndihmohet*. Disa dijetarë thonë

<sup>56</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 109-111.

se kjo fjalë përfshin gjërat tepër të vogla, të cilat njeriut mund t'i hyjnë në punë shumë pak. Sidoqoftë, nëse e ka kuptimin e parë, atëherë Zoti (xh. sh.) tregon se kjo sure është surja e cila ndihmon strukturën më të papërkrahur të njerëzve, prandaj Zoti (xh. sh.) ka zgjedhur që kjo të quhet *ndihmë*, pra, ai që e ka shpërfillur jetimin dhe nuk ka nxitur të ushqehet meskimi, nuk meriton të quhet ndihmës.<sup>57</sup> Gjithashtu, nëse e ka kuptimin e dytë (gjëra me shumë pak vlerë), tregon se shumë gjëra të mëdha, si Dini, varen prej gjërave të vogla.

### Skaji i së keqes

Nëse i analizojmë ajetet e kësaj sureje, atëherë do të kuptojmë se Zoti (xh. sh.) flet për një njeri të cilin fund e krye e ka mbuluar e keqja. Pra, këtu nuk flet për atë që nuk kujdeset për jetimin, por për atë që e shpërfill (atë). Nuk flet për atë që nuk e ushqen meskinin, por për atë që edhe kur dikush do që ta ndihmojë, ai nuk e nxit (ndihmën e tij). Nuk flet për atë që nuk fal namaz, por për atë që është shumë jo-serioz me namazin. Nuk flet për atë që nuk është modest, por për atë që ka shumë syfaqësi. Nuk flet për atë që nuk jep gjënë më të vogël, por për atë që i ndal edhe të tjerët të mos japin. Pra, nëse i shohim këto, atëherë do të vijmë në përfundim se këtu bëhet fjalë për njerëzit të cilët nga mllefi shpirtëror reflektojnë të keqen. Sado që mund të falë namaz, namazi për të është mjerim, sepse ballafaqimi i tij me jetimin dhe me meskinin e tregon natyrën e tij të vërtetë.

---

<sup>57</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Maune*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=AApTrBkCApY>.

## Fjalja pyetëse dhe folja رَأَى

Kjo sure fillon me një fjali habitore. Habi, e cila është shprehur përmes fjalisë pyetëse. Pra, kjo sure na tregon se, sado që habia nuk është veti hyjnore - sepse Allahu (xh. sh.) i di gjërat prej në ezel (eternitet) - përsëri, për të na treguar ligësinë shpirtërore të njerëzve që theksohen në këtë sure, është shprehur në mënyrën habitore. Shkurt thënë, me këta njerëz është habitur edhe Zoti (xh. sh.).

Përdorimi i foljes رَأَى në Kuran gëzon një shtrirje të madhe, prandaj ka shumë situata që duhet të analizohen, mirëpo këtu do të ndalemi vetëm tek ajeti i parë i sures Maun.

Parashtrohet pyetja: përse në këtë sure është thënë أَرَأَيْتَ "A e ke parë..." dhe jo "A e ke ditur..." (përmes foljes أَعْلِمْتَ)? Pasi në këtë sure flitet për një grup të caktuar njerëzish, me cilësitë e numëruara në ajetet e radhës, atëherë sigurisht që më e udhës (në sytë tanë) do të ishte që të përdoret folja أَعْلِمْتَ "A e ke ditur...", sepse përmes kësaj folje bëhet mësimi i informacioneve të reja dhe mësohet ajo që nuk dihet. Por, nëse u hedhim një vështrim mësimëve islame dhe veçanërisht atyre kuranore, do të shohim se qëllimi i tyre nuk është që vetëm t'i mbushë njerëzit me informacione dhe aty të përfundojë gjithçka. Assesi, qëllimi final i mësimëve kuranore është që njerëzit t'i udhëzojë në rrugë të drejtë dhe t'i edukojë që të jenë zbatues të atyre informacioneve që ua jep vetë feja.

Procesi edukativo-arsimor është një proces i ndërlikuar, të cilin shumë njerëz e keqkuptojnë apo e ngatërrojnë me përfitimin e informacionit. Edukimi është një fazë shumë më e avancuar sesa vetëm marrja e disa informacioneve apo

dituria. Sigurisht, faza e parë e edukimit mund të fillojë përmes përvetësimit të disa informacioneve, por pastaj duhet që patjetër nxënësi t'i provojë ato informacione, duke i parë me sytë e ballit, apo përmes ndonjë mënyre sikur t'i kishte parë me sytë e ballit. Kështu që, procesi edukativo-arsimor sot është i ndërtuar mbi një parim shumë të rëndësishëm – mbi parimin e interaktivitetit, ku edhe nxënësi bëhet pjesë e mësimin, ose, thjesht, nxënësi nuk mbetet vetëm një objekt të cilit i plasohen disa informacione të caktuara. Folja رَأَى përvetë diturisë apo marrjes së informacionit, në brendinë e vet përmban edhe kuptimin e shikimit apo provimit të atij informacioni. Pra, Kurani nuk bën edukim të thatë, ku vetëm t'u plasojë disa informacione besimtarëve, por ai kërkon që ato informacione t'i analizojnë mirë, t'i provojnë dhe në fund t'i shohin me sy, apo sikur t'i kenë parë me sy. Gjithashtu, interaktivitetin e mësimin kuranor e tregon edhe veta e dyta, ku Allahu (xh. sh.) në shumë ajete kuranore flet në vetën e dytë, bile në njëjës (ti), që do të thotë se me secilin flet ndaras.

Krahas dallimit nga folja علم, kjo folje po ashtu është dhënë në vetën e dytë.

Vetitë e numëruara në këtë sure nuk janë të njerëzve imagjinativë apo të njerëzve që i kanë takuar një periudhe të caktuar historike, assesi: 'hapi sytë, se ata i ke në mesin tënd'. Prandaj, veta e dytë na mëson se njerëzit e tillë janë të pranishëm në çdo shoqëri, kështu që neve na takon të bëjmë që këta njerëz të këshillohen.

Pse pikërisht është nisur me foljen رَأَى, e cila do të thotë të shohësh apo të mendosh? Sepse, njeriu në jetë ka njërën prej dy alternativave: ose ta shikojë a ta kuptojë të keqen,

ose të mos e shikojë dhe të jetë vetë pjesë e saj. Prandaj, Allahu (xh. sh.) e ka parashtruar në formë pyetëse, ashtu që ne të vetëdijesohemi dhe ta kuptojmë atë.

Forma pyetëse, e cila tregon interaktivitet, është njëra nga format më të avancuara të edukimit bashkëkohor. Aq sa do të bashkëbisedojë mësuesi me nxënësin, po aq do të ketë sukses edhe vetë nxënësi. Pra, Allahu (xh. sh.) mësimet e kësaj sureje nuk i ka mbarështuar në formë të thatë, vetë t'i numërojë, por i ka thurur në formë bashkëbisede me vetën tënde, që ti t'i mësosh më mirë, t'i marrësh si shumë serioze, sepse të është drejtuar drejtpërdrejt; dhe, t'i realizosh ato. Serioziteti i nxënësit nuk është njësoj ndaj një mësimi të cilin mësuesi ia ka dhënë gjithë klasës dhe ndaj një mësimi të cilin ia ka dhënë ekskluzivisht vetëm atij.

Përdorimi i kësaj foljeje e paraqet edhe theksin që Allahu (xh. sh.) i ka vënë strategjisë së verifikimit të ngjarjeve sociale. Pra, nuk kërkohet vetëm njohja teorike e çështjeve të përmendura, por edhe analiza shoqërore e paraqitjes dhe e pranisë së tyre në shoqërinë arabe, apo dhe të tjera.

### Përgënjeshttrim i vazhdueshëm

Fillimisht, praninë e këtyre sëmundjeve shpirtërore dhe të këtyre njerëzve në mesin tonë e tregojnë vetë foljet e kësaj sureje, sepse të gjitha, përveç të parës, janë dhënë në formën e kohës së tashme, e ne e dimë se forma e kohës së tashme në gjuhën arabe e mbulon të tashmen dhe të ardhmen.

Por, kur jemi te folja **يُكَدِّبُ**, nëse i bëjmë një analizë kësaj paradigme<sup>58</sup>, ajo zakonisht tregon një veprim i cili nuk kry-

<sup>58</sup> Paradigma foljore **فَعَّلَ / يُفَعِّلُ**.

het vetëm një herë, por flet për një veprim që realizohet më gjatë. Pra, përgënjeshtrimi i këtyre njerëzve ndaj fesë apo botës tjetër nuk është se u bë vetëm një herë, por ata disa herë bënë punë e cila e përgënjeshton Dinin. Pra, kuptimi i ajetit të parë nuk është: “A i patë ata që e përgënjeshtroan Dinin vetëm me një fjalë goje?!”, por është: “A i patë ata që e përgënjeshtrojnë Dinin me punë të vazhdueshme?!”

### Ushqimi është specifikë

Meskini është nevojtar për shumë gjëra - për veshje, për vendbanim, për ushqim etj., por Allahu (xh. sh.) e ka veçuar ushqimin, sepse ushqimi është nevoja themelore që nuk kr-ahasohet me asgjë. Haja dhe pija janë faktorë për jetë ose vdekje, prandaj Allahu (xh. sh.) ka kërkuar që të nxitet të ushqyerit e të varfrit, në mënyrë që edhe ai ta ketë të drejt-ën e jetës. Mosnxitja për ta ushqyer të varfrin, kur ai ka nevojë për bukën e gojës, në një mënyrë tregon se ti pajtohesh që ai të shkojë drejt shkatërrimit.

Allahu (xh. sh.) jo rastësisht e ka zgjedhur nxitjen, sepse ndoshta dikush mund të mos ketë mundësi që të ushqejë dikë, por çdokush ka mundësi që të nxisë dikë.

### Trajtime rreth fjalës الدَّيْنِ

Një nga kuptimet e fjalës دَيْنٌ është shpërblimi (apo ndëshkimi); qoftë për të mirë, apo për të keq.

Nëse e shohim kuptimin e vetë sures, ajo flet për koprraci të skajshme, ngase ai që e shpërfill jetimin, që nuk nxit të ushqehet meskini dhe të cilit i dhimbset edhe gjëja më e vogël për ta dhënë, atëherë tregon se ai është njeri koprrac dhe shumë materialist, prandaj edhe Allahu (xh. sh.) tregon

se ky njeri e përgënjeshton Ditën e Shpërblimit. Pra, sikur Allahu (xh. sh.) i thotë atij: ‘ti që përpiqesh të kursesh në këtë botë, duke u treguar dorështrënguar ndaj jetimit dhe të varfërve, që t’i fitosh të mirat e kësaj bote, pikërisht ti je ai që e ke humbur shpërblimin më të madh, atë të Botës Tjetër’.

Dallimi i fjalës din دین në suren Maun nga surja Mutaffifin.

Në suren Maun thuhet أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالدِّينِ “A i pe ata që përgënjeshtrojnë me Dinin?!”, kurse në suren Mutaffifin thuhet الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِوَمَدِّ الدِّينِ “ata që përgënjeshtrojnë Ditën e Dinit (Shpërblimit)”. Në njërën përmendet vetëm fjala *Din*, kurse në suren tjetër është *jeumi ed-dini* (Dita e Shpërblimit). Përse ky dallim?<sup>59</sup>

Në suren Mutaffifin flitet drejtpërdrejt për jobesimtarët, prandaj është konkretizuar edhe يَوْمَ الدِّينِ *Dita e Shpërblimit*, sepse ata nuk e besojnë atë, kurse në suren Maun flitet për njerëz që falin namaz, që thirren besimtarë dhe që thirren se e besojnë edhe Ditën e Gjykimit, kurse Allahu (xh. sh.) e demaskon besimin e devijuar të tyre, ngase ata, edhe pse nuk e mohojnë drejtpërdrejt Ditën e Shpërblimit, ata nuk janë të bindur se një ditë njerëzit do të shpërblehen dhe do të dënohen. Pikërisht për këtë arsye Allahu (xh. sh.) e ka përmendur vetëm fjalën *Din* (Shpërblim).<sup>60</sup>

Nëse në suren Maun do të ishte dhënë fjala يَوْمَ (Ditë),

<sup>59</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 113.

<sup>60</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Maune*, <https://www.youtube.com/watch?v=AApTrBkCApY>.

pra **يَوْمَ الدِّينِ** (Ditën e Shpërblimit), atëherë këta njerëz do të thoshin: ‘si ka mundësi ne ta mohojmë atë Ditë, kur ne jemi njerëz që falim namaz?’. Kurse Allahu (xh. sh.) u thotë: ‘edhe nëse ju nuk e mohoni drejtpërdrejt me emër atë ditë, Unë ju them se ju e keni mohuar me veprimet tuaja atë’.

Përmes kësaj fjale kumtohet se:

1. Ata nuk e mohojnë drejtpërdrejt Ditën e Gjykimit;
2. Ata e mohojnë shpërblimin dhe dënimin, gjë e cila tregon se e kanë mohuar edhe vetë Ditën, dhe
3. Ata që e përgënjeshtroan Dinin, me kuptimin e Ditës së Shpërblimit, e kanë përgënjeshtroar edhe Dinin me kuptimin e fesë.

Fjala Din ka edhe dimensionë të tjera kuptimore. Një prej tyre është edhe kuptimi social.

Disa i bëjnë një analizë sociologjike këtij ajeti, pikërisht fjalës Din, ku thonë se jo rastësisht Allahu (xh. sh.) e ka zgjedhur këtë fjalë, në mënyrë që përmes saj të përfshijë dy dimensionë - atë të përgjithshmin dhe atë të veçantin. E përgjithshmja e fjalës Din është feja, kurse e veçanta është Shpërblimi i Botës Tjetër. Kjo ndërthurje na jep edhe një mësim tjetër të rëndësishëm në këtë botë, sepse nëse në një shoqëri humbet Dini (shpërblimi dhe dënimi), atëherë është humbur krejt sistemi funksional i asaj shoqërie; njësoj sikurse ai që e mohon Dinin (shpërblimin e botës tjetër), e ka humbur krejt sistemin e quajtur fe. Pra, aty ku nuk funksionon mirëfilli dhe me vend shpërblimi dhe dënimi, aty nuk ekziston as suksesi dhe shoqëria e shëndoshë.

### **Përse shpërfillja e jetimit?**

Ajeti i dytë i kësaj sureje flet për shpërfilljen e jetimit,

kurse i treti flet për nxitjen për ta ushqyer të varfrin. Parashtrohet një pyetje: përse Zoti (xh. sh.) nuk e ka theksuar ushqimin e jetimit, por shpërfilljen ndaj tij?

Jetim është ai fëmijë të cilit i mungon prindi, ndërsa prindi për fëmijën mbi të gjitha është mbështetje dhe mburojë. Pra, nevoja e parë për jetimin është mbështetja dhe përkujdesja, kurse vepra më e shëmtuar ndaj jetimit është shpërfillja. Pra, Allahu (xh. sh.) e ka specifikuar jetimin me shpërfilljen, sepse ai ka nevojë për përkujdesje dhe mbështetje edhe nëse është i pasur.

Nëse jetimi ka nevojë edhe për ushqim, atëherë mjafton të mos shpërfilllet, sepse ka shumë njerëz që duan t'i ndihmojnë të varfrit, pra bën pjesë në grupin e meskinëve.

Ajeti i tretë i sures Maun flet për një problem shumë të theksuar në historinë e njerëzimit, veçanërisht në kohët moderne-mosnxitja e njerëzve për t'i ndihmuar të varfrit.

Nga ky ajet kuranor kuptohen dy dimensione shumë të rëndësishme: i pari është se në shoqërinë njerëzore është i pranishëm humanizmi, por atij i mungon organizimi, dhe i dyti është se problemi i pranisë së urisë në botë është vetëm si shkak i mosnxitjes për ta bërë këtë, ose nëse do ta përkthenim në gjuhën bashkëkohore, ajo është propaganda kundër shteteve të varfra, p.sh. sot në botë shumë pak flasin mediat për katastrofat humanitare që përjetojnë shtetet e Afrikës, bile nëse dikush dëshiron t'i ndihmojë ato, e konsiderojnë si problem politik dhe ndërhyrje në punët e një shteti tjetër, në mënyrë që dikush t'ua kushtëzojë bukën e gojës. Pra, mjafton që dikush mos të pengojë apo vetëm të nxisë (fjalë) për të, humaniteti njerëzor do të jetë i pranishëm.

Prandaj, nga ky ajet mund t'i nxjerrim disa kuptime:

Allahu (xh. sh.), kur flet për ata që e përgënjeshtrojnë Dinin, e përshkruan situatën e njerëzve të cilët vetëm heshtin dhe nuk flasin për ushqyerjen e të tjerëve. Nëse këta paskan përgënjeshtrojnë për një punë kaq të vogël, vallë si është puna me njerëzit që i pengojnë projektet madhore të myslimanëve?!

Jo rastësisht Allahu (xh. sh.) i ka cilësuar si njerëz që e kanë humbur edhe ahiretin, sepse këtu nuk bëhet fjalë për jetim dhe të varfër, për të cilët nuk jemi të sigurt nëse janë të tillë (jetimë apo të varfër) apo nuk janë, por këtu bëhet fjalë për atë që ne veçse jemi të sigurt se është jetim dhe pa përkrahje, të cilin ne përsëri e shpërfillim, dhe i varfër pa asgjë, të cilin ne jo që nuk e ushqejmë, por edhe ata që kanë mundësi nuk i nxisim që të japin. Pikërisht nyja shquese e përparme ۱۱ është ajo e cila na tregon se jetimi dhe meskimi i kësaj surje janë të shquar dhe të njohur si të tillë.

### **Lidhja e besimit me proceset shoqërore**

Kjo sure është argumenti më goditës për ata që mendojnë se besimi është vetëm diçka abstrakte, që nuk ka lidhje me realitetin, dhe për ata që formalitetin ritual fetar e bëjnë gjënë e vetme të rëndësishme në besimin islam.

Kjo sure fillon me përgënjeshttrimin e Dinit si çështje të besimit, si të tillë. Në të vërtetë, në ajetet vijuese shumë pak flitet për besimin, sepse të gjitha ajetet flasin se ky lloj besimi qenka i varur prej pranisë dhe raportit që krijon vetë njeriu me proceset shoqërore që e rrethojnë. Pra, sipas kësaj sureje, më shumë do të kishim të drejtë të pyesim se sa është mysliman ai që nuk e përkrah jetimin, që nuk e ushqen të varfrin, që nuk ka namaz produktiv, sesa sa është mysliman ai që nuk agjëron etj. Kjo tregon se besimi që i përjashton

proceset shoqërore është vetëm përgënjeshtim.

Lidhja gjentive përfshin dy emra, ku zakonisht emri i parë është pronë e të dytit. Allahu (xh. sh.) në suren Maun, në ajetin e tretë, ka sjellë një lidhje të tillë, ku thotë: **طَعَامُ الْمُسْكِينِ** “ushqimi i meskinit”, gjë e cila nënkupton se haku i ushqimit është e drejtë e meskinit, nuk është e drejtë e jote. Pra, edhe ti, nëse e ushqen, i ke dhënë ushqimin e vet dhe jo ushqimin tënd.

Gjithashtu, Allahu (xh. sh.) përmes këtij ajeti e tregon koprracinë e skajshme të këtyre njerëzve, sepse, edhe pse ushqimi është e drejtë e meskinëve, ai edhe për këtë nuk nxit, e jo më për diçka më shumë apo për diçka që është e drejtë e vetë (e koprracit).

### Dallimi mes **طَعَامٌ** dhe **إِطْعَامٌ**

Fjala **طَعَامٌ** d.m.th. *ushqim*, është emër (jo të ushqyerit si proces), kurse fjala **إِطْعَامٌ** d.m.th. *të ushqyerit*, pra është paskajore (infinitiv). Në gjuhën arabe dallimi mes emrit dhe paskajores është se emri, thjesht, emërton një send apo një frymor, kurse paskajorja emërton një veprim të pacaktuar në kohë. Pra, paskajorja është një ‘folje’ pa kohë.

Nëse e shohim përkthimin e ajetit të tretë të sures Maun, atëherë do të vëmë re se shpeshherë janë ngatërruar këta dy terma. Përkthimi më afër të vërtetës duhej të ishte kështu: **وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمُسْكِينِ** “dhe nuk nxit për ushqimin e meskinit” dhe jo “...për ushqyerjen e meskinit”. Fjala **إِطْعَامٌ** përfshin vetëm procesin e ushqyerjes, kurse fjala **طَعَامٌ** është shumë më e gjërë - nuk flet vetëm për momentin kur meskinit i

mbërrin ushqimi, por për gjithçka që lidhet me ushqimin e meskinit.<sup>61</sup> Pra, këtu bëhet fjalë për mbrojtjen, nxitjen, mbarësitimin, krijimin e sistemit ku sigurohet ushqimi për të varfrit etj. Shkurt thënë, këtu nuk është i fokusuar momenti kur ushqehet meskini, por ushqimi i tij. Pra, ky ajet të bën të mendosh për ushqimin e meskinit edhe kur ai (ushqimi) nuk është i pranishëm.

### F-ja te fillimi i ajetit **فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ**

Pavarësisht nëse F-ja është *shkakore* apo *pasuese*, ajo i jep një mesazh të vyer njerëzimit. Nëse një njeri i ka cilësitë që përmenden në ajetet paraprake: përgënjeshtrohet me Dinin, shpërfill jetimin dhe nuk nxit të ushqehet meskini, edhe nëse menjëherë e sheh duke falur namaz, përsëri mjerë për të, sepse namazi i tij nuk ka si të jetë ndryshe veçse formë pa kuptim. Pra, nëse dikush përpiket që punët e veta të liga t'i lidhë me ibadetet më të çmuara të Zotit si namazi, atëherë vërtet mjerë për të.

Gjithashtu, duhet pasur një kujdes të veçantë se njerëzit që nuk janë humanë përpiqen që johumanizmin ta mbulojnë me ibadet, por harrojnë se ky ibadet është mjerim për ta, bile mund t'i çojë deri në përgënjeshttrim të fesë.

### Përse ajet i veçantë?

Shumë ajete kuranore japin mundësinë e keqkuptimit, prandaj dijetarët islamë kanë vendosur shenjat për t'u ndaluar. Për të mos u keqkuptuar ajeti, diku kanë vënë shenjë për ndalje të domosdoshme (م) e diku tjetër kanë vënë shenjë për moslejim të ndaljes (لا). Këtë ajet kuranor **فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ**, i cili

<sup>61</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Maune*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=AApTrBkCApY>.

në pamje të parë të duket shumë kontradiktor, Allahu (xh. sh.) e ka ndarë në ajet të veçantë, që do të thotë se si i tillë është kuptimplotë. Pra, lëre që nuk është vënë shenjë për lidhje të domosdoshme me ajetin e radhës, por Allahu (xh. sh.) e ka ndarë edhe veç. Tani parashtrohet pyetja: përse kështu? Apo ndoshta sepse shumë njerëz do ta kenë namazin formë pa kuptim. Bile, nëse shihet gjendja faktike e myslimanëve, nuk do të habiteshim përse një ajet i tillë duhet të ekzistojë i mëvetësishëm.

Për cilin namazli bëhet fjalë?

Falja e namazit në gjuhën arabe përmendet përmes dy trajtave: a) vetëm me foljen صَلَّى, apo fjalët tjera të prejardhura prej saj, të cilat kryesisht flasin për formën e namazit dhe jo për formën bashkë me shpirtin e namazit, dhe b) përmes togfjalëshit folje+emër أَقَامَ الصَّلَاةَ, i cili përfshin edhe formën edhe shpirtin e namazit, por sigurisht e favorizon me theks të veçantë shpirtin e namazit. Nëse e shohim ajetin në fjalë فَوَيْلٌ لِّلْمُصَلِّينَ, do të vëmë re se fjala namazli këtu është fjalë e prejardhur nga grupi i parë, që tregon vetëm formën e namazit. Pra, mjerë për ata që falen formalisht vetëm me trup, dhe nuk ka thënë فَوَيْلٌ لِّلْمُقِيمِي الصَّلَاةِ “mjerë për ata që falin namaz me përkushtim, me vlera dhe me përqendrim!”

A ka kush që ndonjëherë nuk falet formalisht?!

Sigurisht, çdo njeriut, përveç pejgamberëve, i ka ndodhur që ndonjëherë namazin ta falë vetëm formalisht. Tani parashtrohet pyetja: mjerimi bie edhe mbi ata që vetëm ndonjëherë falen formalisht, apo vetëm mbi ata që namazin e kanë bërë formalitet të zakonshëm?

Përgjigjen e kësaj e tregon vetë fjala الْمُصَلِّينَ namazli, sep-

se është dhënë me emër, kurse emri në gjuhën arabe tregon një veti statike dhe të zakonshme të njeriut, pra nuk është dhënë me folje, e cila tregon veprim të caktuar në kohë. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për atë që vetëm një apo disa herë është falur formalisht, por për atë që është bërë formalist në kryerjen e namazit. Prandaj, Allahu nuk ka thënë: *فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ صَلُّوا* “mjerë për ata që u falën (koha kaluar)!”, e as *فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ يُصَلُّونَ* “mjerë për ata që falen (koha e tashme)!”, por ka thënë *فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ* “mjerë për ata që vazhdimisht falen formalisht! (me emër)!”

Nga e gjithë kjo, lirisht mund të vijmë në përfundim se fjala *الْمُصَلِّينَ* ka dy dimensione të rëndësishme: formalitetin dhe vazhdueshmërinë.

### Renditja e ajeteve

Allahu (xh. sh.) në këtë sure të shkurtër e ka përmbledhur gjithë sistemin jetësor të kësaj bote, duke i përfshirë të gjitha të drejtat dhe obligimet që njeriu merr mbi supet e veta.

Ka filluar me jetimin, pastaj me meskinin dhe në fund me namazin. Përmes kësaj na mëson se fillimisht duhet të ndërtohet dhe të sigurohet familja, sepse ajo është bërthama kryesore e funksionimit të shëndoshë shoqëror. Po ashtu, të gjitha ndryshimet në botë fillojnë nga ndryshimet familjare. Kështu që, nëse ne kujdesemi për jetimin, atëherë tregon se ne mbajmë të gjallë një bërthamë kyç të shoqërisë. Të mos harrojmë se shumica e dijetarëve islamë thonë se jetim është ai i cili e ka humbur babanë, d.m.th. shpërfillja dhe moskujdesi për jetimin është një goditje e fuqishme edhe për nënën e jetimit, të cilën Zoti (xh. sh.) e ka ngarkuar të kujdeset për familjen pa shtyllën e saj, burrin. Pra, shpërfillja e jetimit

është sulmi më i shëmtuar që mund t'i bëhet familjes që rrezikon të shkatërrohet me humbjen e burrit.

Po ashtu, jetimi është vendosur në nivel të parë, sepse pasojat shpirtërore që mund t'i përjetojë jetimi nga shpërfilja janë pothuaj të parikuperueshme dhe shumë më të rënda sesa çfarëdo lloj tjetër ndjenje njerëzore.

Pastaj Allahu (xh. sh.), në nivelin e dytë ka kaluar në një problem pak më të gjerë se familja, atë shoqëror. Shtresa më e nënvlerësuar e shoqërisë, pas jetimëve, janë meskinët, të cilët dallojnë nga fukaratë, sepse shprehja fukara tregon antonimin (të kundërtën) e të pasurit, kurse meskinllëku është shkalla më e ulët e fukarallëkut dhe përfshin atë që vuan edhe për bukën e gojës.

Këtu del se Allahu (xh. sh.) në këto dy ajete kujdeset për strukturën më të dhimbshme të familjes (jetimët) dhe për strukturën më të dhimbshme të shoqërisë (meskinët).

Kur të sigurohen dy të parat, atëherë nuk do të jetë namazi mjerim për ata myslimanë.

Kjo sure fillon me mbrojtjen e të drejtës individuale (jetimit), të drejtës familjare (nëna e jetimit), të drejtës shoqërore (meskini) dhe në fund përfundon me të drejtën e Zotit (namazi).

Çfarë kuptimi i jep foljes parafjala عَنْ؟

Parafjala është një pjesë e rëndësishme e ligjëratës arabe. Ajo shpeshherë i ndryshon kuptimet në krah të kundërt, veçanërisht kur bëhet fjalë për ligjërimin kuranor. Ato shpeshherë janë kyç në poliseminë kuranore.

Parafjala عَنْ tregon një lloj largësie mes dy objekteve, ose së paku tregon dy gjëra që nuk janë të njëra-tjetrës. Kur thuhet الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ "Ata të cilët ndaj namazit të tyre

janë të pakujdesshëm”, parafjala عَنْ tregon se këtu nuk bëhet fjalë për çështje të brendshme të namazit, të cilat fillojnë me tekbir dhe mbarojnë me selam, madje as përkushtimi, por flitet për çështje shumë të rëndësishme, të cilat lidhen ngushtë me namazin, por janë jashtë namazit.

Sigurisht, shpërfillja nga jashtë namazit mund t’i bëhet në disa forma, por ne kemi veçuar vetëm dy prej tyre: pakujdesia në kohët e namazit dhe pakujdesia në efektin që duhet të lë namazi në jetën e besimtarit të mirëfilltë.

Nëse dikush insiston se këtu bëhet fjalë vetëm për kohët e namazit, atëherë parashtrohet pyetja përse Allahu (xh. sh.) nuk tha: “Ata të cilët ndaj kohëve të namazit nuk janë të kujdesshëm”, por fjala kohë nuk është përmendur, në mënyrë që ajeti të jetë më gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional. Veçanërisht në këtë sure, ku është i theksuar elementi social.

Togfjalëshi عَنْ صَلَاتِهِمْ “ndaj namazit të tyre” është gjymtyrë e fjalisë e cila zakonisht vjen pas fjalisë (سَاهُونَ) me të cilën është e lidhur. Shkurt thënë, në një fjali të zakonshme arabe kjo fjali do të ishte kështu الَّذِينَ هُمْ سَاهُونَ عَنْ صَلَاتِهِمْ “Ata të cilët janë të pakujdesshëm ndaj namazit të tyre”. Në rastet kur një gjymtyrë e fjalisë vjen para një gjymtyrë tjetër, atëherë nënkupton specifikimin.<sup>62</sup> Kjo renditje tregon se këta njerëz pakujdesinë nuk e kanë zakon të vet, por e kanë të theksuar ndaj namazit të tyre. P.sh. e sheh një njeri i cili është shumë i kujdesshëm në organizimin e jetës së tij, por kur është në pyetje namazi, ai nuk sjell asnjë reflektim në jetën e atij njeriu, apo gjatë gjithë jetës është i kujdesshëm, por në faljen e

<sup>62</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Maune*,

<https://www.youtube.com/watch?v=AApTrBkCApY>.

namazit nuk është. Pra, i përpiktë për veten, por i shkujdesur ndaj të tjerëve dhe ndaj Zotit.<sup>63</sup>

Allahu (xh. sh.) në suren Kurejsh tregon shumë të mira që u dha Kurejshëve në veçanti dhe gjithë njerëzimit në përgjithësi. Ajeti i fundit i sures Kurejsh thekson dy begati thelbësore për njerëzimin: ushqyerjen në uri dhe sigurimin në frikë. Pastaj Allahu i Madhërishëm e fillon suren Maun me fjalët *أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالذِّينِ* “A e pe atë që përgënjeshton me Dinin”. Në një mënyrë, surja Maun fillon me qortim ndaj atyre që e përgënjeshtrojnë dinin, por ky qortim vjen vetëm pasi Zoti (xh. sh.) i ushqeui nga varfëria dhe i siguroi nga frika. Prandaj, kjo na mëson se sanksioni dhe përgjegjësia vijnë në shprehje vetëm atëherë kur njerëzve t’u sigurohen kushtet e jetës dhe të kenë siguri. Gjithashtu, kjo na mëson se fukarallëku e dëmton rëndë besimin, por Allahu (xh. sh.) përgjegjësinë më të madhe për besimin e kërkon pasi atyre ua fali bukën e gojës dhe pasi u fali siguri.

### Tri veprime me një kuptim

Në këtë sure janë paraqitur tri veprime, të cilat në pamje të parë nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, mirëpo në esencë e bartin mesazhin e njëjtë.

Kujdesi i jetimit, ushqimi i meskinit dhe namazi. Përse Zoti (xh. sh.) i ka renditur njëra pas tjetrës dhe ç’lidhje kanë mes vete?

Jetimi është ai i cili nuk ka përkrahje nga askush; nëse ti e ndihmon, fiton shpërblim, por nëse jo, përsëri është çësh-

---

<sup>63</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 117.

tje që i mbetet Zotit, sepse askush nuk mund të detyrojë se përse nuk e ndihmon jetimin; po ashtu edhe ai vetë nuk ka mundësi të të detyrojë. Thjesht, është një çështje që mbetet mes teje dhe Zotit.

Gjithashtu, edhe ushqimi ndaj meskinit - nëse i ndihmon, shpërblehesh; nëse nuk i ndihmon, askush nuk mund t'ju detyrojë ta ndihmoni; madje, as vetë ai, sepse nuk ka mundësi. Pra, në fund edhe kjo mbetet mes teje dhe Zotit.

Edhe namazi, ndoshta falja e namazit si formë mund të bëhet për syfaqësi, por brendia e namazit mbetet vetëm mes teje dhe Zotit, e askush nuk mund t'ju censurojë kualitetin e namazit.

Pra, janë tri veprime që i bashkon vetëdija e njohjes së Zotit në të fshehtë dhe vetëdija se Zoti i di edhe të fshehtat. Pikërisht për këtë arsye Allahu (xh. sh.) e ka nisur edhe vetë suren, duke përgënjeshtuar të Fshehtën më të Madhe, Ahiretin.

Pra, nëse njeriu e përmirëson besimin për Ahiretin, sigurisht që do ta përmirësojë edhe veprimin ndaj këtyre tri veprimeve që lidhen po ashtu me të fshehtën. Me pak fjalë, kjo sure më shumë i flet vetëdijes dhe zemrës së njeriut, sesa formalitetit dhe arsyes së cekët.

### **Namazi në fokus**

Në mesin e të gjitha punëve që Zoti i ka numëruar në suren Maun është namazi. Allahu (xh. sh.) i ka renditur kështu: jetimi, meskini, namazi, syfaqësia dhe mauni. Pra, namazin e ka vënë si shtyllë kryesore të një ndërtimi të mirëfilltë, mirëpo ekuilibri i kësaj ndërtese varet nga punët që e rrethojnë namazin (shtyllën kryesore) - nëse ato nuk funksionojnë siç duhet, atëherë edhe shtylla kryesore nuk do të

ketë mundësi ta mbajë ekuilibrin e kësaj ndërtese të quajtur Din. Pra, mungesa e këtyre punëve, që janë para dhe pas namazit, e vë në diskutim edhe shtyllën kryesore.

Gjithashtu, kur e kemi parasysh këtë renditje, atëherë parashtrohet pyetja: Allahu (xh. sh.) në fillim ka përmendur punë më madhore, si përkujdesja ndaj jetimit dhe ushqimi i meskinit, kurse pas namazit ka përmendur vetëm syfaqësinë, që është dëm personal dhe maunin, që është privim i gjësë më të vogël?

Nëse njeriu është i sëmurë me sëmundjen e koprracisë, pas namazit, ka dy alternativa: ose do të shërohet, nuk do të bëjë punët për syfaqësi dhe do të jetë i kujdesshëm për meskinin dhe jetimin edhe me maunin, gjënë më të vogël, ose do të jetë e kundërta.

### **Çrregullim i fitres/natyrshmërisë së shëndoshë**

Sëmundjet shpirtërore janë ato të cilat bëjnë çrregullimin e natyrës së shëndoshë njerëzore. Njeriu që është i prekur nga sëmundjet e sures Maun e ka prishur natyrën e tij të pastër, sepse i vë gjërat në vende jo të duhura. P.sh. namazin, që është shtylla e fesë dhe që është e pranuar vetëm nëse bëhet me sinqeritet për Zotin, ai e bën për dikë tjetër, me syfaqësi, kurse maunin (gjënë më të vogël), që i takon njeriut tjetër, ai e mban për vete. Pra, thjesht ai fillon ta çekuilibrojë sistemin që ka vënë Zoti për të mbijetuar krijesat në këtë botë.



## SURJA EL-KEUTHER – سُورَةُ الْكُؤْتَرِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكُؤْتَرَ ﴿١﴾ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحَرْ ﴿٢﴾ إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ ﴿٣﴾﴾

“(1) Ne të dhamë burimin e Xhenetit. (2) Falju tët Zoti e pre kurban! (3) Përfolësi yt, ai është fatprerë.”

Lidhja e parë dhe shumë e fortë mes këtyre dy sureve është se surja Maun fillon me përgënjeshtimin e Dinit, që ka kuptimin e shpërblimit në Botën Tjetër, kurse surja Keuther dhënie e një shpërblimi shumë të madh, siç është Keutheri. Pra, Mauni përgënjeshton shpërblimin, kurse Keutheri e pohon dhe e vërteton shpërblimin. Ai i cili në këtë botë e përgënjeshton Dinin (Ahiretin), në Botën Tjetër do të privohet nga Keutheri. Gjithashtu, kjo na mëson se çdoherë, për të arritur një sukses të caktuar, duhet vënë re parakushtet e tij - në asnjë mënyrë nuk guxojmë t'i neglizhojmë ato, sepse në fund nuk kemi pse kërkojmë rezultat; njësoj siç e ka një parakusht tjetër surja Keuther, të quajtur sure Maun, të mbushur plot me obligime.

Po ashtu, nëse i analizojmë kuptimet e këtyre dy sureve, do të shohim se njëra (surja Maun) është simbol i koprracisë dhe i arrogancës, sepse aty nënçmohet jetimi, privohet i varfri, madje edhe namazi i këtyre është i paplotë nga koprracia dhe arroganca e madhe, kurse tjetra (surja Keuther) është simbol i bujarisë dhe i përlësisë.

Ka dhe një lidhje tjetër shumë interesante mes këtyre dy sureve, përkatësisht me vetë dy emrave të sureve, apo mes ajetit të fundit të sures Maun dhe ajetit të parë të sures Keuther: fjala Maun nënkupton gjërat e thjeshta, të cilat çdo njeri i ka në shtëpi; po e dhe ndonjërin prej tyre, nuk dëmtohet asgjë. Pra, njerëzit që përshkruhen në ajetin e fundit të sures Maun bëjnë thirrje që edhe gjërat më të vogla dhe të panevojshme të mos jepen. Me një fjalë, e përshkruan kulmin e koprracisë. Ajeti i parë i sures Keuther, ndërkaq, e ka vetëm fjalën Keuther, që është një fjalë me kuptimin “shumë, shumë, mirësi”. Pra, ky ajet e tregon kulmin e bujarisë.<sup>64</sup>

Në suren Maun përshkruhet njeriu që përgënjeshtrohet, që mohon, që nënvlerëson dhe nuk jep. Si rezultat, ky njeri është i pakujdesshëm në namazin e vet dhe ka mjerim për këtë. Në suren Keuther, ndërkaq, përshkruhet namazi i pranuar dhe i dëshiruar, sepse namazit i paraprin bujaria e madhe, dhënia dhe *keutheri* (shumë, shumë!). Kjo na mëson se namazi te Zoti (xh. sh.) nuk vlerësohet vetëm sipas kushteve të fik’hut, të cilat vlejné për ne, por ai ka edhe disa parakushte të tjera besimore, morale dhe etike. Po ashtu, pas namazit në suren Maun përmendet syfaqësia dhe koprracia, kurse pas namazit në suren Keuther përmendet flijimi, të cilat në një mënyrë i tregojné edhe reflektimet e të dy llojeve të namazit.

Në suren Maun koprracia dhe gjithë cilësitë e liga i janë përshkruar njeriut për të treguar se janë cilësi njerëzore, kurse në suren Keuther dhënia dhe bujaria fillojnë me fjalët “Ne”, që nënkupton Zotin, në mënyrë që të tregohet se buj-

---

<sup>64</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Keuther*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=dhh-AcLkpTc>.

aria dhe fisnikëria janë cilësi hyjnore.

Përveç lidhshmërisë së kësaj me suren paraprake, meriton t'i hidhet një vështrim edhe fillimit dhe fundit të kësaj sureje - çfarë lidhshmërie kanë ato?

Keuther është surja më e shkurtër në Kuran. Megjithatë, prej ditës që ka zbritur, kuptimet e saj nuk kanë të shterur.

Fillimi i kësaj sureje është "Ne të dhamë", kurse fundi: "farësosur". Kjo tregon se aktiviteti i çdo njeriu në botë do t'i ketë këto dy gjëra: nëse punon, atij do t'i jepet shumë – pavarësisht asaj se në këtë apo në botën tjetër; dhe, në të njëjtën kohë, ai do të ketë edhe sfida edhe akuza të ndryshme. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se fillimisht është potencuar dhënia.

Këtë ofendim që jobesimtarët ia bënë Muhamedit (a. s.), Allahu (xh. sh.) e mbuloi me mirësitë e Keutherit. Po ashtu, kjo na mëson se sa herë që të shahet dhe të xhelozohet punëtori, ne duhet ta stimulojmë atë.

### Dallimi mes **أَتَى** dhe **أَعْطَى**

Gjuha arabe për *dhënien* ka dy folje: **أَعْطَى** e cila përdoret për dhënien materiale, për dhënien nga sfera e pronës - pra, atij që i jepet me këtë folje, ai është pronar dhe mund të veprojë si të dëshirojë, pa dhënë përgjegjësi për të. Folja **أَتَى** (يُؤْتِي), ndërkaq, përdoret për gjëra kuptimore, të cilat nuk janë pronë e atij që i janë dhënë dhe në fund duhet të përgjigjet për këtë dhënie. Në Kuran këtë 'dhënie' ka pushteti, urtësia etj., sepse ato nuk kanë pronar dhe kanë përgjegjësi.

Pra, në suren Keuther Muhamedit (a. s.) i është dhënë Keutheri si pronë e tij në Botën Tjetër dhe Allahu nuk i kër-

kon përgjegjësi për mënyrën se si do ta menaxhojë. Kjo gjithashtu tregon se sa e privilegjoj Allahu Muhamedin (a. s.) kur të tjerët e ofendonin, apo dëshironin që ta poshtëronin; pra, i dha pa i kërkuar asnjë përgjegjësi.<sup>65</sup>

Përveç dallimit mes dy foljeve të dhëna më lart, duhet parë se si folja *أعطى* është dhënë në kohën e kaluar.

Folja *أعطى* është dhënë në kohën e kaluar, edhe pse bëhet fjalë për diçka që do të ndodhë në të ardhmen, sepse Keutheri do t'i jepet në ahiret Muhamedit (a. s.).

Kur të gjithë jobesimtarët iu vërsulën Muhamedit (a. s.) për ta poshtëruar dhe për t'i thënë se 'mundi yt do të të shkojë kot, ngase ti nuk ke pasardhës djem, që ta vazhdojnë misionin tënd, madje do të shuhet edhe familja jote', Allahu (xh. sh.) ua ktheu me një formë tjetër - u tha se atë për të cilën ata përpiqeshin ta shkatërronin Muhamedin në të ardhmen Allahu ia siguroi pejgamberit me folje të kohës së shkruarës. Pra, kjo del kështu: "Nëse ju ia dëshironi të keqen në të ardhmen, unë ju them se ia kam siguruar ardhmërinë atij qysh para se ju të mendoni ta shani atë."<sup>66</sup>

Gjithashtu, folja e kohës së kaluar përdoret për diçka që është kryer më; pra, 'realiteti i Keutherit për Muhamedin (a. s.) është diçka e kryer, për të cilën ju vetëm mund të shpresoni që të fitoni diçka prej tij dhe assesi mos u lodhni me ardhmërinë e dikujt, por preokupohuni me ardhmërinë tuaj dhe a do të jeni pjesë e asaj mirësie?!'.

<sup>65</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 77-80.

<sup>66</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Keuther*, <https://www.youtube.com/watch?v=dhh-AcLkpTc>.

## Keutheri e përforcon suren Duha

Surja Duha është zbritur në fillim të shpalljes, prandaj Allahu (xh. sh.) në njërin prej ajeteve thotë: “وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَىٰ” “dhe do të të japë Zoti yt, e do të kënaqesh”. Folja “do të të japë” është në kohën e ardhshme, ku shumë komentues thonë se bëhet fjalë për në Botën Tjetër, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që të kuptohet edhe dhënia në këtë botë. Pastaj, kur kthehemi te surja Keuther, shohim se e njëjta folje është përdorur në kohën e kaluar “أَعْطَيْنَا” “ta dhamë”, dhe kjo sure është zbritur pas sures Duha, pra, i thuhet Muhamedit se atë që premtuam për të ta dhënë, ne vetëm ta dhamë qysh në këtë botë, kurse në Botën Tjetër ka mirësi të pakufishme.

Nëse i shohim këto dy sure, përkatësisht kohët e foljeve për ‘dhënie’, atëherë do të vërejmë se nuk mjafton vetëm premtimi për të ardhmen, por duhet dhënë diçka edhe për momentin.

## Kuptimet e fjalës كَوْتَر

Fjala Keuther mund të kuptohet në dy segmente: 1. Lumë në xhenet, që i është dhënë vetëm Muhamedit (a. s.); 2. Dhënie e madhe në dynja dhe në ahiret.

Nuk ka asnjë të keqe nëse e njëjta fjalë i ka të dy kuptimet. Por, ne do t’i bëjmë një qasje gjuhësore fjalës كَوْتَر. Kuptimin e kësaj fjale do ta shohim në dy aspekte: a) rrënja: kjo fjalë e ka rrënjën nga tri shkronja që tregojnë shumë كثر, dhe b) forma: forma e kësaj fjale ka ardhur me paradigmen فَوَعَلَ, e cila tregon pikën kulmore të një cilësie, apo të një përshkr-

imi të caktuar.<sup>67</sup> Pra, rrënja dhe forma e fjalës na tregojnë se përse Allahu e ka zgjedhur këtë fjalë; sepse, atëherë, me shumë të drejtë, do të pyeste dikush: pse nuk ka thënë كَثِيرًا? Sepse كَثِيرًا e ka rrënjën e njëjtë, por jo edhe formën (paradigmën), e cila tregon pikën më të lartë. Me një fjalë كَثِيرًا d.m.th. *shumë*, kurse fjala كَثُرَ d.m.th. *shumë më shumë*.

Po ashtu, parashtrohet pyetja: përse pikërisht në këtë sure u vendos fjala Keuther?

Janë shumë ajete në të cilat Allahu (xh. sh.) premton dhënie me fjalën أُعْطِيَ apo يُعْطَى, por ajeti i fundit që flet për dhënie me këtë fjalë është pikërisht në suren Keuther, prandaj, meqë ky është ajeti i fundit që flet për dhënien, atëherë edhe sasinë e dhënies në fund e ka dhënë me Keuther, sepse ky është kulmi i dhënies.

### Roli i lidhëzës فَ mes dy ajeteve të para

Secila lidhëze në gjuhën arabe jep një kuptim të caktuar; veçanërisht kur flitet për përdorimin e lidhëzave në Kur'an. Një ndër kuptimet më të zëshme të lidhëzës فَ është لِلتَّعْقِيبِ për sqarim të menjëhershëm, apo thënë shkurt: fjalët që vijnë pas F-së janë pasojë e menjëhershme e fjalëve që janë para saj. Kjo tregon se dy ajetet e para të sures Keuther janë të lidhura me këtë lidhëze, sepse për gjithë atë që të ka falur Zoti i Madhërisëm, pasojnë veprime përgjegjësie. Çdokush që nderohet me dhunti, menjëherë ngarkohet edhe me përgjegjësi. Pra, dhuntia dhe marrja e përgjegjësive duhet të shikohen paralelisht me njëra me tjetrën, sepse vetëm kë-

<sup>67</sup> Ibn Mendhur, *Lisanu el-Arabi*, Vëllimi VI, f. 147 (rrënja كَثُرَ).

shtu arrihet Keutheri.<sup>68</sup>

### Përse أَقِمِ الصَّلَاةَ dhe صَلِّ؟

Nëse e shfletojmë gjithë Kuranin, urdhri për namaz çd-ohërë është dhënë përmes togfjalëshit الصَّلَاةَ أَقِيمُوا; i vetmi rast ku falja e namazit kërkohet në formë të drejtpërdrejtë dhe vetëm me një fjalë është në suren Keuther, pra folja صَلِّ.<sup>69</sup>

Fillimisht do të bëhet dallimi mes këtyre dy formave urdhërore, pastaj do të sqarohet arsyeja përse në suren Keuther është veçuar njëra ndaj tjetrës.

Togfjalëshi أَقِمِ الصَّلَاةَ 'fal namazin' është ndërtuar nga folja أَقَامَ e cila do të thotë: të ngresh, të ndërtosh, të krijosh vlera, të bësh diçka të qëndrueshme etj., kurse الصَّلَاةَ d.t.th. namaz, lutje, lidhje etj. Pra, ky togfjalësh nuk kërkon thjesht një falje formale, por kërkon të falet një namaz me plot vlera, një namaz i qëndrueshëm, i cili e ngre besimtarin etj., kurse folja صَلِّ (e cila në këtë ajet ka ardhur në njëjtesin e mënyrës urdhërore صَلِّ) kryesisht përfshin aspektin formal dhe fizik të namazit.

Nëse e kemi të qartë dallimin mes këtyre dy urdhrave për namaz, atëherë shumë lehtë kuptohet përse Allahu në këtë sure thotë صَلِّ. Meqë ajeti i parë flet për shumë dhunti, kurse i dyti për falënderim ndaj atyre dhuntive, atëherë Allahu (xh. sh.) nga mëshira e pafund e Tij ka kërkuar mënyr-

<sup>68</sup> Esh-Sheukani, *Fet'hu el-Kadir*, Vëllimi V, El-Marifetu, 2007, f. 489.

<sup>69</sup> Kjo folje (صَلَّى) është përmendur edhe diku tjetër në Kuran, por jo me kuptimin e namazit. P.sh.

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

ën më të lehtë të falënderimit - të paktën, kryerja formale e faljes, sepse nëse do të ishte kërkuar falja me foljen أَقِمِ الصَّلَاةَ atëherë shumë pak njerëz do ta kishin falënderuar Allahun për dhuntitë e pakufishme që u ka falur atyre.

Gjithashtu, ajeti kërkon falje صَلَّى لِرَبِّكَ “falu për Zotin tënd!” Shprehja “për Zotin tënd” nënkupton se namazi duhet bërë vetëm për Allahun dhe për askënd tjetër. Zakonisht njerëzit të cilëve u janë dhënë shumë të mira shumë pak janë falënderues ndaj Allahut - shpeshherë u falënderohen shkaqeve etj., kurse ky ajet tregon se falënderimi për gjithë mirësitë i takon vetëm Allahut; qoftë ai, bile, edhe vetëm formal.<sup>70</sup>

Një arsye tjetër e përdorimit të kësaj folje lidhet me kohën e zbritjes së kësaj sureje. Kur u zbrit kjo sure, mekasit i adhuronin idhujt, kurse dy komponentë brenda kësaj sureje e përjashtojnë adhurimin e tyre. E para: ata adhuronin idhujt, ndërsa Allahu kërkon që namazi të bëhet për Zotin, dhe e dyta: edhe pse ata bënë një lloj adhurimi, vetë fjala صَلَّى u kërkon edhe formën e namazit ta bëjnë të njëjtë, sepse ata pretendonin se falen me forma të ndryshme. Këto pika janë shumë aktuale edhe sot, sepse shumë falënderime bëhen ndaj njerëzve, por pak ndaj Zotit. Po ashtu, sot shumë njerëz mendojnë se falja (adhurimi) bëhet edhe me zemër të mirë, me mendje apo me meditim, kurse ky ajet tregon se adhurimi ka norma dhe rregulla të veçanta, dhe jo si t’ua do ëndja njerëzve.

Urdhri i përgjithshëm i kësaj foljeje është për faljen e namazit të Bajramit, ngase falja është lidhur me sakrificën

---

<sup>70</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Keuther*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=dhh-AcLkpTc>.

(me kurbanin).

### Kuptimi i foljes نَحَرَ

Gjuha arabe ndryshe njihet edhe si gjuhë e sinonimeve të përafërta, sepse sinonime të plota nuk ka, prandaj për vetë të *therurit* ka disa fjalë. Më të dalluara janë fjalët نَحَرَ dhe نَحَرَ. Edhe pse këto mund të përdoren si sinonime të njëra-tjetrës, ato kanë disa dallime. Dallimi më i theksuar është ky: folja نَحَرَ përdoret për therjen e kafshëve me qafë të shkurtër, si: të lopës, të deles etj., kurse نَحَرَ kryesisht përdoret për therjen e kafshëve me qafë të gjatë dhe të kafshëve të mëdha, si të deveve.

Mësimi i dallimit mes këtyre dy fjalëve hap mundësinë e kuptimit të ajetit të dytë të sures Keuther فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ "falu për Zotin tënd dhe ther!". Siç duket ky ajet, përveç që kërkon përpikëri në realizimin formal të namazit, në të njëjtën kohë edhe sakrifikimin e kërkon të jetë në nivel më të lartë, pra të theret kafsha më e madhe e mundshme për kurban.

Pse نَحَرَ "ther!" dhe نَحَرَ لَهُ "ther për hir të Tij!"?

Mësimet islame na mësojnë se besimtari duhet të therë kurban vetëm për hir të Allahut dhe për askënd tjetër. Atëherë parashtrohet pyetja: përse në ajet është thënë نَحَرَ "ther!" dhe نَحَرَ لَهُ "ther për hir të Tij"? apo: përse për namazin është thënë فَصَلِّ لِرَبِّكَ "falu për hir të Zotit tënd!", kurse për therjen jo.

Kjo është saktësia hyjnore, sepse njeriu namaz nuk mund të bëjë për hir të askujt përveç se për Allahun, kurse therja mund të bëhet për hir të Allahut (kur bëhet për një kur-

bani) dhe për qëllime të tjera, si për të ngrënë etj. Nëse ajeti do të ishte *وَائْحِرْ لَهُ* “ther për hir të Tij!”, atëherë çdo therje e kafshëve, përveç me nijet të kurbanit, do të ishte e ndaluar dhe do të konsiderohej politeizëm, njësoj siç është për namazin.<sup>71</sup>

### Katër përballë katërve

Imam Raziu kur e komenton suren Keuther i nxjerr katër cilësi, të cilat janë oponenca të katër cilësive të tjera të sures Maun.

E para: në suren Maun është përshkruar koprracia me *وَلَا يُحِضُّ عَلَىٰ طَعَامِ الْمِسْكِينِ*, kurse në suren Keuther është kundërshtuar me *إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ*;

E dyta: në suren Maun është përshkruar pakujdesia në namaz me *الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ*, kurse në suren Keuther është kundërshtuar me fjalën *فَصَلِّ*;

E treta: në suren Maun është përshkruar syfaqësia me ajetin *الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ*, kurse në suren Keuther është kundërshtuar vetëm me fjalën *لِرَبِّكَ*;

E katërta: në suren Maun është përshkruar shpirtligësia dhe ngushtësia shpirtërore me *وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ* (pengojnë të jepet edhe gjëja më e pavlerë), kurse në suren Keuther kundërshtohet me fjalën *وَائْحِرْ* (ther atë që është më e vlefshme).

### Dallimet e fjalës *شَتَّانَ* nga sinonimet tjera të përfaqëta

Ajeti i tretë i sures Keuther flet për urrejtjen e politeistë-

<sup>71</sup> Fadil bin Salih es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 86-89.

ve ndaj Muhamedit (a. s.), mirëpo përdorimi i fjalës شَانِي (urryes) tregon edhe llojin apo sasinë e urrejtjes së tyre ndaj të Dërguarit të Zotit, ndaj fesë dhe ndaj myslimanëve në përgjithësi.

Në gjuhën arabe për urrejtjen përdoren disa fjalë, si بُغْضٌ, كُرْهٌ etj., ku secila shpreh një urrejtje ndryshe nga fjalët e tjera.

Urrejtja është një ves shpirtëror, që mund të mbetet fshëhur deri në vdekje (كُرْهٌ), por shpeshherë mund të rezultojë edhe me pasoja të papara, bile deri në vrasje apo konfrontim fizik mes urryesit dhe të urryerit (شَانَانٌ). Apo, ka raste kur mes dy personave fshihet një urrejtje jo edhe aq e theksuar (كُرْهٌ), mirëpo disa herë të tjera urrejtja kalon në një shkallë më të avancuar dhe nuk do që t'ia dëgjojë as emrin dhe as t'ia shohë fytyrën (شَانَانٌ).

Pra, kjo tregon se fjala شَانَانٌ dallohet me këto tri veti:

- Urrejtje, ku urryesi nuk do ta shohë dhe as të dëgjojë për të urryerin;
- Urrejtje që nuk mjaftohet vetëm me ndjenjën shpirtërore, por kërkon reaksion fizik (vrasje, rrahje etj.);
- Urrejtje, përmes së cilës kërkohet poshtërimi dhe nënçmimi i palës tjetër.

Pikërisht ky është personi të cilin e përshkruan Zoti (xh. sh.) në suren Keuther: “Vërtet, urryesi yt është farësosur.” Këtë të vërtetë e tregojnë edhe veprimet e politeistëve ndaj Muhamedit (a. s.), të cilët nuk dëshironin t'ia dëgjonin emrin; dëshironin ta dëmtonin e ta zhduknin dhe kërkonin në çdo mënyrë që ai të poshtërohej.

Në vend të poshtërimit që ata kërkonin t'ia bënin Muha-

medit (a. s.), ky ajet kuranor ua shpalosi mllefin që ata kishin ndaj pejgamberit (a. s.) dhe i demaskoi të gjitha ndjenjat dhe veprimet e tyre vetëm përmes fjalës شَان.

Gjithashtu, ky ajet kuranor na jep edhe një mësim tjetër të çmuar: meqë njeriu është qenie që gabon, pra edhe mund të urrejë dikë, por duhet pasur kujdes që kurrë të mos i urrejë gjërat e shenjta, si: fenë, librat e shenjtë, pejgamberët etj. Po ashtu, edhe kur të urrejë dikë, duhet të jetë i përmbajtur në urrejtje, mos të kalojë në konfrontim fizik, në poshtërim të të urryerit apo në distancim nga i urryeri, sepse atëherë të gjitha pasojat e urrejtjes do të bien mbi të, njësoj siç e pësuuan politeistët me urrejtjen ndaj Muhamedit (a. s.).

Kuptimin e këtyllë e argumenton edhe ajeti 8 i sures Maide:

وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰٓ اَلَّا تَعْدِلُوْا

*“Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi...”*

Pra, urrejtja e quajtur شَان i kalon kufijtë e shpirtërores dhe nxit pasoja fizike, si: padrejtësi etj. Po ashtu, ky ajet tregon se kjo lloj urrejtje vjen në shprehje te njerëzit e këqij, të cilët kanë një lloj averzioni ndaj drejtësisë, veçanërisht kur cenohet aktiviteti i padrejtë i tyre. Njësoj siç u pengonte drejtësia e Muhamedit (a. s.) politeistëve.

Këtu fjala شَان është dhënë si emër prejfoljor.

Allahu (xh. sh.) urrejtjen e ka dhënë me emër “Vërtet, urryesi (شَان) yt është farësosur.”, dhe jo me folje, si p.sh. “Ai që të ka urryer apo të urren ty është farësosur”. Në gjuhën arabe, emri prejfoljor zakonisht mbulon një veti apo veprim të vazhdueshëm dhe të papërcaktuar në kohë. Pra, ky ajet flet për urryesit e vazhdueshëm të Muhamedit (a. s.) dhe

ata që kanë vdekur me urrejtje ndaj tij. Nëse do të ishte thënë me folje, siç e dhamë më sipër, atëherë do të përfshiheshin edhe ata që një kohë e kanë urreyer dhe pastaj e kanë dashur, por saktësia hyjnore ka bërë që përmes emrit të përfshihen vetëm ata që e kanë urreyer vazhdimisht Muhamedin (a. s.) dhe kanë vdekur me atë urrejtje.

### Lidhja e këtij ajeti me dy të parët

Ky ajet bën përmbylljen e edukimit të suksesshëm të një besimtari. Në fillim Allahu (xh. sh.) i fal shumë të mira njeriut (siç është dhënë në ajetin e parë), pastaj në ajetin e dytë e edukon të jetë i denjë me Krijuesin dhe me krijesat, d.m.th. të mbajë ekuilibrin e të qenit rob dhe besimtar i mirëfilltë dhe, në fund, me ajetin e tretë, e mëson se atij që i janë dhënë shumë të mira, që është i kujdesshëm ndaj Zotit dhe Krijesave, ai çdoherë do të ketë disa njerëz që do ta urrejnë, që do ta përbuzin dhe do të përpiqen me çdo kusht që ai të privohet prej atyre mirësive.

### Reflektime kuptimore nga ajeti i fundit

Fjala *أَبْرَأَ* rrjedh nga rrënja *أَبْرَأَ* d.m.th. *të presësh apo të këpusësh*, kurse *أَبْرَأَ* d.m.th. i këputur apo i prerë.<sup>72</sup>

Janë dy dimensione të rëndësishme që duhet të kuptohen rreth kësaj fjale: dimensionin fizik dhe ai shpirtëror. Nga ajo që shohim në shumë përkthime në gjuhën shqipe, “farë-sosur”, kryesisht favorizohet aspekti fizik, kurse në gjuhën arabe më shumë flet në konotacion shpirtëror, sepse, më në

<sup>72</sup> Ibn Mendhur, *Lisanu el-Arabi*, Vëllimi V, f. 99-100.

fund, Muhamedi (a. s.) nuk kishte pasardhës meshkuj. Pra, kjo tregon se ajeti i mban të dy dimensionet, por kryesisht atë shpirtëror, sepse ai që e ofendon Muhamedin (a. s.) është i privuar nga të mirat e kësaj dhe të botës tjetër.

Ky ajet të jep të kuptosh se në mjedisin ku zhvillohet urrejtja është vështirë të edukohen gjeneratat e ardhshme, prandaj aty ku ka urrejtje, ka ardhmëri të dështuar dhe si rezultat edhe mirësi të kufizuara. Pra, ardhmëria e ndërtuar mbi urrejtje, të le farësosur, sepse edhe nëse fëmijët i ke fizikisht, bereqeti dhe mirësitë e atyre fëmijëve janë ndërprerë.

### Nga Keutheri deri tek Ebteri

Kjo sure e shkurtër, por shumë kuptimplote, është çelësi i suksesit.

Kjo sure fillon me Keutherin, me mirësitë e pafundme të kësaj dhe të Botës Tjetër, dhe përfundon me Ebterin, me ndërprerjen e gjitha këtyre mirësive. Aq afër janë këto dy fjalë, saqë ndahen vetëm prej disa njësive tingëllimore. Thjesht thënë, parimisht Allahu (xh. sh.) njeriut i ka falur shumë mirësi, por duhet që: 1) ai të falet (صَلَّ), d.m.th. të rregullojë raportin me Krijuesin; 2) të presë kurban (انْحَرَّ), me të cilin do t'i ushqejë njerëzit, pra të rregullojë raportin edhe me krijesat, dhe 3) ta shmang urrejtjen e pakontrolluar. Vetëm kështu mund të shpëtojë nga Ebteri dhe të qëndrojë brenda Keutherit. Pra, Keutherin dhe Ebterin e ndajnë vetëm këto tri pika.

Përse është thënë هُوَ (vetë ai)?

Përemri هُوَ "vetë ai" në këtë ajet kuranor vjen me funksion të përforcimit dhe të shmangies së mëdyshjes. Nuk lë

hapësirë që dikush apo vetë urryesi të mendojë se ndoshta urrejtja mund t'i sjellë ndonjë të mirë, por është shumë i prerë dhe shumë bindës, se vërtet urryesi do të jetë farësosur apo i privuar prej të mirave.<sup>73</sup>

Këtë të vërtetë e tregon edhe nyja shquese ۱ në fillim të fjalës الأَبْتَرُ d.m.th. se humbësi apo farësosuri është i njohur dhe i shquar, pra është vetë ai urryesi paraparak.

Gjithashtu, një kuptim tjetër i nyjës shquese ۱ te fjala الأَبْتَرُ është gjithëpërfshirja, pra, urryesi apo përbuzësi është farësosur dhe i privuar prej të mirave me plot kuptimin e fjalës, dhe nga të gjitha mirësitë.

Po ashtu, nuk duhet harruar se esenca e këtyre ajeteve flet për personalitetin e Muhamedit (a. s.), të cilin e akuzonin si farësosur dhe njeri me të ardhme të pasigurt.

---

<sup>73</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Keuther*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=dhh-AcLkpTc>.



## SURJA EL-KAFIRUN – سُورَةُ الْكَافِرُونَ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ﴿١﴾ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ﴿٢﴾ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٣﴾ وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ ﴿٤﴾ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٥﴾ لَكُمْ دِينُكُمْ ﴿٦﴾ وَلِي دِينٌ ﴿٦﴾﴾

“(1) Thuaj: “O mobues! (2) Unë nuk adburuj ç’adburoni ju. (3) Edhe ju nuk jeni adburues ç’adburuj unë. (4) As unë nuk jam adburues ç’adburuat ju. (5) Edhe ju nuk jeni adburues ç’adburuj unë. (6) Ju keni fenë tuaj dhe unë fenë time.”

Në fund të sures Keuther, Muhamedi (a. s.) akuzohet si njeri farësosur (Ebter), pa pasardhës, mirëpo Muhamedi (a. s.) ofendimin ndaj tij nuk e ktheu në të njëjtën mënyrë. Pra, ai vetëm u tregon vijat e kuqe të parimeve të besimit të vet. Sikur do që t’u thotë: ‘ju veproni si të dëshironi; nëse doni, edhe më ofendoni, por unë nuk mërzhimet për këtë, sepse unë mërzhitem vetëm nëse shkelen vijat e kuqe që janë vendosur në suren Kafirun’. Pra, Muhamedi (a. s.) nuk bie në nivelin e tyre, por përpiket që ata t’i avancojë në çështje dhe debate më të rëndësishme, duke mos rënë pre e inateve të ulëta sa për t’u hakmarrë.<sup>74</sup>

<sup>74</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 136.

## **Renditja në mus'haf dhe në zbritje**

Surja Kafirun dhe Nasr në mus'haf janë të ndara vetëm me një besmele, gjë e cila na mëson se dështimi dhe sukseesi qëndrojnë shumë afër njëri-tjetrit, prandaj duhet pasur kujdes në finalizimin e sukseeseve, sepse është e mundur që pikërisht në fund të tjetërsohet kahu i aktivitetit. Pra, në vend që në fund të korrë fitore si në suren Nasr, ai, nga karriera e tij e dështuar, ende është i shkelur nga të tjerët dhe i duhet të dialogojë si në suren Kafirun.

Por, edhe pse në Kuran këto dy sure ndahen vetëm me një besmele, shikuar kronologjikisht ato janë zbritur shumë larg njëra-tjetrës. Kafirun ka zbritur në fillim, kurse Nasr në fund të misionit. Pra, duke e shikuar kohën e zbritjes, ato të dyjat i ndan një periudhë e gjatë, e cila është e mbushur me përpjekje, me mund, me luftë, me durim, me hixhret, me thirrje, me marrëveshje dhe në fund me fitore e me çlirim. Pra, është një jetë e tërë e mbushur me aktivitete, e cila Muhamedin (a. s.) e nxori nga situata e sures Kafirun, ku i duhet të debattojë - sepse ishte pakicë, në suren Nasr - kur u bë burrë shteti.

## **Format e mohimit të adhurimit të kotë**

Surja Kafirun është sure mekase, bile ndër suret e zbritura në periudhën e hershme mekase. Ajo ka zbritur si pasojë e ofertës që iu bë Muhamedit (a. s.) për ta adhuruar një kohë Allahun dhe një kohë zotat e kotë të politeistëve mekas.

Allahu (xh. sh.) e mësoi Muhamedin (a. s.) që qëndrimet e veta monoteiste t'i shprehë në një formë të përkryer, duke mbyllur çdo lloj hapësire të mundshme që mund të

nxisë dyshim. Pra, këtu janë zënë të gjitha shtigjet e dyshimit dhe janë shprehur të prera qëndrimet si asnjëherë më parë.

Format e përdorura gjatë dialogut janë këto:

- 1) Emri *عَابِدٌ* adhurues, *عَابِدُونَ* adhurues (shumë). Emri në gjuhën arabe, si në çdo gjuhë tjetër, shpreh një çështje statike dhe të vazhdueshme, pa i kushtuar rëndësi kohës. Pra, përmes emrit (mbiemrit) shprehet një veti e përhershme, prandaj Allahu (xh. sh.) e mëson Muhamedin (a. s.) që qëndrimin e vet ta shprehë me emër, “as unë nuk jam *adhurues* i asaj ç’adhuruat ju”, pra tregon se mosadhurimi është cilësi e vazhdueshme e besimtarit të mirëfilltë;
- 2) Folja e kohës së kaluar (e as unë jam adhurues ç’adhuruat ju). Edhe pse emri (mbiemri) shpreh një veti statike, përsëri ndonjëherë mund të ketë përjashtime. P.sh. kur themi “Aliu është *bujar*”, fjala bujar tregon se Aliu çdoherë është i tillë, mirëpo kjo nuk e përjashton mundësinë që të paktën një herë në jetë ai të jetë koprrac. Prandaj, përdorimi vetëm i formës emërore ndoshta mund të linte ndonjë hapësirë të vogël që dikush të mendojë ndryshe, prandaj Allahu përdori edhe foljen e kohës së kaluar “E as unë jam adhurues ç’adhuruat ju”, në mënyrë që në formë speciale të përjashtohet adhurimi i dikujt tjetër pos Allahut në të kaluarën.
- 3) Folja e kohës së tashme “Unë nuk *adhuroj* ç’adhuroni ju”. Pas emrit, që mbulonte një cilësi statike, dhe foljes së kohës së kaluar, Allahu (xh. sh.) përdor edhe folje të kohës së tashme, përmes së cilës e mbulon të tashmen dhe të ardhmen, sepse dihet që në gjuhën arabe folja e

kohës së tashme përdoret me kuptim edhe të së ardhmes.

Pra, përmes këtyre tri formave Allahu (xh. sh.) i ka mbyllur të gjitha shtigjet e mundshme të dyshimit: emër, folje e kohës së kaluar, folje e kohës së tashme dhe të ardhme.<sup>75</sup>

### **Intoleranca me të keqen dhe kultura e dialogut**

Një mësim i rëndësishëm që përçohet nga surja Kafirun është intoleranca dhe të mos i hapet rrugë të keqes, sepse e keqja vetëm duhet luftuar, kurse çdo tentativë për të bërë kompromis ka mundësi që të inkorporojë dhe të bëhesh pjesë e saj. Fatkeqësisht, sot duket sheshazi se aty ku bëhet debat për gjërat e domosdoshme, pason dështimi dhe në të shumtën e rasteve edhe bërja pjesë e tij (e dështimit). Pra, vetëm një refuzim kategorik dhe i prerë në suren Kafirun, me të gjitha format gramatikore, solli një fitore si ajo në sur-en Nasr.

Para se të flitet për kulturën e dialogut, duhet thënë se në suren Kafirun nuk bëhet fjalë për dialog doktrinar ndërfeetar, por për dialog për bashkëjetesë, duke e pranuar njëritjetrin ashtu siç janë. Në fakt, politeistët i kërkonin Muhamedit (a. s.) dialog doktrinar, që të gjejnë një mesatare dhe të bëjnë gërshetim të besimeve, mirëpo Muhamedi (a. s.), me urdhër hyjnor, e tjetërsoi debatin dhe e ktheu në debat për bashkëjetesë, duke e pranuar njëritjetrin ashtu siç janë.

Këtu qëndron edhe sekreti i kulturës së lartë të dialogut të Muhamedit (a. s.), sepse edhe pse ata i sollën një propoz-

---

<sup>75</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 139.

im të paarsyeshëm, ai përsëri nuk përdori fjalë të ashpra apo ofenduese, sepse la një shteg për të zhvilluar dialog për bashkëjetesë. Nëse i analizojmë fjalët e sures Kafirun, vërejmë se askund nuk është thënë “mos adhuroni!”, “ju jeni gabim”, “zota të kotë” apo të ngjashme, por thjesht është bërë pasqyrimi i qëndrimeve, sepse ky ishte momenti i parë që politeistët pranuan të bëjnë një lloj dialogu me Muhamedin (a. s.), prandaj për të mos qenë tendencioz dhe i skajshëm në kërkesën e vet, ngase e dinte që nuk e pranonin, së paku u tha që ta njohim njëri-tjetrin kështu siç jemi, duke i pastruar qartë dallimet e patejkalueshme doktrinare.

Sigurisht, parashtrohet një pyetje shumë me vend: përse në këtë sure nuk është trajtuar problemi i besimit, por i adhurimit, kur e dimë se besimi është para adhurimit?

Kjo sure na mëson se nuk duhet të përzihemi në zemrat e njerëzve. Edhe pse Muhamedi (a. s.) ishte peygamber dhe ka pasur mundësi t’i dijë, me ndihmën e Zotit, edhe besimet e njerëzve, ai përsëri zgjodhi një pikë tjetër për të debatuar - atë të adhurimit dhe jo të besimit, sepse besimi është diçka shumë subjektiv dhe shumë personal. Pasi debati ishte kolektiv, nuk u fol për atë që është personale (për besimin). Vëmendja e bisedës u përqendrua tek adhurimi, sepse kjo është gjëja për të cilën, për realizimin fizik të së cilës, duket dhe mund të bisedohet.<sup>76</sup>

Qëllimi i krijimit është adhurimi: “Nuk i kam krijuar xhindet dhe njerëzit, përveçse për të Më adhuruar”. Pra, në suren Kafirun u diskutua ajo që Vetë Zoti e bëri qëllim dhe

---

<sup>76</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Kafirune*,  
[https://www.youtube.com/watch?v=dqL2s\\_XHjCs](https://www.youtube.com/watch?v=dqL2s_XHjCs).

ajo që ne mund ta quajmë qëllim.

### Fuqia shprehëse e urdhërores **قُلْ *thujaj!***

Disa sure apo ajete kuranore fillojnë me foljen e mënyrës urdhërore **قُلْ *thujaj!*** Secila sure apo ajet në vete ka një qëllim të caktuar përse fillon me këtë folje. Jo të gjitha kanë një arsye të vetme. Kur jemi te surja Kafirun, dijetarët kanë bërë këto përsiatje:

- Kjo sure fillon me këtë folje që të mos mendojë dikush se Muhamedi (a. s.) është ai i cili i ka caktuar vijat e kuqe, të cilat e ndajnë besimin nga mosbesimi, dhe se ai i paska quajtur ata jobesimtarë. Jo, folja *thujaj* në fillim tregon se këto janë gjëra 'për të cilat unë nuk e kam bërë zgjedhjen; unë vetëm duhet t'i them'. Pra, kjo na jep edhe një mësim tjetër, se në çështjet që janë e drejtë e Zotit dhe e drejtë e njerëzve ne nuk kemi të drejtë ta themi mendimin tonë, apo të veprojmë sipas hamendjes sonë, por duhet t'u nënshtrohemi parimeve të përgjithshme që i ka përcaktuar Zoti (xh. sh.).
- Siç thamë pak më parë, surja paraprake, Keuther, tregon 'nënçmimin' që ata ia bënë Muhamedit (a. s.), kinse ai qenka farësosur dhe nuk do t'i përmendet emri; e nëse menjëherë surja Kafirun do të fillonte pa foljen "Thujaj!", atëherë jobesimtarët do ta llogaritnin si ligjërim tendencioz dhe hakmarrës, andaj do të thoshin: "Për atë që ne i thamë farësosur, ai na quajti jobesimtarë"; bile, do ta akuzonin se e shfrytëzoi peygamberllëkun për t'i mposhtur kundërshtarët. Kjo, gjithashtu, na mëson se edhe kur sulmohemi ose kur ofendohemi, nuk duhet të instrumentalizojmë fenë apo idealet tona, vet-

ëm e vetëm për ta mbrojtur vetveten, por thjesht duhet të paraqesim atë që është drejtësi, pra me: *thuj!* d.m.th. ta paraqesim atë që e thotë dikush tjetër dhe jo ne vetë ta ndajmë drejtësinë;

- Një arsye tjetër është se ligjërimi kuranor është një ligjërim i bekuar dhe privilegjues. Zakonisht ata të cilët thirren drejtpërdrejt nga ana e Zotit (xh. sh.) janë privilegjuar, siç është rasti i besimtarëve, të cilëve u drejtohet pa foljen *thuj!* E, pasi këtu flitet për pabesimtarët, atëherë refuzon t'u flet drejtpërdrejt, sepse ata nuk e njohin Atë dhe kështu nuk meritojnë të pranojnë drejtpërdrejt ligjërimin hyjnor. Pra, pabesimtarët nuk kanë nderin që të flasin drejtpërdrejt me Krijuesin (xh. sh.), por ai ua dërgon mesazhet vetëm përmes njerëzve.<sup>77</sup>

Përveç dhënies së foljes në mënyrën urdhërore, ajo po ashtu është dhënë në njëjës.

Sigurisht, nëse e lexojmë gjithë Kuranin, do të shohim se kjo folje na paraqitet në njëjës, në dysi (kur janë dy veta) dhe në shumës. Me njëjës i drejtohem një individ, me dysi dy vetave dhe me shumës u drejtohem më shumë se dy individëve.

Në suren Kafirun, siç shohim, folja *thuj!* është dhënë në njëjës, për të cilën një pjesë e komentuesve të Kuranit thonë se është vetëm për Muhamedin (a. s.), prandaj shumë njerëz e kanë përkthyer "Thuj (o Muhamed)...", kurse të tjerët thonë se ky ajet është e vërtetë se ka zbritur për Muhamedin (a. s.), mirëpo dispozita e tij vlen për gjithë njerëzimin.

---

<sup>77</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 137.

Grupi i dytë i pyet të parët: pasi ajeti është vetëm për Muhamedin, a nuk kishte mundësi Zoti ta përmendte edhe emrin Muhamed? Kurse grupi i dytë pyet: nëse ky ajet u drejtohet të gjithë njerëzve, a nuk kishte mundësi Allahu ta sillte foljen në shumës, *thuani*? Nëse do të kishte ndodhur njëra ose tjetra, atëherë nuk do të ishte surja shumëkuptimshe siç është tani, sepse nëse do të thuhej “thuaj, o Muhamed...”, atëherë i përjashtonte gjithë njerëzit tjerë; e nëse do të ishte në shumës “thuani”, atëherë thënia jonë dhe thënia e Muhamedit (a. s.), në fushën e thirrjes islame, do të ishin në një nivel, gjë që është krejt e pamundur, dhe shumësi gjithash-tu do ta shmangte përgjegjësinë individuale të secilit. Pra, me trajtën e shumësit secili do të mbështetej te tjetri, kurse njëjësi e obligon secilin që të mbajë përgjegjësinë për thënien e parimeve themelore të besimit apo të rendit shoqëror.

Shkurt-thënë, me njëjësin *thuaj* secili merr obligim individual, duke e marrë për shembull individualitetin e vetë Muhamedit (a. s.), kurse me shmangien e trajtës së shumësit, me *thuani*, përjashtohet paralelizmi ynë me Muhamedin (a. s.).

### Përse shumësi i rregullt?

Një nga kategoritë gramatikore të emrit është numri. Në gjuhën arabe emrat kanë numrin njëjës, dysinë dhe numrin shumës. Vetë shumësi ka dy ndarje kryesore: shumësin e rregullt dhe shumësin e parregullt. Veçori e gjuhës arabe është se një fjalë mund të ketë më shumë se një shumës.

Pikërisht e tillë është fjala كَافِرٌ *jobesimtar*. Ajo ka disa trajta në shumës: كَافِرُونَ *jobesimtarë* (shumës i rregullt), كُفَّارٌ dhe كُفْرَةٌ *jobesimtarë* (shumës të parregullt).

Përzgjedhja e një shumësi në vend të tjetrit, për përdorim të përditshëm, në gjuhën arabe janë të barabarta - pra, cilën trajtë ta përdorësh, është njësoj, kurse në përdorimet kuranore ato kanë dallime në nuanca të imëta.

Në Kuran shumësi *كافرونَ* *jobesimtarë* përfshin një grup njerëzish të cilët nuk u besojnë parimeve islame dhe kaq. Trajta tjetër e shumësit *كُفَّارَ* *jobesimtarë* përfshin një grup njerëzish të cilët nuk u besojnë parimeve islame, që përpiqen t'i luftojnë ato dhe që propagandojnë kundër myslimanëve. Trajta tjetër e shumësit, ndërkaq, *كُفْرًا* *jobesimtarë*, përfshin grupin e mëparshëm, veçse këta janë edhe të kategorisë së kriminelëve.

Tani, pasi e sqaruam dallimin mes trajtave të shumësit, atëherë shumë lehtë kuptohet përse në suren Kafirun është përdorur trajta e parë (*كافرونَ*). Kjo sure e sqaron besimin e jobesimtarëve; thjesht, i përshkruan cilësitë besimore të atij grupi të njerëzve, pa i cilësuar si propagandues të së keqes apo si kriminelë. Gjithashtu, kjo sure flet për dialog, gjë e cila tregon se Muhamedi (a. s.) në dialog ishte tepër i kujdesshëm, pra dialogonte vetëm për cilësitë e tyre besimore, e jo t'i quajë ata si qufarë/kuffar (*jobesimtarë* keqbërës apo propagandues), sepse kjo do t'i nënçmonte ata dhe dialogu nuk do t'i jepte frytet, apo Muhamedi (a. s.) nuk do ta zbatonte atë që është urdhëruar: "Polemizo me atë që është më e mirë".

Shpeshherë bëhen keqkuptime të ajeteve kuranore, p.sh. disa prej tyre:

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ... (الفتح، 29)

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ جَاهِدِ الْكُفَّارَ وَالْمُنَافِقِينَ وَاغْلُظْ عَلَيْهِمْ... (التوبة، 73)

Në suren Fet'h tregohet se Muhamedi (a. s.) është i ashpër me Qufarët (Kuffar) dhe jo me Kafirunët, sepse qufarët janë ata që propagandojnë kundër Islamit dhe janë njerëz që i shqetësojnë besimtarët.

Po ashtu, edhe në suren Teube Muhamedi (a. s.) urdhërohet që t'i luftojë Qufarët (Kuffar) dhe jo Kafirunët, sepse qufarët janë ata që nuk besojnë dhe i shqetësojnë besimtarët.

Këto ajete, ndërkaq, bëjnë dallim edhe në mes vetë mosbesimtarëve, të cilët nuk trajtohen në një nivel. Pra, thirrja në suren Kafirun me shumësin **كٰفِرُوْنَ** është forma më e butë dhe thjesht i tregon cilësitë reale mosbesuese të tyre.

### **Krenaria është në fe**

Dialogu në suren Kafirun zhvillohet rreth adhurimit, kurse në fund përfundon me dallimin mes feve. Pasi flitet për adhurim, atëherë dialogu ka pasur mundësi të përfundojë edhe me këtë: "ju keni zotat tuaj, e unë kam Zotin tim", mirëpo përcaktor u mor feja: "Ju keni fenë tuaj, e unë fenë time".

Feja është veçuar ngase adhurimi është pika kulmore e manifestimit të fesë, pra, adhurimi, në kuptimin e gjerë të fjalës, është thelbi i fesë, sepse, më në fund, ky është edhe qëllimi i krijimit tonë.

Gjithashtu, ka një arsye tjetër përse Allahu (xh. sh.) e përfundoi këtë sure me fjalët: "Ju keni fenë tuaj, e unë fenë time". Adhurimi është nënshtrim ndaj Krijuesit dhe kulm i manifestimit të fesë, mirëpo vetë feja përfshin shumë gjëra: moralin, adhurimin, besimin..., prandaj, edhe pse debati u zhvillua për diçka të veçantë (adhurimin), Muhamedi (a. s.)

u krenua me të përgjithshmen, pra me sistemin e quajtur fe. Kjo u bën me dije të tjerëve se ne nuk duhet të dallohemi vetëm në ibadet, por komplet në manifestimin e fesë duhet të jemi ndryshe nga të tjerët. Pra, nëse duhet të krenohemi, duhet të krenohemi me një fe (sistem) të mirë, dhe jo vetëm me një ibadet të caktuar.

### **Të gjithë kanë një pikë referimi**

Në kohën kur u dërgua Muhamedi (a. s.), hebrenjtë besonin se Uzejri është bir i Zotit, të krishterët besonin se Isa është bir i Zotit, kurse mekasit, të thirrur në fenë e Ibrahimit, filluan dhe shpikën diçka të ngjashme si hebrenjtë dhe të krishterët - filluan të besojnë në idhujt, për t'i afruar te Zoti dhe kështu e deformuan fenë e pastër të Ibrahimit (a. s.). Pastaj, kur Muhamedi (a. s.) u dërgua peygamber, i cili pohonte se thërret në fenë e Ibrahimit (a. s.), mekasit u habitën dhe filluan ta kundërshtojnë, me pretekstin se vetë ata ishin ndjekësit e Ibrahimit (a. s.). Disa prej tyre, ndërkaq, pasi e vërejtën afërsinë dhe referimin e njëjtë (tek Ibrahimit), i kërkuan Muhamedit (a. s.) që një vit ta adhurojnë Allahun (i cili ishte i njohur për ta) dhe një vit zotat (idhujt) e tyre.

Kjo na mëson se mekasit e humbën besimin e pastër të Ibrahimit duke u munduar që t'i imitojnë të tjerët. Pra, sa herë që dikush përpiqet të imitojë të tjerët, duhet të jetë i vetëdijshëm se ka lënë pas dore diçka të veten, autoktone.

Gjithashtu, prej saj kuptojmë se mekasit dhe Muhamedi (a. s.) i referoheshin të njëjtit burim - fesë së Ibrahimit, por dallimi ishte shumë i madh, gjë e cila na mëson se ka një dallim të madh të thirresh në diçka dhe të jesh vërtet pjesë e një realiteti. Pothuaj e njëjta situatë na paraqitet edhe sot.

Shumë sekte islame thirren se janë myslimanë apo grup i shpëtuar, por sa janë në të vërtetë, është krejt diçka tjetër - edhe pse referimi i të gjithëve është se ndjekin Kuranin dhe Sunnetin.

Të njëjtën e gjejmë edhe në spektrin shoqëror - të gjithë thirren në parimet e demokracisë, por divergjencat dhe luftërat nuk ndalen, sepse dikush vërtet nuk është brenda atyre parimeve demokratike në të cilat thirret.

Pra, kjo sure na mëson që vazhdimisht ta rishikojmë vetveten brenda vlerave islame dhe jo, thjesht, vetëm të thirrmi në to.

Përse te fjala دين *dini* ka rënë për emri J (ي)?

Kjo ka ndodhur në suren Kafirun, në ajetin e fundit لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ “ju keni fenë tuaj dhe unë fenë time”. Te fjala e fundit دِينِ, “fenë time”, ka rënë shkronja J, por vokali kesre (I) e mban kuptimin e njëjtë, “fenë time”, dhe tregon se këtu ka rënë shkronja J.<sup>78</sup>

J-ja është përemër pronor i rasës kallëzore, ku në këtë sure ka rënë, por nuk e ka humbur kuptimin; në suren Junus 104 dhe Zumer 14, ndërkaq, fjala është dhënë në formën e plotë, دِينِي, me J. Në vazhdim do t’i japim të tri këto ajete:

• قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِن كُنْتُمْ فِي شَكٍّ مِنْ دِينِي فَلَا أَعْبُدُ الَّذِينَ تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ  
وَلَكِنْ أَعْبُدُ اللَّهَ الَّذِي يَتَوَقَّعُكُمْ وَأُمِرْتُ أَنْ أَكُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ (Junus, 104)

• قُلْ اللَّهُ أَعْبُدُ مُخْلِصًا لَهُ دِينِي (Zumer, 14)

• لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ (Kafirun, 6)

Pra, siç duken, të tri ajetet e kanë të njëjtën fjalë, por dy

<sup>78</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Kafirune*,  
[https://www.youtube.com/watch?v=dqL2s\\_XHjCs](https://www.youtube.com/watch?v=dqL2s_XHjCs).

të parat e kanë me J-në e pronësisë për vetën e parë, kurse Kafiruni e ka vetëm me kesren në fund, e cila gjithashtu nënkupton J-në e vetës së parë, pra: “feja ime”. Meqë forma standarde është me J, atëherë paraqitja e një forme ndryshe në suren Kafirun sigurisht jep edhe një kuptim shtesë, ngase në Kuran nuk ka asgjë rastësisht.<sup>79</sup>

Në suret Junus dhe Zumer kryesisht është folur për adhurimin e Zotit, pra për shmangie adhurimeve të tjera dhe adhurim vetëm të Allahut, prandaj nuk është shkurtuar fjala, kurse në suren Kafirun nuk është përmendur adhurimi i Allahut, por thjesht janë paraqitur qëndrimet e të dy palëve: as njëra nuk e adhuron Zotin e të njëjtës palë dhe as tjetra nuk i adhuron zotat e palës tjetër, pra këtu është i theksuar mosveprimi; bile, nëse i shohim, të gjitha fjalitë janë mohuese, me të cilën tregohet një akt mosveprimi, prandaj këtë mosadhurim të Allahut Allahu e ka treguar edhe përmes mungesës së J-së, kurse në dy suret paraprake J-ja është e evidente, sepse aty favorizohet veprimi për adhurim.

---

<sup>79</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 147.



## SURJA EN-NASR – سُورَةُ النَّصْرِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ ﴿١﴾ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا ﴿٢﴾ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَأَسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا ﴿٣﴾﴾

“(1) Kur vjen ndihma e Allahut dhe fitorja, (2) dhe i sheh njerëzit të hyjnë në Fenë e Zotit grupe-grupe, (3) thuri lavde të Zotit dhe kërkoji falje. Ai pranon pendimin dhe Falja e Tij është e Madhe.”

Përveç lidhshmërisë me suret pasuese, ato kanë lidhshmëri edhe me suret paraprake. Pra, sigurisht edhe surja Nasr ka një lidhshmëri të fortë me suren Kafirun para saj.

Surja Kafirun përfundon me ajetin “Ju keni fenë tuaj e unë fenë time”, kurse surja Nasr fillon dhe flet për fitoren, për ngadhënjimin dhe hyrjen turma-turma të njerëzve në fe. Nëse e analizojmë ajetin e fundit të sures Kafirun, atëherë do ta gjejmë ajetin më madhështor për lirinë e të drejtës së besimit - se Islami nuk imponon asnjë lloj besimi, por thjesht ta respekton përzgjedhjen. Menjëherë pas këtij ajeti vjen surja Nasr, që do të thotë se në rastet kur në botë sigurohet liria e besimit, ngadhënjyes është Islami dhe atëherë njerëzit hyjnë në fe turma-turma.

Pra, nëse myslimanët dëshirojnë fitore dhe çlirim, një parakusht është që të sigurohet liria e besimit. Po ashtu, nëse i hedhim një vështrim sures Kafirun, do të shohim se aty janë paraqitur qartë qëndrimet e të dyja feve, pa u manipul-

uar me to, ndërsa njerëzit pastaj e zgjodhën Islamin dhe hy-në me shumicë, sepse e kishin të qartë ofertën. Sot, ndërkaq, bota vuan për këtë pamje të qartë të feve, veçanërisht për Islamin, sepse nga mediat ato paraqiten të shtrembëruara dhe në forma të ndryshme. Pra, kur ne t'i përgatisim kushtet që në botë fetë të paraqiten në formë transparente, njësoj si në suren Kafirun, vetëm atëherë do të kemi mundësi për ndihmë të Zotit dhe për fitore ashtu siç është dhënë në sur-en Nasr.

Disa dijetarë thonë se Kurani konsiderohet si një sure apo ajet i vetëm, pra lidhen të gjitha me të gjitha. Nëse e lidhim ajetin e fundit të sures Kafirun dhe ajetin e parë të sures Nasr, "Ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time, kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi", lidhja e këtyre dy ajeteve të jep të kuptosh se pasja e fesë dhe manifestimi i saj tërësisht është i mundur vetëm pasi të kesh ndihmën e Allahut dhe pasi të jesh i çliruar.<sup>80</sup> Kjo nuk do të thotë që pa çlirim nuk ka fe, por ajo është më e zbehtë dhe më vështirë e realizueshme, ashtu siç jemi duke e përjetuar myslimanët në mbarë botën. Pra, fe me plotë gojën mund të thuash që ke vetëm pasi të ketë mbërritur çlirimi.

Ç'lidhje ka fitorja dhe kërkimi i faljes?

Kjo sure e shkurtër, sipas shumë transmetimeve, është surja e fundit e zbritur komplet. Këtu flitet për fitoren e myslimanëve dhe çlirimin e Mekës, por në të njëjtën kohë i paralajmëron sahabët se Muhamedi është në fund të misionit të tij dhe dalëngadalë po largohet nga kjo botë.

Përvoja e hidhur historike na ka mësuar që fitoret dhe

---

<sup>80</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nasr*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=M6C6-JuO4KY>.

ngadhënjimet të përfundojnë me kryelartësi dhe diktaturë. Shembuj të këtillë kemi nga historia e afërt dhe e largët, prandaj Allahu i Madhërishëm menjëherë pas fitores kërkon që robi të jetë i nënshtruar dhe i përlulur, siç ishte Muhamedi (a. s.) ditën e çlirimit të Mekës apo pas saj. Pra, këtu duket pse Allahu porositi tesbih dhe istigfar pas fitores, sepse tesbihi dhe istigfari në vetvete përmbajnë nënshtrim, përlulje, dëgjueshmëri, korrektësi etj.<sup>81</sup>, e në të njëjtën kohë e luftojnë kryelartësinë, mendjemadhësinë, egon e tepruar etj.

### **Përdorimi i foljes جاء dhe urdhërorja**

Folja جاء d.m.th. *ka ardhur* ose *erdhi*. Në Kuran, përveç foljes جاء, përdoret edhe folja أتى, me kuptimin *ka ardhur* ose *erdhi*. Parashtrohet pyetja: ku është dallimi mes këtyre dy foljeve dhe përse në këtë sure është përdorur kjo formë?

Pothuajse në tërë Kuranin folja جاء tregon një ardhje të vështirë dhe me sakrificë, prandaj kjo folje nuk ka ardhur në kohën e tashme dhe në mënyrën urdhërore askund në Kuran, sepse Allahu do që vështirësia t'i mbetet të kaluarës. Kurse folja أتى tregon një ardhje të lehtë dhe pa vështirësi.

Dallimi i nuancave kuptimore, të imëta, mes këtyre dy foljeve, pothuajse sinonimike, të bën të kuptosh edhe arsyen e përdorimit të foljes جاء në fillim të kësaj sureje. Pasi Allahu i Madhërishëm flet për fitore dhe për ngadhënjim, përdorimi i kësaj folje tregon se fitorja është një çështje që vjen me vështirësi dhe me mund, jo siç pretendon dikush, me aq

---

<sup>81</sup> Uvejð el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nasr*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=M6C6-JuO4KY>.

lehtësi.

Përveç foljes së kohës së kaluar, në këtë sure kemi edhe folje në mënyrën urdhërore.

Kjo sure, siç u potencua më parë, është sure e fitores; fillimisht, për fitoret e Muhamedit (a. s.), por edhe për të gjitha fitoret që realizon gjinia njerëzore në botë. Zakonisht dështimet më të mëdha vijnë kur pas fitoreve formohet një klimë përtacie dhe inferioriteti, kinse puna paska përfunduar me fitoren, mirëpo Allahu (xh. sh.) e kërkon të kundërtën, sepse menjëherë pasi shpall fitoren në fillim të sures, fillon dhe i paraqet dy folje në mënyrën urdhërore, *لَارْتَسُوا* *lartëso!* dhe *اسْتَغْفِرُوا* *kërko falje!*, ashtu që njeriu të mos ulet këmbëkryq dhe të bëhet përtac, por të angazhohet për ta ruajtur dhe për ta kultivuar fitoren e arritur. Forma urdhërore e këtyre dy foljeve e lufton përtacinë dhe neglizhencën, kurse kuptimet e tyre e luftojnë kryelartësinë dhe vetëpëlqimin. Pra, mund të themi se forma e këtyre foljeve e nxit trupin, kurse kuptimi i tyre e inkurajon shpirtin dhe e bën modest.

### Udha e suksesit

Pasi vetë emri i kësaj sureje është *Ndihma*, atëherë është e sigurt se kjo e ndihmon besimtarin në shumë punë. Në këtë sure janë renditur në formë të shkëlqyer etapat e ngjites drejt suksesit.

1. Fillimisht Allahu (xh. sh.) e ka përmendur *نَصْرٌ* *ndihmën* d.m.th. se për të kryer një punë të caktuar, paraprakisht duhet ndihmë. Punët e mëdha asnjëherë nuk kryhen individualisht dhe pa përkrahje.

Kur jemi te *ndihma*, meriton të thuhet se edhe ajo ka nivelet e saj. Për të qenë i suksesshëm në jetë, ajo duhet

kërkuar nga dikush që është më i mirë, më i fortë, më i mençur etj. Prandaj, Allahu (xh. sh.) në këtë sure thotë *نَصْرُ اللَّهِ ndihma e Allahut*; nuk ka përmendur ndonjë emër tjetër të Tij, sepse vetëm përmes këtij emri mund të sigurohet ndihma universale, kurse emrat tjerë të Tij kanë të theksuar vetëm nga një cilësi të Zotit. Pra, ndihmë llogaritet kur dikujt i siguron krejt çfarë i duhet në atë rrugëtim dhe jo thjesht t'i ofrohet diçka që nuk hyn në punë.

2. Pastaj hapi i dytë është *الْفَتْحُ* çlirimi. Pas ndihmës, menjëherë duhet pasuar çlirimi nga pengesat e mundshme. Prandaj, në ajet nuk përmendet çlirimi i kësaj apo asaj, por thjesht: çlirimi. Nëse dikush nuk ka përkrahje, nuk mund të çlirohet nga një ves, nga një punë apo qoftë edhe nga një armik.
3. Pasi të realizohen dy të parat, ndihma dhe çlirimi, vetëm atëherë vjen në shprehje suksesi dhe i sheh njerëzit duke hyrë në fenë e Zotit turma-turma.

Pra, këto janë tri etapat përmes të cilave njeriu i mbërrin synimet dhe sukseset në jetë. Veçanërisht kur flitet për perspektivën e myslimanëve, nëse nuk ndiqet kjo hierarki, atëherë dështimi është në prag.

Po të analizohet kjo sure, do të dalë në pah se çelësi i gjithë këtij procesi është si të ndillet ardhja e ndihmës së Allahut. Pra, enigma kryesore është: si të fitohet ndihma e Allahut?!

Përgjigjja e gjithë kësaj shpjegohet me pozicionin e vendosjes së kësaj sureje në mus'haf dhe me kohën e zbritjes së saj. Ashtu siç shihet, kjo sure ka zënë vend pothuajse në fund të mus'hafit. Gjithashtu, ajo është surja e fundit që kom-

plet i ka zbritur Muhamedit (a. s.). Pra, kjo na tregon se të dy dimensionet e saj - ai kohor dhe pozicional - janë në fund, që do të thotë se ndihma e Allahut vjen në shprehje vetëm në fund, pas një lodhje dhe mudi të vazhdueshëm, siç i erdhi Muhamedit (a. s.) ndihma e Allahut dhe çlirimi i Mekës në fund të jetës së tij.

Pra, nëse i hedhim një vështrim sures Nasr, atëherë do të kemi mundësi t'i japim përgjigje pyetjes se përse Zoti e përmendi tesbihun, istigfarin dhe teuben në pjesën e dytë të sures, d.m.th. pas tri etapave të thëna më lart.

Nëse në një mjedis punohet që të fitohet ndihma e Allahut, vjen çlirimi nga çdo e keqe: njerëzit hyjnë në fe grupe-grupe dhe në fund pason edhe ibadeti (tesbihi, istigfari dhe teubeja). Nëse nuk ka mirëqenie dhe nëse nuk kalohet procesi i mësipërm, atëherë edhe ibadeti nuk do të jetë shumë efikas.

### **Përdorimi i foljes رَأَيْتَ**

Ashtu si çdo fjalë tjetër, edhe folja رَأَى e ka funksionin dhe rolin e vet në këtë sure. Ato janë:

Kjo tregon se Muhamedi (a. s.) do ta shohë vetë suksesin e punës së tij; bile, do ta shohë gjithë bota se misioni i Muhamedit (a. s.) nuk ishte mision i kotë dhe i fshehtë, por ishte mision të cilin sot mund ta shohë çdokush.

Kjo, njëherësh, tregon se Muhamedi (a. s.) e filloi, e zhvilloi dhe e përfundoi me sukses misionin e vet.

Në çlirimin e Mekës e pranuan Islamin shumë njerëz dhe xhinde, mirëpo Allahu (xh. sh.) në këtë sure i përmend vetëm njerëzit, sepse pas foljes رَأَيْتَ nuk vjen fjala xhinde, ng-

ase ato nuk shihen.

### Fjala النَّاسَ “njerëzit” dhe folja يَدْخُلُونَ “hyjnë”

Nëse e analizojmë kuptimin e fjalës نَاسٌ “njerëz”, ajo përfshin: njerzillëkun, mençurinë, aftësinë e perceptimit dhe predispozitën për ta pranuar të vërtetën. Pra, para se njeriu të hyjë në Islam, paraprakisht duhet të jetë njeri me kuptimin e plotë të fjalës njeri. Për ta dalluar se ata që hyjnë në fe a janë apo nuk janë njerëz në kuptimin e plotë të fjalës, këtë e tregojnë ajetet në vazhdim: pra, nëse ai që ka hyrë në fe nuk kërkon falje, nuk pendohet etj., d.m.th. nuk është modest dhe është kryelartë, atëherë demonstroi një fe pa njerzillëk dhe pa mençuri.

Në këtë sure fisnike, edhe pse bëhet fjalë për një ngjarje në të kaluarën, përsëri në ajetin e dytë është dhënë një folje e kohës së tashme يَدْخُلُونَ ‘hyjnë’. Kjo, për disa arsye:

- Hyrja e njerëzve në Islam është proces i cili do të vazhdojë deri në ditën e fundit të kësaj bote, prandaj është dhënë në kohën e tashme, sepse koha e tashme shpreh një veprim të vazhdueshëm;
- Dhënia e kësaj folje në kohën e tashme tregon se Muhamedi (a. s.) zhvilloi një mision i cili nuk lë efekte vetëm në të kaluarën, por veprimet e tij vazhdojnë të reflektojnë përgjithmonë. Kjo na mëson se punët që i kryejmë duhet të përqipemi që efektin ta kenë shumë afatgjatë dhe jo vetëm me rezultate të momentit.

Përse ‘hyjnë në fe’ dhe jo ‘e pranuan fenë’?

Pranimi i fesë është hapi i parë që e bën njeriu kundrejt

Islamit, e pastaj pasi e pranon, hyn dhe krijon një siguri në të. Allahu pranimin e Islamit e ka shëmbëllyer me hyrjen, sepse hyrja brenda një vendi nënkupton sigurinë dhe qetësinë. Pra, Allahu (xh. sh.) në suren Nasr nuk e tregon thjesht hyrjen në fe të atyre që kanë hyrë, por edhe ndjenjën e sigurisë që kjo fe i dha njerëzimit atëherë, sot dhe çdoherë.

### Tri begati përballë tre urdhrave

Allahu i Madhërishëm njeriut i ka falur shumë begati, por në suren Nasr janë numëruar tri prej tyre: ndihma, çlirimi dhe hyrja në Islam, pas të cilave menjëherë ka sjellë tri obligime të tjera: تَسْبِيحٌ madhërimin, حَمْدٌ falënderimin dhe اسْتِغْفَارٌ kërkimin e faljes. Pra, 'nëse Unë të kam ndihmuar, t'i më madhëro سَبِّحْ nëse Unë ta kam mundësuar çlirimin, atëherë falënderomë بِحَمْدِكَ dhe nëse Unë të kam falur mundësinë e hyrjes në fe, ti kërkko falje اسْتَغْفِرْ.<sup>82</sup>

Pra, këtu duket qartë se përballë tri begative janë dhënë tre urdhra, përmes të cilëve begatitë e mëparshme do të ishin jetëgjatë dhe funksionale; e nëse ato nuk realizohen, atëherë vjen në shprehje vetëpëlqimi dhe kryelartësia - kinse nuk kemi nevojë për ndihmë, se çlirimet i bëjmë vetë dhe se ne jemi ndihmësit e Islamit, e jo Islami ndihmësi ynë. Si pasojë e mosrespektimit të kësaj lidhshmërie, Allahu (xh. sh.) na tregon se do të na ngjajë ajo që i ngjau xhaxhait të Muhamedit (a. s.), për të cilin menjëherë në suren në vijim thuhet: "Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe iu thanë!".

Këto begati ishin privilegj për Muhamedin (a. s.) dhe

<sup>82</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nasr*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=M6C6-JuO4KY>.

për të gjithë besimtarët.

Krijuesi i gjithësisë, Allahu (xh. sh.), në suren paraprake (Kafirun) tregon ballafaqimin e Muhamedit (a. s.) me jobesimtarët, ku njëherë e përgjithmonë vendoset vija dalluese mes besimit dhe mosbesimit. Pasi kjo sure është sure e trishtueshme për besimin e njeriut, Allahu (xh. sh.) menjëherë jep një përgëzim me suren Nasr për ndihmë, për fitore dhe për Islam masiv.

Fillimi i kësaj sureje është një privilegj tjetër për Muhamedin (a. s.), ku i thuhet: “E kur të vijë ndihma e Allahut dhe fitorja” - pra, nuk i kërkohet angazhim ekstra për ta arritur fitoren (sepse këtë e kishte bërë më parë), por i thuhet se ajo do t’i vijë (si dhuratë) nga Zoti (xh. sh.).

Kjo tregon se pasi besimtari ta ketë kryer punën e vet, më pastaj ndihma e Allahut vjen në formë të përkryer; njësoj siç është dhënë në ajetin 31 të sures Kaf, ku thuhet: (وَأَرْزُقْهُ) (الْجَنَّةُ لِلْمُتَّقِينَ), “dhe Xheneti u afrohet të devotshmëve”, e jo “të devotshmit i afrohen Xhenetit”, sepse tani flitet për momente shpërblimi-e Allahu (xh. sh.) kur e shpërblen dikë, nuk e mundon aspak. Pra, vetë akti i afrimit diku sadopak kërkon një lloj mudi, e Allahu (xh. sh.) kur do t’ua japë shpërblimin final të devotshmëve, sikur u thotë: “Jo, ju rrini rehat, nuk duhet ju të shkoni te xheneti, por ai vetë ju afrohet juve.”



## SURJA EL-MESUD – سُورَةُ الْمَسَدِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ ۝۱ مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ ۝۲ سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ ۝۳ وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ ۝۴ فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ ۝۵﴾

“(1) *Iu thafshin duart Ebu Lehebit, qoftë mallkuar!* (2) *Nuk i bënë dobi malli e ç’ka fituar* (3) *përballë zjarrit të flakëruar.* (4) *Dhe e shoqja, nxitëse-gojëlëshuar,* (5) *në qafë një konop lakuar.*”

Para se të bëhen analiza të detajuara për brendinë e sur-eve, fillimisht do të dallojmë disa lidhshmëri të kësaj sureje me atë paraprakën:

1. Surja Nasr tregon se njerëzit hyjnë në Islam grupe-grupe, d.m.th. se Muhamedi (a. s.) është në fund të jetës, bile është surja e fundit e zbritur komplet. Kurse, surja Mesud tregon fundin e Ebu Lehebit. Pra, dy sure: njëra tregon fundin e njeriut të mirë dhe tjetra tregon fundin e njeriut të keq. Kështu, Kurani na paraqet dy forma të përfundimit të jetës, ndërsa neve na mbetet që ta zgjedhim një tërë prej tyre.

2. Surja Nasr flet për fitore, për çlirim dhe për hyrje në Islam turma-turma, kurse surja Mesud tregon se e gjëja që mund ta ndalë fitoren, çlirimin dhe hyrjen në Islam turma-turma është shpifja dhe dezinformimi, të cilat mund t’i sjellin mediat (propaganduese), njerëzit si Ebu Lehebi dhe gru-

aja e tij.<sup>83</sup>

3. Surja Nasr përfundon me fjalën **نَاصِرًا** “pranues i madh i pendimeve”, kurse surja Mesed fillon menjëherë me një mallkim. Kjo, edhe pse tregon mëshirën e pakufishme të Allahut, përsëri janë punët e vetë njeriut ato të cilat e nxjerrin njeriun nga kjo mëshirë, veçanërisht kur janë punë të cilat kanë ndikim në interesin e përgjithshëm. Pra, Allahu është Falës i Madh, por ata që përpiqeshin që ta shuajnë dritën e Islamit, që i keqinformonin njerëzit dhe që ishin kundër një misioni i cili do të kontribuonte për vendosjen e një rendi në botë, Allahu nuk i përfshiu në mëshirën e Vet.

Po ashtu, surja Nasr përfundon me fjalën **نَاصِرًا**, kurse surja Mesed fillon me fjalën **عَسَ**. Nëse i analizojmë shkronjat rrënjësore të këtyre dy fjalëve, do të shohim se njëra e ka rrënjën **نَوَبَ**, kurse tjetra **نَبَبَ**, d.m.th. ato dallojnë vetëm në shkronjën e mesme rrënjore. Kjo na jep të kuptojmë se mes mëshirës (pendimit) të Zotit dhe mallkimit (shkatërrimit) dallimi është shumë i vogël.

### Disa dilema rreth sures Mesed

Të habit fakti që një sure e tërë, edhe pse e shkurtër, zbret vetëm për Ebu Lehebin dhe gruan e tij. Gjithashtu, është për t’u habitur edhe më shumë me zënien në gojë drejtpërdrejt të Ebu Lehebit, kur dihet se emrat e jobsimtarëve ishin shumë?! Po ashtu, është mbresëlënës fakti që kjo sure i ka ndarë dy ajete për bashkëshorten e Ebu Lehebit?! Dhe, krejt në fund, kjo sure është emërtuar me emrin “Mesed –

---

<sup>83</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Mesed*,  
[https://www.youtube.com/watch?v=O\\_IGNdL\\_t\\_8](https://www.youtube.com/watch?v=O_IGNdL_t_8).

Konopi”, gjë e cila lidhet me gruan dhe jo me vetë Ebu Lehebin.<sup>84</sup> Përse?

Për t’i deshifruar gjithë këto mistere, fillimisht duhet shfletuar historinë islame: raportin e Ebu Lehebit dhe bashkëshortes së tij me Muhamedin (a. s.). Nëse e shohim këtë të vërtetë, atëherë do të bindemi se ato nuk karakterizohen si njerëz që i kanë sjellë vuajtje me kamxhik apo me shpatë Muhamedit (a. s.). Atëherë, përse gjithë ky mallkim për këta dy njerëz?

Që në ditët e para të shpalljes, kur Muhamedit (a. s.) iu shpall ky ajet kuranor ﴿وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ﴾ “tërhiqi vërejtje rrethit tënd më të afërt”, Muhamedi i mblodhi gjithë Kurejshët në kodrën Safa dhe i ftoi në Islam, kur Ebu Lehebi e përgënjeshtrroi (mohoi).

Gruaja e Ebu Lehebit, sapo dëgjoi për Islamin, fillimisht e urdhëroi djalin që ta shkurorëzojë vajzën e Muhamedit (a. s.), pastaj vetë Pejgamberin (a. s.) e quajti “mudhemmem – i shëmtuar”, në vend “muhammed – i lavdëruar”; bile, thuri një poezi për ta nënvlerësuar Muhamedin (a. s.). Ajo filloi të ecte mexhliis në mexhliis, edhe pse ishte grua, vetëm për të shpifur dhe për ta nënçmuar Muhamedin (a. s.) dhe misionin e tij. Kështu, preokupim kryesor i saj dhe i burrit të saj u bë që njerëzve t’ua paraqesin Islamin të zymtë. Aty ku ndizej një shkëndijë e vogël dhe dukej se do të shndriste Islami, ajo dhe burri i saj vinin për ta shuar atë me shpifjet dhe gjëmat e tyre.<sup>85</sup>

<sup>84</sup> Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Beirut: Dar el-Fikr, 1981, f. 166.

<sup>85</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Mesed*,

[https://www.youtube.com/watch?v=O\\_IGNdL\\_t\\_8](https://www.youtube.com/watch?v=O_IGNdL_t_8).

Në periudhën kur Muhamedit (a. s.) nuk i erdhi shpallja për disa javë, ajo menjëherë nxori lajmin se ‘shejtani që takonte Muhamedin, tani e ka braktisur’.

Krejt për në fund, nëse ata nuk ishin njerëzit që i sillnin vuajtje me kamxhik dhe me shpatë, atëherë ata ishin njerëzit që i sollën vuajtje shpirtërore. Nëse do t’i krahasonim me kohën moderne, atëherë me plot gojë mund t’i quajmë “media kundër Muhamdit (a. s.)”. Meqë atëherë nuk kishte media për të dezinformuar, rolin e tyre e luante Ebu Lehebi me bashkëshorten e vet.

Sa herë që Muhamedi (a. s.) paraqiste një vlerë islame, ata e përgënjeshtonin, duke u paraqitur si njerëzit më të besueshëm, sepse ata ishin familjarë, të cilët e njihnin Muhamedin prej në fëmijëri. Njësoj si sot - ku shumë media paraqiten si të besueshme, por në realitet ato janë fund e krye të gënjeshtërtë.

Kjo qe arsyeja që një sure e veçantë u zbrit mu për këtë çështja, në mënyrë që ‘t’i demaskojë të gjitha mediat dezinformuese dhe të gjithë gazetarët dashakeqës’. Nëse dëshirojmë ta dimë sa është aktuale kjo sure, atëherë le të analizojmë se sa shkatërruese janë pasojat e keqinformimeve medi-atike që i jeton bota.

### **Mesedi është simbol i flijimit**

Kjo sure, sado e vogël nga vëllimi, me porositë dhe mësimet që jep është një det pa fund, që i provokon vetëm mendjet e shëndosha dhe të afta.

Çdo ideal apo dëshirë që synon njeriu ta mbërrijë në jetë kërkon një sakrificë dhe flijim të pashembullt material dhe shpirtëror. Sa më e lartë të jetë vlera e këtij objektivi, aq më i shtrenjtë është edhe çmimi i tij.

Nëse e kemi parasysh këtë që thamë më parë, atëherë kjo sure na shpalos dy segmente të rëndësishme për realizimin e një misioni të caktuar: *e para*, sakrificën e Muhamedit (a. s.), d.m.th. heqjen dorë nga nepotizmi dhe afërsia familjare vetëm për të sunduar e vërteta, dhe, *e dyta*, të dhënat e çdo gjëje nga ana e Ebu Lehebit vetëm për ta mposhtur këtë të vërtetë - sepse ai kur u mllëfos me myslimanët, tha se do ta shpenzojë gjithë pasurinë dhe familjen për ta mposhtur këtë mision, prandaj Allahu thotë: “nuk i bëri dobi pasuria e ç’ka fituar”. Në një mënyrë, pra, ai krijoi një mision të vet, apo më mirë thënë një kundër-mision.

Kjo na mëson se, pavarësisht asaj që ne dëshirojmë ta mbërrijmë në jetë, duhet që të jemi të gatshëm t’i paguajmë shtrenjtë idealet tona. Idealet që ka, një besimtar duhet të jetë në gjendje t’i paguajë shtrenjtë, sepse vetëm atëherë do të arrijë sukses në misionet e veta. Gjithashtu, kjo mund t’i japë një përgjigje modeste pyetjes: përse sot jobesimtarët kanë shumë sukses? Përgjigjja është: sepse ata janë në gjendje që ta shpenzojnë pasurinë, të shfrytëzojnë familjen dhe afërsitë familjare vetëm për t’i realizuar synimet e tyre.

### ***Jo xhaxha, por Ebu Leheb***

Parashtrohet pyetja: pasi të gjithë pejgamberët kanë pasur nga një kundërshtar nga familja e ngushtë, përse ata nuk janë përmendur me emra, kurse xhaxhai i Muhamedit (a. s.) është përmendur drejtpërdrejt me emër - Ebu Leheb?

Dijetarët kanë dhënë disa mendime. Disa prej tyre janë këto:

- a) Nëse do të përmendej fjala “xhaxha” në vend të fjalës “Ebu Leheb”, atëherë do të ishte e paqartë për cilin

xhaxha të Pejgamberit (a. s.) bëhet fjalë, sepse ai ka pasur edhe Hamzën edhe Abazin xhaxhallarë myslimanë, prandaj është dhënë emri personal i tij.

- b) Disa thonë se problemi i nepotizmit sa vjen e shtohet në shoqërinë njerëzore; në mënyrë që myslimanët të mos bien pre e kësaj ligësie, prandaj ajo është konkretizuar dhe se, absolutisht, interesi familjar nuk duhet përzier në çështjet e përgjithshme të shoqërisë islame. Pra, Kurani për xhaxhain e Muhamedit (a. s.) është i drejtpërdrejtë, në mënyrë që edhe ne të jemi të drejtpërdrejtë për ta luftuar të keqen. Kur njeriu të arrijë që edhe të keqen në familjen e vet ta luftojë drejtpërdrejt dhe barabar si te të tjerët, atëherë vjen edhe realizimi i qëllimeve dhe i kauzave të mëdha.

### Dallimi i foljes **دَمَّرَ** nga **حَسِرَ** dhe **تَبَّ**

Të tri këto folje, shikuar nga këndi i përgjithshëm, e kanë një kuptim të përbashkët, mirëpo, nëse shikohen më hollësisht, ato dallohen nga njëra-tjetra.

Disa nga arsyet përse u zgjodh fjala **تَبَّ**:

1. Folja **تَبَّ** përfshin një shkatërrim të vazhdueshëm dhe më të gjatë. Këtë kuptim nuk e përfshijnë dy foljet tjera. Ky shkatërrim ishte i vazhdueshëm: prej momentit kur zbriti ky ajet, shkatërrimi e mbuloi Ebu Lehebin dhe vazhdoi deri në vdekjen e kobshme të tij. Bile, disa mendojnë se përdorimi i kësaj folje, që përmban vazhdueshmëri, nënkupton se ky mallkim dhe ky shkatërrim do të vazhdojë të reflektojë për aq kohë sa do të ketë njerëz që do ta kundërshtojnë misionin hyjnor, siç e kundërshtoi Ebu Lehebi, ose, thënë thjesht, për aq kohë sa

do të ketë njerëz si Ebu Lehebi.

2. Disa studiues thonë se një arsye tjetër e përdorimit të kësaj folje është se kur Muhamedi (a. s.) i thirri Kurejshitet në kodrën Safa për t'i ftuar në Islam, Ebu Lehebi e kundërshtoi me fjalët **قَاتِلْكَ** "qofsh shkatërruar!", prandaj Allahu (xh. sh.), as më shumë e as më pak, e mallkoi me vetë fjalën që ai e mallkoi Muhamedin (a. s.), d.m.th. kjo na vetëdijeson se njeriu çdoherë do të korrrë atë që ka mbjellë vetë.<sup>86</sup>

Përse "iu shkatërrofshin duart!"?

Parashtrohet një pyetje: përse janë veçuar duart dhe i gjithë Ebu Lehebi, kur dihet se ai u shkatërrua krejtësisht. Janë dhënë disa mendime për këtë çështje, kuptohet të gjitha përmbajnë diçka nga realiteti:

- Disa mendojnë se me *duar* nënkuptohet i gjithë Ebu Lehebi. Ky është mendimi tradicional dhe i përgjithshëm, sepse dihet se Ebu Lehebi u shkatërrua krejtësisht.
- Një pjesë mendojnë se veçimi i *duarve* është bërë për t'i dhënë ajetit edhe kuptime shtesë. Pasi duart janë mjeti i parë i përfitimit dhe i angazhimit, mallkimi i duarve nënkupton bllokimin e aktivitetit të tij kundër Muhamedit (a. s.). Nëse ajeti do të thoshte "u shkatërroftë Ebu Lehebi", do të ishte shumë personal dhe me domethënie vetëm fizike për Ebu Lehebin, kurse dhënia e ajetit në këtë formë - "iu shkatërrofshin duart Ebu Lehebit!", edhe pse e përfshin edhe aspektin fizik, më shumë e mbulon veprimtarinë e tij. Pra, siç dihet nga historia,

---

<sup>86</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Beirut: Dar el-Fikr, 1981, f. 167-168.

Ebu Lehebi nuk u shkatërrua (vdiq) porsa u shpall kjo sure, por e vërtetë është se atij filloi t'i dështojë zbatimi i agjendës së tij për pengimin e Muhamedit (a. s.), sepse prej atë ditë kur zbriti kjo sure dhe deri sot, plani i Ebu Lehebit për ta ulur numrin e myslimanëve dobësohet shumë e më shumë, sepse numri i myslimanëve kurrë nuk është pakësuar.

- Duke pasur parasysh foljen عَبَّ، që përfshin shkatërrim të vazhdueshëm dhe fjalën يَدَا duar, mund të përfundojmë se bëhet fjalë për dështim të të gjitha aktiviteteve të këtij lloji për sa të jetë kjo botë.
- Gjithashtu, veçimi i duarve në shkatërrim është një lloj nënçmimi për Ebu Lehebin, sepse për njerëzit që janë mësuar të jetojnë me pushtet, me pasuri dhe bukuri (Ebu Lehebi i kishte të gjitha!) nuk ka nënçmim më të madh sesa t'u merret e drejta për të menaxhuar me pushtetin e tyre. Pra, Allahu fillimisht ia paralizoi aktivitetin e tij si njeri i pushtetshëm, pastaj e shkatërroi tërësisht. Ose, edhe nëse e shohim konkretisht, një njeri me krenari, nëse hyn në luftë, më mirë është të vritet sesa t'i priten duart dhe të nënçmohet.

Gjithashtu, një fuqi të veçantë shprehëse ka vetë përsëritja e foljes عَبَّ dy herë - një herë në fillim dhe herën tjetër në fund të ajetit të parë.

Nëse shihet mallkimi dhe shkatërrimi që i dëshirohet Ebu Lehebit në këtë sure, do të shohim se është paraqitur me dy folje të njëjta. Një herë në fillim të ajetit të parë thuhet عَبَّ يَدَا "iu thafshin (shkatërrofshin) duart", pastaj në fund të të njëjtit ajet përsëritet folja e njëjtë عَبَّ وَ "dhe u shkatërroua".

- a) Disa, këtë folje, në të dy rastet e konsiderojnë lutje (mallkim), që i bie të përkthehet “iu shkatërrofshin duart Ebu Lehebit dhe u shkatërroftë i tëri ai”;
- b) Kurse disa të tjerë, të parën e trajtojnë si lutje (mallkim), kurse të dytën si realizim të asaj lutjeje, që i bie të përkthehet kështu: “iu shkatërrofshin duart Ebu Lehebit dhe ai u shkatërrua.”

Cilado qoftë, tregon se në fillim Allahu ia mposhti aktivitetin, mundin dhe hapësirën e veprimit, pastaj e shkatërroi tërësisht. Kjo na mëson se aty ku ngushtohet hapësira e punës dhe e aktivitetit, sigurisht do të vijë edhe shkatërrimi i tërësishëm, nëse ne nuk punojmë për ta rikthyer hapësirën për të vepruar.

### **Llagapi Ebu Leheb**

Xhaxhai i Muhamedit (a. s.) emrin e vërtetë e ka Abduluzza, kurse pseudonimin Ebu Utbe dhe Ebu Leheb. Këtu e kemi emrin e tij të përveçëm dhe dy llagape, por parashtrohet pyetja: përse pikërisht u zgjodh llagapi Ebu Leheb?

Ebu Leheb, nëse do ta përkthenim, do të thotë “baba i flakës”. Atij iu dha ky llagap sepse ishte shumë i bukur, shkëlqente si flakë. Allahu (xh. sh.) të njëjtin llagap, “baba i flakës”, të cilin ai e përdorte pozitivisht, ia ktheu negativisht. Pra, kjo na mëson se mirësinë më të madhe që na ka fallë Zoti, nëse ne nuk jemi në gjendje ta përdorim drejt, atëherë ajo mund të kthehet në të keqen më të madhe. Prandaj, Allahu (xh. sh.) e përdori përsëri llagapin “baba i flakës”, në mënyrë që ta nënçmojë me vetë atë që ai u krenua dhe u

bë kryelartë.<sup>87</sup>

Gjithashtu, një sqarim tjetër thotë se të gjitha veprat që i bënte Ebu Lehebi shkaktonin fitne dhe shkatërrim, prandaj emërtimi më i mirë që mund t'i vihet një fitnexhiu dhe propaganduesi është “baba i flakës”, i cili në pamje është i bukur si flaka, por në brendi djeg si zjarri.

### Pasuria dhe fitimi

Allahu (xh. sh.) përmes këtij ajeti ia ndërpreu gjënë më të dashur Ebu Lehebit, por edhe të gjithë Ebu Lehebave të tjerë që do të vijnë pas tij. Secilin që do të punojë për propagandim kundër të vërtetës, do ta ndjekë kjo, pra, nuk do t'i vlejë as pasuria, as ajo që ka fituar.

Në këtë ajet janë theksuar dy humbje: pasuria dhe ajo që ka fituar. Pasuria ishte nga gjërat më të dashura për Ebu Lehebit, por atë vendosi ta sakrifikojë për mposhtjen e Muhamedit (a. s.), mirëpo, pjesa tjetër e ajetit “*dhe ajo që ka fituar*”, ia merr Ebu Lehebit edhe atë që ai nuk donte ta jepte. Kjo pjesë, “*dhe ajo që ka fituar*”, i përfshin edhe përfitimet materiale, por edhe përfitimet shpirtërore, si: famën, pushtetin dhe krenarinë. Kjo na jep të kuptojmë se njerëzit rrezikojnë gjithçka, vetëm që të mos e humbin burimin e fitimit. Ata e japin pasurinë, fëmijët dhe gjithçka tjetër, por vetëm burimi i fitimit (material dhe shpirtëror) të mos humbet.

Allahu (xh. sh.) menjëherë pas mallkimit e ka sjellë ajetin “nuk i bëri dobi malli e as ajo që ka fituar”, gjë që na tregon se mbështetja e parë për njerëzit si Ebu Lehebi është pasuria dhe fitimi.

---

<sup>87</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Mesed*,  
[https://www.youtube.com/watch?v=O\\_IGNdL\\_t\\_8](https://www.youtube.com/watch?v=O_IGNdL_t_8).

Disa dijetarë thonë se ajeti i dytë është shpjegim i të parit, pra: “iu thafshin duart”. Njerëzve të tillë duart u thahen kur u merret pasuria dhe fitimi.

Ky ajet e përshkruan njërin prej dënimeve më të trishtuara që ka parë njerëzimi. Të gjitha ajetet që e kanë përdorur foljen *يَصَلَّى* janë ajete të cilat nënkuptojnë pjekjen në zjarr - jo vetëm djegien, sepse djegia është proces që përfundon shpejt, kurse pjekja dhe rreshkja në zjarr është një proces që zgjat më shumë.

Gjithashtu, parashtrohet pyetja: përse fjala *بُرِّئَ* është e pashquar, kurse dihet çfarë është zjarri?

Kjo formë e shprehjes e mposht konceptin e jobesimtarëve për zjarrin e xhehenemit, sepse ata mendojnë se zjarri, pasi të kalojë një kohë, do të fiket, kurse ardhja e fjalës *بُرِّئَ*, e pashquar, tregon se ky zjarr që përmendet këtu është i panjohur për ju, nuk është si zjarri i dynjasë.

### **Familja e dështuar**

Kjo sure e shkurtër, përveç mësimëve të theksuara më lart, e ka të përfshirë fuqishëm edhe aspektin e funksionimit të familjes.

Nuhu (a. s.) ishte peygamber, i cili nuk e kishte djalin në rrugë të drejtë, por kjo iu tregua vetëm pas përmbytjes, sepse njëri prind, pra vetë ai, ishte në rrugë të drejtë. Gjithashtu, edhe lajmi i devijimit të gruas së Lutit (a. s.) u dha pas shkatërrimit. Bile, edhe familja e Faraonit nuk u mallkua prej në dynja, sepse gruan e kishte besimtare. Kur vjen në shprehje familja e Ebu Lehebit, ndërkaq, ajo u mallkua qysh duke qenë gjallë ata, sepse këtu ndryshon situata. Kur një

prind është në rrugë të gabuar, ka shpresë se një familje rregullohet, kurse, kur të dy janë në devijuar, atëherë dështimi dhe shkatërrimi i ardhmërisë së asaj familje është i garantuar, siç u garantua shkatërrimi i familjes së Ebu Lehebit.<sup>88</sup>

Ky bashkëpunim për të keq i Ebu Lehebit me gruan e tij e jep një porosi të fuqishme për të gjitha çiftet: që kurrë të mos bëhen bashkë në të keqe, sepse ashtu do ta shkatërrojnë familjen.

### Përdorimi i fjalës امْرَأَةٌ

Përdorimi i fjalëve në Kuran është bërë me maturinë absolute; asgjë nuk është përdorur rastësisht ose kot. Këtu është thënë “gruaja e tij” dhe jo “bashkëshortja e tij”.

Nëse i analizojmë fjalët امْرَأَةٌ “grua” dhe زَوْجٌ “bashkëshorte”, atëherë shohim se ato kanë dallime në përdorimet kur-anore:

- Grua (امْرَأَةٌ) përdoret kur nuk ka ekuivalencë mes dy palëve të çiftit, siç është rasti me امْرَأَتُ لُوطٍ وَامْرَأَتُ نُوحٍ “gruaja e Lutit dhe gruaja e Nuhut”, të cilat ishin pabesimtare, pra nuk kishin ekuivalencë me burrat e tyre. Atëherë, duke marrë parasysh këtë sqarim, ku shihet dallimi mes Ebu Lehebit dhe gruas së tij? Dallimi është se gruaja e tij nuk ishte ekuivalente me bashkëshortin, sepse ajo ishte shumë më dinake se ai, pastaj edhe në Botën Tjetër Allahu (xh. sh.) e veçon me dënim të veçantë: “do të digjet duke bartur dru dhe me një konop në qafë”. Prandaj është bërë ndarje mes tyre.

<sup>88</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Mesed*,  
[https://www.youtube.com/watch?v=O\\_IGNdL\\_t\\_8](https://www.youtube.com/watch?v=O_IGNdL_t_8).

- Disa leksikologë mbajnë mendimin se Allahu nuk e përdor fjalën زَوْج “bashkëshorte” për gruan jobesimtare, sepse, edhe nëse ajo është në një besim me burrin e vet, ata kurrë nuk mund të fitojnë statusin e “bashkëshort-it” të njëri-tjetrit.<sup>89</sup>

Pasi e kuptuam arsyen e përzgjedhjes së fjalës امْرَأَةٌ (grua), tani do të përqendrohemi në vetë fjalën حَمَّالَةٌ. Gruaja e Ebu Lehebit ishte ajo që bartte gjemba dhe fëlliqësira kudo që shkonte Muhamedi (a. s.), mirëpo përse Kurani këtë fjalë e përdori حَمَّالَةٌ “ajo që bart shumë”, të hiperbolizuar, dhe jo thjesht حَامِلَةٌ “bartëse”? Nëse analizohen momentet dhe dhimbjet që Muhamedi (a. s.) i përjetoi nga kjo grua, ato janë tepër të sikletshme. Pra, Allahu e përdori fjalën حَمَّالَةٌ “ajo që bart shumë”, sepse dëmtimi i cili për dikë mund të duket i vogël apo pak, për palën e dëmtuar mund të jetë fatal dhe shkatërrues. Pra, shpifjet e ngritura dhe barrierat e vendosura për Muhamedin (a. s.), për Ebu Lehebin dhe gruan e tij ishin gjëra të vogla, por për misionin hyjnor ishin dëm i madh, prandaj Allahu i ndëshkoi rëndë dhe atë e quajti “حَمَّالَةٌ”. Kjo i mëson njerëzimit që vetveten ta mat me peshoret e të tjerëve dhe jo me peshoren e vet; që veprimet tona t’i shohim si duken nga të tjerët dhe nga Zoti dhe jo si na duken neve.

## Kapitullimi i Ebu Lehebit

Ebu Lehebi vinte nga një familje fisnike mekase, nga

---

<sup>89</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-Tefsiru el-Kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 172.

Kurejshitet. Ishte i pasur dhe i pashëm. Pra, katër ishin vetitë e familjes së ngushtë të Ebu Lehebit: pushteti, autoriteti, pasuria dhe bukuria.

Fillimisht, vetë shpallja e kësaj sureje i dha një grusht të fuqishëm autoritetit të familjes së ngushtë të Ebu Lehebit. Ajeti i parë i kësaj sureje e paralizoi pushtetin dhe aktivitetin e tij. Pastaj ajeti i tretë e asgjësoi pasurinë dhe fitimin e tij, d.m.th. e mposhti aspektin material të tij. Në ajetet tjera, ndërkaq, Allahu (xh. sh.) e mposht edhe bukurinë e kësaj familje, sepse bukuri e familjes është gruaja. Bile, shkon edhe më larg; drejtpërdrejt e atakon edhe bukurinë e gruas – zëvendësimin e gjerdanit të dynjasë me një konop të lidhur rreth qafës në Botën Tjetër.

Të gjithë leksikologët arabë thonë se fjala **جيدٌ** përdoret vetëm për qafën, apo për grykën, kur ajo përdoret me konotacion të lavdërimit apo të stolisjes me gjëra të bukura. Atëherë parashtrohet pyetja: përse këtu përdoret me konotacion të dënimit? Përgjigjja: Allahu i Madhërishëm, siç thamë më parë, përmes fjalëve më të zgjedhura dhe me vetitë që ishin lavdërim në dynja, i ktheu dhe i përmbysi për t'i dënuar me të njëjtat në botën tjetër. Pra, dënimi bëhet edhe më i hidhur kur njeriu dënohet me gjërat me të cilat është krenuar.

“Në qafë” **عَلَىٰ جِيدِهَا** dhe jo “mbi qafë” **عَلَىٰ جِيدِهَا**

Zakonisht, arabët për vendosjen e stolive në qafë e përdorin parafjalën **عَلَىٰ** “mbi”, ndërsa në ajetin e përmendur është përdorur fjala **فِي** “në”, pra **عَلَىٰ جِيدِهَا** “në qafën e saj”.

Dallimi mes tyre është i dukshëm: **عَلَىٰ** “mbi” përdoret për diçka sipër, sipërfaqësore dhe për diçka të futur në bre-

ndi, kurse في “në” përdoret për diçka që është e brendshme apo është pjesë e saj.

Allahu (xh. sh.) e ka përdorur في “në”, në mënyrë që ajo litarin apo konopin e varur në qafën e saj në ahiret mos ta kuptojë si diçka sipërfaqësore, të cilën mund ta heqë kur të dëshirojë, por ta kuptojë si pjesë të pandarë të jetës së saj atëherë dhe të cilën nuk do të ketë mundësi ta heqë asnjëherë.

Fjala حَبْلٌ është e pashquar. Edhe pse Allahu (xh. sh.) na tregon se ky konop është prej një lloj bime, përsëri ai mbetet i panjohur për njerëzimin në këtë botë, sepse dënimi i gruas së Ebu Lehebit në Botën Tjetër, me këtë konop, do të jetë i papërshkrueshëm dhe i pakuptueshëm për njerëzimin.<sup>90</sup>

---

<sup>90</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Mesed*,  
[https://www.youtube.com/watch?v=O\\_IGNdL\\_t\\_8](https://www.youtube.com/watch?v=O_IGNdL_t_8).



## SURJA EL-IHLAS – سُورَةُ الْإِحْلَاصِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝﴾

﴿وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝﴾

“(1) Thuaj: “Allahu është Një, (2) Allahu është i Amshtar. (3) Nuk ka lindur, as është i lindur (4) dhe nuk ka të krahasuar.”

Surja Ihlas llogaritet vijë ndarëse mes besimit dhe mosbesimit, por para se të thellohemi në fushat kuptimore të vetë boshteve të sures dhe të fushave semantike që bartin vetë fjalët, fillimisht do t'i shpalosim disa lidhshmëri të kësaj me suren paraprake (Mesed):

- Surja Mesed përshkruan një nga skenat më ofenduese për njeriun - mallkimin dhe nënçmimin, ndërsa surja Ihlas paraqet lavdërimin kulmor të kësaj bote. Pra, njeriu sikur vihet para dy zgjedhjeve: të jetojë si krijesa më e nënçmuar, apo si krijesa më e dalluar, pranë më të Lavdëruarit, Allahut (xh. sh.).
- Këto dy sure na japin dy alternativa, ku njeriu e ka patjetër ta marrë njërën prej tyre: e para: mbështetja në forcat njerëzore, qofshin ato kolektive, shoqërore apo familjare, siç është dhënë në suren Mesed, ose, e dyta, mbështetja në sinqeritet (ihlas). Kjo tregon se nëse ne jemi nepotistë, nacionalistë, lokalistë etj., atëherë do ta pëso-

jmë si Ebu Lehebi dhe gruaja e tij, sepse për parim gjy-  
kues kemi marrë nacionalitetin, familjen, interesin e ng-  
ushtë etj., kurse nëse ne bëhemi ithtarë të së vërtetës  
dhe të sinqertë, atëherë do të jemi të nderuar dhe të res-  
pektuar.<sup>91</sup> Pra, besimi, interesi i përgjithshëm, parimi  
dhe sinqeriteti duhet ta mundin interesin familjar, një-  
soj si Muhamedi (a. s.) me Ihlasin (sinqeritetin) që hoqi  
dorë nga xhaxhai i tij (Ebu Lehebi).

- Surja Mesed përfundon me ajetin “në qafë me një kon-  
op lidhur (për gruan e Ebu Lehebit)” kurse menjëherë  
pas saj vjen surja Ihlas, d.m.th. po deshe ta heqësh litar-  
in prej qafe, atëherë pajisu me sinqeritet, lidhu fort për  
besimin në Zot dhe njihe mirëfilli Zotin.

### Mesedi fillon pa قل, kurse Ihlassi me قل

Surja Mesed, siç e potencuam më parë, e nënçmon kri-  
minelin apo keqbërësin, bile e përmend një rast konkret –  
xhaxhain e Muhamedit (a. s.) me bashkëshorten, prandaj  
Allahu nuk thotë “Thuaj!” në fillim. Jo sepse ishte xhaxhai i  
Muhamedit, por për shkak të parimit, që kur të përmendet  
një e keqe ose kur të nënçmohet dikush, mjafton të marrësh  
mësim ti, e jo të keqen e dikujt ta përfolsh vazhdimisht. Në  
suren Ihlas, ndërkaq, nuk përmendet emër njeriu, por flitet  
për parime, për njohjen e Zotit (xh. sh.), prandaj kërkohet  
që të flitet sa më shumë për parimet e shëndosha dhe të sin-  
qerta, në mënyrë që njerëzit të formohen komfor parimeve  
dhe jo të funksionojnë apo të marrin mësim vetëm kur dik-

---

<sup>91</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Ihlass*,  
[www.youtube.com/watch?v=BKNdHmeKL7w](http://www.youtube.com/watch?v=BKNdHmeKL7w).

ush të dështojë.<sup>92</sup>

Çfarë nënkupton folja e mënyrës urdhërore në njëjës فُلْ (thujaj!)?

- Kjo sure ngërthen parimet kryesore të besimit dhe të mirëqenies në këtë botë. Kjo e sqaron edhe qëllimin e misionit të Muhamedit (a. s.) - të njihet Zoti i Vetëm dhe pa shok. Prandaj, do të ishte dëshpëruese kjo sure pa fjalën فُلْ, sepse Muhamedi (a. s.) do të akuzohej si burim i këtyre parimeve të shëndosha, që në zemrën e njerëzve do të shfaqte dyshim. Pra, vetë fjala فُلْ është një qetësim për njerëzimin, sepse nuk mbështetemi në parime të trilluara nga mendja e njeriut, por në parime të shëndosha dhe hyjnore.
- Gjithashtu, kjo na mëson që çdoherë kur të bëjmë një punë madhore, duhet të jemi të kujdesshëm që të mos mbështetemi në mendime individuale, të cilat burojnë nga njeriu, por të kapemi për parime të përgjithshme. Po ashtu, duhet kuptuar se i singerti asnjëherë nuk i përvetëson të mirat, por çdoherë ia mbështet Zotit (xh. sh.). Pra, sado që të jemi të mençur, më mirë është që t'u mbahemi parimeve të përgjithshme, sepse vetëm si të tilla ato janë më të realizueshme nga popullata.

### Allahu në suren Ihlas

“Ai” هُوَ është përemër vetor, që përdoret vetëm për atë që njihet dhe është plotësisht i ditur. Allahu ka zgjedhur që përshkrimin e Vetvetes kundrejt njerëzve ta nisë me fjalën

<sup>92</sup> Fadil es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 59.

هو "Ai", d.m.th. Ai për të Cilin ju keni nevojë shpirtërore, krijimtarinë e të Cilit e shihni në çdo anë... është Allahu.

Përse atributi أَحَدٌ është i pashquar, kurse atributi الصَّمَدُ është i shquar?

Fjala e shquar në gjuhën arabe zakonisht tregon diçka të njohur mirë, kurse fjala e pashquar parimisht tregon diçka të panjohur. Duke pasur parasysh këtë parim, parashtrahet një pyetje: përse njëri atribut del i shquar, kurse tjetri i pashquar, kur dihet se flitet për të njëjtën Qenie, për Allahun (xh. sh.)?<sup>93</sup>

Pasi kjo sure zbret për politeistët e Mekës, të cilët kërkojnë të përshkruhet Zoti, atëherë duhet kuptuar se ardhja e këtyre dytributeve në këto trajta - njëra e shquar dhe tjetra e pashquar - tregon një realitet të politeistëve të atëhershëm dhe të jobesimtarëve për mbarë botën. Gjithë njerëzimi, besimtarë e jobesimtarë, pohojnë se i Vetmi të Cilit i drejtohet njerëzimi për nevojat e tyre është Allahu. Edhe ata që adhurojnë dikë tjetër, qoftë gur, dru apo ndonjë krijesë tjetër, kur mbesin ngushtë dhe kanë nevojë imediate, i drejtohen vetëm Allahut, sepse nënvetëdija e tyre, apo siç i thuhet në terminologjinë fetare *fitreja*, e di se i Vetmi të Cilit mund t'i drejtohem për nevojat tona, i Cili nuk ka nevojë për askënd, është Vetëm Allahu (xh. sh.), prandaj Allahu në suren *Ihlas* atributin الصَّمَدُ e jep të shquar.<sup>94</sup> Problemi kryesor i politeistëve dhe i jobesimtarëve, ndërkaq, ka qenë dhe vazhdon të jetë të besuarit e Zotit Një dhe të Vetëm, prandaj Allahu

<sup>93</sup> Shih: Fahrudin Er-Razi, *Mefatihul Gajb – Et-tefsiru el-kebiru*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f. 182-183.

<sup>94</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Ihlas*, <https://www.youtube.com/watch?v=BKNdHmeKL7w>.

emrin أَحَدٌ e jep të pashquar, sepse për ata vetëm si Një Allahu është i panjohur.

Këto dy attribute të Allahut (xh. sh.), përveç sqarimeve të mëparshme, ato përmbajnë edhe një urtësi tjetër. Në sur-en Ihlas gjithsej përmenden tre emra të Zotit: Allah, që është emër universal; Ehad, që i përfshin të gjitha cilësitë e qenies së Zotit, pra tregon përsosurinë e vetë Zotit; dhe Samed, që tregon përsosurinë e Zotit me krijesat. Pra, me një rën tregon përsosurinë e vetvetes dhe me tjetrën përsosurinë e vetvetes në raport me krijesat; bile, edhe format e fjalëve i ka dhënë në një paradigme: فَعَلَّ أَحَدٌ dhe صَمَدٌ.

Një fushë e veçantë kuptimore fshihet te vetë dallimi mes këtyre dy emrave: وَاحِدٌ dhe أَحَدٌ.

Këta dy emra (numërorë), parimisht janë sinonime, mirëpo në një vështrim më të detajuar ato dalin vetëm sinonime kontekstore, assesi sinonime të plota, veçanërisht kur është në pyetje fjalësi kuranor.

Fjala أَحَدٌ, kur nuk është e lidhur me një fjalë tjetër (مُضَافٌ), pra kur është e vetme, nënkupton vetëm qenie të gjallë dhe të mençur, kurse fjala وَاحِدٌ i përfshin edhe të gjallët edhe të ngurtët, edhe qeniet që logjikojnë edhe ato që nuk logjikojnë.<sup>95</sup> Pra, me fjalën أَحَدٌ nuk nënkuptohej thjesht numri Një, por ajo e përshkruan një Njësh të Gjallë dhe të Mençur, përshkrim i cili e përjashton çdo pretendim tjetër, edhe nëse një fis adhuronte vetëm një idhull, nuk kishte të drejtë të thoshte se ky ajet nënkupton zotin tonë, sepse ky Njësh është i Gjallë dhe i Gjithëdijsëm.

<sup>95</sup> Fadil es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 60.

Ky kuptim nxirret nga përdorimet e arabëve dhe nga vetë format gramatikore të këtyre dy numërorëve. *أَحَدٌ* është *Sife mushebbehe bil fi'ili*, kurse *وَاحِدٌ* është *ismul-faili*, ku dihet se e para është më specifike dhe më e fuqishme se e dyta. Pra, njësoj si t'i krahasojmë *عَالِمٌ* i dijshtëm (si *وَاحِدٌ*) dhe *عَلِيمٌ* i Gjithëdijshtëm (si *أَحَدٌ*).

Përse *اللَّهُ الصَّمَدُ* është ndarë si ajet më vete?

Ky ajet fisnik, nëse e shohim nga aspekti gramatikor, ka mundur të thuhet menjëherë pas ajetit të parë, *قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ* ﴿اللَّهُ الصَّمَدُ﴾. Nëse do të ishte kështu, atëherë funksioni gramatikor i fjalës Samed do të ishte i diskutueshëm dhe fjalia nuk do ta kishte atë fuqi shprehëse që e ka tani me ajet të veçantë. Pra, Allahu (xh. sh.) në këtë sure i përmend tre emra të Tij: Allah, Ehad dhe Samed. Për të mos u keqkuptuar, ata të gjithë janë lidhur me emrin Allah, prandaj është thënë *اللَّهُ الصَّمَدُ*, dhe askush tjetër pos Allahut.

### Tri cilësi pohuese përballë tri mohueseve

Kjo sure e shkurtër përfshin gjashtë cilësi të Allahut (xh. sh.):

- A) tri cilësi pohuese: Allah, Ehad dhe Samed,
- B) tri cilësi mohuese: nuk ka lindur askënd, nuk është i lindur dhe nuk është i barabartë me Të askush.

Këto gjashtë cilësime të Zotit (xh. sh.) e kristalizojnë besimin e vërtetë, sepse vetë emri Allah në fillim i përjashton të gjithë ata që besojnë dikë tjetër me emra tjerë, prandaj, cilado cilësi tjetër të ishte përdorur në vend të fjalës Allah, nuk do ta plotësonte këtë kuptim. Ehad i përjashton të gjithë ata që e besojnë Allahun, por që me Të njohin edhe dikë

tjetër, pastaj emri Samed shkon edhe më tej, i përjashton ata që besojnë Allahun Një, por nuk i drejtohen atij në çdo punë dhe nuk e njohin të përsosur. لَمْ يَلِدْ i përjashton të gjithë të krishterët dhe hebrenjtë, sepse ata i përshkruajnë Allahut pasardhës. لَمْ يُولَدْ i përjashton të gjithë njerëzit që e diskutojnë eternalitetin e Allahut. Pastaj, me pjesën e fundit të kësaj sureje, وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ, plotësohet përshkrimi i përsosur i Allahut (xh. sh.), sepse tani i përjashton të gjithë ata të cilët përpiqen t'i japin Zotit ndonjë cilësi që nuk e ka. Shkurt thënë, kjo sure i përshin të gjitha cilësitë e Allahut dhe i përjashton të gjitha besimet e kota.<sup>96</sup>

Nëse i analizojmë cilësitë pohuese: Allah, Ehad dhe Samed, do të shohim se dy ajetet që i theksojnë këto cilësi fillojnë me emrin Allah, kurse ajetet që i plotësojnë cilësitë mohuese nuk e kanë në fillim fjalën Allah. Cilësitë mohuese nuk e kanë në fillim fjalën Allah, sepse ato janë përshkrime që iu bënë Zotit vetëm kur u krijua njeriu, prandaj Allahu nuk e ngjiti emrin e vet me ato që njerëzit mund t'i përshkruajnë.

### Pse kjo sure quhet Ihlas?

Nëse analizohen të gjitha suret e shkurtra, do të shohim se përfshijnë nga një aspekt të rëndësishëm të fesë, bile shpeshherë lidhen me ngjarje apo me njerëz të veçantë. Por, kur jemi te surja Ihlas, ajo, edhe pse është shpallur në një rast të caktuar, me kuptim dhe me përmbajtje është shumë e përgjithshme, sepse e sqaron thelbin e fesë islame, i sqaron

---

<sup>96</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Ihlas*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=BKNdHmeKL7w>.

normat e përgjithshme, të cilat nuk janë të lidhura me asnjë ngjarje apo individ.

Kur e kemi parasysh këtë, shumë lehtë kuptohet përse kjo sure u quajt Ihlas. Ajo quhet e tillë sepse sinqeritetin e ka lidhur me çështje të përgjithshme dhe parimore, e jo me raste të veçanta. D.m.th. sinqeriteti i vërtetë i një besimtari apo njeriu është atëherë kur sinqeritetin ta ketë parim të vet dhe jo thjesht të tregohet i sinqertë vetëm në disa raste shumë specifike. Po ashtu, ai që dëshiron të ndërtojë një karakter të shëndoshë, në baza të qëndrueshme, duhet t'u përmbahet parimeve të përgjithshme fetare dhe njerëzore.

### **Lindja, veti njerëzore; jo hyjnore**

Folja وَوَلَدَ në gjuhën arabe llogaritet prej foljeve kalimtare - pra, e ka edhe vepruesin edhe atë mbi të cilin bie veprimi (مَفْعُول), p.sh. ka pasur mundësi të jetë لَمْ يَلِدْ أَحَدًا “nuk ka lindur askënd”, mirëpo në Kuran nuk është dhënë أَحَدًا “askënd”, sepse kur përmendet kundrinori (أَحَدًا), vëmendja fokusohet te kundrinori, kurse kur nuk përmendet (siç është tani), atëherë vëmendja fokusohet te veprimi i foljes.<sup>97</sup> Shkurt thënë, ky ajet nuk synon të përjashtojë të gjitha krijesat nga lindja e Zotit, por synon të tregojë se lindja aspak nuk është veti që i përket Zotit (xh. sh.).

Përse Allahu në suren Ihlas nga gjithë cilësitë tjera njerëzore për Vetveten e ka përjashtuar lindjen? Përse mos e përjashton ushqimin dhe pijen apo ndonjë cilësi tjetër?

---

<sup>97</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Ihlas*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=BKNdHmeKL7w>.

Mospasja e krejt cilësive tjera është thjesht mohim i një vetie njerëzore, kurse moslindja nga askush moslindja askënd tregon se nuk ke asnje lidhje me botën njerëzore. Pra Allahu i ka mohuar Vetvetes lindjen për të treguar se assesi nuk ka lidhje me botën njerëzore dhe në këtë formë ka mohuar çdo veti njerëzore.

## SURJA EL-FELEK – سُورَةُ الْفَلَقِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿١﴾ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ﴿٢﴾ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ﴿٣﴾ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ﴿٤﴾ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ﴿٥﴾﴾

“(1) Thuaj: “Mbrobem me Zotin e agimit, (2) prej së keqes së krijimit, (3) prej së keqes së natës terr e zi, (4) prej së keqes së magjistricave që bëjnë magji, (5) prej së keqes së ẓiliqarit kur ka ẓili!”

Janë dhënë disa mendime për lidhshmërinë e këtyre dy sureve. Në vazhdim do të përmendim vetëm disa reflektime më të theksuara:

- Surja Ihlas është lavdërim për Krijuesin, duke i numëruar vetitë e Tij, ndërsa suret Felek dhe Nas e tregojnë karakterin e mangët të njeriut dhe nevojën për Zot;
- Allahu (xh. sh.) pas sures Ihlas i ka renditur suret Felek dhe Nas, të cilat i tregojnë mangësitë njerëzore. Pra, nëse dëshiron ta njohësh mirëfilli Allahun dhe ta kuptosh suren Ihlas, atëherë njihi dobësitë tua në dy suret në vazhdim; atëherë do ta njohësh edhe Zotin. Siç është thënë: “Kush e njih vetveten, kush i njih dobësitë e veta, ai e ka njohur Zotin.”
- Gjithashtu, Kurani në dy suret e fundit i numëron të këqijat (sherret) që mund t’i bien njeriut mbi kokë, por për të mos u mërzhitur, paraprakisht e ka përkthyer përsosurinë e Vetvetes, në mënyrë që njeriu të mos plo-

gështohet, por të lidhet me Atë që është Es-Samed (Ai, të Cilit i drejtohen krijesat për çdo nevojë).

- Es-Samed (Ai, të Cilit i drejtohen krijesat për çdo nevojë). Kur Allahu e paraqet vetveten si Es-Samed, parashtrohet pyetja: për çfarë ka nevojë më shumë njeriu? Përgjigja është: mënjanimi i të keqes dhe i dëmit, të cilën gjë fund e krye e trajtojnë dy suret në vijim, Felek dhe Nas.
- Surja Ihlas përfundon “*me Të nuk është i barabartë asnjë*”. Komentues më i mirë i këtij ajeti janë vetë dy suret e radhës, sepse nuk mund të jenë të barabartë ata që kërkojnë me Atë nga i Cili kërkohet dhe kurrë nuk i duhet asgjë.<sup>98</sup>

### Përse fillon me **قُلْ** *thuj!*

Shkak i zbritjet së sures Felek thuhet se është zihri që një hebre i bëri Muhamedit (a. s.). Pra, nëse merret parasysh shkakun dhe fillimi i kësaj sureje me fjalën *thuj!*, atëherë kuptohet mirë se përse është filluar kështu.

Allahu (xh. sh.) ka mundur ta nisë këtë sure pa fjalën *thuj!*, njësoj si shumë ajete të tjera, mirëpo e ka filluar me të, sepse i është drejtuar Muhamedit (a. s.), në mënyrë që t’ua bëjë me dije të gjitha krijesave se nëse Muhamedi (a. s.) kërkonte falje për të këqijat, atëherë nuk mbetet njeri mbi faqen e dheut që nuk ka nevojë për ndihmën e Zotit (xh. sh.), prandaj flisni dhe shpërndajeni këtë të vërtetë.<sup>99</sup>

<sup>98</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Feleki*,  
youtube.com/watch?v=QqmD4GGpYeM.

<sup>99</sup> Fadil es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 25.

## Përse folja **أَعُوذُ** është në kohën e tashme?

Nëse analizohet kuptimi i këtyre dy sureve të fundit të Kuranit, atëherë vërehet se përdorimi i kësaj folje në kohën e tashme është mënyra më e mirë, sepse:

- Kurani kërkon që njeriu vazhdimisht të mbrohet nga të këqijat, dhe jo vetëm në të kaluarën, sepse folja e kohës së tashme në gjuhën arabe e mbulon kohën e tashme dhe kohën e ardhshme.
- Po ashtu, përdorimi i saj në kohën e tashme na mëson se si të mbrohemi nga e keqja, sepse fatkeqësisht shumë besimtarë të keqen bashkëkohore mundohen ta sfiidojnë me metoda të së kaluarës. Pra, kjo folje na mëson që të keqen e kohës ta shmangim me metodat e kohës, sepse përndryshe nuk realizohet mbrojtja.
- Dhënia e saj në vetën e parë, siç kemi thënë te surja Nas, tregon iniciativë dhe përpjekje individuale për ta luftuar të keqen, në mënyrë që individi të mos mbështetet në mundin e të tjerëve.
- Surja Ihlas zbret për ta dalluar besimin islam nga politizimi i mekasve, pra i ndan qartazi qëndrimet dhe i formon pastër taborët: iman dhe shirk. Pastaj vjen menjëherë surja Felek, d.m.th. mund të ketë sukses në mbrojtje vetëm ai që e ka të qartë rrugën dhe që i ka qëndrimet e veta;
- Mbrojtja që kërkohet në suret Felek dhe Nas, lufta me të keqen, nuk realizohet kurrë nëse përpara nuk ka një Ihlas (sinqeritet), siç e kanë suret Felek dhe Nas përpara suren Ihlas. Prandaj, ndoshta dështimi për t'i menj-anuar shumë të këqija në mesin tonë është si rezultat i mossinqeritetit.

Dallimi i foljes اَعُوذُ (mbrohem) dhe i foljes اَسْتَعِيذُ (kërkoj mbrojtje).

Procesi i mbrojtjes së besimtarit ka disa faza: faza e parë është koha kur njeriu ende nuk është ballafaquar me të keqen, prandaj vetëm kërkon mbrojtje për atëherë kur do të ndodhë, mirëpo, në fazën e dytë, kur njeriu veçse më e ka përballë të keqen, atëherë nuk thotë “kërkoj mbrojtje”, por thotë “mbrohem”.

Në suret Felek dhe Nas Allahu na i ka numëruar të këqijat një nga një, pra i kemi para vetes, prandaj tani duhet të mbrohemi dhe jo thjesht të kërkojmë mbrojtje, e cila nuk dimë kur realizohet. Nëse në vend të اَعُوذُ (mbrohem) do të ishte folja اَسْتَعِيذُ (kërkoj mbrojtje), atëherë do të kërkohej mbrojtje pa afat të caktuar dhe nuk do të kuptohej se u shpall luftë të këqijave që do të numërohen. Pra, në një mënyrë, ky dallim na mëson se kur ta shohim një të keqe, menjëherë duhet të kalojmë në fazën e punës, të mbrohemi, dhe jo ende të kërkojmë mbrojtje apo të presim se mbrojtja do të vijë nga dikush tjetër. Edhe pse fraza اَعُوذُ بِرَبِّ (mbrohem me Allahun) tregon ndihmën e Zotit, ajo përsëri zanafillën e ka tek iniciativa e vetë njeriut dhe jo thjesht njeriu vetëm të kërkojë apo të mbështetet me parazitizëm tek Allahu (xh. sh.).<sup>100</sup>

### Përdorimi i fjalës فَالِقُ Felekun

Kuptimi i përgjithshëm dhe i njohur i fjalës Felek është

<sup>100</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Feleki*,

<https://www.youtube.com/watch?v=QqmD4GGpYeM>.

*agimi*, mirëpo nëse e dëshirojmë tek esenca e kësaj fjale, atëherë duhet patjetër që të shpjegohet me më shumë fjalë, d.m.th. “momentin e parë kur diçka ndahet nga diçka tjetër e quajmë Felek”<sup>101</sup>. Në këtë sure është paraqitur për disa arsye:

- Kuptimi i kësaj fjale i përshtatet çdo krijese, sepse çdo krijesë në botë, pa përjashtim, e kalon këtë proces;
- Pasi është sure e cila në brendinë e vet përmban lutje, kurse lutja bëhet në rastet kur njeriu ka vështirësi, atëherë fjala më shpresëdhënëse për ta tejkaluar atë vështirësi është fjala Felek, sepse besimtari i vërtetë mendon kështu: “Përderisa Allahu e mposht errësirën e horizontit me Felek (agim), çfarë është brenga ime që të mos i jap një shkëndijë drite?!”
- Kjo fjalë nënkupton edhe mbrojtjen nga diçka që ne nuk e dimë, sepse momenti i parë i ardhjes së agimit, apo i fillimit të gjithçkasë, është i paarritshëm për syrin e njeriut, por Allahu na ka mësuar që ne të kërkojmë falje qysh atëherë, edhe kur ne nuk e shohim.
- Feleku, siç thamë, është momenti i parë kur diçka fillon të ekzistojë. Allahu na ka mësuar që për të keqen të kërkojmë mbrojtje dhe të marrim masa prej në fillim, sepse sa më shumë që ajo të largohet nga Feleku (momenti i parë), ajo rritet edhe më shumë. Prandaj, Zoti i Madhërishëm, prej gjithë të këqijave, na mësoi se është tepër i rëndësishëm momenti i parë. Prandaj edhe e quajti suren Felek, se mbrojtja më e mirë është që e keqja të kapet në momentin sa më të hershëm të mundshëm.<sup>102</sup>

<sup>101</sup> Zemahsheri, *El-Kesh-shafu*, Vëllimi III, f. 368.

<sup>102</sup> Fadil bin Salih es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 26.

Nëse e analizojmë mirëfilli suren Felek, fillimin dhe fundin, do të vërejmë se në ajetin e parë është përmendur fjala Felek, kurse në ajetin e fundit fjala Hasid – Ziliqar. Kjo do të thotë: Nëse të keqen nuk e shmang derisa ajo është shkëndijë e vogël, atëherë prite kur ajo të formësohet dhe të bëhet njeri (Ziliqar).

### Togu **شَرَّ غَاسِقِي** simbolizon esencën e së keqes

Objekt i të dy sureve është e keqja dhe jo vepruesit e së keqes. Kjo na mëson se Allahu (xh. sh.) kërkon t'i shpallet luftë së keqes, e jo vepruesve të të këqijave. Fatkeqësisht, sot objekt i luftës është bërë njeriu dhe jo e keqja.

Nëse e analizojmë fjalën ما (e cila / i cili) në ajetin **مِنْ شَرِّ مَا** خَلَقَ 'nga e keqja që ka krijuar', do të shohim se ما përdoret për gjithçka, përveç për njeriun. Pra, e gjithë veprimtaria jonë duhet bazuar në parime dhe jo në njerëz apo individë. Sepse lufta kundër veseve të këqija, siç e kërkon Zoti, bëhet vetëm me parime të shëndosha. Sipas Raziut, nuk ka asnjë problem që brenda ما të hyjnë edhe njerëzit edhe xhindet.<sup>103</sup>

Për fjalën **شَرِّ غَاسِقِي** ka dy kuptime në gjuhën arabe:

a) Koha kur nata është më e errët. Këtu Allahu i Madhërishëm përmend periudhën më të favorshme për mëkatarët dhe për shejtanët. Nuk është përcaktuar e keqja nga e cila kërkohet mbrojtja, sepse ato janë shumë, por vetëm koha kur bëhen të këqijat.

<sup>103</sup> Fahrud-din Er-Razi, *Mefatihul Gajb*, Vëllimi XXXII, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981, f.193.

b) Hëna. Pra, i njëjti ajet mund të përkthehet edhe “nga e keqja e hënës kur del”. Shikimi i hënës është shenja më e qartë e ardhjes së errësirës së plotë.

Sidoqoftë, ajo që është në qendër të vëmendjes në këtë ajet është e keqja që bëhet gjatë natës. Por, mënyra dhe fjalët si është ndërtuar ky ajet, përveç kuptimeve parësore dhe të padiskutueshme, japin edhe kuptime të tjera:

Përzgjedhja e fjalës غاميق tregon se ajo kohë e cila për dikë është errësira më e madhe e natës - sepse bën punë të këqija, në të njëjtën kohë për besimtarin është si hëna e cila ndriçon në mesin e gjithë kësaj errësire.

### **Lufta me keqbërësin vetëm kur bën keq**

Krahas kuptimeve tjera, do të bëjmë një analizë brenda këtij ajeti. Përse Allahu e ka përcaktuar që të mbrohemi nga e keqja e ziliqarit kur dihet se ziliqari fund e krye është i keq? Nëse do të ishte “Nga ziliqari kur shpreh zili”, e jo “Nga sherri i ziliqarit kur shpreh zili”, atëherë do të vinte në kundërshtim me disa parime fetare, sepse ka raste kur dikush ka zili, por nuk dëmton; p.sh. zilia në dituri dhe në vepra të mira është e lejuar, por nëse ziliqari për shkak të ndjenjës së konkurrencës reflekton të keqen dhe është dëmtes ndaj atij që e ka zili, atëherë hyn brenda këtij ajeti.

Për ziliqar në gjuhën arabe ka dy fjalë kryesore: حَامِيْدٌ dhe حَسُوْدٌ, veçse حَامِيْدٌ është ziliqar i thjeshtë, që shpreh zili, kurse حَسُوْدٌ është ziliqar profesional, edhe më i keq se i pari. Atëherë, përse Allahu na ka mësuar të mbrohemi prej ziliqarit të thjeshtë?

Arsyeja është e thjeshtë: Allahu na mëson që ne të jemi

të mbrojtur prej momenteve të para, kur ziliqari shpreh zili dhe jo vetëm kur ai të jetë i avancuar.<sup>104</sup>

Po ashtu, Allahu na mëson që ne të mos e biem veten që të kërkojmë mbrojtje kundër ziliqarit të keq, sepse atëherë mbrojtja është më e vështirë dhe me pasoja.<sup>105</sup>

---

<sup>104</sup> Fadil bin Salih es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 38.

<sup>105</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti el-Feleki*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=QqmD4GGpYeM>.

## سُورَةُ النَّاسِ – SURJA EN-NAS

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴿١﴾ مَلِكِ النَّاسِ ﴿٢﴾ إِلَهِ النَّاسِ ﴿٣﴾ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ  
الْخَنَّاسِ ﴿٤﴾ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿٥﴾ مِنَ الْغِيَّةِ وَالنَّاسِ ﴿٦﴾﴾

*“(1) Thuaj: “Mbrohëm me Zotin e njerëzve, (2) Sundimtarin e njerëzve, (3) Perëndinë e njerëzve, (4) nga e keqja e pëshpëritjeve të djajve, (5) që pëshpëritin në zemrat e njerëzve (6) dhe janë prej xhindëve e njerëzve!”*

Në suren Felek kërkohet mbrojtje nga Zoti, i cili këtu cilësohet vetëm si *Zot i Agimit*, kurse në suren Nas ka tri cilësime: *Zoti i njerëzve, Sundimtar i njerëzve dhe Perëndi i njerëzve*. Objekti kundër kujt kërkohet mbrojtja, ndërkaq, dallon. Në suren Felek janë katër objekte: krijimtaria, nata, nyjat e lidhura dhe ziliqari, kurse në suren Nas është vetëm një - ajo është vesvesja.

Në mesin e shumë sqarimeve që janë dhënë për këtë renditje, është edhe ky në vazhdim: Problemet në suren Felek kryesisht janë afatshkurtra dhe materiale, kurse problemi i vesveses është kryesisht shpirtëror, më gjatë i shërueshëm, më delikat dhe shumë më i pranishëm, prandaj Allahu e ka veçuar si problem në vete dhe e ka paraqitur Vetën me tri cilësime. Jo rastësisht Muhamedi (a. s.) në shumë raste ka

pohuar se vesvesja është arma më e fuqishme e djallit.<sup>106</sup>

Meqë vesvesja, e cila sot shpeshherë rezulton me stres, me depresion apo me krizë shpirtërore, Allahu zgjodhi që Vetveten ta paraqet me tri cilësime, në mënyrë që besimtari të ndjejë më shumë siguri për ta luftuar këtë sëmundje (shpirtërore) kaq të rrezikshme.

Kjo renditje e attributeve të Allahut, fillimisht Rabbun (Zot), Melik (Sundues) dhe në fund Ilahun (Zot), është dhënë në kështu për disa arsye:

- Pasi në të tri rastet cilësimet e Allahut janë të lidhura me shumësin *njerëz*, atëherë Allahu (xh. sh.) dëshiron që lidhja apo njohja e parë me njerëzit të jetë Zot (Edukues). Pra, Allahu (xh. sh.) dëshiron që fillimisht të prezantohet si Edukues i njerëzve, pastaj si Sundues dhe si Zot që meriton adhurim;
- Allahu (xh. sh.) në fillim të kësaj sureje e ka prezantuar Vetën si Rabb, sepse mënyra më e përkryer dhe kryesore për ta luftuar vesvesen në këtë sure është që robi të edukohet sipas parimeve të Edukuesit Absolut. Pra, ata që kërkojnë shërim afatgjatë dhe të denjë nga vesvesja, duhet ditur se ky është edukimi sipas fesë së Edukuesit Absolut.
- Gjatë procesit të edukimit dhe luftës ndaj të keqes (vesveses) njeriu shpeshherë përjeton sfida dhe plogështi, prandaj Allahu (xh. sh.) menjëherë e paraqet Vetën si Sundues, për t'i mësuar robit se 'Unë jam edhe Sundues i njerëzve, i Cili ngadhënjën mbi çdo fuqi dhe i heq

---

<sup>106</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nas*,

<https://www.youtube.com/watch?v=FQWIqFV-hQw>.

të gjitha barrierat e mundshme'.

- Allahu (xh. sh.), pasi prezantohet si Zot (Edukues, Menaxhues...) dhe Sundues, atëherë prezantohet si Zot me meritë për t'u adhuruar. Në një mënyrë na tregon se meriton të adhurohet vetëm Ai i Cili është Edukues dhe Sundues në të njëjtën kohë.
- Arsyeja e dhënies së atributit Ilahun (Zot që meriton të adhurohet). Nëse analizohet mirëfilli rezultati i vesveses, do të mësohet se pasojat e saj janë largimi dhe nënshtrimi ndaj paudhësive shejtanore, kurse Allahu (xh. sh.) na tregon se nëse nuk dëshironi t'u nënshtroheni ligësive të djallit, atëherë nënshtrojuni dhe adhurojeni vetëm Atë që meriton të adhurohet.
- Kjo radhitje tregon se njeriu fillimisht edukohet nga Ai, e kupton madhërinë e Tij dhe pastaj e adhuron vetëm Atë.

### **Atributet e Zotit dhe fjala *njerëz***

Kjo mund të kuptohet në dy drejtime:

*E para:* privilegj prej anës së Zotit (xh. sh.), i Cili në të tri rastet emrin e Tij e lidh me emrin e njerëzve. Edhe pse ekzistojnë shumë krijesa në krijimtarinë e tij të pafund, ai i zgjodhi njerëzit që të atribuohet si Zot, Sundues dhe i Adhuruar i tyre.

Megjithatë, nuk duhet harruar se Allahu e ka përdorur shumësin, si *Zot i njerëzve*, *Sundimtari i njerëzve* dhe *i Adhuruar i njerëzve*, e jo: *Zot i njeriut...* Kjo tregon se Zoti çdoherë është afër bashkësisë dhe afër individëve. Pra, për luftimin e ligësive, vesveseve (streseve) dhe për fitimin e kësaj dhe të botës tjetër, nevojitet që të bashkëveprojmë si një bashkësi njerëzish, sepse vetëm atëherë hyjmë brenda nocioneve të

cituara më lart.

*E dyta:* ballafaqimi me vesveset (dhe të gjitha ligësitë, të cilat në këtë sure janë përfaqësuar nga djalli) duhet kërkuar te faktori njeri. Edhe pse vesvesja është nga shejtani, përsëri faktori kryesor mbeten njerëzit. Shejtani nuk i cyt (me vesvese) njerëzit pse ai është shumë i fortë, por pse vetë njerëzit i lënë hapësirë që ai të depërtojë në mesin e tyre.

Gjithashtu, nëse i shohim sot njerëzit të sëmurë nga vesveset (stresi, depresioni etj.), do të shohim se ilaçi më i mirë për ta është qëndrimi, bashkëpunimi dhe komunikimi i ëmbël me njerëzit që janë afër Zotit, Sunduesit dhe të Adhruarit.<sup>107</sup>

### **Përdorimi i urdhërores قُلْ *thuj!***

Kjo dhe surja paraprake fillojnë me foljen e mënyrës urdhërore قُلْ ‘thuj’, për shumë arsye. Ndër to:

- Pasi këto dy sure trajtojnë problemin e ballafaqimit me të keqen, fillojnë me foljen e urdhërores *thuj*, sepse e keqja kërkon të thuhet dhe jo të fshihet, sepse atëherë nuk luftohet kurrë. Pra, në një mënyrë, kur të jetë e pranishme e keqja e krijimit, e natës, e magjive, e ziliqarit dhe e vesveseve, prej njeriut kërkohet që ta proklamojë publikisht luftën e me ta dhe të tregojë anën e lidhjes së tij me të vërtetën, me Zotin Fuqiplotë.
- Pasi këto janë çështje të një rëndësie të veçantë për mbarrëvajtjen e jetës shoqërore dhe individuale, atëherë kërkohet që të përvetësohen dhe, në të njëjtën kohë, të transmetohen dhe t’u mësohen të tjerëve.

<sup>107</sup> Uvejd Atavij, *sureti en-Nas*, [www.youtube.com/watch?v=FQWIqFV-hQw](http://www.youtube.com/watch?v=FQWIqFV-hQw).

- Kjo folje tregon se mësimet islame nuk bëjnë monopol me mësimet që u vlejné të gjithëve, përkundrazi, kërkon që ato të thuhën zëshëm dhe njerëzit sa më shumë të afrohen me Zotin për t'i përvetësuar ato.
- Përdorimi i foljes *thuaj* d.m.th. edhe luftim i kryelartësisë dhe vetëpëlqimit, sepse këto sure shtjellojnë nevojën e njeriut për t'iu mbështetur Krijuesit, e kur njeriu ta shprehë publikisht nevojën për ndihmë, apriori kuptohet dobësia e tij, gjë të cilën nuk mund ta bëjë kryelarti.
- Nëse bëhet një analizë mes fjalës së parë *فُلْ* *thuaj* dhe fjalës së fundit *النَّاسِ* 'njerëz', do të shohim se ato lidhen në formë të përkryer njëra me tjetrën. Vetëm njeriu modest, i cili i pranon haptazi dobësitë e veta, është në gjendje të jetojë në bashkësi me njerëzit. Kryelarti, i cili nuk i shpreh nevojat e tij, të cilit vetja i duket i aftë për t'iu zgjidhur të gjitha hallet, nuk mund të jetojë në bashkësi me njerëzit.

Kurani është libër i Zotit, i cili duhet lexuar, duhet mësuar, duhet predikuar dhe duhet praktikuar.

Çdo lexues i Kuranit, nga fillimi deri në fund, do të ballafaqohet me mësimet, me informacione, me urdhra, me sugjerime, me kërcënime dhe me vërejtje të ndryshme. Kështu që, kur të mbërrijë në fund, Allahu të tri suret e fundit i fillon me fjalën *فُلْ*, që d.m.th. 'gjithë këtë që e ke mësuar, tani ka ardhur koha ta thuash dhe jo të bësh monopol me të, duke e mbajtur vetëm për vete'. Pra, në një mënyrë, nëse dëshiron të plotësohet ajo që e ke lexuar, tani thuaje dhe predikoj atë që e ke mësuar deri tani.

Po ashtu, duke qenë të vetëdijshëm se Kurani e urren të thuhet diçka që nuk praktikohet, atëherë këto tre Kula (*فُلْ*)

tregojnë se besimtari e paska përfunduar fazën e mësimit dhe të praktikimit, e tani i ka mbetur vetëm predikimi i të vërtetës.

### **Etimologjia e fjalës نَامٌ**

Për etimologjinë (prejardhjen) e fjalës نَامٌ etimologët arabë kanë dy mendime kryesore: disa mendojnë se rrjedh prej rrënjës نَمِيَ *të harrosh*, kurse disa të tjerë thonë se rrjedh prej rrënjës اُنْسَ *të shoqërohesh*.

Kjo tregon se esenca e njeriut është e përbërë nga veti kryesore: të qenët krijesë *harrestare* dhe *e shoqërueshme*.

Kur është në pyetje përdorimi i fjalës نَامٌ në këtë sure, të jep të kuptosh se Allahu (xh. sh.) të tregon se ti je qenie *harrestare*, prandaj prekesh nga pëshpëritjet dhe vesveset. Kjo është dhe arsyeja e lidhjes së fjalës Rabb, Melik dhe Ilah me Nasin, sepse vetëm kur lidhesh me atë që nuk harron e fiton vesvesen.

Kuptimi i dytë - njeriu si qenie e shoqërueshme, ndërkaq, të jep të kuptosh se shoqëria me njerëz pesimistë të sjell vesvese, kurse shoqëria me njerëz optimistë të shëron nga vesveset.

Fjala *njerëz* نَامٌ, krahas kuptimit etimologjik që ka, në të njëjtën kohë shpreh edhe kuptime të tjera, dhe atë, përmes përsëritjes së vetë fjalës tri herë radhazi.

Fjala نَامٌ 'njerëzit' përsëritet tri herë. Kjo tregon se në të tri rastet nuk bëhet fjalë për njerëz të njëjtë, sepse në të kundërtën nuk do të ishte *Zot i njerëzve*, *Sundimtar i njerëzve* dhe *i Adhuruar i njerëzve*, pra nuk do të përsëritej fjala *njerëz*,

por do të ishte *Zot i njerëzve, Sundimtar i tyre dhe i Adhuruar i tyre*. Në gjuhën arabe, përsëritja e një fjale në vendin kur mund të mos përsëritet nënkupton një kuptim të veçantë.

Në të vërtetë, kjo e tregon procesin e ngritjes së njerëzimit. Njerëzit në ajetin e parë janë në fazën fillestare të edukimit, pastaj njerëzit në ajetin e dytë janë ata që u edukuan dhe që e kuptuan madhështinë e Krijuesit, të cilin e pranojnë për Sundues të vetëm, dhe krejt në fund janë njerëzit të cilët i kanë kaluar dy fazat e para dhe tani janë të gatshëm ta adhurojnë Allahun (xh. sh.).

Pasi të tri ajetet flasin për Allahun, atëherë do të ishte krejt e palogjikshme që këto të lidhen me *vav*, sepse pastaj do të keqkuptoheshin nga lexuesit. Vetë lidhësja *و* e tregon tubimin e disa gjërave, por këtu nuk tubohen, sepse Allahu është një, por thjesht numërohen cilësitë e Njërit, të Allahut (xh. sh.).

Tani do të shohim një dallim mes dy sinonimeve të përfërta, mes fjalës *شَرٌّ* dhe fjalës *ضَرٌّ*

Fjala *شَرٌّ* e keqe përfshin dëmin material dhe shpirtëror, kurse fjala *ضَرٌّ* dëm përdoret vetëm për aspektin material të njeriut, prandaj Allahu (xh. sh.) ka zgjedhur fjalën e cila do ta mbrojë njeriun nga të gjitha anët dhe jo vetëm nga e keqja materiale, por nga çdo e keqe e mundshme materiale dhe shpirtërore, e cila këtu është quajtur si *sherr*.

Gjithashtu, përveç dallimit të theksuar më parë, duhet shikuar me vëmendje edhe togfjalëshi “nga sherri i vesvesecytësit” dhe jo: “nga vesvesecytësi”.

Nëse i hedhim një vështrim ajetit të katërt të kësaj sureje, do të shohim se Allahu i ka thurur fjalitë në formë të për-

kryer.

Fjala **الْوَسْوَاسُ** do të thotë vesvesecytës, i cili mund të jetë nga bota e njerëzve apo e xhindeve. Megjithatë, vetëm pasja e mundësisë për të cytur vesvese nuk do të thotë se ai është i keq dhe duhet ndrojtur prej tij. Besimtari, sipas asaj që ka thënë Allahu i Madhërishëm në këtë sure, detyrohet të mbr ohet vetëm nga e keqja e vesvesecytësit dhe jo nga vetë vesvesecytësit. Prandaj, thuhet **مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ** nga e keqja e vesvesecytësit dhe jo **مِنَ الْوَسْوَاسِ** nga vesvesecytësi.<sup>108</sup>

Ajetit të katërt të kësaj sureje shpeshherë i ngushtohet kuptimi. Në shumë raste e përkthejnë “nga e keqja e pëshpëritjeve të djajve”. Këtu nuk kërkohet mbrojtje vetëm nga e keqja e pëshpëritjeve, por nga e keqja e pëshpëritësve, sepse kur kërkohet - nuk duhet përqendruar vetëm në të keqen e pëshpëritjes, sepse vesvesecytësit kanë më shumë të këqija, prandaj ajeti thotë: “nga e keqja e vesvesecytësit” dhe jo: “nga e keqja e vesveseve të djajve”. Me pak fjalë, kuptimi i këtij ajeti është “nga çdo e keqe e njerëzve dhe e xhindeve”, por arsyeja e përfaqësimit të njerëzve dhe xhindeve me këtë fjalë: **الْوَسْوَاسِ** pëshpëritës apo vesvesecytës është se e keqja më e madhe e këtyre krijesave është vesvesja.<sup>109</sup>

### Kuptimi i fjalës **الْحَنَاسِ**

Fjala **الْحَنَاسِ** e ka kuptimin e atij që fshihet, apo të atij që e

<sup>108</sup> Uvejð el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nas*,

<https://www.youtube.com/watch?v=FQWIqFV-hQw>.

<sup>109</sup> Shihabuddin el-Alusi, *Ruhu el-Meani – tefsiru el-Alusi*, Vëllimi XXX, Dar el-Kutub el-Ilmijeh, f. 286.

bën një paudhësi dhe tërhiqet pa e hetuar askush.

Halli më aktual sot në botë është krijimi i problemeve dhe telasheve nga prapaskena, vënia e fitilit dhe tërheqja.

Nxitësit kryesorë sot në botë janë pëshpëritësit e fshehtë, të cilët çdoherë janë të tërhequr dhe kryesisht prononcohen si të pafajshëm për problemet që i kanë shkaktuar vetë. Njësoj si pëshpëritësi الوسواس (djalli), i cili pasi e humb njeriun, prononcohet si i pafajshëm, bile pretendon se e ka frikë edhe Zotin.<sup>110</sup>

Allahu (xh. sh.), i Gjithëdijshmi, e vuri këtë si problem të fundit, ashtu që njeriu çdoherë kur ta përfundojë leximin e Kuranit, e fundit që t'i qëndrojë në kujtesë të jetë ky problem, sepse me të do të ballafaqohet menjëherë sa ta mbyll këtë libër; bile, në çdo segment të jetës.<sup>111</sup>

### Kraharorët dhe jo zemrat

Në ajetin e pestë të kësaj sureje thuhet: *الَّذِي يُؤَسُّوسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ* "ai i cili pëshpërit në kraharorët e njerëzve". Këtu është përmendur 'kraharor' në vend të fjalës 'zemër' për disa arsye:

- Allahu i Madhërishëm na tregon se zemrën e ka në dorë vetëm Ai dhe nuk i lejon askujt që të depërtojë në të, përveç dëshirës së vetë njeriut.
- Ky ajet kuranor na tregon se kur njeriut t'i prishet zemra (të bëhet i keq), të mos e kërkojë fajin te shejtani apo dikush tjetër, por duhet ta dijë se faji i përket vetë atij.
- Kraharori përbën një hapësirë më të gjerë dhe është vendi ku qëndron vetë zemra. Ky ajet tregon se pëshpëri-

<sup>110</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nas*,

<https://www.youtube.com/watch?v=FQWIqFV-hQw>.

<sup>111</sup> Fadil es-Samurai, *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002, f. 52-53.

tësi asnjëherë nuk prek drejtpërdrejt, por interesi i tij është t'i bëjë të gjitha parakushtet që pastaj ti vetë ta shkatërrosh zemrën tënde.

- Disa thonë se kjo është mënyra më e sigurt për ta humbur një njeri, sepse kur ai t'ia mbush kraharorin me vesese, atëherë nuk i lë hapësirë imanit të depërtojë në zemër dhe çdo gjë është e kryer. Gjithashtu, sundimi i kraharorit tregon se edhe nëse ka diçka të shëndoshë në zemër, përmes sundimit të kraharorit i shkëputet lidhja dhe furnizimi dhe, si rezultat, ajo dorëzohet.

Përse një herë është dhënë fjala ناس، pastaj جن dhe në fund përsëri ناس؟

Në fillim të sures tri herë përmendet fjala njerëz, që tregon se, sigurisht, për të gjitha të këqijat që i bien njeriut mbi kokë, fajin kryesor e ka njeriu. Pastaj, pasi t'i ketë hapur rrugë pëshpëritësit, një kohë do të menaxhohet prej tij dhe në fund, përsëri, përfundohet me fjalën *njerëz*, sepse, edhe pse djalli është shumë i keq, përsëri i mbetet njeriut në dorë ta heqë qafe apo mos ta heqë këtë telash.

Ç' kuptim shpreh tingulli fundor S (س)؟

Një tërësi shkronjash në gjuhën arabe quhen shkronja pëshpëritëse, me në krye bashkëtingëlloren S (س). Këto shkronja quhen të tilla sepse gjatë shqiptimit kanë një lloj pëshpërime. Allahu i Madhërishtëm pikërisht këtë sure e ka zgjedhur që fundin e secilit ajet ta japë me shkronjën pëshpëritëse S, njësoj si pëshpërime e shejtanit apo e njerëzve.

Përse Kurani fillon me vetën e parë shumë dhe përfundon me vetën e parë njëjës?

Medituesi i ajeteve kuranore, sigurisht do të përpiqet të shohë lidhshmërinë e fillimit dhe të fundit të Kuranit.

Dy foljet e para në suren Fatiha janë dhënë në kohën e tashme, në vetën e parë shumë *إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ*, kurse foljet e para të dy sureve të fundit janë dhënë në vetën e parë njëjës *قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْمَلِئِكِ* dhe *قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ*.

Parimisht, në suren Fatiha flitet për iniciativë për të mirë, për adhurim dhe për ndihmesë, kurse në dy suret e fundit flitet për sfida dhe për formën e kalimit të tyre. Meqenëse njeriu është qenie e cila iniciativat dhe punët e mira dëshiron t'i bëjë vetë, Allahu në suren Fatiha kërkon që ato të bëhen në bashkësi. Në anën tjetër, ndërkaq, kur bëhet fjalë për ballafaqimin me të këqijat dhe kalimin e sfidave, ai vetvetiu dëshiron që të mbështetet në mundin e të tjerëve dhe të mos rrezikojë veten, kurse Allahu e urdhëron të kundërtën, pra, të mos mbështetet në mundin e të tjerëve, por ta japë mundin e tij personal, prandaj në këto dy sure folja për ballafaqim të sfidave është përdorur në vetën e parë.

Gjithashtu, nëse shihet kuptimi i këtyre dy grupeve të foljeve, atëherë shohim se Kurani qenkësh i mbështjellë mes dy kopertinave të foljeve: me foljet nxitëse për punë të mira dhe iniciativë në suren Fatiha dhe me foljet për mbrojtje dhe përbalim me sfidat në fund, në suret Felek dhe Nas.

Nëse analizohet gjithë veprimtaria njerëzore, ajo rezulton pikërisht me këto dy segmente: krijimi i sukseseve dhe përbalimi me sfidat.

### **Toleranca dhe barazia në suren Nas**

Emërtimi i kësaj sureje me emrin Nas dhe përsëritja e fjalës Nas – *njerëzit* pesë herë, tregon se problemi që trajtohet

në këtë sure është i pranishëm te të gjithë njerëzit, pavarësisht besimit.

Problemet e përgjithshme dhe të cilat e prekin gjithë njerëzimin Allahu nuk i quan si probleme vetëm të besimtarëve, por të të gjithëve. Prandaj, në suren Nas tregohet toleranca dhe mëshira e Zotit (xh. sh.), sepse, edhe pse njerëzit nuk e besojnë të gjithë, Ai përsëri u bën thirrje për t'u treguar se rruga e vetme për të shpëtuar është Rruga Ime.

Pasi këtu flitet për vesvese dhe punë xhindesh, duhet ditur se të gjithë njerëzit e sëmurë nga xhindet, pavarësisht besimit, pas leximit të Kuranit lirohen. Kjo bëhet veçanërisht me këto dy sure. Ashtu siç i shëron Zoti të gjithë njerëzit me Kuran, ashtu i ka vënë edhe emërtim të përgjithshëm kësaj sureje.

### E përgjithshmja e sures Felek dhe e veçanta e sures Nas

Të dyja suret fillojnë me formë të njëjtë *قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ...*; njëra vazhdon me fjalën Felek-*agim*, kurse tjetra me fjalën Nas-*njerëzit*. Kjo të jep të kuptosh se surja Felek është më e përgjithshme, sepse agimi është proces natyror, kurse Nasi është më i veçantë, sepse i flet drejtpërdrejt njeriut.

Nëse u hedhim një vështrim problemeve për të cilat kërkohet mbrojtje në suren Felek, do të shohim se janë probleme të këqija, që mund t'i prekin edhe njerëzit edhe të gjitha krijesat tjera, prandaj edhe fjala Rabb është lidhur me agimin. Në suren Nas, ndërkaq, flitet për një problematikë e cila mund ta prek vetëm njeriun dhe asnjë krijesë tjetër, prandaj

fjala Rabb është e lidhur me fjalën Nas – njerëzit.<sup>112</sup>

Në fillim, në suren Fatiha përdoret folja *إِيَّاكَ نَعْبُدُ*, e cila do të thonë *vetëm Ty të adhurojmë*, kurse në fund, në suren Nas, përdoret emri i Zotit *إِلَهَ النَّاسِ* d.m.th. *i Adhuruari i njerëzve*.

Nëse u bëjmë një analizë të shkurtër këtyre dy fjalëve, ku njëra është folje e tjetra emër, atëherë do të vërejmë se në fillim të Kuranit adhurimi qenkësh paraqitur me folje (pjesë e pandarë e së cilës është veprimi), sepse çdo fillim kërkon punë, kurse në fund është dhënë me emër (që tregon një veti statike dhe të vazhdueshme të dikujt), pra, në fund të Kuranit nuk përdoret folja, por ajo punë duhet të jetë e kryer për një njeri që e ka lexuar Kuranin dhe e ka mbërritur deri në fund, prandaj thjesht tregohet se Ky është i Adhuruari i njerëzve. Thënë shkurt, kjo formë e të shprehurit i flet nënvetëdijes së besimtarit, se Allahu është adhuruar, por ti a je prej adhuresve apo jo - kjo është krejt puna jote.

### Asnjë emër i përveçëm

Allahu (xh. sh.) në këtë sure fisnike ka tubuar shumë vlera dhe çdo shkronjë të saj i ka dhënë kuptimin e duhur.

Po t'i hedhim një vështrim gjithë sures, do të shohim se Zoti (xh. sh.) nuk e ka përfaqësuar vetveten me fjalën Allah, por me Rabb, Melik dhe Ilah. Gjithashtu, as shejtanin (sipas disave, edhe njeriun) nuk e ka theksuar me emrin e tij shejtan apo Iblis, por e ka zgjedhur emrin Ves'vas dhe Hannas. Pastaj, edhe te njerëzit nuk ka veçuar asnjë njeri, por i ka përmendur njerëzit dhe xhindet në përgjithësi, pra, nuk ke-

<sup>112</sup> Uvejd el-Atavij, *Tefsiru sureti en-Nas*,  
<https://www.youtube.com/watch?v=FQWlqFV-hQw>.

mi të përmendur besimtarë apo pabesimtarë, bile as emra të pejgamberëve.

Të gjitha këto paraqiten në këtë formë, edhe pse dihen qartë kush, të në vërtetë, janë ata. Përse, vallë, gjithë ky largim nga paraqitja e drejtpërdrejtë?

Është parim gjuhësor që kur subjekti ka një veti shumë të theksuar, lirisht mund të thirret me vetë cilësorin e tij (mbiemrin) apo llagapin. P.sh. për dikë që është shumë i urtë, themi “melaqe”, apo për dikë që është i keq - “djalli” etj.

Allahu (xh. sh.) në fund të Kuranit na mëson që njerëzit të lidhen me emra, por dhe me cilësi. Pra, Allahu do të adhurohet mirëfilli vetëm atëherë kur do të njihet mirëfilli Rabbi, Meliki dhe Ilahi. Po ashtu, Allahu (xh. sh.) na ka mësuar që të luftohen cilësitë shejtanore, veprat e liga dhe jo vetë emrat e njerëzve.

Fatkeqësisht, sot shumë njerëz thirren tek Allahu, por nuk përfaqësojnë asnjë lloj edukate nga Rabbi, as pushtet nga Meliki dhe, si rezultat, as ibadet të mirëfilltë për Ilahun. Kjo nuk duhet keqkuptuar, se nuk duheshka të përmendet Allahu, por përkundrazi, pasi të jesh i pajisur me këto veti, përmendja e emrit të Allahut të shkëlqejë tek ti. Ose edhe e kundërta: ka shumë njerëz të cilët mallkimin e shejtanit e kanë në majë të gjuhës, por, nga ana tjetër, ata janë vetë shejtani.

Thënë shkurt, kjo sure e ruan identitetin e besimtarit të vërtetë, sepse asnjëherë nuk e lejon atë që të bie pre e emrave, por çdoherë është kërkues i vlerave apo luftues i antivlerave.

### Synimi i sures Nas

Nëse u bëhet një analizë e detajuar ajeteve të sures Nas, do të shohim se ato kërkojnë që ta forcojnë lidhjen e njeriut me Zotin, me krijesat (njerëzit) dhe me vetveten. Pra, në një mënyrë, këto janë boshtet kryesore të veprimtarisë njerëzore në këtë botë. Çdo veprim i njeriut, qoftë i mirë apo i keq, ai e prish ose e rregullon raportin me Zotin, me krijesat dhe me vetveten. Prandaj, Allahu (xh. sh.), pikërisht në fund të Kuranit, e ka përfunduar fjalën e Vet me shtjellimin e kësaj problematike, në mënyrë që robi të jetë i vetëdijshëm se ky Kuran është libër që fuqishëm i mbron këto tri lidhje: me Zotin, me krijesat dhe me vetveten.

Gjithashtu, ka sqaruar se vesvesja është e vetmja ligësi e cila i shkatërron këto tri lidhje. Të gjitha vetitë e tjera e shkatërrojnë njëën prej lidhjeve të përmendura, kurse vesvesja ta këput edhe lidhjen me Krijuesin, edhe me krijesat, por edhe me vetveten. Pra, Kurani përfundon duke i mbajtur raportet shumë të fuqishme me Krijuesin, me krijesat dhe me vetveten.

### **Vendosmëria dhe aktualiteti i besimtarit**

Surja Nas është surja e cila trajton njëën prej çështjeve më delikate të karakterit njerëzor - ajo e lufton fuqishëm vesvesen, kurse efekti i parë dhe më shkatërrues i vesveses është formimi i një karakteri labil. P.sh. nëse njeriu falet dhe shejtani i bën vesvese, atëherë ai menjëherë fillon të dyshojë në namazin e vet, dhe kështu kualiteti i namazit vazhdon të bie; ose, nëse njeriu merr një vendim për kryerjen apo moskryerjen e një pune të caktuar, atëherë shejtani vjen me vesvese dhe përpiqet ta bëjë pishman, ose të paktën t'i futë dyshime në realizimin e asaj pune, e pastaj si rezultat do të bie edhe kualiteti i asaj pune.

Allahu (xh. sh.) jo rastësisht e ka lënë këtë sure në fund të Kuranit, ashtu që çdo iniciativë, çdo ibadet apo çfarëdo veprim ta kryejmë me vendosmëri dhe të paluhatshtëm. Sikur duket, mungesa e tepruar e vendosmërisë për kryerjen e punëve ka bërë që Zoti këtë sure ta vendosë në fund të Kuranit, në mënyrë që njeriut sa herë që të ndahet nga leximi i Kuranit, t'i bëhet me dije që të mos bie pre e karakterit të pavendosur, të cilën e proklamoi shejtani me vesvese.

Nëse i analizojmë fjalët e sures Nas, do të shohim se folja e fundit që përmendet në Kuran është folja يُوسُوسُ 'pëshpërit'. Ardhja e kësaj folje në kohën e tashme kupton:

- Se Kurani është libër aktual;
- Se problemi i vesveses, qoftë shejtanore ose njerëzore, është një çështje që vazhdon të jetë e pranishme në mesin tonë;

Folja e kohës së tashme përfshin gjithë atë që është tani dhe që do të jetë në të ardhmen, pra Kurani na mëson që ta menaxhojmë të tashmen dhe ta projektojmë të ardhmen, prandaj Zoti e ka dhënë në kohën e tashme, në mënyrë që të merremi me probleme aktuale dhe jo me të kaluarën.

### **Përmbyllja e Kuranit**

Sikurse që shihet, Allahu i Madhërishtëm e përfundon Kuranin me fjalën *njerëz* në trajtën e shumësit, dhe atë për disa arsye:

- Kjo tregon se në fund janë njerëzit ata që vendosin për fatin e tyre dhe jo faturën e dështimeve të tyre t'ia plasojnë Zotit;
- Zbatimi i gjithë kësaj që u lexua (i gjithë Kuranit) varet

prej vetë faktit se sa njerëzit do të funksionojnë si bashkësi njerëzore. Pra, terreni i mirëfilltë i Kuranit është shoqëria dhe jo individi;

- I gjithë Kurani mëton që lexuesit dhe praktikuesit e tij, mbi të gjitha, t'i paraqet si njerëz. Pra, njeriu mund të quhet njeri me plotë kuptimin e fjalës vetëm atëherë kur pas do të ketë një Kuran;
- Mos i llogaritni mësimet kuranore me abstraktivitet, por si realitet, që lidhen me njeriun.

Përveç fjalës së fundit të Kuranit, një mësim i rëndësishëm nxirret nga vetë renditja në fund e kësaj sureje.

Surja Nas fund e krye flet për mbrojtjen e njeriut nga e keqja dhe nga shejtani. Allahu (xh. sh.) e përfundon këtë libër duke e lënë njeriun të mbrojtur dhe të sigurt. Gjithashtu, ia lë të qartë kufijtë e veprimit: kundër kujt duhet të luftojë dhe pranë Kujt duhet të afrohet.



## INDEKSI I EMRAVE

- Abazi, 195  
*Ademi*, 23, 22, 23, 39, 94  
 Alemin, 73  
 Alusi, 19, 70, 114, 123, 232,  
 249, 250  
 Arshi, 37  
 Azazil, 22  
 besmeleja, 3, 20, 21, 51, 52, 53,  
 54, 57, 77, 3, 51, 54, 56, 57,  
 20, 51, 52, 54, 56, 64, 71  
 bismilah, 54  
 Davud el-Kajseriu, 13  
*Din*, 129, 130, 136, 137, 148,  
 129, 130, 135, 136, 137, 138,  
 139, 142, 147, 151, 129, 136,  
 140, 151  
 Duha, 5, 155  
 Ebrehaja, 103, 107, 119, 120,  
 123, 118, 120, 100, 104, 111,  
 112, 115, 122, 126, 105  
 Ebter, 167  
 Ebu Hanifja, 43  
 Ebu Lehebi, 191, 192, 193, 196,  
 197, 199, 200, 203, 208, 191,  
 196, 197, 203, 6, 189, 190,  
 191, 192, 194, 197, 198, 199,  
 201, 202, 203, 205, 208  
 Ehad, 211, 212, 213  
 El-Fatiha, 1, 4, 60, 70, 79, 95  
 El-Megamisi, 19  
 El-Melik, 71  
 Er-Rahim, 55, 56, 57, 71  
 Er-Rahman, 55, 56, 71  
 Ez-Zemahsheriu, 19  
 Fahrudin er-Razi, 12, 113  
 Faraonit, 55, 201  
 Fatiha, 67, 68, 71, 76, 77, 80, 84,  
 85, 93, 97, 100, 234, 235, 236,  
 60  
 Fatil bin Salih es-Samurai, 19  
 Felek, 7, 216, 217, 218, 219,  
 220, 221, 224, 235, 236  
 Fil, 97, 98, 100, 102, 104, 106,  
 108, 111, 113, 115, 125  
 fitne, 199  
 Froni, 37  
 hamd, 3, 62, 67, 69, 60, 61, 62,  
 63, 68, 61, 62, 65, 64, 62  
 Hamza, 195  
 hemzeja, 32, 60  
 hemzetu el-vasli, 60  
 Hidri, 63  
 Humezeh, 97, 98, 108  
 ibadet, 4, 32, 34, 35, 79, 81, 95,  
 142, 177, 238, 239  
 ibadetit, 4, 79, 81, 82  
 Iblis, 22, 24, 237, 39, 46, 94, 23  
 Ibrahimimi, 117, 177  
 Ihlas, 6, 7, 207, 208, 210, 211,  
 213, 214, 215, 216, 217, 218,  
 219  
 Ilah, 229, 237, 225, 226, 238

- Isa, 177
- istiadhe, 3, 28, 30, 31, 34, 35,  
40, 42, 48, 27, 30, 34, 45, 49,  
50, 3, 20, 27, 32, 34, 35, 40,  
48, 20, 21, 26, 30, 32, 34, 35,  
36, 44, 49, 50, 3, 20, 27, 28,  
29, 30, 32, 33, 40, 41, 45, 49
- istigfari, 183, 186
- istikameti, 92
- ixhtihadit, 12
- Jemen, 103, 118, 119, 122, 105
- Junus, 179
- Kafirun, 167, 168, 170, 171,  
172, 174, 175, 176, 178, 179,  
181, 182, 189
- Keuther, 151, 152, 153, 154,  
155, 156, 157, 158, 159, 160,  
161, 162, 165, 167, 172
- Keutheri, 5, 6, 151, 154, 155,  
157, 165
- Kuran, 8, 23, 27, 29, 30, 34, 46,  
48, 61, 63, 69, 70, 81, 82, 83,  
88, 93, 98, 132, 153, 154, 156,  
157, 168, 175, 179, 183, 201,  
214, 235, 238, 239, 240, 248,  
249
- Kurani, 3, 8, 9, 13, 14, 24, 27,  
29, 32, 45, 47, 50, 54, 59, 60,  
64, 65, 66, 68, 70, 74, 81, 87,  
113, 133, 182, 190, 195, 202,  
216, 218, 228, 229, 234, 235,  
238, 239, 240, 249
- Kuranin, 3, 8, 35, 47, 51, 54,  
157, 173, 178, 183, 236, 240
- Kuranit, 3, 7, 8, 9, 11, 12, 13,  
14, 15, 16, 19, 21, 27, 29, 33,  
34, 35, 47, 48, 49, 57, 59, 60,  
61, 67, 68, 70, 75, 77, 78, 81,  
86, 87, 97, 174, 218, 228, 232,  
234, 235, 236, 237, 238, 239,  
240
- Kurejsh, 111, 112, 114, 116,  
118, 119, 120, 122, 124, 125,  
126, 128, 129, 146, 4, 111,  
113, 114, 116, 118, 123, 192,  
115, 121
- Luftën e Elefantit, 101, 108
- Luftën e Hunejnit, 106
- Luti, 201, 202
- Mahmud Shems, 15, 19
- Makiaveli, 82
- Maun, 112, 124, 128, 129, 130,  
132, 136, 137, 138, 140, 141,  
147, 148, 149, 151, 152, 160,  
161
- med'h, 61, 62, 60
- Mekë, 103, 105, 126
- Melik, 225, 229, 237
- Mesed, 6, 190, 191, 192, 193,  
199, 201, 205, 207, 208
- Mevdudiu, 19
- Muhamed Ikbali, 19
- Muhamed Safi el-  
Musteganemi, 19
- Muhamedi, 33, 61, 68, 85, 100,  
116, 130, 164, 167, 171, 172,  
175, 176, 177, 178, 182, 183,  
186, 187, 190, 192, 193, 196,  
202, 208, 209, 217, 224, 9,  
116, 154, 163, 164, 168, 169,  
171, 174, 189, 192, 193, 196,  
203, 12, 46, 59, 86, 116, 120,

- 121, 153, 154, 155, 161, 162,  
163, 166, 168, 171, 172, 174,  
177, 184, 186, 189, 192, 193,  
194, 195, 197, 198, 200, 208,  
209, 217
- Muhammed Mutevelli esh-  
Sha'ravi, 19
- Mulla Sadra Shirazi, 13
- Musa, 3, 53, 54, 55
- Musait, 53, 63, 54
- muxhahede, 45
- Nas, 7, 70, 97, 216, 217, 218,  
219, 224, 225, 227, 231, 232,  
235, 236, 238, 239, 240
- Nasr, 168, 170, 181, 182, 183,  
186, 188, 189, 190, 191
- Nëna e Librit, 8, 60
- Nuhi, 56
- Qabe, 103, 111, 121, 122
- qibri, 47
- Qufarët, 176
- Rabb, 225, 229, 236, 237, 70,  
71, 72, 73, 100, 122, 225
- Razi, 19, 33, 35, 38, 43, 53, 63,  
99, 100, 103, 108, 112, 119,  
127, 130, 136, 146, 154, 168,  
170, 173, 179, 192, 196, 202,  
210, 222, 248
- sadaka, 43
- Samed, 211, 212, 213, 217
- sexhde, 22, 39, 44, 94
- Sham, 118, 119
- shehadeti, 45
- shejtan, 22, 23, 24, 28, 36, 41,  
42, 43, 44, 237, 26, 27, 28, 29,  
33, 38, 40, 46, 47, 48, 50
- shukri, 62, 63
- teemmul, 17
- tefekkur, 17
- tefsir, 15
- tefsiri, 13, 15, 121, 124, 160,  
209, 212, 218, 221, 223, 232,  
248, 249, 9, 10, 15, 16, 92
- tesbihi, 183, 186
- teubeja, 186
- Uvejd el-Atavij, 19, 99, 102,  
105, 108, 112, 118, 124, 131,  
137, 141, 146, 152, 154, 158,  
165, 172, 178, 182, 183, 188,  
191, 193, 199, 201, 205, 208,  
211, 213, 215, 217, 220, 223,  
225, 227, 231, 232, 236
- Uzejri, 177
- vakar, 47
- xhehenemi, 34, 57
- xheneti, 34, 37, 38, 39, 189
- xhind, 50
- zuhdi, 45
- Zumer, 179



## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Bardhi, Ismail. *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur-anore*, Shkup: Logos-A, 1998.
2. Čauševića, Džemaludina. *Arapska stilistika Islamska mis-a*, El-Kalem.
3. Duraković, Esad dhe Kurić, Lutvo. *Kuran sinteza estetsk-og i matematickog*, Tugra.
4. Duraković, Esad. *Stil kao argument, nad tekstom Kurana*, Tugra:
5. Ebu el-Hasen Hixham el-Mahxhubi dhe Vedi er-Radi. *Tefsiru el-istiadheti*, Rijad: 2015.
6. Ebu El-Kasim, Muhamed bin Ahmed bin Xhuzij El-Kel-bij. *Et-Tes'hil li ulumi et-tenzil I*, Bejrut: Dar el- Kutub el-Ilmijeh, 1995.
7. Ebu Sulejman, Abdulhamid. *Botëkuptimi kuranor*, Shkup: Logos-A, 2014.
8. El-Bejdaviu, *Envaru et-tenzil ve envaru et-te'vili, Vëllimi I, Daru Ihjai et-Turathi el-arabijji*, Bejrut.
9. Esh-Sheukani. *Fet'hu el-Kadir*, Vëllimi I, El-Marifetu, 2007.
10. Fadil bin Salih es-Samurai. *Ala tariki et-tefsiri el-bejanijji 1*, Sharika, 2002.
11. Fadil bin Salih Es-Samurai. *Lemesatun bejanijjetun fi nus-usi et-tenzili*, Aman: Dar Ammar, 2003.
12. Fahrudin Er-Razi. *Mefatihul Gajb I*, Bejrut: Dar el-Fikr, 1981.
13. Faqić, Almir. *Kuranski semantički kontekst*, El-Kalem.
14. Gorgun, Tahsin. *Kuptimi dhe interpretimi i teksteve fetare*, Shkup: Logos-A.

15. Gormez, Mehmet. *Metodologjia hermeneutike e studimit të hadithit*, Logos-A.
16. Ibn Kethiri. *El-Bidajetu ve en-nihajetu*, Vëllimi III, Daru Hixhr li Et-Tabaatu ve en-Neshri ve et-Teuzi'i ve el-I'lami, 1997.
17. Ibn Mendhur. *Lisanu el-Arabi*, Vëllimi VI.
18. Imam Ahmedi. *El-Musnedu*, Vëllimi XIV, Muessesetu Er-Risaleh, 2001.
19. Izeti, Metin. *Dyzet netë I-II*, Logos-A, 2015.
20. Kariç, Enes. *Hermeneutika Kurana*. Zagreb: 1990.
21. Kariç, Enes. *Kuran u sovremenu dobu I-II*. Sarajevë: 1997.
22. Kariç, Enes. *Semantika Kurana*. Sarajevë: 1998.
23. Latiç, Xhemaludin. *Stil Kuranskog izraza*, El-Kalem.
24. Merkezu tedebburin li ed-dirasati ve el-istisharati. *Li jeddebberu ajatili 1-10*, Rijad: 2012.
25. Minter, Adam. *The Harvard Review of Philosophy*, Vëllimi I, 1992.
26. Muftiç, Teufik. *Klasicna arapska stilistika*, El-Kalem.
27. Muhammed Kerim El-Kevvaz. *El-Uslubu fi el-I'xhazi el-belagijji li el-Kurani el-kerimi*, Bengazi: Dar El-Kutubi el-vetanijetu, 1426.
28. Muhammed Mutevel-li Esh-Sha'ravi. *Havatiri havle el-Kur'ani el-kerimi*, Egjipt: Ahbar el-jeumi, 1991.
29. Muhammed Shukri El-Alusi. *Ruhu el-meani fi tefsiri el-Kur'ani el-kerimi ve es-seb'u el-methani*, Bejrut: Idaretu et-tabaati el-munirijjeti.
30. Ramiç, Jusuf. *Arabska stilistika – U svjetlu Kurana i hadisa Allahova poslanika*, El-Kalem.
31. Ramiç, Jusuf. *Naši prijevodi Kurana i stil kuranskog izraza*, Connectum.
32. Shihabuddin el-Alusi, *Ruhu el-Meani – tefsiru el-Alusi*,

Vëllimi I, Dar el-Kutub el-Ilmijeh.

33. Xha'fer El-Garnatijj. *El-Burhanu fi tertibi suveri el-Kur'ani*, Marok: 1990.

34. Zemahsheri. *El-Kesh-shafu*, Vëllimi III.

35. <http://islamiyyat.3abber.com/>

36. <http://www.alatwi.net/inf/>

37. <https://www.youtube.com/user/DrAlatawi>



*Botimi (i parë) i këtij libri doli në dritë falë zemërgjerësisë dhe kontributit të rinisë së Xhamisë së Altendorfit të Zvicrës, të cilët i falënderojmë për zemërsisht dhe i lutemi Zotit të Madhërishtëm që bereqetin e Tij ta korrin në këtë dhe në Botën Tjetër!*